





*Eruditi, juristi dhe komentuesi*  
**NASER MEKARIM SHIRAZI**

## **KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT**

*(Xhuzi i katërt)*

***TIRANË, 2013***

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

***(Xhuzi i katërt)***

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

***Naser Mekarim SHIRAZI***

E përktheu nga arabishtja: ***Agim REÇAJ & Vullnet MERJA***

E redaktoi: ***Jerida KULLA***

Korrektura teknike: ***Sonila QAZIMI***

Përkujdesja grafike: ***Vullnet MERJA***

Kapaku: ***Sabrie Feza***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***"LILO"***

## Ajeti 92

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ ۚ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ

عَلِيمٌ ﴿٩٢﴾

**Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, All'Ilahu e di mirë atë.**

### Komentimi

#### Shenjat e besimit

**“Nuk keni për të arritur përkushtimin e vërtetë derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni.”**

Fjala *el berr'rru* vjen nga gjuha arabe dhe do të thotë *gjerësi, bollëk, begati, pasuri*. Edhe fjala *el berr'rru* - *shkretëtirë*, quhet e tillë për shkak të gjerësisë dhe hapësirës së madhe që ka. Gjithashtu, edhe punët e mira, me ndikim të gjerë, që përfshijnë edhe të tjerët, quhen *el berr'rru*.

Kurse fjala *el hajru*, nënkupton dobinë që u shkon të tjerëve, qoftë edhe pa qëllim.

Ndryshimi mes fjalës *el berr'rru* dhe *el hajru*, nga ana gjuhësore, është se fjala *berr'rrun* nënkupton dobinë që u shkon të

tjerëve, bazuar te qëllimi. Kurse fjala *el hajru*, nënkupton dobinë që u shkon të tjerëve, qoftë edhe pa qëllim.

### **Çfarë do të thotë fjala *el birr'rru* në këtë ajet?**

Komentuesit kanë dhënë disa mendime për shpjegimin e kësaj fjale: Disa kanë thënë se kjo fjalë nënkupton *Xhennetin*, të tjerë *bindjen* dhe *devotshmërinë*, disa të tjerë thonë se kjo fjalë nënkupton *shpërblimin e mirë*.

Duke e parë brenda kontekstit të ajeteve kur'anore, fjala *el birr'rru* ka kuptim të gjerë, që përfshin të gjitha llojet e mirësisë, si nga aspekti i besimit, ashtu edhe nga veprat e mira.

Bazuar në ajetin 177 të sures "El-Bekare", *el birr'rru* është: besimi te All'llahu, besimi në Ahiretin, besimi te profetët, përkrahja e nevojtarëve, namazi, agjërimi, plotësimi i premtimeve, palëkundshmëria në kohë skamjeje, lufte e sëmundje. Të gjitha këto janë pjesë e mirësisë dhe e vërtetësisë së saj.

Kështu që, për të arritur shkallën e punëmirëve të vërtetë ka shumë kriterë. Prej tyre është të jepet lëmoshë nga pasuria që njeriu do, sepse dashuria e vërtetë duhet të jetë vetëm për All'llahun e Lartësuar. Lidhja e njeriut me vlerat e larta morale dhe njerëzore qartësohet kur njeriu arrin në fundin e dy rrugëve dhe gjendet përballë dy zgjedhjeve e s'ka të tretë. Mund të ndodhet në një situatë që duhet të zgjedhë pasurinë, postin, pozitën që i pëlqen, ose të zgjedhë kënaqësinë e All'llahut, singëritetin e ndjenjave, kryerjen e veprave të mira. Ai duhet të zgjedhë njërën prej këtyre dy zgjedhjeve dhe të flijojë tjetrën për të. Nëse i mbyll sytë për të parën, për të gjykuar të dytën, vërtetohet singëriteti i njiçitit të tij të pastër, argumentohet

dashuria dhe realiteti i tij për ngritjen dhe zhvillimin e anës shpirtërore.

E nëse kufizohet në këtë rrugë, duke dhënë të dobëtën, të paktën, atë që nuk e dëshiron, kjo do të thotë se ai nuk është i kënaqur me veten e tij. Ky veprim është argument për mungesën e besimit dhe lidhja shpirtërore me All'llahun nuk është në gradë të lartë.

Ky veprim, dhënia dhe lëmosha, është tregues i forcës së besimit.

### **Ndikimi i Kur'anit në zemrat e myslimanëve**

Ajetet e Kur'anit të Shenjtë ndikonin shumë shpejt në mendjet dhe zemrat e myslimanëve të parë. Ata, sapo dëgjonin një ajet të sapozbritur e shfaqnin ndikimin e atij ajeti në sjelljet dhe veprat e tyre. Po tregojmë si shembull atë çfarë lexojmë në librat e tefsirit dhe në historinë islame rreth zbritjes së ajetit në fjalë:

1) Ebu Talha ka qenë ndër ensarët e Medines, që ka pasur hurma të shumta. Pasuria e tij më e dashur kanë qenë palmat e *bejrhasë*, të cilat kanë qenë përballë xhamisë. I Dërguari i All'llahut hante dhe pinte në këtë kopsht. Kur zbriti ajeti kur'anor: *"Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, All'llahu e di mirë atë"*. Ebu Talha i tha Profetit: "O i Dërguari i All'llahut. All'llahu thotë se nuk keni për ta arritur devotshmërinë deri sa të ndani atë që e doni më shumë nga pasuria juaj dhe pasuria ime më e dashur është *bijrha*. Atë do ta jap lëmoshë për hir të All'llahut, duke shpresuar që të jetë mirësi dhe thesar për mua tek All'llahu. Merre o i Dërguar dhe vendose atje ku do All'llahu."

Profeti i tha: “Urime, urime. Ajo është fitim i madh për ty. Unë i dëgjova ato që the dhe kam mendimin që ta ndash te të afërmit e tu.” Ebu Talha tha: “Bëje o i Dërguari i All’llahut.”

Atëherë Ebu Talha ua ndau të afërmit të vet dhe fëmijëve të xhaxhait të tij.<sup>1</sup>

2) Ebu Dherr El Gaffari ftoi një mysafir në shtëpinë e tij dhe i tha: “Unë jam i zënë me punë por, meqë kam deve, shko e më sill më të mirën prej tyre.”

Mysafiri shkoi e i solli një deve të dobët. Ebu Dherri i tha: “Me këtë zgjedhje më ke tradhtuar mua.”

Mysafiri iu përgjigj: “Unë e gjeta devenë më të mirë mashkull, por kujtova ditën që ti ke nevojë për të dhe nuk e solla.”

Ebu Dherri i tha: “Me të vërtetë, dita kur unë do të kem nevojë për të është dita kur do të vendosem në varr. All’llahu i Lartësuar thotë: ***“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë derisa të ndani nga ajo (pasuri) që e doni.”***<sup>2</sup>

3) Zubejdetu, bashkëshortja e Harun Reshedit, ka pasur një mus’haf - (Kur’an) të shtrenjtë dhe kopertina e tij ishte e zbukuruar me xhevahiret më të shtrenjta. E dëshironte shumë këtë Kur’an, sa nuk e lëshonte nga dora dhe krenohej me të.

Një ditë lexoi fjalën e All’llahut të Lartësuar: ***“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni.”*** Meditoi rreth këtij ajeti. Ky ajet e preku shumë, sa iu drejtua vetes: “Me të vërtetë, nuk ka gjë tjetër më të dashur

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, Sahih Muslim, Sahih Buhari, “Mustedrekul Vesail”, vëllimi 7 faqe, 148-149.

<sup>2</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëllimi 2, faqe 474.

tek unë se sa ky Kur'an i zbukuruar më gurë të çmuar. Do ta shpenzoj në rrugën e All'lahut."

I dërgoi këta gurë të çmuar tek argjendari dhe me vlerën e tyre hapi puse uji dhe ndërtoi ujëmbledhës në shkretëtirën e Hixhazit, për të pirë ujë banorët e shkretëtirës dhe udhëtarët. Thuhet se këto puse janë akoma dhe njerëzit i quajnë me emrin e saj.<sup>1</sup>

Duhet të qetësohen hipokritët se çdo gjë që japin ose shpenzojnë në rrugët e All'lahut nuk humbet dhe nuk shuhet. All'llahu i Lartësuar i nxit njerëzit që të japin lëmoshë nga ajo që dëshirojnë më shumë. Prandaj All'llahu i Lartësuar thotë: *"Çfarëdo që të ndani, All'llahu e di mirë atë."*

Me të vërtetë, All'llahu e di më së miri çfarë ju jepni lëmoshë e shpenzoni në rrugën e Tij, qoftë e vogël apo e madhe, e doni apo nuk e dëshironi.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Ruhul Xhinan", vëllimi 3, faqe 157. "Taxhul Arus", vëllimi 7, faqe

## Ajetet 93- 95

كُلُّ الطَّعَامِ كَانَ حَلَالًا لِّبَنِي إِسْرَءِيلَ إِلَّا مَا حَرَّمَ إِسْرَءِيلُ عَلَى نَفْسِهِ  
مِن قَبْلِ أَنْ تُنَزَّلَ التَّوْرَةُ ۚ قُلْ فَأْتُوا بِالتَّوْرَةِ فَاتْلُوهَا إِن كُنتُمْ  
صَادِقِينَ ﴿٩٣﴾ فَمَنْ أَفْتَرَى عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ مِنْ بَعْدِ ذَٰلِكَ فَأُولَٰئِكَ  
هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٩٤﴾ قُلْ صَدَقَ اللَّهُ فَاتَّبِعُوا مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا وَمَا كَانَ مِنْ  
الْمُشْرِكِينَ ﴿٩٥﴾

**“Të gjitha ushqimet kanë qenë të lejuara për bijtë e Izraelit, përveç asaj që Izraeli ia ndaloi vetes para shpalljes së Teuratit. Thuaj (o Muhammed): “Silleni Teuratin dhe lexojeni atë, nëse thoni të vërtetën!”**

**E kushdo që shpif gënjeshtër për All’llahun, pas kësaj ai ka kaluar nga e drejta në të shtrembrën.**

**Thuaj (o Muhammed!): “All’llahu thotë të vërtetën, prandaj ndiqeni fenë e pastër të Ibrahimit, i cili nuk ishte idhujtar.”**

## Shkaku i zbritjes

Nga transmetimet e ardhura për këto ajete dhe nga ajo çfarë na kanë përcjellë komentuesit e Kur'anit, përfitohet se jehudinjtë, gjatë debateve të tyre me profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i kanë parashtruar të Dërguarit të All'lahut dy probleme të tjera:

I pari: Pse e kishte lejuar të përdorej mishi dhe qumështi i devesë, kur ato kanë qenë të ndaluara në fenë e Ibrahimit? Ata thoshin: “Çdo gjë që e ndalojmë tani, ka qenë e ndaluar edhe për Nuhun dhe Ibrahimin. Si e lejon ti këtë dhe pretendon se je pasues dhe ndjekës i fesë së tij?”<sup>1</sup>

I dyti: Namazi i profetit kah Qabja. Ata thoshin: “O Muhammed. Si pretendon se je pasues i fesë së Ibrahimit dhe i profetëve të mëdhenj, ndërkohë që të gjithë profetët me prejardhje nga Is'haku drejtoheshin nga Bejtul Makdis dhe faleshin në atë drejtim, kurse ti falesh kah Qabja dhe jo nga Bejtul Makdisi?” Atëherë zbritën tre ajetet e lartpërmendura, që u përgjigjen atyre për problemin e parë. Ndërsa ajetet në vijim i përgjigjen problemit të dytë.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në fjalë.

<sup>2</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në fjalë.

## Komentimi

Ajeti i parë nga këto tre ajete ka hedhur poshtë mendimin e jehudinjve rreth ndalimit të disa llojeve të ushqimeve të begata, si mishi dhe qumështi i devesë dhe i kundërpërgjigjet kësaj gënjeshtre me fjalën e All'llahut të Lartësuar: **“Të gjitha ushqimet kanë qenë të lejuara për bijtë e Izraelit, përveç asaj që Izraeli<sup>1</sup> ia ndaloj vetes para shpalljes së Teuratit.”**

Për sa i përket thënies: Pse ia ndaloj Jakubi vetvetes disa ushqime? Cilat janë llojet e ushqimeve që ia ka ndaluar vetes së tij? Në këtë ajet nuk ka ardhur asnjë sqarim rreth kësaj çështjeje. Ne mund ta shpjegojmë nga disa transmetime islame.

Jakubi, sikurse thuhet, sa herë që ushqehet me mishin e devesë, e ngacmonte nervi shiatik<sup>2</sup>. Prandaj u zotua se, nëse All'llahu e shëronte atë, nuk do ta hante mishin e devesë. Ndjekësit e tij e kanë zbatuar si rregull mos ngrënien e mishit të devesë. Më pas kjo çështje ka shkaktuar shumë diskutime.

---

<sup>1</sup> Israjil (Izrael) është emri tjetër i Ja'kubit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*).

<sup>2</sup> Nervi shiatik është ai nerv që i nervon muskujt e pasmë të kofshës dhe të kërcit. Shtypja e këtij nervi nga një hernie fiskale, që del nëpërmjet vertebrës së 5-të lumbare dhe së parës sakrale (L 5- S 1), jep dhembje që përhapet në të gjithë pjesën ku kalon ai. Kur hernia diskale del nëpërmjet vertebrës së 4-të lumbare, dhe vertebrës së 5-të lumbare, ajo shtyp nervin e 5-të lumbar dhe vertebrën e 1 sakrale (S1). Simptomat e kësaj sëmundjeje janë: mpirja e gjymtyrëve të poshtme (këmbëve), dhembje e fortë dhe pamundësi ecjeje në distanca të gjata. Shkaqet më të rëndësishme të kësaj sëmundjeje janë: malcimi i nervit shiatik dhe rrëshqitja kërcore (hernia diskale) që shkaktonte shtypjen e këtij nervi (shih: [www.mjekesiabimorearabe.com/semundje/nervishiatik.php](http://www.mjekesiabimorearabe.com/semundje/nervishiatik.php)).

Disa e kanë menduar se kjo është një ndalesë nga All'llahu, të tjerë e kanë konsideruar si ligj dhe këtë ligj ia kanë dedikuar All'llahut.<sup>1</sup> Ata pretendonin se All'llahu ua ka ndaluar atyre ngrënien e mishit të devesë. Atëherë, ky ajet zbriti për të përgënjeshtuar këtë supozim, duke ua qartësuar shkakun e mos ngrënies dhe duke u dhënë fund diskutimeve dhe dilemës. Ajeti sqaron se thënia e tyre, që ky ndalim është ligj nga All'llahu, është një shpifje.

Duke u bazuar në këtë, të gjitha llojet e ushqimeve kanë qenë të lejuara. Dhe çdo gjë që ka qenë e mirë, nuk ka qenë e ndaluar ndaj bijve të Izraelit, përpara se të zbriste Teurati, ashtu siç thotë fjala e All'llahut të Lartësuar: **“Para shpalljes së Teuratit.”** Edhe nëse janë ndaluar – pas zbritjes së Teuratit dhe ardhjes së Musa Ibn Imran – disa ushqime të mira për bijtë e Izraelit, nuk janë ndaluar vetëm nga padrejtësia dhe mëkatet e tyre. Për të vërtetuar këtë të vërtetë, All'llahu i Lartësuar, me anë të këtij ajeti, e urdhëroi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të kërkonte nga jehudinjtë ta sillnin Teuratin që ekzistonte në mesin e tyre, që ta lexonin atë dhe të zbardhnin gënjeshttrat e pretendimit të tyre: **“Thuaj (o Muhammed!) “Silleni Teuratin dhe lexojeni atë nëse thonë të vërtetën!”**

Por ata e refuzuan këtë kërkesë, sepse e dinin shumë mirë se Teurati nuk e përmbante këtë ndalesë që ata pretendonin.

Dhe tani, pasi u qartësua përgënjeshtrimi dhe shpifja e tyre ndaj All'llahut të Lartësuar, duke mos iu përgjigjur kërkesës së Profetit, ata duhet ta dinë se çdo shpifje a gënjeshtër ndaj

---

<sup>1</sup> Biharul Anuar, vëll. 9, f. 191.

All'llahut cilësohet padrejtësi, sepse me këtë shpifje bëhet padrejtësi, jo vetëm ndaj All'llahut, por edhe ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve, pasi veten e çon drejt dënimit dhe të tjerët drejt devijimit, duke i larguar nga rruga e drejtë.

Ky është edhe kuptimi i fundit i këtij ajeti që thotë: **“E kushdo që shpif gënjeshtër për All'llahun, pas kësaj ai ka kaluar nga e drejta në të shtrembrën.”**

### **Teurati në qarkullim dhe ndalimi i mos ngrënies së disa lloje kafshësh**

Në kapitullin e njëmbëdhjetë të Librit të Levitikut prej Seferul Euelijne, në sqarimin e mishrave të ndaluar e të lejuar thuhet: “Zoti foli me Moisiun e me Aronin: “U tregoni bijve të Izraelit. Këto janë kafshët që mund t’i hani prej të gjitha kafshëve të tokës: “Hani çdo kafshë që ka thundër plotësisht të ndarë dhe që ripërthypet. Por mos hani prej atyre që ripërthypen ose e kanë thundrën e ndarë; (deveja) se edhe pse ripërthypet, nuk e ka thundrën e ndarë! Çmoje ndër të papastrat.” (1-4)

Nga këto shprehje kuptojmë se jehudinjtë e kanë pasur të ndaluar ngrënien e mishit të kafshëve që kanë thundra e në veçanti devenë (gamilen), por kjo nuk tregon se ajo ka qenë e ndaluar në legjislacionin (Sheriatin) e Nuhut dhe të Ibrahimit. Ka mundësi të jetë e ndaluar vetëm për jehudinjtë, për shkak të mëkateve të tyre.

Për këtë, jehudinjtë nuk kanë asnjë argument për pretendimet e tyre. Përderisa atyre iu qartësua vërtetësia e fjalës së të Dërguarit të All'llahut dhe se profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është në fenë

e Ibrahimit dhe se feja e tij është e pastër dhe e vërtetë, atëherë është detyrë e tyre që ta ndjekin atë në këtë fe.

All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj (o Muhammed!): “All'Ilahu thotë të vërtetën, prandaj ndiqeni fenë e pastër të Ibrahimit, i cili nuk ishte idhujtar.”** Pra, ndiqeni fenë e pastër të Ibrahimit, i cili nuk ka anuar në asnjë gjë, por ka ecur në rrugën e drejtë. Në fenë e tij nuk ka pasur ligje që shmangeshin nga e drejta, qoftë edhe për të ngrënit apo të pirit. Për çdo gjë ai ka pasur argumente. Asgjë nuk e ka ndaluar pa shkak. Me të vërtetë, ai nuk ka qenë prej idhujtarëve dhe u bën thirrje idhujtarëve arabë që të ndjekin fenë e tij të pastër, që të adhurojnë vetëm Zotin që është Një. Aty ku është adhurimi i idhujve, aty është shkatërrimi.

Është e vlefshme të përmendet se Kur'ani i Shenjtë e përsërit këtë cilësi **“i cili nuk ishte idhujtari”** në çështjen e Ibrahimit dhe këtë gjë e përforcon në shumë vende. Kjo nuk është gjë tjetër përveç se arabët injorantë, idhujtarë e kanë quajtur fenë dhe besimin e tyre si fenë e Ibrahimit. Ata kanë supozuar e kanë trumbetuar se janë në fenë e tij dhe se janë ndjekësit e tij. Kur'ani e mohon idhujtarinë e Ibrahimit dhe vërteton se ai ka qenë i pastër dhe se asnjëherë nuk ka qenë prej idhujtarëve.<sup>1</sup> All'Ilahu e ka shkatërruar këtë thirrje të shpifur për ta pastruar personalitetin e këtij profeti të madh.

---

<sup>1</sup> Fjalja **“nuk ishte idhujtar”** përmendet edhe në: suren “Ali Imran”, ajeti 67 dhe 95; në suren “En'am”, ajeti 79 dhe 161; në suren “Nahl”, ajeti 120 dhe 123; në suren “El-Bekare”, ajeti 135.

## Ajetet 96 – 97

إِنَّ أَوَّلَ بَيْتٍ وُضِعَ لِلنَّاسِ لَلَّذِي بِبَكَّةَ مُبَارَكًا وَهُدًى لِّلْعَالَمِينَ ﴿٩٦﴾ فِيهِ  
آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ مَّقَامُ إِبْرَاهِيمَ <sup>ص</sup> وَمَن دَخَلَهُ كَانَ ءَامِنًا <sup>ط</sup> وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ  
الْبَيْتِ مَن أَسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا <sup>ج</sup> وَمَن كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ ﴿٩٧﴾

**“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekke), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.**

**Në të ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit (mekami Ibrahim); kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, All'illahu është i Vetëmjaftueshëm ndaj krijesave.”**

## Komentimi

### Shtëpia e parë e ngritur për njerëzimin

Jehudinjtë, sikurse e kemi treguar më lart, i mohuan profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dy çështje. Në tre ajetet që komentuam më lart, Kur'ani iu kundërpërgjigj çështjes së parë. Ajetet në fjalë i përgjigjen çështjes së dytë, që ishte kundërshtimi i marrjes së Qabes si

drejtim për t'u falur dhe dhënies përparësi asaj më shumë se Bejtul Makdis, të cilën jehudinjtë e quanin më të mirë se Qabeja.

All'llahu i Lartësuar thotë: **“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekkë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.”** Nuk kemi pse të çuditemi, pse Qabeja është kibleja e myslimanëve. Ajo është epiqendra e parë për njësimin e All'llahut dhe faltorja më e vjetër mbi sipërfaqen e tokës, e ngritur për njerëzit që të adhurojnë All'llahun e Lartësuar. Asnjë faltore tjetër nuk është ngritur përpara saj. Është faltorja e parë e ngritur për të mirën e njerëzimit. Ajo është e vendosur në atë tokë të mbushur me mirësi e begati. E ngritur për t'i tubuar njerëzit e për t'u takuar me njëri-tjetrin.

Me të vërtetë, burimet islame dhe historia na tregojnë se Qabeja është themeluar dhe është ngritur nga duart e Ademit. Pastaj është shkatërruar nga tufani (përmbytja), në kohën e Nuhut. Atë e ringriti profeti Ibrahim. Ajo është e lashtë sa vetë historia e njerëzimit.<sup>1</sup>

S'ka dyshim se zgjedhja e Shtëpisë më të lashtë, e ngritur për monoteizmin, që të jetë kibleja e myslimanëve, është zgjedhja më e përkryer. Është e rëndësishme të themi se Qabeja njihet edhe me emra të tjerë, si: “Shtëpia e All'llahut”. Në këtë ajet është quajtur “Shtëpia për njerëzit”. Ky emërtim zbulon të vërtetën e madhe se çdo gjë që është me emrin e All'llahut, është për Të, duhet të jetë në shërbim të njerëzve nga adhuruesit e tij. Çdo gjë, që është në shërbim të njerëzve dhe për adhuruesit e mirë, është për All'llahun e Lartësuar.

---

<sup>1</sup> Për më tepër njohuri kthejuni burimeve, ajeteve kur'anore dhe haditheve. Në veçanti, komentimit të ajetit 127 të sures “El-Bekare” të këtij komentimi.

**“Në të ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit (mekami Ibrahim); kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, All’llahu nuk ka nevojë për askënd.”**

Në këtë ajet qartësohet vlera e së lashtës në lidhjen ndërmjet krijesës dhe Krijuesit. Në këtë ajet tregohet për lashtësinë e Qabes.

Historia e saj e gjatë, e gërshetuar me ngjarjet e kohëve të lashta është një nga veçoritë dalluese të mirësisë së Qabes. Këtu qartësohet shkaku pse Guri i zi është i shenjtë, si dhe u jepen përgjigje pyetjeve: Cila është vlera e Gurit të zi? Përse për çdo vit miliona njerëz nxitojnë ta prekin? Përse ata interesohen për të, deri sa prekja e tij është një prej riteve të pëlqyera të Haxhit?

Historia e Gurit të zi është shumë interesante. Është guri i parë i përdorur për ndërtimin e Qabes. Elementet përbërëse të Gurit të zi nuk gjenden në asnjë material tjetër.

Të gjithë e dimë se të gjitha vendadhurimet deri edhe Qabeja, i kanë humbur lëndët e para ndërtuese prej prishjeve dhe rikonstruksioneve, me përjashtim të Gurit të zi, që ka qëndruar me mijëra vite dhe është përdorur për ndërtimin e kësaj ndërtese madhështore. Nuk ka dyshim se kjo vazhdimësi dhe kjo lashtësi në rrugën e All’llahut të Lartësuar dhe në shërbimin ndaj njerëzve ka vlera që nuk mohohen.

Ky gur është një histori e heshtur për breza të shumtë besimtarësh në kohë të ndryshme. Ai ringjall përkujtimin dhe dorëzimin e profetëve të mëdhenj dhe na kujton adhurimin e përgjërimit e adhuruesve të sinqertë të All’llahut përgjatë mijëra viteve.

Është një çështje tjetër që duhet theksuar: ajeti në fjalë thotë qartë se Qabeja është shtëpia e parë e ngritur për njerëzit. Dihet se ajo u ngrit për qëllim adhurimi. Për këtë ajo është shtëpia e parë që është vendosur për adhurim.

Ky përshkrim është përgjigje e qartë<sup>1</sup> ndaj të gjithë atyre që supozojnë se profeti Ibrahim është ai që e ka themeluar dhe e ka ndërtuar Qaben e Shenjtë.

Adhurimi i All'llahut ka qenë edhe para kohës së profetit Ibrahim. Atëherë si ka mundësi që Qabeja është ndërtuar nga duart e profetit Ibrahim?

---

<sup>1</sup> I tillë është Reshid Rida, autori i tefsirit "El-Menar".

## Hulumtime

### Cili është kuptimi dhe qëllimi i fjalës Bekkeh?

Fjala *bekkeh* rrjedh nga fjala *el bek*, që do të thotë trafik, dendësi. *Tabaken-nasu* do të thotë që njerëzit janë tubuar, janë grumbulluar. Tokës ku është ndërtuar Qabeja i është thënë *bekketu* – *vendgrumbullim dhe dyndje e njerëzve*. Emërtimi i saj me këtë emër është bërë kur ka marrë sifatin (emrin) zyrtar si vend adhurimi.

Në transmetimin e Ebu Abdullah es Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Vendi i shtëpisë quhet *Bekkeh*, kurse vendbanimi quhet *Mekke*.”<sup>1</sup>

Disa komentues të Kur'anit kanë supozuar se *Bekkeh* është e njëjta fjalë *Mekke*, vetëm se i është ndryshuar germa *m* në *b*, si te fjala *lazib* – *lazim*, të cilat kanë të njëjtin kuptim në gjuhën e arabëve.

Ka edhe një tjetër shkak të emërimit me fjalën *bekkeh*. Është quajtur e tillë, sepse ajo thyen qafat e tiranëve dhe shkatërron mendjemadhësinë dhe kokëfortësinë e tyre. Në Qabe zhduken të gjitha dallimet dhe ndryshimet artificiale dhe mendjemëdhenjtë bëhen si njerëzit e tjerë. Atëherë është detyrë e tyre që t'i binden, t'i përulen dhe t'i luten All'Ilahut, se çështja e tyre është si çështja e të tjerëve dhe me këtë shkatërrohet mendjemadhësia e tyre.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> “Men la jahdurul fakijh”, vëllimi 2, faqe 193.

<sup>2</sup> “Usulul Kafijj”, vëllimi 4, faqe 211.

## Zgjerimi i Mesxhidi Haramit (Qabes)

Që në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) numri i myslimanëve në botë filloi të shtohet. Gjithashtu, është shtuar edhe numri i Haxhinjve që vizitojnë Shtëpinë e Shenjtë. Prandaj, Bejtul Haram (Qabeja) ka pasur një zgjerim të vazhdueshëm në duart e udhëheqësve në kohë të ndryshme.

Nga tefsiri "Ajjashi" lexojmë se Ebu Xha'fer El Mensuri kërkoi nga banorët e Mekës që të blinte shtëpitë e tyre për të zgjeruar xhaminë, por ata nuk pranuan. Edhe pse i detyroi, ata nuk pranuan. Ai u shqetësua shumë. Një ditë shkoi te Ebu Abdullahu (Sadik) dhe i tha: "Me të vërtetë, unë u kërkova atyre diçka nga shtëpitë e tyre, që të zgjeroj xhaminë. Ata ma ndaluan këtë gjë. Unë jam shumë i shqetësuar."

Ebu Abdullahu i tha: "Argumenti yt është shumë më i qartë se i atyre."

Ebu Xhafer El Mensuri i kërkoi mendim se si t'ua argumentonte atyre këtë çështje. Ebu Abdullahu iu përgjigj: "Me Librin e All'llahut."

Ebu Xhafer El Mensuri e pyeti: "Po me cilën fjalë?"

Ebu Abdullahu i tha: "Me këtë fjalë të All'llahut të Lartësuar: **"Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt."**

All'llahu i Lartësuar sapo të ka lajmëruar se faltorja e parë, që është ngritur e është ndërtuar për njerëzimin, është ajo e Bekkes në Mekë. Nëse ata janë përpara faltores në atë vend, atëherë ata do të shkatërrojnë shtëpitë e tyre e nëse faltorja ka qenë përpara tyre në atë vend, atëherë është e drejta e tij që t'i shkatërrojë ata."

Ebu Xha'fer El Mesuri i ftoi ata dhe ua kumtoi atyre këtë ajet. Ata u bindën dhe i thanë që të veprojnë ashtu si dëshironte.<sup>1</sup>

Po në tefsirin “Ajjashi” thuhet se kur Mehdiu (nga dinastia Abasite) bëri zgjerim në Xhaminë e Shenjtë dhe donte ta bënte në formë katrore kishte disa shtëpi. Ua kërkoi pronarëve të shtëpive, por ata nuk pranuan. Mehdiu abasit pyeti dijetarët për këtë çështje. Dijetarët iu përgjigjën se nuk lejohet të merret diçka me forcë e të përfshihet në Mesxhidul Haramin.

Ali ibn Jektijn i tha atij: “O prijësi i besimtarëve, sikur t'i shkruash Musa ibn Xha'ferit, ai do të të japë ty një mendim për këtë çështje.” Ai i shkroi guvernatorit të Medines që ta pyeste Musa ibn Xha'ferin për shtëpitë që duan t'i prishim dhe të zgjerojmë Mesxhidin Haram, pasi pronarët refuzojnë ta japin. Çfarë rrugëzgjidhje do t'i jepte kësaj çështjeje? Guvernatori shkoi te imam Musa ibn Xha'feri dhe ia paraqiti çështjen. Imami i tha: “Patjetër duhet përgjigje për këtë?” Guvernatori iu përgjigj: “Është çështje e domosdoshme.”

Ebu Hasani, imam Musa ibn Xha'feri (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha që të shkruajë: “*Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Nëse Qabeja është vizitore tek njerëzit, atëherë oborri u takon atyre (që nuk ndodh<sup>2</sup>). Dhe nëse njerëzit janë vizitorë të Qabes, atëherë oborri i takon Qabes.*”

Kur i erdhi mesazhi Mehdisë, e puthi dhe u gëzua shumë. Pastaj urdhëroi që shtëpitë të shkatërrohen. Pronarët e shtëpive shkuan tek Ebu Hasani, imam Musa ibn Xha'feri dhe i kërkuan që t'i shkruajë Mehdiut një letër për vlerën e shtëpive të tyre. Ai i

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Ajjashij”, vëllimi 1, faqe 185. “Vesailu Shijja”, vëllimi 13, faqe 217.

<sup>2</sup> Shënim i përkthyesit

shkroi Mehdiut, që t'ua kompensonte atyre shtëpitë. Me zgjidhjen që dha Mehdiu, bëri që të gjithë të mbeten të kënaqur.<sup>1</sup>

Në këto dy transmetime ka një argument të fortë e qetësues, që përshtatet plotësisht me sistemet e sotme ligjore. Argumenti thotë: Qëllimi me të cilin është ndërtuar Qabeja është adhurimi. Kur është ndërtuar ajo, nuk ka pasur asgjë mbi sipërfaqen e tokës.

Në kohën kur është ndërtuar, sipërfaqja e Qabes ka qenë më se e mjaftueshme. Ndërsa tani është bërë më se e domosdoshme zgjerimi i territorit të saj.

### **Veçoritë e Qabes dhe dobitë e saj**

Në këto dy ajete, krahas dy veçorive që përmendëm, ka edhe katër veçori të tjera. Ato janë:

#### **1- E bekuar - mubarek**

Fjala *mubarek* ka kuptimin e mirësisë dhe të bereqetit të shumtë. Me të vërtetë, Qabeja është e madhëruar dhe e bekuar, sepse me të drejtë, toka ku ndodhet ajo është e vetmja nga të gjitha skajet e tokës që përmban mirësi dhe dobi, qofshin ato materiale apo shpirtërore.

Për sa i përket të mirave shpirtërore, me të cilat zbukurohet kjo tokë, është tubimi i Haxhinjve, lëvizja, aktiviteti dhe uniteti. Gjithashtu, forca tërheqëse hyjnore, që ringjall shpirtrat dhe zemrat, e veçanërisht në periudhën e Haxhit, ku askush nuk mund ta fshehë këtë gjë.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Ajjashij", vëllimi 1, faqe 185; "Vesailu Shijja", vëllimi 13, faqe 217.

Sikur myslimanët të interesohen më shumë për anën shpirtërore në periudhën e Haxhit dhe ta studionin filozofinë e saj, atëherë do t'i dallonin më shumë mirësitë, begatitë dhe dobitë shpirtërore. Dukuritë do të zbardheshin gjithmonë e më shumë. Kjo është nga ana shpirtërore.

Nga ana materiale, edhe pse ky qytet është ngritur në një tokë të thatë, të shkretë, pa ujë, pa bimësi, ku nuk mund të zhvillohet bujqësia e blegtoria, gjatë gjithë historisë njerëzore, është një ndër qytetet më të populluara, me më shumë lëvizje, me kushte të mira për jetesë dhe për tregti.

## **2- Udhërrëfyese për popujt**

Sigurisht që Qabeja është e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt, sepse ajo “tërheq” miliona njerëz, që kapërcejnë dete dhe ultësira për t'u tubuar në këtë vend. Në këtë mënyrë ata kryejnë me përkushtim dhe madhështi ritualin e Haxhit. Ky rit është kryer që nga koha e Ibrahimit e do të kryhet deri në Ditën e Gjykimit.

Kjo ndërtesë gjithmonë ka qenë madhështore, që nga koha paraislame. Edhe pse në këtë kohë ritualet e Haxhit i kanë përzier me legjenda dhe besime të kota, ata janë të sinqertë në kryerjen e këtij rituali. Shmangia nga këto rituale ka qenë ndalesa e disa gjërave për të cilat All'illahu nuk ka urdhëruar.

Kjo është arsyeja se pse Qabeja është bërë shkak udhërrëfimi dhe udhëzimi edhe për idhujtarët. Me të vërtetë, kjo faltore, nga ana shpirtërore, ka një tërheqje që askush nuk mund ta përshkruajë dhe nuk mund t'i rezistojë dot.

### 3- Në të ka shenja të qarta: Vendi i Ibrahimit

Në këtë faltore ka shenja të qarta rrezatuese për adhurimin e All'llahut të Lartësuar dhe për Njehsimin e Tij. Në këtë tokë të bekuar ka shenja shpirtërore e të ndjeshme, që shpërthejnë rrëke burimet e lotëve, mbushen e përmallohen të gjitha zemrat.

Në këtë vend të Shenjtë ka shenja që ua kanë hequr maskën hipokritëve dhe intrigantëve, të cilët janë munduar t'i shkatërrojnë ato. Për këto shenja flet dhe Kur'ani Famëlartë. Ato Shenja të qarta janë që prej Ibrahimit, si: Zemzemi, Saffa, Merua, Rukni<sup>1</sup>, Hatimi<sup>2</sup>, Guri i zi dhe Guri i Ismailit. Të gjitha këto konsiderohen "trupa" të gjalla të historisë dhe përkujtime madhështore, të pavdekshme.

Mekami i Ibrahimit veçohet me përkujtim ndërmjet të gjitha këtyre shenjave, sepse ai është vendi ku ka qëndruar Ibrahim për të ndërtuar Qaben, ose vendi ku ka ardhur të kryejë ritet e Haxhit, ose vendi ku i është drejtuar dhe ka ftuar hapur njerëzit që të kryejnë ritin e Haxhit. Me të vërtetë, ky vend është prej shenjave më të rëndësishme ndër ato që u përmendën.

Ato janë argumentet më të forta e më të qarta, që dëshmojnë, bashkë me këtë tokë të bekuar, sakrificat, kujtimet, tubimet, ngjarjet madhështore, etj.

Ka mendime të ndryshme mes komentuesve për kuptimin e mekamt të Ibrahimit. A është i veçantë vendi ku ndodhet Guri, që mbart akoma shenjën e gjurmës së tij? A është Mekka vend i

<sup>1</sup> Çdo qoshe e Qabes quhet ruknun.

<sup>2</sup> Hatimi ndodhet midis Gurit të zi dhe derës së Qabes. Është quajtur *hatim* për arsye të tubimit dhe të grumbullimit të njerëzve. Ai mund të jetë vendi ku është penduar Ademi (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ose vendi ku shlyhen dhe falen mëkatet, sepse falja është në gradën e shkatërrimit të mëkateve. Fjala *hatim* do të thotë *shkatërrim*.

shenjtë? A janë të gjitha vendet që kanë lidhje me ritualet e Haxhit?

Në një transmetim të përcjellë nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) në librin “Kafijj” thuhet për mendimin e parë.<sup>1</sup>

#### 4- ...kush hyn në të është i sigurt

Ibrahimi, sapo mbaroi ndërtimin e Qabes kërkoi nga Zoti i tij që ta bëjë Mekkën vend të sigurt. Ai iu drejtua Zotit: **“O Zoti im, bëje të sigurt këtë Qytet!”**<sup>2</sup>

All'Ilahu i Lartësuar ia pranoi lutjen dhe e bëri Mekkën qytet të sigurt. Aty, jo vetëm banorët vendas, por edhe njerëzit që tubohen jetojnë të lumtur, duke kryer ritet e tyre fetare.

Siguria në këtë vend është në shkallën më të lartë, pasi lufta dhe vrasja është e ndaluar.

Siguria në Qabe nuk përfshin vetëm njerëzit, por edhe kafshët.

Nëse dikush strehohet në Qabe, qoftë edhe kriminel i madh, duke mos ia humbur të drejtat e tolerancës edhe kësaj pjesë të shoqërisë, deri sa ai të largohet, është i sigurt.

Pasi ka paraqitur të gjitha këto veçori e vlera të kësaj faltoreje, Kur'ani i ka urdhëruar njerëzit që të kryejnë Haxhin – pa dallim race apo kombësie. Është detyrë e njerëzve ta kryejnë këtë rit. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“dhe vizita (për Haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën.”**

Fjala *Haxh*, nga ana gjuhësore, do të thotë *qëllim* dhe për këtë është quajtur xhadeja “mehaxhetun”, sepse ajo e çon

---

<sup>1</sup> “Usulul Kafijj”, vëllimi 4, faqe 223; “Vesailu Shijja”, vëllimi 13, faqe 239.

<sup>2</sup> Surja “El-Bekare”, ajeti 126, ajeti 35.

përshkuesin e saj për tek qëllimi i tij. Sikurse për të njëjtën arsye është quajtur argumenti “el huxhetu”, sepse ai qartëson qëllimin.

E ndërsa emërtimi i kësaj vizite dhe i riteve me emrin Haxh është bërë, sepse vepruesi i Haxhit del me qëllim për të vizituar Shtëpinë e All’llahut. Dhe për këtë thuhet “haxhahul bejti”, vizita e shtëpisë.

Më lart ne e cekëm se ritet e Haxhit janë themeluar e janë ushtruar që në kohën e hazretit Ibrahim (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) dhe kanë vazhduar deri në kohën paraislame. Mirëpo, në formë të plotë janë vendosur në kohën e ardhjes së Islamit, duke i zhveshur nga legendat, paganizmat dhe trillimet e kohës së injorancës.

Por nga ajo çfarë mund të lexojmë nga fjalimi “El Kasiah” në librin “Nehxhul Belaga” dhe nga disa hadithe dhe transmetime, kuptojmë se Haxhi, për herë të parë është bërë obligim që në kohën e Ademit, ndërsa në kohën e Ibrahimit ai (Haxhi) mori formën e tij zyrtare.

Me të vërtetë, Haxhin e kanë obligim të gjithë ata njerëz që e kanë mundësinë, një herë në jetë. Në këtë ajet nuk përfitohet më tepër se kaq, sepse kuptimi i rregullit në këtë ajet është i përgjithshëm dhe ai arrihet nëse kryhet vetëm një herë.

Kushti i vetëm të cilin e cek ky ajet dhe që e bën obligim, është “mundësia”. Nëpërmjet fjalës së All’llahut del qartë një prej rregullave të Haxhit, mundësia. “(e cila është detyrë) **për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën.**” Fjala *mundësi*, që përmendet në këtë ajet, përfshin mundësinë ekonomike për të shpenzuar e për të përballuar udhëtimin vajtje-ardhje, mundësinë fizike e shëndetësore dhe mundësinë ekonomike të familjes, deri sa personi të kthehet nga Haxhi.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> “Uesailu Shijja”, vëllimi11, faqe 7 dhe 23.

Duhet patjetër që personi ta dijë se mos pranimit i Islamit nuk ua hedh poshtë kryerjen e këtij riti apo nuk ua heq atyre përgjegjësinë e moskryerjes së tij.

## Rëndësia e Haxhit

Për të garantuar rëndësinë e Haxhit, All'llahu i Lartësuar, në vazhden e këtij ajeti, thotë: **“E kush nuk beson, All'llahu është i Vetëmjaftueshëm ndaj krijesave.”** Sigurisht, ata që e injorojnë këtë thirrje, që e mohojnë këtë obligim dhe e kundërshtojnë, nuk i bëjnë keq askujt, përveç vetes së tyre, sepse All'llahu nuk ka nevojë për askënd, sepse All'llahun nuk e godet asgjë, sido që të jetë sjellja e tyre, kundërshtimi, mohimi apo kryerja e ritit.

Fjala *kufër*, nga ana gjuhësore, do të thotë *mbulesë* dhe *fshetje*, ndërsa nga ana fetare ka një kuptim më të gjerë. Kuptimi i saj është kundërshtim i së vërtetës, mohim e mosbindje të rregullave të fesë. Përdorimi i shumtë i kësaj fjale për mohimin e parimeve të fesë nuk do të thotë se kuptimi i saj është i kufizuar vetëm në to. Për këtë është përmendur edhe në lënien e Haxhit. Kjo është arsyeja që pse fjala *kufër* në këtë ajet është shpjeguar mohim nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), lënia dhe moskryerja e detyrës së Haxhit.<sup>1</sup>

Mosbesimi dhe largimi nga e vërteta ka shkallë dhe faza. Për secilën shkallë a fazë ka rregulla të veçanta.

Mosbesimi është përdorur në Kur'an edhe për çështjen e përdorimit të kamatës, ajeti 275, surja “El-Bekare” apo për çështjen e magjisë, ajeti 102 i po të njëjtës sure. Këto të dyja përshkruhen me mos besimin (kufër). Ky është qëllimi për atë që treguam më lart, sepse si kamata, ashtu edhe magjia janë largim nga e vërteta.

---

<sup>1</sup> “Tehdhijb”, vëllimi 5 faqe 18; “Tefsir Safijj”, vëllimi 1, faqe 362.

E mbi të gjitha, nga ky ajet përfitojnë dy çështje:

**E para:** Rëndësinë e madhe të Haxhit. Kur'ani i jep një rëndësi të madhe kryerjes së këtij riti, sa atë që nuk e kryen (pa arsye) e quan kafir (mohues). Këtë gjë e vërteton edhe transmetimi nga Suduku, në librin e tij "Men la Jahduru Fakijh" ku profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka thënë Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): "O Ali, me të vërtetë, ai që nuk e kryen detyrën e Haxhit dhe i ka mundësitë, ai është kafir (mohues), pasi All'llahu i Lartësuar thotë: **"Dhe vizita (për Haxh) e kësaj faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, All'llahun nuk ka nevojë për askënd!"** O Ali, ai që e vonon dhe e shtyn kryerjen e Haxhit deri në vdekje, All'llahu, Ditën e Gjykimit e ringjall atë jehudi ose të krishterë."<sup>1</sup>

**E dyta:** Me të vërtetë, kjo detyrë e caktuar nga All'lahu është e rëndësishme, ashtu si të gjitha detyrat dhe rregullat fetare, të cilat janë vendosur për të rregulluar çështjet e njerëzve. Ato janë caktuar dhe janë bërë detyrim për edukimin dhe ndreqjen e gjendjes së tyre. Nëse i kryejnë, i kryejnë për veten e tyre, sepse All'llahu i Lartësuar nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd.

<sup>1</sup> "Men la jahdaruhul fakih", vëllimi 4, faqe 368.

## Ajetet 98 - 101

قُلْ يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَآبِ لِمَ تَكْفُرُونَ بِآيَٰتِ ٱللَّهِ وَٱللَّهُ شَهِيدٌ عَلَىٰ مَا تَعْمَلُونَ ﴿٩٨﴾  
 قُلْ يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَآبِ لِمَ تَصُدُّونَ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ مَن ءَامَنَ تَبْغُونَهَا عِوَجًا  
 وَأَنتُمْ شُهَدَآءُ ۚ وَمَا ٱللَّهُ بِغَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿٩٩﴾ يٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا إِن  
 تُطِيعُوا فَرِيقًا مِّنَ ٱلَّذِينَ أُوتُوا ٱلْكِتَآبَ يَرُدُّوكُم بَعْدَ إِيمَٰنِكُمْ كَافِرِينَ ﴿١٠٠﴾  
 وَكَيْفَ تَكْفُرُونَ وَأَنتُمْ تُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ ءَايَٰتُ ٱللَّهِ وَفِيكُمْ رَسُولُهُ ۚ وَمَن  
 يَعْتَصِم بِٱللَّهِ فَقَدْ هُدِيَ إِلَىٰ صِرَاطٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿١٠١﴾

“Thuaj (o Muhammed): “O ithtarët e Librit! Pse mohoni shpalljet e All’llahut, ndërkohë që All’llahu është dëshmitar i çdo gjëje që bëni!?”

Thuaj: “O ithtarët e Librit! Pse e pengoni nga rruga e All’llahut atë që beson e përpiqeni ta shtrembëroni (atë rrugë), ndërkohë që jeni dëshmitarë? All’llahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprave që ju bëni!”

O ju që keni besuar! Nëse i bindeni një grupi nga ata që u është dhënë Libri, ata do t’ju kthejnë në jobesimtarë, pasi patët besuar.

E si mund të mos besoni kur juve ju lexohen shpalljet e All’llahut dhe midis jush ndodhet i Dërguari i Tij?! Kush

**mbahet fort pas (fesë së) All'llahut, sigurisht që është i udhëzuar në rrugë të drejtë."**

### **Shkaku i zbritjes**

Shkakun e zbritjes së këtij ajeti na e tregojnë librat e shi'iave dhe të sunive. Në këto libra flitet për historinë e Sha's Ibn Kajsit, një prej parisë së jehudinëve. Ai i urrente me shpirt myslimanët. Një ditë kaloi pranë një grupi të shokëve të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Pjesëtarët e grupit ishin prej fiseve Ous dhe Hazrexh. Ai u tërbua kur dëgjoi bisedën e ngrohtë dhe miqësore të këtyre fiseve, si dhe harmoninë islame mes tyre. Para Islamit, ato fise ishin në armiqësi me njëri-tjetrin.

Sha's Ibn Kajsi urdhëroi një djalosh jehudin, që e shoqëronte, të shkonte e të ulej me ta dhe t'ua kujtonte atyre Ditën e Beathes.<sup>1</sup> Dita e Beathes ka qenë dita e luftës midis fiseve Ous dhe Hazrexh. Triumfues doli fisi Ous. Udhëheqësi i fisit Ous në atë kohë ka qenë Hudejr Ibn Semak el Eshhelij Ebu Esijd ibn Hudejr, kurse udhëheqësi i fisit Hazrexh ka qenë në atë kohë Amru en Nu'man el Bejadij. Të dy u vranë.

Djali veproji ashtu siç dëshiroi Sha'si. Të pranishmit, kur dëgjuan fjalët e djaloshit, filluan të flisnin rreth kësaj gjëje. Në ato momente, dy burra nga të dy fiset u çuan dhe filluan të kërcënojnë njëri-tjetrin. Për pak desh u ndez zjarri i luftës mes tyre. Të pranishmit i mbuloi nervozizmi dhe filluan të grinden.

Kjo çështje arriti tek i Dërguari i All'llahut. I Dërguari i All'llahut, së bashku me disa shokë të tij, shkoi te grupi dhe u foli atyre: "Po veproni ashtu siç keni vepruar para se të pranoni thirrjen e Islamit, kur unë jam në mesin tuaj?! Po veproni kështu,

<sup>1</sup> Për t'u njohur më shumë me Ditën e Beathit (jeumun beath), shihni librin "El Kamil", i ibn Ethijrit, vëll. 1, f. 443.

pasi All'llahu i Lartësuar ju ka udhëzuar në Islam, ju ka respektuar e ju ka lartësuar me të, ju ka shkëputur nga çështja e injorancës, ju ka shpëtuar juve nga mosbesimi (kufri) dhe ju ka bashkuar zemrat.”

Ata e kuptuan se kjo është përçarja e shejtanit dhe një kurth i armiqve të tyre. Filluan të qanin dhe të përqafoheshin me njëri-tjetrin. Të gjithë u larguan së bashku në shoqërinë e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). All'llahu e fiku zjarrin që deshi të ndizte Sha'si mes tyre dhe All'llahu zbriti 4 ajetet e lartpërmendura.

Dy ajetet e para flasin për çështjen e Sha's Ibn Kajsit dhe për atë që veproji, ndërsa dy ajetet e tjera zbritën si paralajmërim për myslimanët, që të kenë kujdes.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Ruhul Meanijj”, vëllimi 4, faqe 14; “Biharul Anuar”, vëllimi 71, faqe 246.

## Komentimi

### Përçarësit e rreshtave dhe përhapësit e mospajtimeve

Pas veprës së disa elementëve jehudinj smirakë, të cilët donin të ndiznin zjarrin e armiqësisë mes myslimanëve, siç u mësua në shkakun e zbritjes së ajeteve, zbriti thënia e All'llahut: **“Thuaj (o Muhammed): “O ithtarët e Librit! Pse mohoni shpalljet e All'llahut, ndërkohë që All'llahu është dëshmitar i çdo gjëje që bëni?!”** Me anë të këtij ajeti, All'llahu i Lartësuar u drejtohet ithtarëve të Librit (*jehudinjve dhe të krishterëve*), por qëllimi në këtë ajet është ndaj jehudinjve. Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij që t'i pyesë ata, duke i qortuar se përse i mohojnë ajetet dhe argumentet, ndërkohë që All'llahu është i informuar më së miri për veprat e tyre.

Qëllimi i fjalës *ajatullah, shenjat e All'llahut*, që përmendet në ajet ose mund të jetë për ajetet që kanë ardhur në Teurat për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për shenjat e profetësisë së tij, ose për të gjitha argumentet dhe mrekullitë që i janë shpallur Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilat janë realizuar në duart e tij dhe që kanë zbuluar vërtetësinë e mesazhit të tij hyjnor dhe të profetësisë së tij.

Pastaj ka ardhur ajeti i dytë, i cili i qorton ata duke u thënë: **“Thuaj: “O ithtarët e Librit! Pse e pengoni nga rruga e All'llahut atë që beson e përpiqeni ta shtrembëroni (atë rrugë), ndërkohë që jeni dëshmitarë?...”**, që do të thotë: “O i Dërguar, u thuaj atyre: “Nëse ju nuk jeni të gatshëm dhe të përgatitur për ta pranuar të vërtetën, përse i pengoni të tjerët ta pranojnë këtë? Përse mundoheni të largoni njerëzit nga rruga e All'llahut, duke ua paraqitur atyre rrugën e drejtë të shtrembër dhe hidhni dyshime në zemrat dhe në mendjet e tyre?

Ndërkohë që ju duhet të jeni të parët që ta pranoni këtë thirrje dhe këtë mesazh të All'llahut, sepse shenjat dhe myzhdet e ardhjes së Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të fundit i keni në librat tuaj dhe ju jeni dëshmitarë.

Nëse çështja është kështu, përse këto dyshime dhe këto përpjekje për të futur përçarje, për t'i larguar nga rruga e drejtë dhe e vërtetë njerëzit? Përse përpiqeni kaq shumë që t'i çoni njerëzit në humbje? Përse mbartni mëkatën e krimit e të devijimit të njerëzve nga e drejta? Përse? A mendoni se të gjitha veprimet tuaja Ne nuk do t'i mësojmë? Ju nuk mund t'ia fshihni këto gjëra All'llahut të Lartësuar, sepse Ai thotë: **"All'llahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprave që ju bëni!"**

All'llahu i Lartësuar e ka cilësuar Veten e Tij se nuk është i pavëmendshëm, sepse jehudinjtë gjithmonë janë munduar që t'i fshehin veprat e tyre dhe të veprojnë në fshehtësi me intriga dhe komplete, duke u hedhur hi syve njerëzve që nuk janë të informuar për veprimet e tyre, që të mbledhin sa më shumë fryte prej veprave të tyre. Mund të ketë njerëz që mashtrohen me intrigat tuaja, për shkak të pavëmendjes së tyre. Por All'llahu është në dijeni të gjithçkaje që ju bëni, pasi dija e Tij përfshin çdo gjë. Juve ju pret një ndëshkim i dhimbshëm nga ana e All'llahut.

Pasi All'llahu i Lartësuar kritikon të gjithë ata që fusin përçarje, që largojnë të tjerët nga rruga e drejtë e besimit, u drejtohet myslimanëve që të mos mashtrohen, të mos bien pre e mashtrimeve të armiqve. Rezultati i gjithë kësaj është rënia në kthetrën dhe në hijen e mosbesimit. Lidhur me këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"O ju që keni besuar! Nëse i bindeni një grupi nga ata që u është dhënë Libri, ata do t'ju kthejnë në jobesimtarë, pasi patët besuar."**

Sigurisht, qëllimi i armiqve është t'i kthejë njerëzit në mosbesim, sepse armiku, së pari, përpiket të ndezë në mesin tuaj zjarrin e armiqësisë dhe të vriteni ndërmjet njëri-tjetrit.

Ata nuk kënaqen me kaq, por vazhdojnë me intriga e pëshpëritje, derisa t'ju nxjerrin nga feja islame. Nga ky shpjegim qartësohet se qëllimi i kthimit në mosbesim, që përmend ajeti, është shkëputja e plotë nga Islami. Po ashtu, mund të ketë qëllim armiqësinë në kohën e injorancës (para Islamit), e cila konsiderohet një prej llojeve të mosbesimit, një prej shenjave të tij dhe ndikim prej ndikimeve të asaj kohe të zyrtë, sepse, me të vërtetë, nga besimi lind dashuria, mëshira, vëllazërimi e bashkimi, ndërsa nga mosbesimi buron vrasja, armiqësia e urrejtja.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar, me anë të këtij ajeti, vazhdon e pyet në një formë të habitshme: **"E si mund të mos besoni kur juve ju lexohen shpalljet e All'Ilahut dhe midis jush ndodhet i Dërguari i Tij?! Kush mbahet fort pas (fesë së) All'Ilahut, sigurisht që është i drejtuar në udhë të mbarë."**

Si është e mundur që ju të ndiqni rrugën e mosbesimit dhe të ktheheni në mosbesim, kur i Dërguari i All'Ilahut ndodhet në mesin tuaj dhe ajetet e qarta të All'Ilahut u lexohen juve? Si mund ta bëni këtë kur drita e Revelata ndriçon zemrat tuaja?

Me të vërtetë, këto shprehje janë një mësim i mirë për të gjithë ata që kanë humbur e i janë shmangur rrugës së drejtë. E habitshme është për ata që janë bërë ndjekës dhe e shikojnë atë në mesin e tyre. Ai, me ajetet që i shpallen, është në lidhje të vazhdueshme me Zotin e tij. Është me të vërtetë e habitshme se si ata janë larguar dhe kanë humbur rrugën e vërtetë.

Është me të vërtetë e habitshme se si humbasin njerëzit, kur kanë shembullin që duhet të ndjekin, që të jetojnë nën hijen e mirësisë së kësaj drite hyjnore. Nuk ka dyshim se ata mbartin përgjegjësinë e mëkatit të humbjes. E nëse humbasin, nuk humbasin vetëm pas qartësimit dhe nuk largohen vetëm pas dijes që atyre u ka ardhur. Nuk ka dyshim se për ta do të ketë vetëm ndëshkim të rëndë e të dhembshëm.

Pastaj, në mbyllje të këtyre ajeteve, Kur'ani Famëlartë i këshillon myslimanët se, nëse dëshirojnë të ruhen nga intrigat e armiqve, nëse dëshirojnë të udhëzohen e të drejtohen në rrugë të drejtë, të mbështeten fort te All'llahu i Lartësuar, të dëgjojnë fjalën e Tij dhe të ndjekin udhëzimin e ajeteve. Me qartësinë më të madhe, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Kush mbahet fort pas (fesë së) All'llahut, sigurisht që është i drejtuar në udhë të mbarë.”**

Kjo është një nga pikat më të rëndësishme që mund të vërtetojmë në këto ajete: në dy ajetet e para, thirrja hyjnore u drejtohet jehudinjeve me ndërmjetësim, ku All'llahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin e Tij t'i informonte jehudinjtë rreth këtyre temave. Me fjalën e Tij: **“thuaj:”** All'llahu u drejtohet myslimanëve, duke qenë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndërmjetësues, ndërsa në dy ajetet e tjera, thirrja u drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë myslimanëve, pa ndërmjetësimin e fjalës së profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kjo sqaron mbrojtjen e All'llahut dhe mirësinë e Tij ndaj besimtarëve. Me të vërtetë, besimtarët e meritojnë që All'llahu t'u drejtohet me fjalë ndërmjetësuese.

## Ajetet 102-103

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تُقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ  
 ﴿١٠٢﴾ وَاعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا ۚ وَادْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ  
 إِذْ كُنْتُمْ أَعْدَاءً فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا وَكُنْتُمْ عَلَىٰ  
 شَفَا حُفْرَةٍ مِّنَ النَّارِ فَأَنْقَذَكُم مِّنْهَا ۚ كَذَٰلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ ءَايَاتِهِ لَعَلَّكُمْ  
 تَهْتَدُونَ ﴿١٠٣﴾

“O ju që keni besuar! Jini të devotshëm ndaj All’llahut ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!

Të gjithë mbahuni fort për litarin e All’llahut (Kur’anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e All’llahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja, e në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, All’llahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.”

## Shkaku i zbritjes

Mes dy fiseve të mëdha, që banonin në Medine, fisi Ous dhe fisi Hazrexh, ka pasur konflikte dhe luftëra të shpeshta për njëqind vjet. Këto konflikte e luftëra u kanë sjellë shumë dëme të dy palëve, në pasuri dhe humbje në njerëz. Të gjitha këto kanë qenë në kohën e injorancës, para ardhjes së Islamit dhe para lindjes së diellit të besimit në sipërfaqen e asaj toke.

Pas emigrimit në Medinen e Ndritur, prej sukseseve të mëdha të profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ishte ndalimi i luftës mes këtyre dy fiseve dhe pajtimi i tyre, duke vendosur ndjenjën e vëllazërisë në vend të armiqësisë, vendosjen e paqes në vend të luftës dhe bashkimin për adhurimin e All'llahut. Ai ndërtoi një strukturë të fortë udhëheqjeje në Medine.

Meqenëse rrënjët e armiqësisë kanë qenë të forta dhe të vjetra, ky bashkim herë pas here përballej me tronditje dhe lëkundje për shkak të disa konflikteve të harruara që dilnin mbi sipërfaqe, pasi ishin harruar. Falë mirësive, edukimit dhe zgjuarsisë së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ky zjarr shuhej shpejt.

Në ajetet e mëparshme pamë arsyet se pse ndizeshin këto konflikte, nga nxitja dhe ndërhyrja e armiqve të zgjuar. Këto ajete tregojnë një lloj tjetër mospajtimi e përçarjeje, e cila shkaktohej nga shoqëria e injorancës dhe nga fanatizmi verbues dhe injorant.

Thuhet se dy persona nga fisi i Ousit dhe i Hazrexhit, Tha'lebeh ibn Ganemi dhe Es'ad ibn Zurarehi, bisedonin dhe secili ngrinte lart vlerën e fisit të tij.

Tha'lebi iu drejtua e i tha Es'adit: "Fisi ynë ka nxjerrë shumë njerëz të ditur. Prej nesh janë: Hazijmetu ibn Thabit, i zoti i dy dëshmimeve, Handhele që e kanë larë melekët, Asim ibn Thabit ibn Eflehi,

mbrojtësi i fesë dhe Sad ibn Muadhi, me të cilin All'llahu ka qenë i kënaqur me gjykimin e tij në fisin kurejdheh."

Më pas, Es'ad ibn Zurarehi tha: "Prej nesh janë katër persona të ditur, që kanë gjykuar me Kur'an: Ebij ibn Ka'bi, Muadh ibn Xhebeli, Zejd ibn Thabit dhe Ebu Zejdi. Prej nesh është Sa'd ibn Ibade, i pari i ligjëruesve të Ensareve."

Biseda vazhdoi gjatë, kush e kush të qëndronte më lart. Ata thërrisnin dhe vinin prej fisit të Ousit te njeriu i vet dhe prej fisit të Hazrexhit te njeriu i vet. Situata arriti deri aty sa ata nxorën armët për të luftuar me njëri-tjetrin.

Kjo çështje arriti tek i Dërguari i All'llahut dhe All'llahu i Lartësuar zbriti këto ajete, të cilat Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua lexoi atyre dhe ata u pajtuan.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan"; "Biharul Envar", vëllimi 18, faqe 155-1

## Komentimi

### Thirrje për devotshmëri

Ajeti i parë nga këto dy ajete bën thirrje për devotshmëri, e cila është hyrje për unitet e vëllazërim. Me të vërtetë, thirrja për unitet, që nuk ka rrënjë të forta në moral e në besim, ka një ndikim të pakët, ose nuk mund të ketë asnjë ndikim. Ky ajet përqendrohet në kurimin e rrënjëve të mosmarrëveshjes e të konfliktit, si dhe me fjalët e tij, zvogëlon faktorët që shkaktojnë mospajtim dhe mosmarrëveshje. E ky kurim duhet të jetë i bazuar në besim dhe devotshmëri. Për këtë ajeti u bën thirrje besimtarëve: **“O ju që keni besuar! Jini të devotshëm ndaj All’Ilahut ashtu si i takon Atij...”**

Ka shumë mendime në mesin e komentuesve të Kur’anit rreth fjalës së All’Ilahut të Lartësuar: **“ashtu si i takon Atij.”** Ajo që nuk ka dyshim është se kjo frazë konsiderohet prej shkallëve më të larta të devotshmërisë dhe më e përkryera, sepse përfshin largimin nga çdo mëkat, gjynah, padrejtësi, armiqësi dhe afrim tek e vërteta.

Në tefsirin “Durrur Menthur” është transmetuar nga i Dërguari i All’Ilahut, i cili ka thënë se kjo frazë do të thotë: *“T’i bindesh All’Ilahut dhe të mos bësh gjynahe, ta kujtosh dhe ta përmendësh (për ta falënderuar) e të mos e mohosh.”* Po kështu ka thënë edhe Imam Xha’fer Sadiku, siç përmendet në tefsirin “El Ajjashij” dhe në librin “Meanijul Ahbar” në komentimin e fjalës së All’Ilahut **“ashtu si i takon Atij”**.<sup>1</sup>

Kryerja e këtij urdhri, si urdhrat e tjerë të All’Ilahut, është i lidhur me mundësinë dhe fuqinë e njeriut. Për këtë nuk ka kundërshtim

---

<sup>1</sup>Sherh “Nehxhul Belaga” Ibn Ebu Hadijð, vëllimi 11, faqe 185; “Biharul Anuar”, vëllimi 67, faqe 291.

dhe papajtueshmëri mes këtij ajeti që kërkon gradën e lartë të përsosmërisë me ajetin gjashtëmbëdhjetë të sures “Tegabun”, ku All’Ilahu i Lartësuar thotë: **“Prandaj, jini të devotshëm ndaj All’Ilahut sa të mundeni.”**

Mendimi se këto dy ajete kanë kundërthënie e papajtueshmëri midis tyre dhe se njëri nga këto dy ajete është i abroguar nga tjetri nuk ka asnjë bazë dhe është e papranueshme.

Ajeti, pasi i porositi të gjithë besimtarët që të arrijnë gradën më të lartë të përsosmërisë, përfundon me tërheqjen e vëmendjes, e cila, në realitet, nuk është vetëm për fiset Ous dhe Hazreth, por për të gjithë myslimanët, duke u thënë: “Nuk është e mjaftueshme vetëm pranimi i Islamit, por e rëndësishme është që njeriu ta ruajë dhe ta mbrojë Islamin dhe besimin e tij deri në fund të jetës. Të mos përdoret për të ndezur zjarrin e përçarjes, armiqësisë dhe të urrejtjes, sepse fundi i kësaj veprë është humbja dhe largimi nga rruga e drejtë. Për këtë, All’Ilahu i Lartësuar thotë: **“dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”**”

## Thirrje për në unitet

Pasi ajeti i mëparshëm i porositi besimtarët që të jenë në shkallën më të lartë të devotshmërisë, vjen ajeti i dytë, i cili u bën thirrje të jenë të bashkuar për të përballuar intrigat, përçarjet dhe largimin nga rruga e drejtë dhe e vërtetë. All’Ilahu i Lartësuar thotë në këtë ajet: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e All’Ilahut (Kur’anin) dhe mos u përçani!”**

Por cili është qëllimi dhe kuptimi i frazës **“litarin e All’Ilahut”**, i përdorur në këtë ajet? Komentuesit e Kur’anit kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me këtë. Disa kanë thënë se ka për qëllim Kur’anin, të tjerë për Islamin, disa të tjerë për imamët e pastër prej familjes së profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Të gjitha këto kuptime janë përmendur në transmetimet e përcjella nga i Dërguari i All'llahut dhe imamët e Ehli Bejtit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*).

Në tefsirin “Durrur Menthur”, sipas transmetimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në librin “Meanijul Ahbar”, sipas transmetimit të imam Sexhadi, thuhet: “Libri i All'llahut (Kur'ani) është litari i zgjatur nga qielli.”<sup>1</sup>

Transmetohet nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*): “Familja e Muhammedit është litari i All'llahut, që na ka urdhëruar të kapemi fort me të.” Pastaj lexoi fjalën e All'llahut të Lartësuar: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e All'llahut (Kur'ani) dhe mos u përçani!”**<sup>2</sup>

Nga sa thamë më lart, nuk ka ndonjë mospërputhje apo papajtueshmëri ndërmjet këtyre thënieve. Frazja “*litari i All'llahut*” kupton çdo mjet që të lidh me All'llahun, cilado qoftë rruga: Islami, Kur'ani, Profeti apo Ehli Bejti.

Si përfundim, themi se të gjitha kuptimet realizojnë lidhjen me All'llahun e Lartësuar.

### **Përse përdoret fraza “litarin e All'llahut”?**

Pikë e rëndësishme në këtë ajet është përdorimi i litarit të All'llahut. Ky përdorim tregon për një të vërtetë, që është se njeriu do të mbetet në vazhden e injorancës dhe do të bjerë pre e instiktive të pakontrolluara, nëse nuk i plotëson kushtet e udhëzimit, nëse nuk ecën në rrugën e drejtë.

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Durrur Menthur”, vëllimi 2, faqe 60; “Ujunul Ahbarul Rrida”, vëllimi 2, faqe 130.

<sup>2</sup> Tefsiri “Ajjashi”, vëllimi 1, faqe 102 dhe 193.

Njeriu duhet patjetër të dalë e të largohet nga rrjedha e keqe, të ngrihet nga shtrati i fjetur dhe me anë të litarit të dalë nga pusi i materializimit, i injorancës dhe i mosinformimit; të çlirohet nga prangat e natyrës (adhurimin pagan të natyrës, duke harruar Krijuesin e vërtetë të saj, All'Ilahun e Lartësuar). Ky litar është vetëm litari i fortë i All'Ilahut. Ai është lidhja me Të, leximi dhe zbatimi i Kur'anit Famëlartë dhe zbatimi i mësimave të udhëheqësve udhëzues. Të gjitha këto e lartësojnë dhe e ngrenë njeriun nga shtrati i injorancës në gradët më të larta.

### Armiqtë e djeshëm dhe vëllezër të sotëm

Për ta kuptuar më mirë lidhjen me litarin e All'Ilahut, Kur'ani na paraqet një shembull të gjallë nga realiteti i umetit islam. Në të njëjtën kohë, përmend edhe mirësinë e bashkimit dhe të vëllazërimit, e cila është mirësi e madhe dhe u bën thirrje myslimanëve që ta rishikojnë dhe t'i kthehen së kaluarës (fjala *e kaluar* nënkupton kohën e injorancës, para ardhjes së Islamit) së dhimbshme dhe t'i krahasojnë ato përçarje e luftëra me këtë vëllazërim e bashkim të pathyeshëm. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Kujtoni dhuntinë e All'Ilahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja, e në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër.”**

Ajo që vihet re në këtë ajet është përsëritja dy herë e fjalës *niametun – dhunti*. Kjo fjalë është mesazh i fortë për rëndësinë e unitetit të kësaj dhurate të All'Ilahut, e cila realizohet vetëm nën hijen e mësimave islame dhe kapjes fort pas litarit të All'Ilahut.

Pikë tjetër, që duhet t'i jepet rëndësi është se vetë All'Ilahu ia dedikon Vetes së Tij pajtimin dhe bashkimin e zemrave të besimtarëve: **“Ai i pajtoi zemrat tuaja.”**, që do të thotë se All'Ilahu i Lartësuar pajtoi zemrat tuaja. Me këtë thënie, Kur'ani Famëlartë tregon një mrekulli të madhe të shoqërisë islame, sepse në të vërtetë, nëse vërejmë me kujdes gjendjen e arabëve dhe të shoqërisë që ka qenë në kohën e injorancës, do

të shohim përçarje, ku në zemrat e tyre mbizotëronte smira dhe urrejtja. Do të mjaftonte shkëndija më e vogël, e lufta do të shpërthente menjëherë.

Një luftë që ushqej me urrejtje e në veçanti me padituri (analfabetizëm), injorancë, që zakonisht, duke ndjekur zakonet e prapambetura, pjesëtarët e kanë të vështirë t'i harrojnë ngjarjet e mëdha.

Dhe nga këtu zbardhet rëndësia e mrekullisë shoqërore, të cilën e ka realizuar Islami, i cili pajtoi zemrat dhe i bashkoi ato, duke harruar urrejtjen. Kjo mrekulli krijoi një popull të fortë e të bashkuar.

### **Pranimi i dijetarëve dhe i historianëve**

Bashkimi i fiseve arabe në armiqësi, të cilat i bashkoi Islami nuk është i panjohur te historianët dhe dijetarët, deri edhe ata jomyslimanë. Ata e kanë përmendur këtë mrekulli të Islamit në librat e tyre. Po përmendim disa prej tyre:

Xhon Dajon Pouarth, dijetar i shquar anglez, thotë: *"Muhammedi (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shndërroi shoqërinë e thjeshtë arabe, të varfër, të ndarë në fise të uritura, në një shoqëri të fortë, e cila u shqua në mesin e popujve të tokës me veçori të rralla morale. Për më pak se tridhjetë vjet, nëpërmjet kësaj metode, doli fitimtar mbi Perandorinë Romake të asaj kohe, rrëzoi mbretëritë persiane, mori në kontroll Sirinë dhe vendet që ndodhen mes dy lumenjve, duke zgjeruar kufijtë deri te Oqeani Atlantik, te brigjet e Detit Khazer e deri tek lumi Sihjan (në Juglindje të Azisë Qendrore)."<sup>1</sup>

Tomas Karlejl thotë: "Me Islamin, All'llahu i Lartësuar i nxori arabët nga errësira në dritë. Shoqëria e plogët, së cilës nuk i dëgjohej zëri e as nuk i ndihej lëvizja, u bë e njohur. E panjohura u bë e njohur,

---

<sup>1</sup> "Muhammedi dhe Kur'ani" (në gjuhën frënge) faqe 77.

dobësia u kthye në forcë dhe përçarja përvëluese në bashkim. Drita e Islamit përfshiu të gjitha skajet. Nuk kishte kaluar as një shekull nga ardhja e tij, njëra këmbë arriti në Indi e tjetra në Endolus. Drita, inteligjenca dhe udhëzimi i Tij përfshiu gjysmën e botës.”<sup>1</sup>

Doktori Gustaf Lubon, e pohon këtë realitet duke thënë: “...deri në kohën e ndodhjes së kësaj ngjarjeje madhështore (ka për qëllim ardhjen e Islamit), e cila papritur e shfaq arabin me rrobën e çlirimtarit dhe krijues të ideve e të kulturës, të cilat nuk njiheshin në tokën e Hixhazit...”<sup>2</sup>

Nahru, dijetar dhe politikan indian, midis të tjerash, shkruan: “Me të vërtetë, historia e përhapjes së arabëve në Azi, Evropë e Afrikë, si dhe qytetërimi i lartë e i lulëzuar që sollën për njerëzit është mahnitje prej mahnive dhe mrekulli prej mrekullive të historisë. Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë i besueshëm dhe i qëndrueshëm në përhapjen e Islamit. Me këtë besim ai përgatiti shkaqet e forcës, krenarisë dhe imunitetit të ummetit të tij.”<sup>3</sup>

Gjendja e arabëve ka qenë aq e keqe, sa Kur’ani e përshkruan me këto fjalë: **“Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj.”**

Fjala *shefa* do të thotë *greminë e zjarrit apo skaji i greminës*. E ngjashme me këtë kuptim është fjala *sheffetu*. Po ashtu fjala *shefa* përdoret edhe për shërimin e sëmundjes.

All’llahu i Lartësuar, me këtë fjalë ka për qëllim se ju ishit në prag të greminës dhe se rënia juaj në greminë mund të bëhej në çdo kohë. Pas rënies ju do të bëheshit hi dhe lajm i paqenë. Por All’llahu i Lartësuar ju shpëtoi juve nga kjo rënie, duke shndërruar frikën me

<sup>1</sup> “Islam ve Ilmu Hadith”, faqe 33; “Taktikat e pushtimit dhe përballja e Islamit Safi”, faqe 38.

<sup>2</sup> “Civilizimi arab”<sup>2</sup> Gustaf Lubon.

<sup>3</sup> “Lamehat min tarihul alem”, vëllimi 1, faqe 317.

sigurinë dhe shkatërrimin me ngritje e krenari. Ju udhëzoi në atë që gjendet siguria dhe kënaqësia e vëllazërimit dhe e dashurisë.

Në lidhje me fjalën *zjarr*, që përdoret në këtë ajet, ka shumë pyetje: Bëhet fjalë për zjarrin e Xhehennemit apo për zjarrin e kësaj bote? Komentuesit kanë thënie të ndryshme. Por nëse vërejmë në ajetet që flasin për këtë, ato udhëheqin se kjo fjalë, pra *zjarr*, është aludim i zjarrit të luftërave dhe të konflikteve, të cilat, për shkaqe të kota, ndizeshin në mesin e arabëve. Këto zjarre ndizeshin herë pas here në kohën para Islamit.

Me të vërtetë, Kur'ani, në këtë fjalë paraqet gjendjen kritike të shoqërisë në kohën e injorancës, përshkruan rrezikun e luftërave, të cilat kanë kërcënuar në çdo moment me shkatërrim dhe me rënien në greminën e zjarrit jetën e njerëzve.

All'llahu i Lartësuar ka garantuar për njerëzimin shpëtimin dhe largimin nga kjo gjendje nën hijen e Islamit. Për shkak të kësaj, i shpëton myslimanët nga zjarri i Xhehennemit dhe nga ndëshkimi i tij i dhembshëm.

Për të përforcuar domosdoshmërinë e kapjes pas litarit të All'llahut, për të parë të kaluarën dhe për të ecur në të ardhmen, All'llahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet: **“...kështu All'llahu ua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.”**

Atëherë, qëllimi kryesor i udhëzimit tuaj është pastrimi dhe shpëtimi juaj, për të ecur të sigurt në rrugën e paqes. Në këtë udhëzim ka dobi të shumta. Detyra juaj është që të kujdeseni sa më shumë për ato që sqaruam dhe qartësuam.

## Roli i bashkimit në ekzistencën e popujve

Me gjithë fjalët që thuhën për rëndësinë e unitetit dhe të ndikimit të tij në përparimin shoqëror tek popujt, përsëri mund të thuhet se ka ndikime reale të unitetit, të cilat akoma janë të paditura e të panjohura.

Bota sot gjithnjë e më shumë po bën përparime në fushën e teknologjisë. Mjafton të përmendim energjinë që prodhohet nga mbledhja e ujërave, që dikur rridhnin kot. Do të ishte mirë të meditonim pak rreth kësaj dukurie, që kjo fuqi e madhe buron vetëm nga grumbullimi dhe bashkimi i fuqive të vogla. Nga këtu kuptojmë rëndësinë e bashkimit të fuqive njerëzore dhe të trupëzimit të energjive të tyre, si dhe përpyekjet e shumta e frytdhënëse si pasojë e bashkimit.

Rëndësia dhe domosdoshmëria e bashkimit dhe e unitetit përmendet edhe në hadithet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Besimtari për besimtarin është si ndërtesa, elementet e së cilës forcojnë njëra-tjetrën.” Këtë gjë e vërtetoi duke bashkuar gishtërinjtë e tij.<sup>1</sup>

Dhe: “Besimtarët janë si një shpirt i vetëm.”<sup>2</sup>

Dhe: “Shembulli i besimtarëve në shfaqjen e dashurisë së tyre, të respektit e të mëshirës së tyre është si shembulli i një trupi të vetëm. Nëse vuan një pjesë e tij, vuajnë dhe rënkojnë të gjitha pjesët e tij.”<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Tefsiri “Ruhul Xhinan”, vëll. 4, f. 476. “Biharul Anuar”, vëll. 8, f. 150.

<sup>2</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 7, f. 207, fundi i ajetit 11 të sures “Nur”. Tefsiri “Ruhul Xhinan”, vëll. 4, f. 477.

<sup>3</sup> Tefsiri “Ruhul Xhinan”, vëll. 2, f. 450. “Mustedrekul Uesail”, vëll. 12, f. 424.

## Ajetet 104-105

وَلْتَكُنْ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ  
الْمُنْكَرِ ۚ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿١٠٤﴾ وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ تَفَرَّقُوا  
وَأُخْتَلَفُوا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْبَيِّنَاتُ ۚ وَأُولَٰئِكَ هُمُ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿١٠٥﴾

“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi<sup>1</sup>, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”

Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh.”

---

<sup>1</sup> D.m.th. për në fenë e pastër islame.

## Komentimi

### Thirrja në të vërtetën e lufta ndaj së keqes

Pas ajeteve të mëparshme që nxisinin për vëllazëri dhe bashkim, në ajetin e parë të dy ajeteve në fjalë flitet për një çështje shumë madhore, “urdhërimi në të mirë” dhe “ndalimi nga e keqja”. Kjo çështje është mburojë për shoqërinë, sepse e ruan atë. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: **“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”**

E nëse humbet “urdhërimi për vepra të mira” dhe “ndalimi për vepra të shëmtuara” u hapet rruga faktorëve armiqësorë të bashkimit, duke shkatërruar shoqërinë. Për t’u mbrojtur nga shkatërrimi, duhet të ketë një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe një ruajtje të përhershme të këtij uniteti. Kjo plotësohet e realizohet vetëm nëse urdhërohet për të bërë vepra të mira dhe të ndalohet nga kryerja e veprave të këqija.

Është më se e sigurt se ky ajet përmbledh një ligj të fortë për unitetin islam, që të zbatojë këto dy detyra madhështore. Baza e këtij uniteti është zbatimi i urdhrit të All’llahut të Lartësuar, që nga ky zbatim ata do të jenë të shpëtuarit: **“Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”**

Fjala *ummet* rrjedh nga fjala arabe *ummun*, që do të thotë diçka rreth së cilës mblidhen të tjera. Në të njëjtin kontekst mund të shpjegohet edhe fjala *ummet*, bashkësi, të cilën e bashkon një çështje e përbashkët, një fe e vetme, një kohë apo një vend i vetëm. Ummet nuk mund të quhen njerëzit e ndarë apo individë që nuk i bashkon një lidhje e vetme.

**Pyetje:** Nga pamja e jashtme e frazës **“...prej jush një grup”** nënkuptohet për një grup prej myslimanëve dhe nuk ka për qëllim të gjithë myslimanët. Për këtë, urdhërimi për vepra të mira dhe ndalimi nga e keqja nuk është detyrë për të gjithë, por është detyrë fetare, e posaçme për një grup të veçantë prej myslimanëve.

Me fjalë të tjera, fjalia **“...prej jush një grup”** na thotë se këto dy urdhëresa **“urdhërimi në të mirë dhe ndalim nga e keqja”** nuk është farz ajn, por është farz kifaje. Ndërkohë, nga ajete të tjera kuptojmë se këto dy çështje janë për mbarë myslimanët dhe jo për një grup, siç thuhet në ajetin 110 të po kësaj sureje: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat ...”**

Apo ajo që ka ardhur në ajetin 3 të sures “El-Asr”, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“...përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”** Me të vërtetë, urdhërimi dhe këshillimi për t’u bashkuar, për të bërë vepra të mira dhe për t’u ndaluar nga e keqja, si dhe çështje të ngjashme me to, nuk përfshin vetëm një grup, por të gjithë besimtarët.

**Përgjigja:** Duke medituuar rreth këtyre ajeteve na qartësohet mendimi se urdhri në të mirë dhe ndalimi nga e keqja ka dy periudha: periudha individuale, e cila është e detyruar për të gjithë, që ta kryejnë këtë vepër me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë, duke kontrolluar reagimet e tij dhe të tjerëve; si dhe periudha shoqërore, e cila është përgjegjësia e ummetit, që ka për detyrë të kurojë të gjitha shmangiet e shoqërisë dhe të vendosë kufij për ta. Midis pjesëtarëve të shoqërisë gjithmonë duhet të ketë bashkëpunim.

Grupi i parë konsiderohet prej detyrave individuale. Meqenëse mundësitë e individëve janë të kufizuara, atëherë edhe hapësira e këtij grupi kufizohet me mundësitë dhe fuqinë që ai ka.

Ndërsa grupi i dytë është uaxhib kifaji. Mundësitë, hapësirat janë më të mëdha. Me të vërtetë, prania e këtyre dy grupeve, që i bëjnë ballë së keqes dhe bëjnë thirrje drejt së vërtetës konsiderohen nga mësimet më të rëndësishme që mund të zbulohen në ligjet dhe rregullat e fesë islame, ashtu si mund të zbulohet politika dhe masat në shtetin islam. Është më se e domosdoshme themelimi i grupit të mbikëqyrjes, për të mbikëqyrë çështjet e shoqërisë dhe organizatat e ndryshme me sistemin e Islamit.

Është bërë traditë krijimi i sektorëve të veçantë që kryejnë këto çështje të rëndësishme, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja e shoqërisë. Në vende të ndryshme islame, këta sektorë kanë emërtime të ndryshme. Nganjëherë këta sektorë janë quajtur me emrin “Sektori i mbikëqyrjes” dhe punonjësit quhen mbikëqyrës; herë të tjera quhen “urdhëruar në rrugë të drejtë” apo “urdhëruar në të mirë”. Punonjësit e këtij sektori janë të detyruar të ndalojnë dhe t’i bëjnë ballë çdo të keqeje që vihet re në shoqëri apo çdo të keqeje apo padrejtësi të strukturave shtetërore. Nga ana tjetër, kanë për detyrë që të frymëzojnë njerëzit që të bëjnë vepra të mira dhe të nxisin për tek e vërteta.

Me shembujt që dhamë, kuptohet fare qartë dëshira dhe detyra për të urdhëruar në të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja, duke përfshirë edhe individin, edhe pse ka mundësi të kufizuara. Nëse vështirësia e kryerjes së kësaj detyre është më e madhe, atëherë i takon shtetit islam të merret me këtë punë.

Ky kërkim dhe studim konsiderohet nga kërkimet dhe mësimet më të rëndësishme të Kur’anit. Ka ajete të shumta që e tregojnë këtë. E ndiejmë si detyrë për të folur diçka rreth kësaj fushe.

## Hulumtim

### 1) Çfarë është “e mira” dhe çfarë është “e keqja”?

Në gjuhën arabe, fjala *el ma'ruf*, është çdo gjë që njihet dhe pranohet. Kjo fjalë rrjedh nga fjala *arene*, kurse fjala *el munker* është çdo gjë që mohohet dhe është e keqe. Ajo rrjedh nga fjala *inkar*. Në këtë mënyrë janë cilësuar veprat e mira. Veprat e këqija janë çështje të mohuara, sepse natyra e njeriut është e pastër, e cila pranon llojin e parë, pra, veprat e mira e të dobishme dhe mohon llojin e dytë, veprat e këqija dhe shkatërruese.

### 2) Urdhërimi në të mirë, a është detyrë logjike apo zbatim i porosisë së Profetit?

Një grup prej dijetarëve islamë mendojnë se detyrimi i këtyre dy detyrave është vërtetuar vetëm me argumentet përcjellëse (nga Kur'ani dhe Suneti) dhe se logjika nuk mund të gjykojë rreth këtyre detyrave.

Duke parë marrëdhëniet shoqërore dhe ndikimet negative të veprave të këqija, të cilat nuk janë të kufizuara me vendin ku kryhen, sqarohet rëndësia logjike e këtyre dy detyrave.

Me fjalë të tjera: Në shoqëri nuk ka “dëm individual”, i cili mund të kufizohet vetëm me individin. Por, dëmi individual mund të rritet, duke u shndërruar në dëm shoqëror. Mendja e shëndoshë e logjikon se çdo shoqëri duhet të kujdeset për të ndërtuar një mjedis të shëndoshë shoqëror dhe për ta pastruar atë nga çdo mbeturinë e papastërti.

Dhe këtë e tregojnë disa hadithe.

Transmetohet nga i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili ka thënë: “Shembulli i atij

që kryen urdhërimet e All'Ilahut dhe i pengmarrësit është si shembulli i një populli të cilët kanë hipur në një anije dhe kanë dalë në det. Disa prej tyre godasin nga lart, të tjerët nga poshtë.<sup>1</sup> Ata që ishin poshtë thanë: “U besoni thirrjeve të atyre që janë poshtë, për ta ndaluar ujin. Sikur të gjithë të kapnin duart e njëri-tjetrit, do ta ndalonin ujin dhe do të shpëtonin. Sikur të gjithë ta linin, do të mbyteshin.”

Me anë të këtij shembulli, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka përforcuar tematikën e urdhrit për të bërë vepra të mira dhe për t'u larguar nga veprat e këqija. Duke i parë me një logjikë të shëndoshë, këto janë urdhëresa legislative hyjnore, por është e drejta e individit të zgjedhë se cilën prej këtyre rrugëve do të zgjedhë.

### 3) Rëndësia e urdhërimit në të mirë dhe e ndalimit nga e keqja

Ajetet e lartpërmendura dhe shumë ajete të tjera kur'anore, si dhe shumë hadithe flasin për vlerën dhe rëndësinë e madhe të këtyre dy detyrave të mëdha shoqërore. Po përmendim disa hadithe:

1) Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thanë: “Me të vërtetë, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja është një detyrë e madhe. Mbi të qëndrojnë detyrat e tjera, sigurohet feja, fitimet janë të lejueshme, largohen padrejtësitë, lulëzohet toka dhe pastrohet prej armiqve dhe ecet në rrugë të drejtë.”<sup>2</sup>

2) Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush urdhëron në të mirë dhe ndalon nga e keqja, ai

<sup>1</sup> Tefsiri “Ruhul Xhinan”, vëllimi 4, faqe 482; “Mu'xhemul Eusat i Tabarani”, vëllimi 3, faqe 149.

<sup>2</sup> “Vesailu Shijja” vëllimi 11, faqe 395. Libri i urdhërimit në të mira dhe e ndalimit nga të këqijat, kreu 1, hadithi 1.

është mëkëmbësi i All'llahut në tokën e Tij, mëkëmbësi i të dërguarit të All'llahut dhe mëkëmbësi i Librit të Tij.<sup>1</sup>

3) Një person shkon tek i Dërguari i All'llahut, i cili ishte në mimber dhe i tha: “O i Dërguari i All'llahut, kush është më i miri ndër njerëzit?”

Ai tha: “Ai që i urdhëron njerëzit në të mirë dhe i ndalon nga e keqja. Ai që i frikësohet më shumë All'llahut dhe është më i kënaquri ndaj Tij.”<sup>2</sup>

4) Në një hadith tjetër nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Do të urdhëroni në të mirë dhe do të ndaloni nga e keqja ose All'llahu do t'ju çojë një udhëheqës mizor, që nuk e respekton të madhin tuaj, nuk e mëshiron të voglin. Kur i miri juaj do të lutet, nuk do t'i pranohet lutja; do të kërkonti fitore e nuk do të keni sukses. Do të kërkonti ndihmë dhe nuk do t'ju përgjigjet për t'ju ndihmuar, do të kërkonti falje e nuk do t'ju falë.”<sup>3</sup>

Të gjitha këto çështje ndodhin për shkak të qëndrimit indiferent të shoqërisë ndaj këtyre dy detyrave madhështore. Si pasojë, çështjet do të kapen nga shkatërruesit dhe do të sundojnë çdo gjë sipas dëshirës së tyre dhe shoqëria do të goditet me ato të këqija që përmenden në hadithin e lartpërmendur.

5) Transmetohet nga imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “Të gjitha veprat e mira, lufta për në rrugën e All'llahut, në krahasim me urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga të këqijat, janë si fryrjet në thellësinë e detit.”<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në fjalë dhe “Mustedrekul Vesail”, vëllimi 12, faqe 179.

<sup>2</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në fjalë.

<sup>3</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në fjalë.

<sup>4</sup> “Nehxhul Belaga”, fjalët e urta, fjala 374.

Të gjitha këto argumente flasin për vlerën e zbatimit të këtyre dy detyrave madhështore, duke i konsideruar si themel për ndërtimin e një shoqërie të fortë, si dhe siguri për zbatimin e detyrave të tjera individuale dhe shoqërore, sepse ato konsiderohen si shpirti i shoqërisë dhe frymëmarrje për atë. Nëse lihen pas dore këto detyra, humbet vlера e morali dhe shkatërrohet jeta e shoqërisë.

#### **4) A e mohon lirinë urdhërimi me të mirë?**

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, patjetër duhet të themi se sistemi i jetës shoqërore ka dobi të shumta. Karakteristikat e mira që ka ky sistem e ka çuar njeriun që ta zgjedhë atë. Por, nga ana tjetër, ky sistem ka disa kushte për lirinë individuale. Përderisa dëmi i këtij kushti është shumë i pakët në krahasim me dobitë e shumta të sistemit shoqëror, atëherë njeriu e zgjodhi atë që në fillim të jetës së tij në këtë planet.

Me të vërtetë, e ardhmja e individëve është e lidhur me jetën e shoqërisë, duke ndikuar te njëri-tjetri. Të gjitha së bashku bëjnë pjesë në një të ardhme të përbashkët e të vetme për jetën e shoqërisë. Për këtë është e drejtë që të mbikëqyren reagimet e të tjerëve dhe morali i tyre. Kjo është një e drejtë e natyrshme që të vazhdojë jeta shoqërore.

Duke u bazuar në këtë, urdhërimi në të mirë nuk e mohon lirinë e individit. Kjo çështje tregon qetësinë dhe rregullin e të tjerëve për të zgjidhur çështjet, ku secili individ duhet të zgjidhë çështjen e tij.

#### **5) A nuk krijon urdhërimi me të mirë çrregullim në shoqëri?**

Vetvetiu shtrohet kjo pyetje: “Nëse i lejojmë njerëzit të hyjnë në çështjet e të tjerëve dhe të kenë mbikëqyrjen e punëve dhe të veprave të tyre, në të vërtetë, kjo shkakton çrregullim në shoqëri. Si pasojë, ndodhin përplasje midis individëve. Kjo sepse është në kundërshtim me

parimin e shpërndarjes së përgjegjësisë e të detyrave në jetën shoqërore. Si ta kuptojmë këtë?

**Përgjigje:** Hulumtimet e mëparshme sqaruan se detyra e urdhërimit në të mirë dhe e ndalimit nga e keqja ka dy periudha: Periudha e parë është periudha e përgjithshme. Ajo është e kufizuar e nuk mund ta kalojë kufirin e përkujtimit, të këshillës dhe të kritikës dhe të tjera të ngjashme me këto. Nuk ka dyshim se, nëse shoqëria dëshiron të mbijetojë, të mbesë e gjallë e aktive, patjetër duhet që të gjithë individët e saj ta ndiejnë këtë përgjegjësi për t'i bërë ballë së keqes dhe ta luftojë atë.

Periudha e dytë është ajo që veçon një grup të shoqërisë. Kjo çështje i përket shtetit islam, i cili ka fuqi dhe hapësirë më të madhe se individi. Themi kështu, pasi shteti mund të përdorë dhe forcën për të rregulluar problemet që mund të lindin.

Grupi i parë, edhe sikur të dojë, nuk mund ta kalojë cakun e tij. Ai qëndron në kufirin e këshillës dhe të përkujtimit.

Në të dyja këto periudha ka detyra fetare që duhen të kryhen dhe secila periudhë ka kufijtë e saj. Nëse kryhen këto detyra, shoqëria nuk do të ketë çrregullime dhe rrëmujë. Një shoqëri që ndjek këto rregulla është një shoqëri e gjallë, aktive dhe shkon drejt zhvillimit.

## **6) Urdhërimi në të mirë nuk është ashpërsi**

Në mbyllje të këtij hulumtimi dëshirojmë t'ju kujtojmë këtë të vërtetë. Ky detyrim madhështor nga ana e All'llahut, thirrja në të mirë, është thirrja në të vërtetën, që do të thotë luftimi i së keqes dhe shkulja e saj me rrënjë, por jo me anë të dhunës dhe ashpërsisë, me përjashtim të disa rasteve të veçanta. Por, fatkeqësisht, ka persona të cilët janë të ashpër në kryerjen e kësaj detyre të shenjtë, duke mos e kontrolluar

veten, duke fyer e duke sharë. Kjo mënyrë sjelljeje nuk lë shije të mirë dhe në vend që të ndikojë për mirë, t'i afrojë në rrugën e drejtë njerëzit, ndodh e kundërta.

Nëse do të lexonim jetën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe të imamëve të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), do të shohim se ata e zbatonin këtë detyrë me mënyrën më të lartë të butësisë, të mëshirës dhe të dashurisë, si dhe me shkallën më të lartë të moralit.

Kjo është arsyeja se pse ata kanë qenë shumë të afërt dhe populli i donte. Ata respektonin edhe kundërshtarët më të mëdhenj dhe njerëzit më të egër e të ashpër.

Në tefsirin “El-Menar” lexojmë hadithin që shpjegon këtë ajet.

Një djalosh i ri ka ardhur tek i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i ka thënë: “A më jep mua leje që të bëj imoralitet (zina)?” Njerëzit i bërtitën atij.

Profeti u tha atyre: “Afrojeni atë këtu!” Ai u afrua dhe u ul. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: “A e dëshiron këtë gjë për nënën tënde?”

Ai tha: “Jo, All'llahu më bëftë flijim për ty!”

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: “Kështu, pra, njerëzit nuk e duan për nënat e tyre këtë gjë. A e dëshiron ti për vajzën tënde?”

Ai tha: “Jo, All'llahu më bëftë flijim për ty!”

Profeti i tha: “Kështu, ata nuk e duan për vajzat e tyre e ti a e dëshiron për motrën tënde?”

Ai tha: “Jo, All'llahu më bëftë flijim për ty!”

Dhe i Dërguari i All'lahut vendosi dorën e tij në gjoks dhe tha: “O All'llah, pastroje zemrën e tij, falja mëkatit dhe ruaje nderin e tij!”

Gjëja më e urryer te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë imoraliteti.<sup>1</sup>

Ky ishte ndikimi i natyrshëm i metodës së butë të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në ndalimin nga e keqja.

## **7) Përçarja pas bashkimit është veçori e jehudinjtë dhe e të krishterëve**

Kur'ani Famëlartë, herë pas here, thekson vlerën e bashkimit. Ai tërheq vëmendjen rreth pasojave negative të përçarjes dhe të hipokrizisë, duke thënë: **“Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën.”**

Ky ajet u tërheq vëmendjen myslimanëve që të mos ndjekin popujt e mëparshëm, si: jehudinjtë dhe të krishterët, të cilët, pasi u erdhi e vërteta, u përçanë, duke përfituar ndëshkimin e dhembshëm.

Në të vërtetë, ky ajet i fton myslimanët që ta vlerësojnë të kaluarën dhe të meditojnë rreth jetës së popujve të mëparshëm, si ka qenë fundi i tyre për shkak të përçarjes e grindjes.

Me të vërtetë, vendosmëria e Kur'anit Famëlartë në këto ajete, për t'iu larguar përçarjes dhe hipokrizisë, është se ai na paralajmëron se kjo çështje do të ndodhë në të ardhmen edhe në shoqërinë islame. Nëse Kur'ani paralajmëron për diçka apo këmbëngul në braktisjen e diçkaje, kjo për faktin se do të ndodhë në ardhmen.

Për këtë gjë i ka lajmëruar myslimanët edhe i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili ka thënë: “Me të vërtetë (ummeti) populli i Musait u përça në

---

<sup>1</sup> Tefsiri “El-Menar”, vëllimi 4, faqe 33-34; “Musned Shamijijn Tabranij”, vëllimi 2, faqe 139.

shtatëdhjetë e një grupe dhe populli i Isait u përça në shtatëdhjetë e dy grupe dhe se populli (ummeti) im do të përçahet e do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe.”<sup>1</sup>

Numri shtatëdhjetë tregon numrin e shumtë të grupeve dhe jo numrin përlllogaritës dhe se transmetimi e ka kuptimin se grupi i vetëm ndërmjet jehudinjeve dhe të krishterëve është ajo e vërteta dhe e shpëtuar dhe se të gjitha grupet e tjera do të jenë në zjarr. E njëjtë është edhe gjendja e myslimanëve dhe ndoshta mund të shtohet numri i përçarjeve dhe i grindjeve në mesin e tyre. Përçarja do t'i largojë nga rruga e drejtë dhe e vërtetë. Kjo përçarje bën që myslimanët të bëhen armiq, të mallkojnë dhe të nxjerrin shpatat, duke derdhur gjakun e njërit-tjetrit. Përçarja bëhet aq e madhe, sa disa myslimanë do të kërkojnë mbështetje tek jobesimtarët (kafirët) ose të vrasin vëllezërit e tyre, i cili ka qenë një ndër arsyt e inferioritetit të myslimanëve të mëparshëm. Suksesi shndërrohet në hipokrizi, në përçarje dhe deformim. Në vend të krenarisë mbizotëron përçmimi dhe dobësia. Kështu shkatërrohet madhështia dhe përfundon krenaria.

Sigurisht, ata që ndjekin rrugën e përçarjes e të grindjes, pas mirëkuptimit në njësim, do të ndëshkohen dhembshëm. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Për këtë do të ketë dënim të madh.”**

Me të vërtetë, nuk duhet të ketë dyshim se rezultati i përçarjes dhe i grindjes nuk është gjë tjetër veçse përçmim e thyerje. Ky është sekreti i rrënjës së popujve dhe përçmimi i tyre, sepse ata u përçanë dhe u grindën dhe jetojnë në hipokrizi.

---

<sup>1</sup> Këto transmetime kanë ardhur nga burime të shumta, si nga burimet e shi'ave, ashtu edhe nga burimet e sunive. Prej burimeve të shi'ave janë: “El Khisal”, “Meanij Akhbar”, “El Ihtixhaxh”, “Amalij Suduk”, “Aslu Selijm i ibn Kubejs” dhe tefsiri “El Ajjashij”. Prej burimeve sunite janë: tefsiri “Durul Menthur”, “Xhamiul Usul” dhe “Milel e Nihel”.

Shoqëritë që shkatërrojnë bashkimin, duke përçarë, do të bien nën kthetrat e luftës armiqësore dhe se jeta e tyre do të jetë në duart e pushtuesve lakmues e të pangopur.

Sa i madh është ky ndëshkim dhe sa i ashpër është ky dënim? Nuk ka dyshim se ky është dënimi e ndëshkimi i hipokrizisë dhe i përçarjes.

Ndërsa ndëshkimi i Botës Tjetër, ashtu si e ka përshkruar All'Ilahu në Kur'anin Famëlartë, është më i madh e më i rëndë. Ai është në pritje për të gjithë ata që sjellin përçarje dhe grindje mes njerëzve. Ata kanë përçmimin në këtë botë dhe dënimin e rëndë në Botën Tjetër.

## Ajetet 106-107

يَوْمَ تَبْيَضُّ وُجُوهٌ وَتَسْوَدُّ وُجُوهٌ فَأَمَّا الَّذِينَ اسْوَدَّتْ وُجُوهُهُمْ أَكْفَرْتُمْ بَعْدَ  
إِيمَانِكُمْ فذوقوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْفُرُونَ ﴿١٠٦﴾ وَأَمَّا الَّذِينَ أَبْيَضَتْ  
وُجُوهُهُمْ فَفِي رَحْمَةِ اللَّهِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿١٠٧﴾

“Ditën (e Kiametit) kur disa fytyra do të zbardhen e disa të tjera do të nxihen. Atyre që do t’u nxihet fytyra, do t’u thuhet: “Vallë, ju mohuat pas besimit?! Atëherë shijoni dënimin për shkak se nuk besuat!”

Kurse ato fytyra që do të zbardhen e do të shkëlqejnë, do të jenë në mëshirën e All’llahut (në Xhennet), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”

## Komentimi

### Fytyra të zbardhura dhe fytyra të nxira

Pas paralajmërimeve të forta që përmbanin ajetet e mëparshme rreth përçarjes, hipokrizisë dhe kthimit në zakonet e injorancës (xhahilijetit), vijnë këto dy ajete që tregojnë për rezultatet përfundimtare të këtij kthimi të shëmtuar në moralin e injorancës dhe në zakonet e saj, si dhe qartëson se mosbesimi, hipokrizia, përçarja dhe kthimi i injorancës bën që fytyrat në Ditën e Gjykimit të nxihen.

E kundërta do të ndodhë për të gjithë ata që kanë qëndruar në rrugën e besimit, të bashkimit, të dashurisë dhe të vëllazërimit. Zemrat dhe fytyrat atë ditë do të jenë të zbardhura.

All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ditën (e Kiametit) kur disa fytyra do të zbardhen e disa të tjera do të nxihen.”**

Ditën e Gjykimit fytyrat e disa njerëzve do të nxihen dhe disa të tjerë, po atë Ditë, do të jenë me fytyra të pastra, të ndritshme e të zbardhura. All'llahu i Lartësuar vazhdon: **“Atyre që do t'u nxihet fytyra, do t'u thuhet: “Vallë, ju mohuat pas besimit?! Atëherë shijoni dënimin për shkak se nuk besuat!”**

E përse ju përzgjedhët rrugën e hipokrizisë, të përçarjes, të tradhtisë, të injorancës, duke mohuar njësimin dhe unitetin nën hijen e Islamit? Tani përjetoni dhe shijoni dënimin tuaj të drejtë. Kurse besimtarët, janë të mbushur me mëshirën e All'llahut: **“Kurse ato fytyra që do të zbardhen e do të shkëlqejnë, do të jenë në mëshirën e All'llahut (në Xhennet), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”**

Këto dy ajete shpjegojnë qartë se hipokritët dhe përçarësit, pasi u ka ardhur argumenti dhe e vërteta, do t'u nxihen fytyrat e do të shijojnë ndëshkimin e rëndë e të dhimbshëm për shkak të mohimit të tyre; ndërsa besimtarët, të vëllazëruar e të bashkuar me njëri-tjetrin, me ndjenjën e dashurisë mes veti, do të jenë në mëshirën dhe kënaqësinë e All'llahut. Fytyrat e tyre do të jenë të bardha.

E kemi thënë disa herë se ajo që merr njeriu në Botën Tjetër nuk është gjë tjetër veçse ajo që ka bërë në këtë jetë.

Me fjalë të tjera: çdo vepër që kryen njeriu në këtë botë është një gjurmë e madhe që mbetet në shpirtin e tij, e cila pothuajse nuk mund të mësohet në këtë botë, por shfaqet e qartësohet në Botën Tjetër. Secila nga këto gjendje do të shfaqet me gjithë të vërtetat e rezultatet e saj. Ndërkohë, nga ana shpirtërore do të jetë një realitet më i fuqishëm, ku

gjykimi i saj do të mbizotërojë anën tjetër të njeriut. Të gjitha ato gjurmë dhe vepra që kanë mbetur në shpirt do të kthehen.

Sikurse besimi dhe uniteti çojnë në ngritjen e njeriut dhe në zbardhjen e fytyrës së tij në këtë jetë, e kundërta ndodh me mohimin dhe përçarjen. Ato e shtyjnë popullin në përçmimin e vlerave morale, duke ia nxirë fytyrën. E më të vërtetë, kjo zbardhje dhe nxirje e fytyrave në këtë botë shfaqet në Botën Tjetër në një paraqitje e formë të vërtetë, ku besimtarët, të njësuar e të vëllazëruar, tubohen me fytyra të zbardhura e të ndritshme, ndërkohë mohuesit dhe ata që u përçanë e u grindën tubohen në Ditën e Gjykimit me fytyra të nxira e të poshtëruara.

Këtë të vërtetë e tregojnë dhe ajetet e tjera të Kur'anit Famëlartë, çështjen e atyre që zhyten në mëkate. All'llahu i Lartësuar thotë në suren "Junus", ajeti 27: **"Kurse ata që bëjnë vepra të këqija, do të kenë dënim gjegjës për atë të keqe. Ata do t'i mbulojë poshtërimi, pa pasur askënd që t'i mbrojë nga dënimi i All'llahut, me fytyrat e tyre si të ishin të mbuluara me copa të errëta nate. Këta do të jenë banorët e zjarrit dhe aty do të qëndrojnë përgjithmonë."**

Në suren "Ez-Zumer", ajeti 60, All'llahu i Lartësuar tregon për çështjen e atyre që përgënjeshtrojnë dhe shpifin ndaj Tij: **"Në Ditën e Kiametit do t'i shihni ata që kanë trilluar gënjeshtër për All'llahun, me fytyra të nxira. Vallë, a nuk është Xhehennemi vend për ata që janë mendjemëdhenj?!"**

Të gjitha këto çështje janë të rikthyera dhe gjurmë të natyrshme për atë që e pret njeriun nga veprat e kryera në këtë botë.

## Ajetet 108-109

تِلْكَ ءَايَاتُ اللَّهِ نَتْلُوهَا عَلَيْكَ بِالْحَقِّ وَمَا اللَّهُ يُرِيدُ ظُلْمًا لِّلْعَالَمِينَ  
وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَمَا فِي الْاَرْضِ ۚ وَإِلَى اللَّهِ تُرْجَعُ الْاُمُورُ

**“Këto janë vargjet e All’llahut, që t’i lexojmë ty me të vërtetën dhe All’llahu nuk i dëshiron askujt padrejtësi.”**

All’llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë dhe tek All’llahu do të kthehen të gjitha çështjet.”

### Komentimi

Këto dy ajete tregojnë atë çfarë kanë paraqitur ajetet e mëparshme, që flasin rreth besimit dhe mohimit, njësimi, unitetit dhe përçarjes, urdhërimit në të mirë e ndalimit nga e keqja, gjurmët e saj dhe përfundimin e këtyre veprave. Ajeti i parë thotë: **“Këto janë vargjet e All’llahut, që t’i lexojmë ty me të vërtetën dhe All’llahu nuk i dëshiron askujt padrejtësi.”**

Të gjitha këto ajete (të mëparshmet dhe ato në fjalë) tërheqin vëmendjen për ato vepra që e kanë përfundimin e keq, që njerëzit i kryejnë me vetëdijen e tyre. Për këtë, All’llahu u drejtohet: **“All’llahu nuk i dëshiron askujt padrejtësi.”**

Me anë të këtij ajeti, All'Ilahu tregon se nuk i bën askujt padrejtësi, se është Krijuesi i gjithçkaje dhe se njeriu është vetë përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera.

Për këtë gjë All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“All'Ilahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë dhe tek All'Ilahu do të kthehen të gjitha çështjet.”**

Në të vërtetë, ky ajet përfshin në thellësinë e tij dy argumente:

E para: Çfarë ka në qiej dhe gjithçka gjendet në Tokë është e All'Ilahut dhe nuk ka kuptim që Ai të bëjë padrejtësi dhe të ekzistojë kjo cilësi tek Ai. Këtë gjë e tregon pjesa e parë e ajetit: **“All'Ilahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë...”**

E dyta: Me të vërtetë, padrejtësi mund të bëjë ai që humbet diçka apo vepron me pavetëdije. Kurse, Ai tek i cili kthehen të gjitha çështjet, nuk është e mundur që të bëjë padrejtësi. Për këtë, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Tek All'Ilahu do të kthehen të gjitha çështjet.”**

## Ajeti 110

وَلَوْ أَنَّهُمْ ءَامَنُوا وَاتَّقَوْا لَمَثُوبَةٌ مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ خَيْرٌ لَّوْ كَانُوا يَعْلَمُونَ ﴿١١٠﴾

**“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni All’llahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”**

### Komentimi

#### **Luftimi i së keqes dhe thirrja për tek e vërteta dhe tek e drejta**

Në këtë ajet paraqitet edhe një herë çështja e urdhërimit në të mirë dhe e ndalimit nga e keqja, duke i konsideruar detyra të përgjithshme, siç u tha edhe në ajetin 104 të po kësaj sureje. Kurse ajeti i mëparshëm sqaroi fazën e posaçme, që është faza e uxhubit kifai, që do të thotë se është detyrë e posaçme e një grupi të caktuar, siç u tha në komentimin e ajetit. Pra, ajeti i mëparshëm flet për një pjesë të posaçme të këtyre dy detyrave, kurse ajeti në fjalë flet për një pjesë të përgjithshme të këtyre dy detyrave.

All’llahu i Lartësuar thotë: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni All’llahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre**

**besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”**

Është e vlefshme të kujtohet se Kur’ani i Madhëruar në këtë ajet i cilëson myslimanët si populli më i mirë që ka dalë mbi sipërfaqen e tokës për t’i shërbyer shoqërisë njerëzore. Argument për këtë cilësim është përzgjedhja për këtë mision të madh “urdhërimi në të mirë”, “ndalimi nga e keqja” dhe besimi në All’llahun e Lartësuar.

Nga kjo përfitohet se ndreqja e një shoqërie njerëzore nuk mund të bëhet pa besimin në All’llahun e Lartësuar, pa thirrjen në të vërtetën dhe pa luftuar të keqen. Themi se këto dy detyra madhore janë nga vlerat që ka Islami. Janë pikërisht këto dy detyra madhështore që e dallojnë Islamin nga të gjitha legjislacionet dhe fetë e mëparshme.

Disa mund të pyesin se përse myslimanët duhet të jenë populli më i mirë mbi sipërfaqen e tokës? Përgjigjja është e qartë: Islami është feja e fundit e All’llahut dhe për këtë ajo duhet të jetë më e plotësuar dhe më e përkryera e feve.

### **Dy qëndrime në këtë ajet**

Është e rëndësishme që të ndalojmë pak në këtë ajet dhe të sqarojmë dy pika:

**E para:** Ajeti, këtë gjendjen e popullit, e ka përshkruar me foljen në kohën e shkuar: “*ju jeni*”. Kjo do të thotë se ju keni qenë në të shkuarën. Ka pasur dhe ka diskutime të shumta në lidhje me këtë përshkrim. Kuptimi i veprimit në kohën e shkuar në fjalën *kuntum* është për të konstatim dhe forcim, si dhe tregon që me siguri ka ndodhur, edhe pse folja është në kohën e shkuar.

Për këtë, në Kur'anin Famëlartë gjejmë shembuj ku janë shprehur shumë çështje, të cilat kanë ndodhur dhe janë shprehur me fjalinë në kohën e shkuar, për të nënkuptuar se kjo patjetër ka ndodhur, edhe pse është zbritur në të shkuarën dhe është realizuar në atë kohë.

**E dyta:** Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, në këtë ajet, ka ardhur përpara thënies: “...**dhe besoni All'Ilahun**”. Ky është dëshmuesi më i mirë dhe më i madh për rëndësinë e këtyre dy detyrave hyjnore, të cilat nxitin për të përhapur besimin, për të forcuar rrënjët e tij në shpirtin e shoqërisë njerëzore, për të zbatuar të gjitha rregullat e ligjet e individit dhe të shoqërisë.

Por sigurisht, moszbatimi i këtyre dy detyrave çon në dobësimin e besimit në zemrat e njerëzve, duke shkatërruar bazat e besimit në shpirtat e njerëzve. Të gjitha këto kanë qenë arsyet që i paraprinë (urdhërimi në të mirë dhe ndalimin nga e keqja) besimit. Nga ky shpjegim qartësohet se myslimanët janë “populli më i mirë”, përderisa bëjnë thirrje në të mirë, urdhërojnë njerëzit të kryejnë vepra të mira dhe i ndalojnë të kryejnë vepra të këqija. Nëse ata i harrojnë këto dy detyra apo i neglizhojnë, nuk konsiderohen populli më i mirë, sikurse nuk mund të konsiderohen asnjëherë se i shërbejnë shoqërisë njerëzore.

Në këtë ajet, thirrja u drejtohet të gjithë myslimanëve, në të gjitha kohët, sikurse është gjendja në të gjitha thirrjet e Kur'anit. Nuk është mendim i saktë i disave që thonë se kjo thirrje është veçanërisht për muhaxhirët apo për myslimanët e parë. Kjo thënie nuk ka asnjë argument.

Më pas ajeti tregon se këtë fe me këtë qartësi të madhe, me këtë legjislacion madhështor, me këto mësimë mjaft të dobishme, të cilat nuk mund të mohohen, duhet që ithtarët e Librit, jehudinjtë dhe të krishterët, ta besojnë se në të kanë të gjitha të mirat e tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”**

Por, fatkeqësisht, nuk kanë besuar vetëm një pakicë, të cilët e kanë përqaftuar Islamin me një dëshirë të sinqertë dhe e kanë pranuar këtë fe me sinqeritetin e shpirtit larg fanatizmit verbues. Shumica prej tyre (jehudinjtë dhe të krishterët) e kanë mohuar Islamin dhe kanë preferuar të rrinë në mosbesim dhe në fanatizëm, duke mohuar edhe argumentet e qarta që gjenden në librat e tyre rreth kësaj feje. Për këtë flet edhe All'llahu i Lartësuar: **“...ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”**

## Ajetet 111-112

لَنْ يَضُرُّكُمْ إِلَّا أَذًى ۖ وَإِنْ يُقْتَلُوا يُوَلُّوكمُ الْأَدْبَارَ ثُمَّ لَا  
يُنصَرُونَ ﴿١١١﴾ ضُرِبَتْ عَلَيْهِمُ الذِّلَّةُ أَيْنَ مَا ثُقِفُوا إِلَّا بِحَبْلٍ مِّنَ اللَّهِ  
وَحَبْلٍ مِّنَ النَّاسِ وَبَاءُ وَبِغَضِبِ مِّنَ اللَّهِ وَضُرِبَتْ عَلَيْهِمُ الْمَسْكَنَةُ ۚ ذَلِكَ  
بِأَنَّهُمْ كَانُوا يَكْفُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ وَيَقْتُلُونَ الْأَنْبِيَاءَ بِغَيْرِ حَقٍّ ۚ ذَلِكَ بِمَا  
عَصَوْا وَكَانُوا يَعْتَدُونَ ﴿١١٢﴾

“Ata, përveç lëndimit, nuk mund t’ju dëmtojnë juve. Nëse ju luftojnë, ata do të kthejnë thembrat (të mundur) dhe pastaj nuk do të ndihmohen.

Kudo që gjenden, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej All’liahut apo prej njerëzve. Ata merituan zemërimin e All’liahut dhe do t’i kaplojë mjerimi. Kjo ishte për shkak se mohuan shpalljet e Tij dhe pa kurrfarë të drejte, i vrisnin profetët. Kjo ishte për shkak se ata nuk u bindën dhe i kaluan kufijtë (në të këqija).”

## Shkaku i zbritjes

Kur u mor vesh që Abdullah Ibn Selami la fenë e tij dhe përqafoi fenë islame, pjesëtarët e fisit të Abdullait filluan fushatën e tyre të kërcënimeve. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje zbritën ajetet e lartpërmendura, për t'i garantuar e për t'i përgëzuar ata dhe myslimanët me fitore.<sup>1</sup>

## Komentimi

Ajeti i parë i përgëzon myslimanët që u përballën me presione dhe nganjëherë me kërcënime të rrepta prej popullit të tyre mosbesimtar, për shkak të përqaimit të Islamit. I përgëzon dhe u premton atyre se janë triumfues e të shpëtuar dhe se ithtarët e Librit (jehudinjtë dhe të krishterët) nuk janë në gjendje të përballen me ta dhe t'u bëjnë keq. Çdo gjë të keqe që hasin (nga ithtarët e Librit) do të jetë kalimtare, pasi All'llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: **“Ata, përveç lëndimit nuk mund t’ju dëmtojnë juve. Nëse ju luftojnë, ata do të kthejnë thembrat (të mundur) dhe pastaj nuk do të ndihmohen.”**

Në të vërtetë, këto dy ajete, në thelbin e tyre, përbëjnë disa lajmërimë të fshehta dhe përgëzime të rëndësishme për myslimanët. Të gjitha këto (lajmërimë të fshehta dhe përgëzime) janë dhënë gjatë jetës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Këto lajmërimë janë:

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”; Tefsiri “Kurtubijj”, “Biharul Envar”, vëllimi 9, faqe 72.

1) Me të vërtetë, ithtarët e Librit (jehudinjtë dhe të krishterët) nuk mund t'u shkaktojnë ndonjë të keqe myslimanëve, përveçse ndonjë lëndim të vogël. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ata, përveç lëndimit, nuk mund t'ju lëndojnë juve.”**

2) Ata nuk mund t'u bëjnë ballë myslimanëve në luftë, do të humbasin dhe fitorja do të jetë e myslimanëve. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Nëse ata ju luftojnë, ata do të kthejnë thembrat (të mundur) dhe pastaj nuk do të ndihmohen.”**

3) Ata nuk mund të mbështeten në forcat e tyre, pasi jetojnë pa mësimet e All'llahut dhe do të mbesin gjithmonë të nënçmuar, nëse i hedhin një shikim sjelljes së tyre dhe pendohen për veprimet e tyre. Për këtë, All'llahu i Lartësuar urdhëron: **“Kudo që gjenden, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej All'llahut apo prej njerëzve.”**

Nuk kalon kohë e gjatë pas zbritjes dhe thënies së All'llahut zbatohet. Të gjitha veprimet që bënin jehudinjtë, si: Beni Kurejdha, Beni Nadhijr, Beni Kajnaka dhe jehudinjtë e Hajberit e të Beni Mustalikut, kanë përfunduar me humbje, u shuan përpara forcës së Islamit, pasi u përçanë lidhjet e provokimeve dhe të intrigave kundër Islamit dhe myslimanëve.

### **Jehudinjtë dhe ardhja e tyre e frikshme**

Në të vërtetë, këto ajete nuk e përmendin emrin e jehudinjve. Por gjatë argumentimit të këtij ajeti, duke u bazuar dhe në ajetet e mëparshme, gjithashtu dhe në argumentimin e ajetit të gjashtë të sures “El-Bekare” dhe të të tjerëve të ngjashëm, është qartësuar emri i jehudinjve.

Në lidhje me këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Kudo që gjenden, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej All'llahut apo prej njerëzve.”**

Në këtë pjesë të ajetit, All'llahu i Lartësuar thotë se përpara jehudinjeve ka vetëm dy rrugë për të ndjekur: Të kthehen tek All'llahu dhe të mbështeten te Ai ose të mbështeten te mbrojtja e njerëzve dhe të jetojnë të përcmuar duke ndjekur të tjerët.

Fjala *thekefu* rrjedh nga fjala *thekeue*, që do të thotë *zgjuarsi*, persona që dinë të zgjidhin çështjet.

Ky është qëllimi pse janë zbritur këto ajete. Çështja është e qartë, se jehudinjtë, kudo që të gjenden, do ta përçmojnë leximin e Kur'anit. Sado që ta fshehin këtë, ata do të përballen me këtë realitet. Kjo është një cilësi e dukshme për shkak të qëndrimit të tyre armiqësor e të pabindur ndaj mësimëve të të dërguarve të mëdhenj.

Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme për fjalinë **“...vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej All'llahut apo prej njerëzve”**. Duke u bazuar në atë çfarë treguam më parë, mund të themi se për këtë ajet janë dhënë mendime të tjera. Kur të vendoset “mbrojtja prej All'llahut” përballë “mbrojtjes prej njerëzve” qartësohet se atje nuk ka një kuptim të kundërt, se kuptimi i parë “mbrojtje prej All'llahut” është besimi në All'llahun dhe e dyta “apo prej njerëzve” është besa e myslimanëve, dhënë atyre, e cila ishte siguri e qetësi.

Në mënyrë të përmbledhur, kuptimi i këtij ajeti është se jehudinjtë duhet të ndryshojnë mënyrën e jetës së tyre, të kthehen e të besojnë në All'llahun e Lartësuar, duke fshirë nga mendja e

tyre mendimet e shejtanit; ose të vazhdojnë jetën e tyre të përçmuar, të mbushur me hipokrizi, ose të besojnë All'Ilahun dhe të hyjnë nën hijen dhe nën mbrojtjen e Tij të fortë, ose të mbështeten në ndihmën e njerëzve, të cilët janë të paafte, duke vulosur vazhdimësinë e një jete të përçmuar.

### **Jehudinjtë dhe qëndrimi i tyre i përhershëm**

Jehudinjtë kishin dy rrugë: ose të kthehen tek legjislacioni i All'Ilahut, ose të mbesin në sjelljen e tyre e të jetojnë të përçmuar. Ata përzgjedhën rrugën e dytë, duke i përndjekur përçmimi. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Ata merituan zemërimin e All'Ilahut dhe do t'i kaplojë mjerimi.”**

Fjala *bau* do të thotë *kthim* dhe *kaplim prej mjerimit*. Këtu është përdorur në funksionin e antonimit. Kuptimi i kësaj është se jehudinjtë e merituan ndëshkimin hyjnor për shkak të jetës së tyre mëkatore dhe përzgjedhën zemërimin e All'Ilahut, sikurse njeriu përzgjedh banesën e vet për të jetuar.

Ndërsa fjala *meskenetu* do të thotë *përçmim* e *mjerim*, shkëputje të madhe nga mëshira e All'Ilahut, e cila do të ketë një mashtrim të vazhdueshëm e të përhershëm. Kjo fjalë është e huazuar nga rrënja e fjalës *sukun*, që do të thotë *banesë* e *qëndrueshme*. Arsyeja e huazimit është se banesat, ndërtesat janë të forta dhe të palëvizshme (ashtu janë dhe zemrat e tyre ndaj kësaj të vërtete të realitetit).

Duhet të sqarojmë se i mjerë nuk është ai që nuk ka pasuri. Kjo cilësi përfshin të gjithë ata që nuk janë në gjendje të ngjiten në majat e larta të besimit, për shkak të dobësive dhe të paafësive.

Disa mendojnë se ka ndryshim mes *përçarjes* - *dhiletu* dhe *mjerimit* - *meskenetu* se përçmimi është përçmimi i njeriut, ndërsa mjerimi lind nga zilia dhe lulëzimi i saj i brendshëm. Sigurisht, i mjerë është ai që dobëson personalitetin dhe aftësitë e tij.

Ky mjerim buron nga brendësia e njeriut, kurse përçmimi rrjedh nga jashtë. Duke u bazuar në këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ata merituan zemërimin e All'llahut dhe do t'i kaplojë mjerimi.”**

Themi se jehudinjtë, për shkak të qëndrimit të tyre mëkatar, u goditën me dy gjëra: E para, largimi nga ana e shoqërisë dhe kaplimi i tyre me hidhërimin e All'llahut të Lartësuar.

E dyta, me të vërtetë, kjo gjendje (sigurisht përçmimi) është bërë gradualisht cilësi e brendshme e tyre. Pavarësisht fuqisë së tyre monetare dhe të pushtetit, ata fituan përçmimin. Për këtë ne nuk gjejmë asnjë veçim në këtë fjali të këtij ajeti.

Këtë gjë e tregon fjala e All'llahut të Lartësuar: **“Kjo ishte për shkak se mohuan shpalljet e Tij dhe pa kurrfarë të drejte, i vrisnin profetët.”**

Ata, pa kurrfarë të drejte, i vrisnin profetët. **“Kjo ishte për shkak se ata nuk u bindën dhe i kaluan kufijtë (në të këqija).”**

Me këtë, All'llahu i Lartësuar tregon të ardhmen e zymtë që i ndjek jehudinjtë. Ata nuk janë goditur për shkak të nacionalizimit dhe fanatizmit të tyre apo diçka të ngjashme me këtë, por për shkak të veprave që kanë bërë.

E para: Ata kanë mohuar ajetet e All'llahut, i kanë kundërshtuar e i kanë përgënjeshtuar ato.

E dyta: Ata janë të vendosur për të vrarë profetët e All'llahut Udhëzues, të cilët kanë dëshiruar që të shpëtojnë njerëzit nga injoranca dhe t'i nxjerrin nga përçmimi dhe mjerimi.

E treta: Me të vërtetë, ata kanë vepruar me të gjitha veprat e këqija dhe kanë bërë të gjitha krimet: kanë përdorur çdo lloj padrejtësie mizore dhe e kanë kaluar cakun në shkeljen e të drejtave të të tjerëve. Nuk ka dyshim se çdo popull që i bën këto vepra, goditet me këto të këqija, me të cilat janë goditur jehudinjtë. Këta e meritojnë ndëshkimin e dhimbshëm dhe të ardhmen e zymtë.

### **E ardhmja e zymtë e jehudinjve**

Historia e jehudinjve është e mbushur plot me ngjarje e ndodhi, të cilat na i treguan ajetet e mëparshme. Gjendja e tyre është një argument i mirë për këtë realitet. Sigurisht, përçmimi i ndjek jehudinjë kudo që të jenë. Nuk është një rregull legjislativ (hukem sheraij) sikurse kanë thënë disa komentues. Por, ajo është një çështje e përbërë dhe ai është rregull i prerë historik, i cili e detyron ta ndjekë përçmimi. Përulja e mjerimi godet çdo popull që ecën në padrejtësi dhe garon të largojë udhëheqësit e drejtë dhe shpëtimtarë.

Kur një popull hedh një shikim në sjelljen e tij, ndryshon programin dhe rregullin e tij, pendohet dhe kthehet tek All'llahu i Lartësuar, mbështetet tek Ai, duke e lidhur të ardhmen e tij me adhurimin e All'llahut, sikurse është gjendja e cionistëve në ditët e sotme.

Me të vërtetë cionistët, të cilët shkaktojnë genocide ndaj myslimanëve dhe e luftojnë Islamin, nuk mund t'u bëjnë ballë

rreziqeve që i kërcënojnë ata, duke u mbështetur vetëm tek të tjerët apo te mbrojtja e tyre.

Dhe nuk ka dyshim se kjo gjendje do të vazhdojë për sa u përket jehudinjeve, vetëm nëse ata i lënë këto sjellje mizore e armiqësore dhe ua kthejnë njerëzve të drejtat e tyre, duke mbështetur të tjerët dhe duke vendosur baza të shëndosha mirëkuptimi, pa armiqësi, urrejtje e pushtim.

## Ajeti 113 -115

لَيْسُوا سَوَاءً مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ أُمَّةٌ قَائِمَةٌ يَتْلُونَ آيَاتِ اللَّهِ ءَانَاءَ اللَّيْلِ  
وَهُمْ يَسْجُدُونَ ﴿١١٣﴾ يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَيَأْمُرُونَ  
بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيُسْرِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَأُولَٰئِكَ مِنَ  
الصَّالِحِينَ ﴿١١٤﴾ وَمَا يَفْعَلُوا مِنْ خَيْرٍ فَلَن يُكْفَرُوهُ ۚ وَاللَّهُ عَلِيمٌ  
بِالْمُتَّقِينَ ﴿١١٥﴾

“(Megjithatë) ata nuk janë të gjithë njëlloj. Disa nga ithtarët e Librit janë në të drejtën: në orët e natës lexojnë vargjet e Librit të All’llahut dhe falin namaz.

Ata besojnë All’llahun dhe Ditën e Kiametit, e urdhërojnë të mirën, e ndalojnë të keqen dhe nxitojnë për të bërë punë të mira. Këta janë ndër të drejtët.

Çfarëdo të mire që të bëjnë, nuk do t’iu mohohet shpërblimi. All’llahu i di mirë të devotshmit.”

## Shkaku i zbritjes

Thuhet se kur Abdullah Ibn Selami, i cili ishte dijetar i jahudinje dhe ndër njerëzit më të rëndësishëm të grupit të tyre, e pranoi Islamin, jahudinjtë u shqetësuan shumë nga kjo ngjarje, veçanërisht priftërinjtë e tyre. Ata vazhduan të vendosin pengesa dhe ta akuzonin për tradhti. Gjithashtu, priftërinjtë e tyre thoshin: “Muhammedit nuk i kanë besuar vetëm të këqijtë tanë.”

Qëllimi i tyre ishte i qartë, ta ulnin figurën e tij (Selamit) në sytë e jahudinje, që të tjerët të mos ndjekin shembullin e tij. Prandaj zbritën këto ajete, për ta mbrojtur këtë grup besimtarësh.<sup>1</sup>

## Komentimi

Pas gjithë atyre qortimeve për jahudinjtë, që përmbanin ajetet e mëparshme, për shkak të qëndrimeve dhe veprave të këqija të tyre, shohim se Kur’ani, gjithmonë, ruan drejtësinë dhe respekton çdo njeri që pastrohet nga sjelljet përçmuese si ato të jahudinje. Kur’ani lajmëron me një qartësi të plotë se ai nuk i përfshin të gjithë në këtë rregull, pasi është e pamundur të shikohen të gjithë me të njëjtin shikim, pa dalluar ndërmjet popujve që bëjnë vepra të këqija dhe atyre që kërkojnë të vërtetën.

Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: “(Megjithatë) **ata nuk janë të gjithë njëloj. Disa nga ithtarët e Librit janë në të drejtën:**

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, komentimi i këtij ajeti.

## **në orët e natës lexojnë vargjet e Librit të All'Ilahut dhe falin namaz."**<sup>1</sup>

Sigurisht që ithtarët e Librit nuk janë të barabartë, sepse ka prej tyre që i binden All'Ilahut të Lartësuar dhe e kanë frikë Atë, i besojnë Atij dhe Botës Tjetër, e kryejnë detyrën e urdhërimit në të mirë dhe ndalohen nga e keqja.

Kur'ani e kundërshton plotësisht racizmin jahudit dhe përqendrohet në përmendjen e veprave të tyre. Ai i lavdëron dhe i respekton të gjithë ata që shpëputen nga shumica e tyre devijuese dhe futen në rrugën e besimit e të vërtetës. Kjo është mënyra dhe rruga e Islamit, që nuk përçmon askënd, bazuar te ngjyra apo raca, por kundërshton atë që bazohet në besimin e gabuar dhe lufton veprat që nuk përputhen me të vërtetën, me drejtësinë, me të mirën e të dobishmen.

**All'Ilahu i Lartësuar thotë: "Ata besojnë All'Ilahun dhe Ditën e Kiametit, e urdhërojnë të mirën, e ndalojnë të keqen dhe nxitojnë për të bërë punë të mira. Këta janë ndër të drejtët."**

Nga disa hadithe shikojmë se të lavdëruarit, që përmendet në këtë ajet, nuk është vetëm për Abdullah Ibn Selamin dhe grupin e tij, që ka përqafuar Islamin, por edhe për të dyzetë (40) të krishterë nga Nexhrani, tridhjetë e dy (32) të krishterët nga Habeshi (Etiopia) dhe tetë (8) persona nga banorët e Bizantit, të cilët e kishin pranuar Islamin përpara kësaj ndodhie.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Fjala arabe *el enau* që përmendet në ajet është shumësi i fjalës *ena*, që do të thotë *el eukat*, kohë.

<sup>2</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", fundi i ajetit në fjalë. "Biharul Enuar", vëllimi 9, faqe 73.

Këtë e tregon edhe përdorimi i togfjalëshit *ithtarët e Librit*, e cila siç e dimë përfshin si jahudinjtët, ashtu edhe të tjerët.

Pastaj All'llahu i Lartësuar vazhdon e thotë: **“Çfarëdo të mire që të bëjnë, nuk do t’iu mohohet shpërblimi. All’llahu i di mirë të devotshmit.”** Kjo do të thotë se ata që e pranojnë Islamin, tregohen të devotshëm, All’llahu nuk ua humbet veprat, edhe nëse në të kaluarën kanë bërë mëkate të rënda, pasi ata i kanë parë dhe janë penduar për veprimet e tyre. E kanë rregulluar të ardhmen duke ndryshuar qëndrimin e tyre.

Kuptimi i fjalës *kefere* është e kundërta e *falënderimit*, sepse falënderimi në origjinal do të thotë pohim dhe mirënjohje ndaj mirësisë dhe begatisë. Ndërsa fjala *kufër* do të thotë *mohim*. Kuptimi i këtij ajeti është se All’llahu nuk i mohon veprat e tyre të mira dhe nuk i mohon shpërblimet.

Në fund All’llahu i Lartësuar thotë: **“All’llahu i di mirë të devotshmit.”** Kjo fjali mbyllëse e ajetit duket se tregon një të vërtetë të rëndësishme, që të devotshmit, në përgjithësi, janë të paktë e veçanërisht në shoqërinë e jahudinjve, të cilët jetuan në kohën e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Megjithatë, All’llahu i njeh mirë ata dhe ne e dimë se Atij nuk mund t’i shpëtojë asgjë. Njerëzit nuk kanë pse të shqetësohen, përderisa All’llahu i Lartësuar i di të mirët e të devotshmit dhe se asnjë vepër, sado qoftë ajo, e madhe apo e vogël, nuk humbet.

## Ajetet 116-117

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا لَنْ تُغْنِيَ عَنْهُمْ أَمْوَالُهُمْ وَلَا أَوْلَادُهُمْ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا ۖ  
وَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿١١٦﴾ مَثَلُ مَا يُنْفِقُونَ فِي هَذِهِ  
الْحَيَاةِ الدُّنْيَا كَمَثَلِ رِيحٍ فِيهَا صِرٌّ أَصَابَتْ حَرْثَ قَوْمٍ ظَلَمُوا أَنْفُسَهُمْ  
فَأَهْلَكَتَهُ ۖ وَمَا ظَلَمَهُمُ اللَّهُ وَلَٰكِنْ أَنْفُسُهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿١١٧﴾

**“Ata që nuk besojnë, nuk do t’i mbrojnë asgjë nga dënimi i All’lauhut, as pasuria e tyre e as fëmijët e tyre. Ata do të jenë banorët e zjarrit (të Xhehennemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”**

**“Gjithçka që jobesimtarët shpenzojnë në jetën e kësaj bote, i përngjan erës së akullt, e cila godet të lashtat e ndonjë populli që i ka bërë dëm vetes dhe ua zhduk të lashtat. All’lahu nuk u ka bërë padrejtësi atyre, por ata i kanë bërë padrejtësi vetvetes.”**

## Komentimi

Përballë personave që kërkojnë të vërtetën dhe i besojnë asaj, siç i cilësoi ajeti i mëparshëm, ka persona jobesimtarë, të padrejtë, të cilët All'llahu i përmend në këto dy ajete: **“Ata që nuk besojnë nuk do t'i mbrojnë asgjë nga dënimi i All'llahut, as pasuria e tyre e as fëmijët e tyre.”**, sepse në Botën Tjetër nuk do të ketë dobi asgjë, përveç veprave të mira dhe besimit të singertë. Në atë Botë nuk ka dallime materiale. All'llahu i Lartësuar thotë te surja “Esh-Shuara”, ajeti 88-89: **“...në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek All'llahu!”**

Mbetet të mësojmë se përse All'llahu i Lartësuar në këtë ajet ka cekur pasurinë dhe fëmijët në mesin e gjërave të tjera? Kjo tregon se mundësitë më të rëndësishme materiale kufizohen në dy kategori:

**E para:** Fuqia njerëzore. Në këtë ajet janë çekur fëmijët si shembulli më i mirë i kësaj fuqie.

**E dyta:** Pasuria ekonomike

Kurse mundësitë e tjera materiale burojnë prej këtyre dy kategorive.

Me të vërtetë, Kur'ani bën thirrje të qarta se veçoritë materiale dhe fuqia e shoqërisë njerëzore nuk konsiderohet prej veçorive dhe përzgjedhjeve në peshoren e All'llahut të Lartësuar. Mbështetja vetëm në to është një gabim i madh, vetëm nëse shoqërohen me besim dhe me vepra të mira dhe përdoren në dobi të këtyre dy rrugëve (besimit dhe veprave të mira).

Ata persona që mbështeten te fuqia dhe pasuria ekonomike dhe nuk besojnë dhe nuk bëjnë vepra të mira, do të hidhen në Xhehennem dhe ndëshkimi i tyre do të jetë i përhershëm. Në lidhje me këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ata do të jenë banorët e zjarrit (të Xhehennemit) ku do të qëndrojë përgjithmonë."**

Përderisa bëhet fjalë për pasurinë, patjetër duhet të flitet për çështjen e shpenzimit. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Gjithçka që jobesimtarët shpenzojnë në jetën e kësaj bote, i përngjan erës së akullit, e cila godet të lashtat e ndonjë populli që i ka bërë dëm vetes dhe ua zhduk të lashtat."**

Fjala *sirrun* (me germën *Sad*) rrjedh nga fjala *esrr-rrarr* që në gjuhësi do të thotë *tërheqje me forcë dhe ashpërsi*. Këtu është fjala për erën e fortë, qoftë e shoqëruar me të ftohtë acar apo me të nxehtin përvëlues.

## Hulumtim

### Shpenzimi i jobesimtarëve

Ky ajet tregon mënyrën e shpenzimit të jobesimtarëve i shoqëruar me mburrje e hipokrizi duke sjellë një shembull të mrekullueshëm, i cili përfytyron fundin e këtij shpenzimi. Kur'ani e shëmbëllen shpenzimin e jobesimtarëve me erën e fortë e të ftohtë, shoqëruar me akull, ose me erë përvëluese, djegëse. Nëse kjo erë i godet të mbjellat, nuk mbetet asgjë, duke i shkatërruar dhe duke e lënë tokën të shkretë.

Nuk ka dyshim se erërat e lehta dhe flladet i bëjnë të mbjellat të lulëzojnë dhe e ringjallin natyrën. Flladet e pranverës i bëjnë lulet të çelin, duke mbushur degët e pemëve dhe të bimëve me një lëvizje të re, u jep jetë, zhvillim dhe i ndihmon të pllenohen. I njëjtë është edhe shpenzimi i dobishëm që buron te singeriteti dhe besimi i çiltër. Ky lloj shpenzimi shëron plagët dhe zgjidh problemet e shoqërisë. Gjithashtu, ndikon thellë në shpirtin e shpenzuesit, duke forcuar në të virtytet humane e njerëzore dhe e rrit më shumë ndjenjën e bujarisë, të respektit, të dashurisë, gjë që çon në arritjen e lumturisë së të tjerëve.

Nëse këto erëra të buta, të freskëta, të ëmbla shndërrohen në erëra të forta, të egra e përvëluese ose të ftohta, të shoqëruara me akull, çojnë, ose në djegien, ose në ngrirjen e bimëve e të luleve.

Kështu është edhe gjendja e jobesimtarit në shpenzimin e tij, sepse nuk e shpenzon pasurinë në rrugë të drejtë, por e shpenzon me hipokrizi, me ego e për qëllime keqbërëse. Kjo është arsyeja se pse shpenzimi i tij krahasohet me erën shfarosëse,

përvëluese, ftohëse e ngrirëse, që vjen përmbi çdo gjë që ai shpenzon dhe investon, sikurse vjen përmbi të mbjellat dhe bimësinë, duke i shkatërruar.

Ky lloj shpenzimi nuk shëron apo zgjidh asnjë problem të shoqërisë, sepse nuk është shpenzuar në vendin e duhur. Gjithashtu, ky lloj shpenzimi nuk ndikon as në moralin e tij.

Në këtë ajet na tërheq vëmendjen: **“e cila godet të lashtat e ndonjë populli që i ka bërë dëm vetes dhe ua zhduk të lashtat.”**. Kjo tregon se ata që mbollën të lashtat, u goditën me atë që u goditën, sepse neglizhuan përzgjedhjen e vendit të të mbjellave dhe kohën e saj. Ata mbollën në atë tokë që rrihet nga erërat e forta ose ata zgjodhën për mbjellje kohën në të cilën fryjnë shumë erëra shkatërruese, duke mos i lënë bimët të rriten. Me këtë ata i bënë padrejtësi vetes së tyre.

Kështu është gjendja e jobesimtarit me shpenzimin e tij, sepse ai i ka bërë padrejtësi vetes së tij, duke e shpenzuar pasurinë në mënyrë të padrejtë, në kohën dhe vendin e papërshtatshëm dhe me qëllim jo të sinqertë. Me këtë vepër ai shfaq pasurinë e tij përballë erërave. Nga e gjithë ajo çfarë treguam, duke parë edhe argumentet e pranishme në këtë ajet, qartësohet se shëmbëllimi i shpenzimit të pasurisë së mosbesimtarit me të mbjellat, të cilat thahen nga erërat shkatërruese është shëmbëllim me dy veçori:

E para: Shëmbëllimi i shpenzimit të jobesimtarit me të mbjellat në vendin dhe kohën e përshtatshme.

E dyta: Shëmbëllimi i qëllimit në shpenzim, me erërat e forta, të ftohta e vdekjeprurëse. Duke u nisur nga kjo, kuptimi i fjalisë nuk mbetet i paqartë dhe se kuptimi i fjalës së All'llahut të

Lartësuar: **“...gjithçka që jobesimtarët shpenzojnë në jetën e kësaj bote.”** tregon se qëllimet e jobesimtarit në shpenzim janë si erërat e ftohta shkatërruese, që godasin të mbjellat dhe i shkatërrojnë ato.

Një grup komentuesish të Kur'anit Famëlartë kanë thënë. “Me të vërtetë, ajeti tregon për pasuritë që jobesimtarët i përdorin kundër Islamit, për të penguar përhapjen e tij dhe për të ofenduar figurën e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), apo janë pasuritë që jahudinjtë ua japin priftërinjve të tyre, me qëllim që t'i shtrembërojnë shenjat dhe argumentet e All'llahut, duke hequr dhe duke shtuar në librat qiellorë.”

Është shumë e qartë se ky ajet ka kuptim të gjerë dhe përfshin këtë mendim dhe mendime të tjera. Pastaj, All'llahu i Lartësuar e sqaron çështjen e shpenzimit të jobesimtarëve, fundi i së cilit është mjerim, duke thënë: **“All'llahu nuk u ka bërë padrejtësi atyre, por ata i kanë bërë padrejtësi vetvetes.”**

Sigurisht, vepra e keqe i sjell vepruesit veçse rezultat të keq e shkatërrues. Ajo çfarë korrin jobesimtarët nga shpenzimi i pasurisë së tyre prej moshpërblimit është se qëllimi i tyre në shpenzim ka qenë i padrejtë dhe shkatërrues.

## Ajeti 118- 120

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا بَطَانَةً مِّن دُونِكُمْ لَا يَأْلُونَكُمْ خَبَالًا وَدُّوا  
مَا عَنَيْتُمْ قَدْ بَدَتِ الْبَغْضَاءُ مِنْ أَفْوَاهِهِمْ وَمَا تُخْفِي صُدُورُهُمْ أَكْبَرُ قَدْ  
بَيَّنَّا لَكُمُ الْآيَاتِ إِن كُنتُمْ تَعْقِلُونَ ﴿١١٨﴾ هَتَأْتُمْ أَوَّلَاءِ حُبُّهُمْ وَلَا تُحِبُّونَهُمْ  
وَتُؤْمِنُونَ بِالْكِتَابِ كُلِّهِ وَإِذَا لِقَاكُمْ قَالُوا ءَامَنَّا وَإِذَا خَلَوْا عَضُوا عَلَيْكُمْ  
الْأَنَامِلَ مِنَ الْغَيْظِ قُلْ مُوتُوا بِغَيْظِكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿١١٩﴾  
إِنْ تَمَسَّسَكُمْ حَسَنَةٌ تَسُؤْهُمْ وَإِنْ تُصِيبْكُمْ سَيِّئَةٌ يَفْرَحُوا بِهَا وَإِنْ تَصْبِرُوا  
وَتَتَّقُوا لَا يَضُرُّكُمْ كَيْدُهُمْ شَيْئًا إِنَّ اللَّهَ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطٌ ﴿١٢٠﴾

"O ju që keni besuar! Mos zgjidhni për miq dhe këshilltarë të afërt njerëz të tjerë jashtë gjirit tuaj; ata nuk ngurrojnë që t'ju bëjnë dëm. Ata dëshirojnë që të vuani. Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre, është edhe më e madhe. Ne jua kemi shpjeguar vargjet (e Kur'anit), nëse jeni njerëz që kuptoni."

"Ja, ju i doni ata, por ata nuk ju duan juve dhe ju u besoni të gjitha librave (ndërsa ata jo). Kur ata ju takojnë, thonë: "Edhe ne besojmë" e, kur mbeten vetëm, nga mllefi ndaj jush, ata i kafshojnë majat e gishtave me dhëmbë. Thuaju: "Plasni me mllefin tuaj". Vërtet, All'lahu e di mirë ç'ka në gjokset e tyre."

"Nëse ju vjen ndonjë e mirë, ata i brengos e, nëse ju gjen ndonjë e keqe, ata gëzohen, por nëse ju duroni dhe ruheni nga gjynahet,

**dinakëritë e tyre nuk mund t'ju dëmtojnë aspak. Vërtet All'Ilahu ka dijeni për çdo gjë që punojnë ata."**

### **Shkaku i zbritjes**

Transmetohet nga Ibn Abasi se këto ajete kanë zbritur kur disa myslimanë, për shkak të miqësisë, shoqërisë, apo fqinjësisë, apo betimit apo gjidhënies, mes tyre dhe jahudinjeve, filluan të përmendin sekretet e myslimanëve. Me anë të kësaj, disa jahudinjtë, të cilët shfaqnin miqësinë dhe fshihnin armiqësinë dhe urrejtjen dhe ishin armiq të më të ashpër e të përbetuar ndaj myslimanëve, mësonin sekretet e myslimanëve. Atëherë zbritën këto ajete, për t'u hequr vërejtje atyre myslimanëve që të mos mashtrohen nga afrimiteti dhe miqësia që shfaqin jahudinjtët. Ajetet u këshillojnë atyre që të mos i zënë miq jahudinjtët, duke u treguar çdo gjë atyre, sidomos sekretet, të cilat duhen të mbahen të fshehta dhe të mos nxirren në shesh, pasi ato sekrete mund t'i përdorin më pas për t'i bërë keq dhe për t'i dëmtuar myslimanët. Jahudinjtët gjithmonë duan që ju të jeni në konflikte, probleme dhe fatkeqësi.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri "Xhamiul Bejjan", vëllimi 4, faqe 82.

## Komentimi

### Mos i bëni armiq të miq

Ajeti i parë i ajeteve në fjalë ka parashtruar çështjen e marrëdhënieve mes myslimanëve dhe jomyslimanëve. Ai flet për një çështje delikate dhe shumë të rëndësishme, që është paralajmërimi i myslimanëve që të mos krijojnë lidhje miqësore me personat që përçmojnë dhe mohojnë fenë islame. Dhe, të mos u tregojnë asnjë sekret prej sekreteve e as të zbulojnë qëllimet para tyre. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"O ju që keni besuar! Mos zgjidhni për miq dhe këshilltarë të afërt njerëz të tjerë jashtë gjirit tuaj."**

Kjo do të thotë se jobesimtarët nuk mund të jenë miq me myslimanët dhe as mbartës të sekreteve të tyre, pasi ata në çdo moment përpiqen të bëjnë keq. Prandaj All'llahu, duke parë në shpirtin e tyre, ka thënë: **"Ato nuk ngurojnë që t'ju bëjnë dëm."**

Miqësia e jobesimtarë nuk mund t'i ndalojë ata nga të mosbërit keq myslimanëve. Ata u dëshirojnë atyre (myslimanëve) fatkeqësi e vuajtje. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ata dëshirojnë që të vuani."** Ata ndiejnë kënaqësi në zemër nëse juve ju godet e keqja.

Me fshehjen e qëllimit të tyre, gjithmonë përpiqen të mbikëqyrin veprimet dhe veprat tuaja. Këtë e bëjnë që të mos

shfaqin atë që fshehin brenda tyre. Ka raste që gjurmët e kësaj armiqësie dhe urrejtjeje të shfaqen në bisedat dhe fjalët e tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre...”**

Në një nga thëniet e Imam Aliut, prijësit të besimtarëve, thuhet: *“Askush nuk mund të fshehë diçka në vetveten e vet, sepse ajo zbulohet nga mospërmbajtja e gjuhës dhe nga pamja e fytyrës së tij.”*<sup>1</sup>

Është e patjetërsueshme që të derdhet diçka jashtë kur mbushet brenda, siç ndodh me enën me ujë. All'llahu i Lartësuar ka qartësuar në këtë ajet një nga rrugët e njohjes së të fshehtave të armiqve dhe atë çfarë fshehin zemrat e tyre. Për këtë gjë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“...kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre, është edhe më e madhe.”**, që do të thotë se, ajo që del prej gojës së tyre, (prej fjalëve) është një shkëndijë e zjarrit djegës që fshihet në zemrat e tyre.

Pastaj All'llahu i Lartësuar shton e thotë: **“Ne jua kemi shpjeguar vargjet (e Kur'anit), nëse jeni njerëz që kuptoni”**, që do të thotë se ajo çfarë ne treguam prej mjeteve të njohjes së armikut është një çështje me rëndësi të madhe, nëse ju po e mendoni atë. Kjo gjë ju bën juve të qëndroni përpara një fakti shumë të madh, që të njihni atë që të tjerët fshehin ndaj jush. Kjo është një çështje shumë e rrezikshme, përse i përket sigurisë së jetës tuaj.

## Urrejtja përballë dashurisë

Disa myslimanë mendojnë se, duke i dashur armiqtë, mund të fitojnë dashurinë e tyre. Ky është përfytyrim i rremë dhe gabim

<sup>1</sup> “Nehxhul Belaga”, fjala 26.

fatal, sepse All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ja, ju i doni ata, por ata nuk ju duan juve dhe ju i besoni të gjitha librave (ndërsa ata jo)."**

Me të vërtetë, All'llahu i Lartësuar i drejtohet këtij grupi myslimanësh dhe i thotë se ju i doni ata që nuk janë në fenë tuaj për shkak të miqësisë, afrimitetit, fqinjësisë. Por, gjendja është krejt ndryshe, sepse ata nuk ju duan juve kurrë. Ju i besoni librave të tyre dhe librit tuaj, Kur'anit, pa asnjë dallim. Ndërkohë që ata nuk besojnë në librin tuaj dhe nuk besojnë se ai ka zbritur nga qielli.

Me të vërtetë, ky grup prej ithtarëve të Librit është hipokrit dhe mashtrues. Për këta, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Kur ata ju takojnë, thonë: "Edhe ne besojmë" e, kur mbeten vetëm, nga mllefi ndaj jush, ata i kafshojnë majat e gishtave me dhëmbë.**

Nuk ka dyshim se kjo urrejtje nuk i shkakton dëm myslimanëve, prandaj All'llahu i Lartësuar i thotë të Dërguarit të tij: **"Thuaju: "Plasni me mllefin tuaj."**

Kjo është e vërteta e jobesimtarëve ndaj së cilës ju jeni të pavëmendshëm. Por All'llahu i Lartësuar nuk është i pavëmendshëm ndaj së vërtetës së tyre, sepse: **"Vërtet, All'llahu e di mirë ç'ka në gjokset e tyre."**

Pastaj All'llahu i Lartësuar tregon një shenjë tjetër nga shenjat e fshehura në zemrat e mohuesve: **"Nëse ju vjen ndonjë e mirë, ata i brengos e, nëse ju gjen ndonjë e keqe, ata gëzohen..."**

Por a u bën dëm kjo armiqësi dhe çfarë ata mundohen t'u bëjnë myslimanëve? Përgjigjen e kësaj pyetjeje All'llahu e jep në fundin e ajetit: **"...por nëse ju duroni dhe ruheni nga gjynahet, dinakëritë e tyre nuk mund t'ju dëmtojnë aspak. Vërtet All'llahu ka dijeni për çdo gjë që punojnë ata."**

Nga ky ajet kuptohet se siguria dhe ruajtja e identitetit të myslimanëve nga intrigat e armiqve qëndron në devotshmërinë e tyre, në forcën e madhe të besimit.

## Hulumtim

### Paralajmërim për myslimanët

Me anë të këtij ajeti, All'llahu i Lartësuar i paralajmëron myslimanët që të mos i marrin armiq të për miq dhe mos ua shfaqin sekretet atyre. Ky është një paralajmërim i përgjithshëm dhe nuk është i posaçëm për një kohë, vend apo grup prej myslimanëve.

Duhet që myslimanët të kenë kujdes nga ky veprim në të gjitha kohët dhe vendet, që të ruajnë sigurinë dhe identitetin e tyre.

Fatkeqësisht, shohim shumë pasues të Kur'anit, të cilët janë të pavëmendshëm ndaj këtij paralajmërimi të rëndësishëm të All'llahut. Si pasojë ata u përballën me fatkeqësitë, miqësinë me jobesimtarët dhe me ndikimet negative të këtij veprimi. Armiq të kanë rrethuar myslimanët nga të gjitha anët. U shfaqin atyre dashurinë dhe miqësinë dhe në disa raste janë pro çështjeve të tyre, por gënjeshtrenë e tyre e shfaqin në disa qëndrime. Edhe pse janë të tillë, myslimanët mashtrohen dhe bien pre e asaj që shohin prej armiqve, duke u besuar atyre shumë gjëra, njësoj siç u besojnë vëllezërve të tyre myslimanë. Ndërkohë që armiq të nuk i duan ummetit islam veçse fatkeqësi, mjerim shkatërrim e zhdukje. Nuk i kursejnë përpjekjet që myslimanët të përballen gjithmonë me probleme në jetën e tyre.

Nuk shkojmë më larg. Vitet e fundit kanë dëshmuar dy luftëra mes myslimanëve dhe armiqve të tyre cionistë. Në luftën e parë (lufta e qershorit) myslimanët u përballën me një thyerje të tmerrshme dhe dëbim. Kurse në luftën e dytë (lufta e Ramazanit) arritën të triumfojnë mbi armiqtë e tyre dhe si pasojë ndryshoi harta politike e tyre. Ata arritën ta varrosin legjendën e ushtrisë izraelite në shkretëtirën e Sinasë dhe në lartësinë e Golanit që në ditët e para të luftës. Kështu myslimanët shijuan triumfin e parë në vitet e fundit.

Çfarë ndodhi në këtë periudhë të shkurtër, që solli këtë ndryshim të madh?

Përgjigjja ka nevojë për një hulumtim të gjatë. Është më se e sigurt se një ndër shkaqet që ka ndikuar në humbjen e parë dhe në fitoren e armiqve ka qenë se ata që shfaqnin miqësi e dashuri ndaj myslimanëve, e dinin çështjen e luftës me të gjitha detajet e saj. Por në betejën e dytë sekretet e luftës i dinin vetëm dy apo tre prej drejtuesve të vendeve islame. Ky ishte një ndër faktorët e fitores dhe dëshmi e gjallë për madhështinë e këtij legjislacioni qiellor, të Kur'anit Famëlartë e Fisnik.

## Ajeti 121 - 122

وَإِذْ غَدَوْتَ مِنْ أَهْلِكَ تُبَوِّئُ الْمُؤْمِنِينَ مَقْعِدَ لِلْقِتَالِ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ  
إِذْ هَمَّتْ طَّائِفَتَانِ مِنْكُمْ أَنْ تَفْشَلَا وَاللَّهُ وَلِيُهُمَا وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ  
الْمُؤْمِنُونَ

**“Atë mëngjes, kur ti (o Muhammed) dole nga shtëpia jote për t’u caktuar besimtarëve vendet e luftës<sup>1</sup> - e All’Ilahu dëgjon dhe di çdo gjë.”**

**“dy grupe nga ju menduan të ktheheshin prej frikës, ndonëse All’Ilahu ishte ndihmues i tyre. Andaj besimtarët le të mbështeten vetëm te All’Ilahu!”**

---

<sup>1</sup> Bëhet fjalë për Betejën e Uhudit.

## Komentimi

Nga këtu fillojnë ajetet që kanë zbritur për një prej ndodhive të rëndësishme islame, e cila është Beteja e Uhudit. Argumentet që gjenden në këto dy ajete tregojnë se kanë zbritur për Betejën e Uhudit. Ato tregojnë edhe për disa ndodhi të frikshme, siç thonë shumica e komentuesve të Kur'anit.

Ajeti i parë tregon fillimin e daljes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga Medineja për të zgjedhur vendin për ushtrinë tij në Uhud. Ajeti thotë: **"Atë mëngjes, kur ti (o Muhammed) dole nga shtëpia jote për t'u caktuar besimtarëve vendet e luftës - e All'llahu dëgjon dhe di çdo gjë."**

Në mesin e myslimanëve ka pasur mendime të ndryshme për vendin që duhet të zërë ushtria, si dhe për mënyrën e përbaljes me armiqtë: të rrinin në Medine apo të dilnin jashtë saj dhe të luftonin me armiqtë.

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pas konsultimit me mendimin e shumicës, e cila përbëhej më shumë prej të rinjve energjikë, vendosi të dilnin nga Medina dhe të luftonin armikun jashtë saj, pas vendosjes te mali i Uhudit.

Është mëse e natyrshme që në mesin e myslimanëve të gjendeshin persona që fshinin disa gjëra, edhe pse për arsye personale. Prandaj, ka mundësi që thënia: **"All'llahu dëgjon dhe di çdo gjë."** ka për qëllim këto të fshehta, sepse All'llahu i Lartësuar dëgjon atë që ju thoni dhe di atë që ju fshihni në veten tuaj.

Ajeti i dytë në fjalë tregon për një këndvështrim tjetër të kësaj ngjarjeje: **“dy grupe nga ju menduan të ktheheshin prej frikës, ndonëse All’llahu ishte ndihmues i tyre. Andaj besimtarët le të mbështeten vetëm te All’llahu!”**

Sikurse e tregojnë historianët, këto dy grupe janë Benu Seleme nga Ousi dhe Benu Haritheh nga Hazrexhi. Këto dy grupe këmbëngulën që ta lehtësonin çështjen e kësaj beteje dhe të ktheheshin në Medine dhe ashtu vepruan.

Shkaku i këtij qëndrimi poshtërues të tyre ishte se në vend që të dilnin e të luftonin armikun jashtë Medines, ata ishin të mendimit për të qëndruar në Medine dhe t’i luftonin armiqtë brenda, por Profeti e ka refuzuar këtë mendim, që t’i luftonte armiqtë brenda në Medine. Abdullah Ibn Ebi Seluli, i cili iu bashkua myslimanëve së bashku me treqind jahudinj, u kthyen në Medine, sepse Profeti e kundërshtoi qëndrimin e tyre në ushtrinë myslimane. Kjo bëri që dy grupet e lartpërmendura të kthehen e të mos dalin në luftë me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ata vendosën të kthehen në Medine, ndërkohë që ishin në mes të udhës.

Mirëpo, në fund të këtyre dy ajeteve kuptohet që këto dy grupe e ndryshuan vendimin dhe vazhduan bashkëpunimin me myslimanët. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: **“...All’llahu ishte ndihmues i tyre. Andaj besimtarët le të mbështeten vetëm te All’llahu!”**, që do të thotë se All’llahu i ndihmoi ato dy grupe. Dhe se ata nuk mund të humbasin e as nuk mund të dështojnë, nëse i mbështeten All’llahut dhe se All’llahu i ndihmon besimtarët.

Duhet të theksojmë një pikë të rëndësishme: Përmendjen e këtyre pjesëve prej Betejës së Uhudit, pas ajeteve që flasin për

mosbesim ndaj jobesimtarëve. Kjo tregon se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), siç e thamë dhe siç do të sqarohet, nuk i lejoi jahudinjtët, të cilët shfaqën përkrahjen e myslimanëve, të qëndrojnë në kampin ushtarak të myslimanëve, sepse ata ishin të huaj dhe nuk duhet të qëndronin në mesin e tyre për të mësuar sekretet e tyre në ato momente të rrezikshme. Po ashtu, nuk mund të ishin pikë mbështetjeje për myslimanët në atë situatë delikate.

## Hulumtim

### Shkaku i Betejës së Uhudit

Përpara së gjithave, duhet të tregojmë disa ngjarje që kanë ndodhur në këtë betejë. Nga transmetimet dhe tregimet e historisë islame ka ardhur që, kurejshët, pasi u kthyen në Mekë prej Luftës së Bedrit, patën shumë të vrarë dhe robër të zënë. Prej tyre u vranë shtatëdhjetë persona dhe u zunë rob shtatëdhjetë të tjerë. Nisur nga kjo gjendje e pasluftës, Ebu Sufjani u tha: “O kurejsh mos i lini gratë tuaja të qajnë e të vajtojnë për të vrarët tuaj, sepse, nëse lotët rrjedhin, e largojnë pikëllimin dhe armiqësinë ndaj Muhammedit.” Ebu Sufjani bëri një betim, se nuk do të binte në shtrat me gruan e tij derisa të hakmerrej për të vrarët e Bedrit. Për këtë, kurejshët nxitën njerëzit kundër myslimanëve, duke thirrur në çdo skaj të Mekës: “Hakmarrje, hakmarrje!”

Në vitin e tretë të emigrimit (hixhretit) kurejshët vendosën të luftonin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ata dolën nga Meka me tremijë kalorës dhe dymijë këmbësorë të pajisur me çdo gjë që ka nevojë lufta vendimtare. Me vete morën gratë, fëmijët dhe idhujt për të qenë sa më të fortë në fushën e betejës.

### Abasi i dërgon mesazh Profetit

Abasi, xhaxhai i Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), deri në atë kohë nuk e kishte pranuar Islamin. Por ai e donte shumë djalën e vëllait të tij.

Kur mësoi se kurejshët kishin vendosur të mësynin Medinen, i dërgoi një mesazh urgjent Profetit, me anë të një personi nga fisi Gafirij, duke i treguar qëndrimin e mekasve dhe vendosmërinë e kurejshëve. Kur profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e mësoi lajmin, takoi Sad Ibn Ebij dhe i tregoi çfarë i kishte shkruar xhaxhi i tij. Profeti i kërkoi Sa'dit ta mbante të fshehtë lajmin për pak kohë.

### **Profeti konsultohet me myslimanët**

Pasi e mori mesazhin nga xhaxhai i tij, Profeti dërgoi dy burra prej myslimanëve në rrugët e Mekës dhe të Medines për të mbledhur informacione për lëvizjet e kurejshëve. Nuk kalon shumë kohë dhe të dy personat kthehen dhe e lajmërojnë Profetin për ato që mësuuan rreth ushtrisë kurejshe, që këtë ushtri e udhëhiqte Ebu Sufjani.

Pas disa ditëve, Profeti ftoi të gjithë shokët dhe banorët e Medines për ta studiuar çështjen dhe për të gjetur rrugët më të mira të mundshme për mbrojtje. Ai hulumtoi me ta se a duhej ta luftonin armikun mësymës brenda në Medine apo të dilnin nga qyteti dhe të luftonin jashtë saj. Një grup, propozoi: "Mos të dalim nga Medineja, por t'i luftojmë në rrugicat e saj. Të luftojnë edhe burri i dobët edhe gruaja, edhe robi edhe robëresha, në kryet e rrugëve e në çatitë e shtëpive..." Këtë e tha Abdullah Ibn Ubeji.

Profeti ka anuar nga ky mendim, duke parë pozicionin e Medines në atë kohë. Ai dëshironte të qëndronte në Medine dhe të luftonte armikun brenda saj. Por një grup të rinjsh, të cilët e dëshironin përballjen me armikun dhe martirizimin (shehadetin)

thanë: “Na nxirr te armiku ynë. Sad ibn Muadhi dhe të tjerë prej fisit Ous thanë: “O i Dërguar i All’llahut, asnjë nga arabët nuk na ka lakmuar kur ishim idhujtarë, adhuronim statujat dhe idhujt. Si do të na lakmojnë tani që ti je në mesin tonë? Të dalim e t’i luftojmë. Kush vritet prej nesh, bie dëshmor dhe kush shpëton, ka luftuar në rrugë të All’llahut.”

Shumica e të mbledhurve, kur dëgjuan fjalët e Sadit, iu bashkuan këtij mendimi. Ndërsa një pakicë, dëshironte të qëndronte e të luftonte brenda mureve të Medines. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe pse anonte nga luftimi brenda në Medine, si respekt i konsultimit me ta, miratoi mendimin e shumicës. Me një nga shokët e tij doli të shikonte se ku duhet ta vendoste ushtrinë e tij. Ata zgjodhën një anë të malit të Uhudit, si vendi më i përshtatshëm nga ana ushtarake dhe mbrojtëse.

### **Myslimanët përgatiten për t’u mbrojtur**

Profeti u konsultua ditën e xhuma me shokët e tij për këtë çështje. Pas konsultimit mbajti predikimin e ditës së xhuma, falënderoi All’llahun e Lartësuar e tha: “Vëreni në atë çfarë ju urdhërova dhe ndiqeni atë. Ecni me emrin e All’llahut se do të triumfoni për çfarë duruat.”

Pastaj ai i udhëhoqi vetë luftëtarët dhe urdhëroi që të merrnin tre flamuj. Një ua dha muhaxhirëve dhe dy ensarëve. Rrugën nga Medineja në Uhud e përshkoi në këmbë, duke kontrolluar ushtrinë dhe duke renditur rreshtat e saj.

Historiani i shquar Halebij, në librin e tij "Es Sijretul Halebijeh" thotë: "Ai ka ecur deri sa ka arritur në Re'suth Thenijeti. Aty gjeti një batalion të madh dhe pyeti: "Kush janë këta?" I thanë se janë aleatët e jahudnjit Abdullah Ibn Ebij. U tha: "A e kanë pranuar Islamin?"

Përgjigjja ishte: "Jo, o i Dërguari i All'llahut!"

Profeti ua ktheu: "Ne nuk fitojmë ndaj mosbesimtarëve me ata që i bëjnë idhujtari e shok All'llahut." Jahudnji Abdullah Ibn Ebij, së bashku me hipokritët, që ishin treqind burra u kthyen."<sup>1</sup>

Komentuesit shkruajnë se "Abdullah Ibn Ebij" u kthye gjatë rrugës me grupin e tij, të përbërë prej 300 personash, sepse nuk u mor për bazë mendimi i tij kur u konsultuan. Por sido që të jetë çështja, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) pasi i pastroi rreshtat e ushtrisë prej disa hipokritëve dhe dyshuarve u vendos në një anë të malit Uhud, duke e lënë malin Uhud pas shpine dhe përballë kishte Medinen.

Pasi i priu myslimanët për të falur namazin e sabahut, i vendosi ata në rreshta dhe i mobilizoi për luftë. Abdullah Ibn Xhubejrin e caktoi udhëheqës të shigjetarëve, të cilët ishin pesëdhjetë burra. I urdhëroi të qëndronin në mal pas myslimanëve dhe i këshilloi: "Nëse na shihni se po triumfojmë ndaj tyre dhe po i dërgojmë në Mekë, mos u largoni nga ky vend. Edhe nëse vëreni se ata po na mundin dhe po na çojnë në Medine, mos u largoni nga ky vend! Ruani pozicionin tuaj!"

---

<sup>1</sup> "Sijretul Halebijeh", vëllimi 2, faqe 233.

Nga ana tjetër, Ebu Sufjani vendosi Halid Ibn Velidi, me dyqind kalorës, që të sulmonin pas shpine myslimanët, duke shfrytëzuar hyrjen nga kjo grykë mali. Ebu Sufjanni u tha: “Nëse na shikoni që u bashkuam me myslimanët në dyluftim, dilni nga kjo grykë dhe bjeruni pas shpine.”

### Fillimi i betejës

Të dyja ushtritë u rreshtuan për luftë. Komandantët u jepnin guxim ushtrive dhe i nxisnin të qëndronin deri në minutën e fundit.

Ebu Sufjani i nxiste burrat e tij në emër të idhujve që ata adhuronin dhe i mashtronte se do t’u jepte femra të bukura. Ndërsa Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i nxiste myslimanët që të qëndronin, duke u kujtuar ndihmën e All’llahut dhe triumfin hyjnor. Thirrjet e myslimanëve ishin: “All’llahu Ekber, All’llahu Ekber! - Zoti është më i madhi!”

Grykat e Uhudit dhe luginat e saj ushtonin nga thirrjet e myslimanëve.

Ndërkohë Hindi nxiste gratë dhe vajzat kurejshe, që e shoqëronin, t’u binin dajreve dhe të lexonin poezi inkurajuese.

Lufta filloi. Myslimanët i sulmuan idhujtarët dhe i mposhtën me një fuqi të paparë. Idhujtarët u detyruan të zmbrapsen. Myslimanët i ndoqën që t’i shpartallonin. Kur Halid Ibn Velibi mësoi që idhujtarët humbën, dëshiroi t’i sulmonte prapa shpine myslimanët, duke kaluar nga gryka e malit. Por harkëtarët e vendosur në mal, shpartalluan ushtrinë e Halid Ibn Velibit.

Kjo mposhtje e idhujtarëve i shtyu disa myslimanë të rinj në besim, të mendojnë të mbledhin plaçkat e luftës e ta linin vendin e luftimit. Këta harkëtarë u larguan nga vendet e tyre në mal, duke i harruar udhëzimet e udhëheqësit të tyre. Abdullah Ibn Xhubejri u tha: "A e harruat çfarë ju këshilloi Profeti?"

Me Abdullah Ibn Xhubejrin, për të ruajtur atë grykë të rrezikshme mali, mbetën vetëm një pakicë. Numrin e pakët të harkëtarëve e vuri re Halid Ibn Velidi. Ai u kthye së bashku me dyqind kalorësit dhe e sulmoi Abdullah Ibn Xhubejrin dhe ata që ishin me të, duke i vrarë të gjithë dhe i sulmoi myslimanët pas shpine.

Papritur, myslimanët e gjetën veten të rrethuar nga shpatat e armiqve. Ata i kaploi frika dhe u prish sistemimi i tyre. Idhujtarët vranë shumë prej myslimanëve. Në këtë vend ra dëshmor Hamzai, prijësi i dëshmorëve dhe një grup prej shokëve trimë të Profetit. Disa prej tyre u larguan nga frika. Me Profetin mbeti vetëm një grup i vogël, që e mbronin nga mësymjet e armikut. Pjesë e këtij grupi ishte edhe Imam Aliu, i biri i Ebu Talibit, i cili e mbronte me trimëri e guxim Profetin derisa iu thyje shpata e tij. Profeti i dha shpatën e vet, të quajtur Dhulfikar. Sipas historianëve, edhe pse kishte mbi gjashtëdhjetë plagë në trup, ai përsëri vazhdonte ta mbronte Profetin. Në këtë moment Xhebraili ka thënë: "Me të vërtetë, ky është një ngushëllim o Muhammed!" Profeti i tha: "Ai është prej meje dhe unë jam prej atij.<sup>1</sup> Xhebraili tha: "Edhe unë jam prej jush (nga ju të dy)."

---

<sup>1</sup> "Biharul Envar", vëllimi 38, faqe 188.

Imam Sadiku thotë: “Profeti shikonte tek Xhebraili ndërmjet qiellit dhe tokës dhe thoshte: “Nuk ka shpatë përveç Dhulfikarit dhe nuk ka djalë të ri përveç Aliut!”<sup>1</sup>

Dhe në këtë moment, një zë thirri: “Muhammedi u vra (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)!”

**Kush thirri se Muhammedi** (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) **u vra?!**

Disa historianë mendojnë se Ibn Kumele, i cili vrau ushtarin islam, heroin Mus’ab Ibn Umejr, duke e menduar se ishte Profeti, thirri : “Pasha latën dhe uzanë! (dy idhuj që idhujtarët i adhuronin) Muhammedi sapo është vrarë!”

Pavarësisht se kush ka thirrur, mysliman apo jomysliman, thirrja ka qenë në dobi të myslimanëve, sepse i ka bërë armiq të lënë fushën e betejës dhe të drejtohen për në Mekë, me mendimin se Profeti është vrarë dhe çështja u mbyll. Sikur të mos ishte kështu, ushtria e kurejshëve do të kishte korrur një fitore të madhe, duke vrarë dhe myslimanin e fundit në fushë të betejës, për armiqësinë që kanë ndaj Profetit. Ata kishin ardhur deri në Uhud vetëm për të vrarë Profetin.

Ushtria e përbërë prej pesë mijë vetëve, pas triumfit, nuk qëndroi asnjë moment në fushën e betejës. Ata u larguan po atë natë në drejtim të Mekës, para se të lindte dielli.

Lajmi i rremë për vrasjen e Profetit i tronditi disa myslimanë dhe u larguan nga fusha e betejës.

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan” vëllimi 1, faqe 497.

Kush mbeti në fushën e betejës, krahas ruajtjes së qetësisë dhe të heqjes së frikës, e morën Profetin dhe e dërguan në anën tjetër të Uhudit, që ta shihnin myslimanët dhe të binden që ai është i gjallë.

Kur myslimanët mësuuan se i Dërguari i All'llahut është gjallë, u kthyen dhe u mblodhën rreth tij. I Dërguari i All'llahut i kritikoi ata për largimin e tyre nga lufta në atë moment të vështirë. Ata i thanë: "O i Dërguar! Neve na thanë se ti u vrave dhe zemrat tona i kaploi frika dhe ikëm."

Në betejën e Uhudit myslimanët i goditi një humbje e madhe në njerëz dhe pasuri. Në këtë betejë janë vrarë shtatëdhjetë myslimanëve dhe një numër i madh janë plagosur.

Mirëpo, nga kjo humbje e madhe myslimanët nxorën mësim të shumta, se si duhet të luftohet në të ardhmen.

Mësimet e fituara nga kjo luftë do t'i paraqesim në shpjegimin dhe studimet e ajeteve në vazhdim.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> El Kamil fij Tarih, "Ibn Ethijr", vëllimi 1, faqe 547.

## Ajeti 123- 127

وَلَقَدْ نَصَرَكُمُ اللَّهُ بِبَدْرٍ وَأَنْتُمْ أَذِلَّةٌ ۖ فَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿١٢٣﴾ إِذْ تَقُولُ  
لِلْمُؤْمِنِينَ أَلَنْ يَكْفِيَكُمْ أَنْ يُمَدِّدَ رَبُّكُمْ بِثَلَاثَةِ أَلْفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ مُزِيلِينَ  
﴿١٢٤﴾ بَلَىٰ ۚ إِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا وَيَأْتُوكُم مِّن فَوْرِهِمْ هَذَا يُمَدِّدْكُمْ رَبُّكُمْ  
بِخَمْسَةِ أَلْفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ مُسَوِّمِينَ ﴿١٢٥﴾ وَمَا جَعَلَهُ اللَّهُ إِلَّا بُشْرَىٰ لَكُمْ  
وَلِتَطْمَئِنَّ قُلُوبُكُم بِهِ ۗ وَمَا النَّصْرُ إِلَّا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ ﴿١٢٦﴾  
لِيَقْطَعَ طَرَفًا مِّنَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَوْ يَكْبِتَهُمْ فَيَنْقَلِبُوا خَائِبِينَ ﴿١٢٧﴾

“All’Ilahu ju ndihmoi në Bedër, kur qetë të pafuqishëm, prandaj jini të devotshëm ndaj All’Ilahut, për të qenë falënderues.”

Atëherë ti (Muhammed) u thoshe besimtarëve: “A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë engjëj të dërguar?”

Po! Por, nëse ata ju sulmojnë, bëhuni të durueshëm dhe të dëgjueshëm dhe Zoti juaj menjëherë do t’ju dërgojë në ndihmë pesë mijë engjëj, me shenjë të dalluar.

All’Ilahu e bëri këtë që t’ju sjellë lajmin e gëzuar dhe që t’jua qetësojë zemrat. Vërtet, fitorja është vetëm nga All’Ilahu, i Plotfuqishmi dhe i Urti.

(Gjithashtu All’Ilahu e bëri këtë edhe) që të shkatërrojë një pjesë prej atyre që nuk besuan apo t’i turpërojë, e kështu të kthehen të humbur.”

## Komentimi

### Periudha e rrezikshme e luftës

Pas përfundimit të Luftës së Uhudit, idhujtarët u kthyen me shpejtësi triumfues në Mekke. Gjatë rrugës menduan dhe diskutuan që të ta plotësojnë këtë triumf dhe ta bëjnë dërmues. Menduan të kthehen në Medine, ta grabisin, t'u bëjnë keq myslimanëve dhe të vrasin profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nëse do të ishte gjallë. Ata mendonin se me këtë veprim do t'i asgjësonin një herë e mirë myslimanët dhe Islamin. Vetëm me këtë veprim shpirtrat dhe mendjet e tyre do të qetësoheshin. Kështu, u vendos që të kthehen në Medine.

S'ka dyshim se kjo ka qenë periudha më e vështirë e Luftës së Uhudit, duke pasur parasysh çfarë u ndodhi myslimanëve, numrin e madh të të vrarëve dhe të plagosurve, humbjet materiale, dobësimin shpirtëror, etj. Të gjitha këto bënë që myslimanët të dobësohen dhe u bënë të paaftë për të hyrë në betejë të re.

Krejt ndryshe ishte situata në kampin armik. Ata ishin në kulmin e fuqisë shpirtërore dhe ushtarake, e cila i mundësonte armikut fitore të reja.

Lajmi i kthimit të tyre i arriti Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Sikur të mos ishte zemërgjerësia, fisnikëria dhe fuqitë e tij, të fituara nga shpallja hyjnore, historia islame dhe jeta e tij do të përfundonin në atë moment.

Në këtë periudhë delikate dhe kritike zbritën këto ajete, për të forcuar zemrat e myslimanëve dhe për t'u ngritur atyre moralin.

Pas kësaj, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i urdhëroi myslimanët që të përgatiten e të mobilizohen për t'u bërë ballë idhujtarëve. Të gjithë myslimanët deri edhe të plagosurit, midis tyre edhe Imam Aliu, me gjashtëdhjetë plagët e tij, u përgatitën për luftë. Të gjithë së bashku dolën nga Medina për në fushën e betejës.

Ky lajm i arriti parisë mekase (kurejshëve). Morali i lartë që kishin myslimanët i frikësoi ata. Menduan se radhët e myslimanëve janë shtuar me ushtarë të rinj dhe kjo mund të ndryshojë rezultatit e luftës në favor të myslimanëve, nëse përballen me ta. Për këtë, ata ndërruan mendje për të sulmuar Medinen, nga frika e humbjes së fuqive të tyre. Kështu u kthyen në Mekë. Këtu u mbyll gjithçka.

Këtu po paraqesim shpjegimin e ajeteve, që zbritën për të forcuar anën shpirtërore të myslimanëve, duke kompensuar ato që humbën në këtë betejë.

Këto ajete fillojnë duke u kujtuar myslimanëve fitoren e madhe që arritën me ndihmën e All'llahut në Luftën e Bedrit:<sup>1</sup> **“All'llahu ju ndihmoi në Bedër, kur qetë të pafuqishëm...”** Qëllimi i këtij përkujtimi ka qenë forcimi i myslimanëve, të mbillte në zemrat e tyre vendosmërinë dhe sigurinë, të qetësonte ndjenjat dhe t'u jepte siguri dhe shpresë për të ardhmen.

---

<sup>1</sup> Quhet *Bedër*, sepse uji ishte i një burri prej Xhuhejnit që quhej Bedër (Mexhmaul Bahrejni). Në gjuhësi, fjala *bedër* ka kuptimin e mbushjes dhe të plotësimit. Për këtë edhe hëna, kur plotësohet, quhet *bedër*.

All'llahu i ndihmoi kur ishin shumë të dobët dhe ishin të pakët në numër. (Numri i tyre ishte jo më shumë se treqind e trembëdhjetë vetë dhe mundësitë i kishin të pakta. Kurse numri i idhujtarëve ishte më shumë se një mijë luftëtarë dhe mundësitë i kishin të shumta).<sup>1</sup>

E nëse çështja është kështu, atëherë jini të devotshëm ndaj All'llahut të Lartësuar dhe mos thyeni urdhrat e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Duke zbatuar këto, kanë kryer falënderimin ndaj dhënieve të All'llahut. **"...prandaj jini të devotshëm ndaj All'llahut, për të qenë falënderues."**

Ajeti në vazhdim paraqet disa shpjegime të qarta rreth asaj që ka ndodhur në Luftën e Bedrit. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Atëherë ti (Muhammed) u thoshe besimtarëve: "A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë engjëj të dërguar?"**

Përkujtoni (o besimtarë) dhe ti o Profet ditën kur u thoshe myslimanëve të dobët: "Luftoni se All'llahu do t'ju ndihmojë juve me engjëj mbrojtës. A nuk ju mjafton kjo për të realizuar fitoren e madhe ndaj idhujtarëve, të armatosur gjer në dhëmbë?"

Sigurisht o myslimanë, ajo që arritët në Bedër erdhi si rezultat i durimit që ju bëtë. Kjo gjë arrihet edhe sot, nëse i bindeni urdhrave të Profetit dhe të zbatoni me durim mësimet dhe këshillat e tij. **"Po! Por, nëse ata ju sulmojnë, bëhuni të durueshëm dhe të dëgjueshëm dhe Zoti juaj menjëherë<sup>2</sup> do t'ju dërgojë në ndihmë pesë mijë engjëj, me shenjë të dalluar."**

---

<sup>1</sup> El Kamil fij Tarih, i "Ibn Ethijr", vëllimi 1, faqe 526.

<sup>2</sup> Fjala *el feur* që përmendet në arabisht në këtë ajet, ka kuptimin e shpejtësisë (e menjëhershme) së ndryshimit të raporteve.

Zbritja e këtyre engjëjve nuk ishte faktori bazë i fitores suaj, sepse fitorja vjen nga ana e All'llahut. Zbritja e engjëjve nuk ishte veçse qetësim për zemrat tuaja: **“All'llahu e bëri këtë që t'ju sjellë lajmin e gëzuar dhe që t'jua qetësojë zemrat. Vërtet, fitorja është vetëm nga All'llahu, i Plotfuqishmi dhe i Urti.”** Ai është i Gjithëditur për rrugët e fitores dhe për çelësat e suksesit. Ai është i Plotfuqishëm për ta realizuar atë.

Pastaj All'llahu i Lartësuar, në fund të këtyre ajeteve, thotë: **“(Gjithashtu All'llahu e bëri këtë edhe) që të shkatërrojë një pjesë prej atyre që nuk besuan apo t'i turpërojë, e kështu të kthehen të humbur.”**

Ky ajet, edhe pse në mesin e komentuesve ka mendime të ndryshme, është në vazhden e atyre që shpjeguar dhe argumentuar deri tani. Ndihma e All'llahut për myslimanët, duke u zbritur melekët kishte si qëllim forcimin e besimit të myslimanëve, si dhe dobësimin e fuqisë ushtarake të armikut dhe shkatërrimin e tyre.

Duhet të theksojmë se fjala *tarf* do të thotë *ana e një diçkaje dhe pjesa e saj*, ndërsa fjala *jukbitkum* do të thotë *kthim me forcë e përçmim*.

Këtu lind pyetja: Si mundën engjëjt t'i ndihmojnë myslimanët dhe t'u japin fitoren atyre? Përgjigjen e kësaj pyetjeje do ta japim kur të bëjmë komentimin e ajeteve 7-12 të sures “El-Enfal.”

## Ajeti 128

لَيْسَ لَكَ مِنَ الْأَمْرِ شَيْءٌ أَوْ يَتُوبَ عَلَيْهِمْ أَوْ يُعَذِّبُهُمْ فَإِنَّهُمْ ظَالِمُونَ ﴿١٢٨﴾

**"Ti nuk ke asgjë në dorë, nëse do t'ua pranojë Ai pendimin apo do t'i dënojë, se ata janë vërtet keqbërës."**

### Komentimi

Komentuesit e Kur'anit kanë shumë mendime për komentimin e këtij ajeti. Por, mendimi më i pranueshëm është se ky ajet ka zbritur pas Betejës së Uhudit. Ajeti ka lidhje me ndodhitë e asaj beteje. Këtë të vërtetë e përforcojnë edhe ajetet e mëparshme.

Ajo që tërheq vëmendjen është se ndër kuptimet që përmban ky ajet dy janë më tërheqëse:

I pari: Ky ajet përbën fjali të pavarur. Për këtë, fjalia **"Nëse do t'ua pranojë Ai pendimin"** ka kuptimin: Ti o Muhammed nuk ke në dorë asnjë gjë rreth së ardhmes së tyre. Ata e meritojnë ndëshkimin për atë që kanë bërë. Duhet të themi që kjo gjë është në dorë të All'llahut. Nëse dëshiron, i fal, ose nëse dëshiron, i ndëshkon për padrejtësinë që kanë bërë.

Përemri *hum*, që do të thotë *ata*, nënkupton ose mohuesit e idhujtarëve, të cilët përndoqën myslimanët dhe i goditën ashpër ata dhe Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi*

*familjen e tij!*), ose ata myslimanë që u larguan nga fusha e betejës, pastaj u penduan për çfarë bënë, kur lufta u qetësua dhe shfaqën keqardhje ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i kërkuan atij falje.

Ajeti thotë: Falja dhe ndëshkimi i tyre për veprimet që kanë bërë i takon vetëm All'llahut të Lartësuar dhe Profeti nuk bën asnjë gjë pa lejen e Tij.

Ka komentim tjetër, që e konsideron fjalën e All'llahut: **“Ti nuk ke asgjë në dorë”** si fjali kundërshtuese dhe si fjalia **“nëse do t’ua pranojë Ai pendimin”** është pjesë e lidhur me fjalinë **“apo t’i turpërojë”** (e ajetit të mëparshëm). Kështu, ky ajet konsiderohet si vazhdimësi dhe lidhje e ajeteve të mëparshme.

Duke u bazuar mbi këto fjalë, kuptimi i dy ajeteve, të mëparshme dhe i këtij ajeti, është: Me të vërtetë, All'llahu do t’ju mundësojë juve mjetet e fitores dhe do t’i godasë mohuesit me një prej katër gjërave; ose do të ndajë një pjesë të ushtrisë së idhujtarëve; ose do t’i kthejë ata prapa të frikësuar e të përçmuar, ose do t’i falë ata, nëse rregullohen e përmirësohen, ose do i ndëshkojë për padrejtësitë e tyre. Sido që të jetë, Ai do të veprojë me urtësi dhe drejtësi me çdo grup. Prandaj, ti (o Muhammed) s’ke të drejtë të veprosh nga ana jote, sepse çdo gjë i përket All'llahut.

Për shkakun e zbritjes së këtij ajeti kanë ardhur disa transmetime. Prej atyre transmetive është se ajo çfarë bënë idhujtarët në Luftën e Uhudit: plagosjen e Profetit, gjaku që rrodhi mbi fytyrën e tij të ndritshme, humbjet e myslimanëve, në njerëz dhe në materiale, shqetësimi i Profetit për të ardhmen e popullit të tij. Të gjitha këto bënë që Profeti të mendonte me vete se si është e

mundur që All'llahu i Lartësuar të udhëzojë atë grup që është zhytur në urrejtjen e armiqve: "Si mund të shpëtojë një popull, të cilët ia bënë këtë padrejtësi Profetit të tyre dhe ai i fton (që të besojnë) në All'llah?"<sup>1</sup>

Atëherë zbriti ajeti dhe All'llahu i Lartësuar e lajmëroi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai nuk ka asgjë në dorë, përveçse asaj për të cilën është urdhëruar, t'i informojë njerëzit për mesazhin e ardhur dhe t'u bëjë atyre thirrje të udhëzohen. Profeti nuk është përgjegjës nëse njerëzit nuk udhëzohen dhe nuk i përgjigjen thirrjes së tij.

## Ndreqja e gabimit

Këtu patjetër duhet të vërejmë dy pika.

1- Komentuesi i njohur i tefsirit "El-Menar" mendon se ky ajet u mëson myslimanëve një mësim të madh në përfitimin e mjeteve të fitores dhe të triumfit. Vërtet, premtimi i All'llahut të Lartësuar për fitoren e betejës nuk do të thotë që myslimanët të nënvleftësojnë mjetet materiale, mënyrat, praktikat dhe shkaqet e luftës. Dhe jo të presin që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të lutet për fitore. Për këtë ka ardhur ajeti që i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **"Ti nuk ke asgjë në dorë."** Kuptimi i këtij ajeti është se fitorja nuk të është dhënë ty, por është në dorën e All'llahut të Lartësuar. Që të arrihet fitorja, All'llahu ka

---

<sup>1</sup> "Biharul Anuar", vëllimi 20, faqe 102; Tefsiri "Durrul Menthur", vëllimi 2, faqe 71.

vendosur rregulla e ligje, që njerëzit duhen t'i zbatojnë. Lutja e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe pse është e ndikueshme dhe dobiprurëse, ka veçori të tjera.

Këto fjalë, edhe nëse mund të jenë të pranueshme në thelbin e tyre, nuk janë në përputhje me atë çfarë thuhet në fundin e ajetit: **"...nëse do t'ua pranojë Ai pendimin apo do t'i dënojë."** Për këtë, nuk mund të komentohet ajeti me ato që ka thënë ky shkrimtar.

2- Me të vërtetë, ky ajet, edhe nëse mohon të drejtën e faljes ose të drejtën e ndëshkimit të mohuesve dhe të idhujtarët nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk bie në kundërshtim me atë që përfitohet nga ajetet e tjera për ndikimin e lutjes së Profetit, shefaatit dhe të faljes së tij. Qëllimi i këtij ajeti është mohimi që Profeti të ketë të drejtën e pavarësisë në veprim. Atëherë, me lejen e All'llahut, fal kë të dojë dhe ndëshkon kë të dojë, ashtu sikurse Ai ka të drejtë që të përgatisë terrenin për fitoren.

Ata që kapen pas fjalës së All'llahut të Lartësuar: **"Ti nuk ke asgjë në dorë..."** duke i mohuar fuqitë e të Dërguarit të All'llahut për këtë çështje, kanë harruar ajetet e tjera kur'anore që flasin për këtë çështje.

Kur'ani Famëlartë, në suren "En-Nisa", në ajetin 64, thotë: **"...Dhe në qoftë se ata, kur i bëjnë padrejtësi vetave të tyre, të vinin te ti për t'i kërkuar falje All'llahut, dhe i Dërguari i kërkon falje All'llahut për ata, do ta vërenin se All'llahu, me të vërtetë, është Pranues dhe Mëshirëplotë."** Sipas këtij ajeti, falja e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

*tij!)* është prej faktorëve ndikues në faljen e gjynaheve. Me shpresën e All'llahut këtë të vërtetë do ta sqarojmë në hulumtimet e ardhshme dhe në komentimin e ajeteve të përshtatshme me këtë çështje.

## Ajeti 129

وَلِلّٰهِ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَمَا فِي الْاَرْضِ يَغْفِرُ لِمَن يَشَآءُ وَيُعَذِّبُ مَن يَشَآءُ

وَاللّٰهُ غَفُوْرٌ رَّحِيْمٌ ﴿١٢٩﴾

**“All’Ilahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë! Ai fal kë të dojë dhe dënon kë të dojë. All’Ilahu është Falës i madh e Mëshirëplotë.”**

### Komentimi

Në të vërtetë ky ajet është përforcues i asaj që përmban ajeti i mëparshëm. Kuptimi i këtij është se falja dhe ndëshkimi nuk janë në dorën e Profetit, por në dorën e All’Ilahut të Lartësuar, i Cili zotëron çdo gjë që ndodhet në qiej e në tokë, Ai është Gjykatësi i prerë dhe i Plotfuqishëm, sepse Ai është Krijuesi. Atij i takon zotërimi dhe mbikëqyrja. Kështu që Ai fal kë të dojë prej mëkatarëve ose i ndëshkon sipas urtësisë, sepse dëshira e Tij është në përputhje me urtësinë e Tij. **“All’Ilahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Ai fal kë të dojë dhe dënon këtë dojë.”**

Pastaj All’Ilahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet me thënien e Tij: **“All’Ilahu është falës i madh e mëshirëplotë.”** Si kujtesë, që edhe pse është i ashpër në ndëshkim, duhet të themi që mëshira i paraprin zemërimit të Tij. Ai është Falës i Madh e Mëshirëplotë, përpara se të jetë Ndëshkues i dhembshëm.

Këtu është e vlefshme të tregojmë çfarë ka thënë një nga dijetarët e mëdhenj të tefsirit, eruditi Tabarsi. Në fundin e këtij ajeti thotë: U pyetën disa dijetarë: "Si i ndëshkon All'llahu robtë e vet për gjynahet që kanë bërë, kur mëshira e Tij është e madhe?"

Përgjigjja: "Mëshira e tij nuk e mposht urtësinë e Tij, sepse mëshira e Tij nuk është prej dobësisë së zemrës, sikurse është mëshira e jonë (njerëzve)."

Kjo do të thotë se mëshira e All'llahut nuk është e ndërtuar mbi baza ndjenjash dhe emocionesh, sikurse është gjendja jonë, por mëshira e Tij është e bashkuar gjithmonë me urtësinë e Tij, e cila obligon ndëshkimin e mëkatarëve.

## Ajeti 130-132

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ الَّتِي كُنتُمْ تَرْبَوْنَ أَضْعَافًا مُّضَاعَفَةً ۖ وَاتَّقُوا اللَّهَ  
لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿١٣٠﴾ وَاتَّقُوا النَّارَ الَّتِي أُعِدَّتْ لِلْكَافِرِينَ ﴿١٣١﴾ وَأَطِيعُوا  
اللَّهَ وَالرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿١٣٢﴾

**“O ju që keni besuar! Mos pranoni kamatë të shumëfishtë mbi kamatë! Kijeni frikë All’llahun, që të shpëtoni dhe ruajuni zjarrit, i cili është përgatitur për jobesimtarët!”**

**“Binduni All’llahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën (e All’llahut).”**

## Komentimi

### Rreth lidhjes ndërmjet ajeteve të Kur'anit

Ajetet e mëparshme, sikurse e mësuam, flisnin për Betejën e Uhudit, për ndodhitë, për mësimet dhe për përvojën që fituan myslimanët prej saj. Kurse këto tre ajete dhe gjashtë ajetet e tjera, që vijnë më pas, përmbajnë një seri programesh ekonomike, shoqërore dhe edukative. Pas këtyre nëntë ajeteve Kur'ani flet përsëri për Betejën e Uhudit.

Mundet që ky lloj diskutimi dhe qartësimi të shkaktojë habi tek disa njerëz. Por, nëse e vërejmë me kujdes, parimi bazë e qartëson realitetin e kësaj çështjeje dhe zbulon sekretin e kësaj mënyre. Ky parim është: Kur'ani nuk është si librat e tjerë, të cilët kanë stil klasik dhe përbëhen prej kapitujve të veçantë. Ai (Kur'ani) është libri i shpallur me ajete, në mënyrë të përshkallëzuar gjatë një periudhe kohore njëzet e tre vjeçare. Kjo zbritje është bërë sipas nevojave të ndryshme edukative, në vende e kohë të ndryshme.

Në kohën që ndodhi Beteja e Uhudit zbritën ajete që bëjnë fjalë për rregullat dhe çështjet e luftës.

Në kohën që kërkohej sqarimi i disa programeve e mësimëve ekonomike, si qëndrimi ndaj kamatës; apo disa çështje për të drejtat dhe liritë njerëzore, si rregullat e martesës; apo disa çështje edukative ndaj moralit, si pendimi, kanë zbritur ajete që i kanë shqyrtuar ato.

Duhet të theksojmë se të gjitha suret dhe ajetet e Kur'anit janë të lidhura në atë formë, saqë të gjitha së bashku përbëjnë një paketë ligjesh dhe udhëzimesh, të plotësuara e të lidhura me veprat e njeriut, të lidhura me edukimin e tij. Të gjitha së bashku kanë zbritur për të formuar një shoqëri sa më të mirë, të kuptueshme e të zhvilluar në të gjitha sferat, si nga ana materiale, ashtu edhe nga ana shpirtërore (e brendshme).

### **Ndalimi i kamatës në disa periudha**

Të gjithë e dimë se metoda që përdor Kur'ani për luftimin e devijimeve shoqërore në jetën e njerëzve është "Hap pas hapi". Në fillim përgatit situatën e përshtatshme, duke i njohur njerëzit me dëmet e devijimit dhe se ato duhen luftuar dhe duhen ndaluar. Pasi njerëzit e pranojnë ndalimin përfundimtar, Kur'ani shpall frazën ligjore përfundimtare të ndalimit (kjo metodë është e posaçme nëse çështja dëmtuese a shkatërruese është përhapur shumë në mesin e shoqërisë).

Gjithashtu, ne e dimë që shoqëria arabe, në kohën para shpalljes së Islamit, ka qenë e goditur nga kamata, ku ajo shoqëri, veçanërisht Meka, ka qenë një arenë e madhe e kamatarëve. Kjo çështje ka shkaktuar shumë fatkeqësi shoqërore. Për ndalimin e kësaj vepre të shëmtuar (kamatës), Kur'ani ka përdorur mënyrën e ndalimit me periudha. Kamatën e ka ndaluar në katër periudha:

1 - Në ajetin 39 të sures "Er-Rum", Kur'ani mjaftohet me drejtimin e porosive morale rreth kamatës. All'Ilahu i Madhëruar thotë: **"Ato që i jepni dhuratë për t'jua shtuar (pasurinë tuaj) përmes pasurisë së njerëzve të tjerë (duke jua kthyer dhuratën me një më të mirë), nuk do të shtohen tek All'Ilahu (s' do të ketë**

shpërblim), **kurse kur të jepni si bamirësi, për të arritur kënaqësinë e All'Ilahut, do t'ju shumëfishohen (të mirat)."**

Me këtë thënie, Kur'ani zbulon gabimin e atyre që mendojnë se kamata ua shton atyre pasurinë, ndërkohë që zekati, sadakaja dhe shpenzimi në rrugën e All'Ilahut e shtojnë pasurinë.

2- Kur'ani, duke kritikuar traditat e gabuara dhe të dëmshme të jahudinjeve, flet se kamata është prej zakoneve të këqija të tyre. Në ajetin 101 i sures "En-Nisa" thuhet: **"Për shkak se merrnin kamatë, megjithëse kjo ishte e ndaluar për ta dhe për shkak se përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve."**

3- Ajeti në fjalë, sikurse do ta shpjegojmë më poshtë, tregon me qartësi rregullin e ndalimit të kamatës. Por ai tregon vetëm një lloj prej llojeve të kamatës dhe ai është lloji më i rreptë, më poshtëruesi dhe më dëmtuesi.

4 - Dhe së fundi, në ajetet 275 - 279 të sures "El-Bekare", Kur'ani flet për ndalimin e plotë e të rreptë të të gjitha llojeve të kamatës. **"Nëse nuk e bëni këtë, atëherë iu është shpallur luftë nga All'Ilahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar. Në këtë mënyrë, nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni vetë."**<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sure "El Bekare", ajeti 279.

## Ndalimi i kamatës në këtë ajet

Thamë se ajetet në fjalë tregojnë për kamatën e ndyrë dhe shkatërruese, duke thënë: **“O ju që keni besuar! Mos pranoni kamatë të shumëfishtë mbi kamatë! Kijeni frikë All’llahun, që të shpëtoni...”**

Kuptimi i kamatës “së ndyrë e shkatërruese” është kur kamata është në rritje, që do të thotë se ka shtesë mbi kapitalin dhe shtesa e kamatës shtohet disa fish nga pagesa fillestare.

Shtesa e dytë, që vlerësohet me shumën reale të kapitalit (e cila është vlere reale e kapitalit dhe shtesa e obliguar herën e parë) bashkohet me shtesën e parë dhe kështu me radhë, me veprime njëra pas tjetrës. Dhe kështu kapitali dhe shtesa e tij në çdo radhë shumëfishohet. Kështu, vlere e huamarrësit (borxhliut) shumëfishohet nga vlere reale dhe borxhliu është i detyruar të paguajë borxhin me gjithë pasurinë e tij. Për këtë, All’llahu i Lartësuar urdhëron: **“O ju që keni besuar! Mos pranoni kamatë të shumëfishtë mbi kamatë!”**

Nga transmetimet e ardhura thuhet se personi - në kohën e injorancës - nëse nuk e paguante borxhin e tij në kohën e caktuar, huadhënësi i kërkonte që të shtohet një shumë mbi shumën reale të borxhit të marrë, pastaj ia shtynte atë për një periudhë tjetër kohe. Kështu vazhdohej derisa i merrej e gjithë pasuria borxhliut prej huadhënësit me kamatë. E njëjta gjë ndodh edhe sot. S’ka dyshim se kjo vepër ua shton shumë pasurinë kamatlinjve të pamëshirshëm, pa mund e lodhje. Kjo dukuri mund të ndalohej vetëm duke pasur frikë All’llahun e Lartësuar. Prandaj All’llahu i Lartësuar thotë: **“Kijeni frikë All’llahun, që të shpëtoni.”**

Vallë, a është e mjaftueshme vetëm frika ndaj All'llahut dhe dëshira e shpëtimit duke e lënë kamatën apo duhet përmendur edhe ndëshkimi në Jetën Tjetër për kamatlinjtë? Për këtë, All'llahu i Madhëruar në ajetin e dytë thotë: **"...dhe ruajuni zjarrit, i cili është përgatitur për jobesimtarët."** Ky ajet përforcon rregullin e devotshmërisë ndaj All'llahut.

Fjala *jobesimtar* nënkupton se marrja e kamatës nuk pajtohet me shpirtin e besimit. Për këtë, si kamatlinjtë, ashtu edhe jobesimtarët i pret zjarri dhe ndëshkimi i rëndë. Nga këto ajete përfitohet se zjarri është përgatitur për jobesimtarët. Edhe mëkatarët dhe të pabindurit do të ndëshkohen me këtë zjarr, bazuar te ngjashmëria e tyre me jobesimtarët dhe te bashkëpunimi i tyre me ata jobesimtarë.

Pastaj All'llahu i Lartësuar e përzien këtë kërcënim me një nxitje për të bindurit dhe zbatuesit e urdhrave të All'llahut, ku thotë: **"Binduni All'llahut dhe të Dërguarit për të shpresuar mëshirën e (All'llahut)."**

## Ajetet 133 -136

وَسَارِعُوا إِلَى مَغْفِرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَجَنَّةٍ عَرْضُهَا السَّمَوَاتُ وَالْأَرْضُ  
 أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ ﴿١٣٣﴾ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ وَالْكَبِيرِ  
 وَالصَّغِيرِ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٣٤﴾ وَالَّذِينَ  
 إِذَا فَعَلُوا فَحِشَةً أَوْ ظَلَمُوا أَنْفُسَهُمْ ذَكَرُوا اللَّهَ فَاسْتَغْفَرُوا لِذُنُوبِهِمْ وَمَن  
 يَغْفِرِ الذُّنُوبَ إِلَّا اللَّهُ وَلَمْ يُصِرُّوا عَلَىٰ مَا فَعَلُوا وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿١٣٥﴾  
 أُولَٰئِكَ جَزَاؤُهُم مَّغْفِرَةٌ مِّن رَّبِّهِمْ وَجَنَّاتٌ تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ  
 خَالِدِينَ فِيهَا ۖ وَنِعَمَ أَجْرُ الْعَامِلِينَ ﴿١٣٦﴾

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilët është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit,

të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. All’llahu i do bamirësit.

Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë padrejtësi vetes, e kujtojnë All’llahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre - e kush i fal gjynahet përveç All’llahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë,

**pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!"**

## Komentimi

### Garimi në fushën e lumturisë

Pas kërcënimit me ndëshkimin e rëndë me zjarrin e Xhehennemit të atyre që mëkatojnë dhe nuk u binden urdhrave të All'llahut, që përmendën ajetet e mëparshme, ajetet në fjalë përgëzojnë të bindurit ndaj urdhrave të All'llahut me mëshirë hyjnore. Ajeti i parë në fjalë e ngjason përpjekjen e besimtarëve me garimin. Garimi shpirtëror ka për qëllim mbërritjen te mëshira dhe te mirësitë e pafundme të All'llahut të Madhëruar. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj..."**

Fjala *sariu* – *nxitoni*, këtu ka kuptimin e garimit të dy ose më shumë personave për të arritur një qëllim të caktuar, ku gjithsecili përpiqet të ecë më shpejt në garim. Kjo gjë është e pëlqyeshme për punët e mira dhe për moralet e pëlqyera.

Ndërsa garimi për vepra të këqija është i urryer. Vërtet, Kur'ani na tregon këtu për diçka psikike; kur njeriu është i vetëm, nuk e kryen veprën e tij me nxitim dhe veprimet e tij kthehen në rutinë.

Kurse kur vepra e tij merr natyrë garimi dhe konkurrimi, e cila në fund do të shpërblehet me një dhuratë të çmuar, e shohim atë (njeriun) të përdorë të gjitha fuqitë dhe energjitë e tij për fitimin e asaj dhurate.

Nëse qëllimi i vendosur në këtë ajet është arritja e mëshirës dhe e faljes, sepse arritja e gradës së lartë shpirtërore bëhet vetëm me falje dhe pastrim të mëkateve, atëherë patjetër duhet të pastrohet shpirti, më pas të afrohet falja e All'llahut. Ky është edhe qëllimi i parë i besimtarit.

Qëllimi i dytë i këtij nxitimi të madh shpirtëror është fitimi i Xhenetit, për të cilin Kur'ani thotë se është i gjerë sa gjerësia e Tokës dhe e qiellit. **"...hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit..."**

Ka një ndryshim të vogël ndërmjet këtij ajeti dhe ajetit njëzet e një të sures "Hadijd" në të cilin thuhet: **"Prandaj rrekuni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka..."**

Në këtë ajet përmendet fjala *musabekatu* - *rrekuni*, *garoni* në vend të fjalës *musareatu* - *nxitoni*. Po ashtu, fjala *qiell* përmendet në numrin njëjës dhe paraprihet nga *elifi* dhe *lami*, e llojit që tregon përgjithësim. Sikurse është përdorur germa *kef* që do të thotë *sa*, në formën e krahasimit (sa gjerësia dhe hapësira e qiejve dhe e Tokës).

Kuptimi i këtij ajeti është se gjerësia e Xhenetit është po e njëjtë sa gjerësia e qiellit dhe e tokës.

All'llahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet me fjalën e tij: **“është përgatitur për të devotshmit.”** Ky Xhenneti i madh, i cilësuar me këtë gjerësi, është përgatitur për ata që e kanë frikë All'llahun, që janë të devotshëm, që i largohen mëkateve dhe kryejnë urdhrat e Tij.

Duhet të dimë se qëllimi i përdorimit të konceptit të gjerësisë këtu nuk është lartësia dhe gjerësia gjeometrike, por, ashtu siç thonë dijetarët e gjuhës, është për një hapësirë.

### Dy pyetje:

**E para:** A ekzistojnë me të vërtetë Xhenneti dhe Xhehennemi apo do të krijohen më pas, bazuar te veprat e njerëzve?

**E dyta:** Nëse këto të dyja (Xhenneti dhe Xhehennemi) ekzistojnë, ku ndodhen, pasi All'llahu i Lartësuar thotë se hapësira e tyre është sa e qiellit dhe e Tokës.

**Përgjigja:** Shumica e dijetarëve myslimanë besojnë dhe mendojnë se Xhenneti dhe Xhehennemi ekzistojnë me të vërtetë dhe se ajetet e Kur'anit e përforcojnë këtë mendim. Si shembull po tregojmë:

**1-** Ky ajet dhe ajetet e tjera përmendin foljen *është përgatitur*, si dhe fjalë të ngjashme me këtë. Kjo folje, herë është përdorur për Xhennetin dhe herë për Xhehennemin.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Lexo këto ajete: ajetet 89-100 të sures “Et-Teube”, ajeti 6 i sures “El-Fet’h”, ajeti 24 i sures “El-Bekare”, ajetet 131-133 të sures “Al-Imran”, ajeti 21 i sures “El-Hadid”.

Nga këto ajete kuptojmë se Xhenneti dhe Xhehennemi janë krijuar me të vërtetë, edhe pse më pas zgjerohen sipas veprave të njerëzve. (Mendo thellë!)

2- Në ajetet 13-15 të sures “En-Nexhem”, që kanë lidhje me Miraxhin, lexojmë: **“...ndërkohë që ai e ka parë atë edhe një herë tjetër, te Sidretul Munteha-ja, ku ndodhet Xheneti i Strehimit.”** Ky ajet është dëshmi tjetër se Xhenneti dhe Xhehennemi ekzistojnë.

3- Në ajetet 5-7 të sures “Tekathur” All’llahu i Madhëruar thotë: **“Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri! Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues! Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë”**, që do të thotë se, nëse do të kishit një dije të sigurt, do ta shihnit Xhehennemin.

Ka transmetime të shumta që kanë lidhje me Miraxhin dhe ka të tjera që mbartin dëshmi rreth kësaj çështjeje që po flasim.<sup>1</sup>

## Ku ndodhet Xhenneti dhe Xhehennemi?

Nëse konstatohet se Xhenneti dhe Xhehennemi realisht ekzistojnë, pyetja tjetër që shtrohet është: Atëherë ku ndodhen?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje mund ta japim në dy drejtime.

**I pari:** Me të vërtetë, Xhenneti dhe Xhehennemi ndodhen në brendësi të kësaj bote dhe nuk kemi pse të habitemi për këtë gjë, pasi ne i shohim me sytë tanë qiellin, tokën dhe yjet.

---

<sup>1</sup> Duhet ditur se Xhenneti, që flitet këtu dhe që ka lidhje me Botën Tjetër, është ndryshe nga Xhenneti në të cilin banoi Ademi me Havanë.

Por ne nuk i shohim botët e tjera, të cilat ndodhen në po këtë brendësi të kësaj bote. Sikur ne të zotëronim mënyra të tjera për t'i njohur këto botë, do të qëndronim përpara krijesave të tjera, që valët e tyre nuk i nënshtrohen shikimit tonë dhe nuk përfshihen në fuqinë e shqisave tona.

Ajetet 5- 7 në suren "Tekathur": **"Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri! Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues! Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë",** që i përmendëm më lart, është një argument tjetër përforcues për këtë mendim. Nga disa hadithe ne kuptojmë se disa të devotshëm dhe të dashur të All'Ilahut (eulija), kanë mundur ta shohin Xhennetin dhe zjarrin e Xhehennemit.

Këtë tematikë mund ta përshkruajmë me këtë shembull: Supozojmë se diku, në një vend të tokës është një aparat i fortë radiofonik, i cili, me ndihmën e satelitëve hapësinorë dhe valëve zanore, transmeton për njerëzit lexim Kur'ani me zë të ëmbël. Në të njëjtën kohë, gjendet aparat tjetër transmetues, i cili me po të njëjtën forcë, transmeton zëra të mërzitshëm. Nuk ka dyshim se ne nuk kemi forcë që t'i mësojmë ose t'i njohim këto dy lloj transmetimesh me shqisat tona të zakonshme. Ne e kuptojmë praninë e këtij transmetimi vetëm me praninë e radios dhe kur e çojmë në valën e posaçme. Nëpërmjet kësaj arrijmë të dallojmë se cili prej transmetimeve është i pëlqyeshëm dhe cili jo.

Ky shembull, edhe pse nuk është i plotë, na paraqet një të vërtetë të rëndësishme, se Xhenneti dhe Xhehennemi mund të ekzistojë në brendësi të kësaj bote, pavarësisht se nuk zotërojmë njohuri dhe forcë me shqisat tona që t'i dallojmë e t'i shohim.

Por njohjen e këtyre botëve mund ta bëjë ai që zotëron shqisa të përshtatshme.

**I dyti:** Me të vërtetë, Bota Tjetër, Xhenneti dhe Xhehenemi është e përfshirë me këtë gjithësi. Thënë ndryshe: Universi ynë ndodhet në rrethin e kësaj bote. Kjo është sikurse ndodhet bota embrionale në thelbin e kësaj bote, ku të gjithë e dimë se bota embrionale është e veçantë, ajo ka ligjet dhe rregullat e veta. Edhe pse është e tillë, ajo nuk është e ndarë nga kjo botë ku ne jetojmë. Kështu është gjendja e kësaj bote përse i përket Botës Tjetër.

Kur shohim Kur'anin të thotë se gjerësia e Xhennetit është sa hapësira e qiejve dhe e Tokës është se njeriu nuk njih asnjë gjë më të gjerë se qielli dhe Toka që të masë gjerësinë e Xhennetit. Në këtë mënyrë, Kur'ani e paraqet madhësitinë e Xhennetit dhe gjerësinë e tij se është sa gjerësia e qiejve dhe e Tokës.

Për sa u tha më lart, u sqarua se Xhenneti është i gjerë sa gjerësia e qiejve dhe e Tokës. Po Xhehenemi ku ndodhet?

Sipas përgjigjes së parë, qartësohet se Xhehenemi (zjarri) është një botë tjetër, e cila ndodhet në brendësi të kësaj bote. Prania e saj në këtë botë nuk bie ndesh me praninë e Xhennetit (ashtu si u qartësua nga shembulli i sistemit të transmetimit).

Sipas përgjigjes së dytë, që Xhenneti dhe Xhehenemi janë në perimetrin dhe hapësirën e kësaj bote që ne jetojmë, përgjigjja e kësaj pyetjeje është më e thjeshtë për t'u dhënë, pasi Xhehenemi (zjarri) mund të jetë i përfshirë në këtë botë dhe Xhenneti është i përfshirë me të dhe si rezultat i kësaj, del se Xhenneti është më i gjerë dhe më i madh se Xhehenemi (zjarri).

## Veçoritë e të devotshmëve

Ajeti 133 i kësaj sureje shpjegon se Xhenneti është përgatitur për të devotshmit, kurse ajeti në vazhdim përmend pesë cilësi të të devotshmëve, që janë prej cilësive të tyre të larta humane e njerëzore. Ato cilësi janë:

**1- Ata japin prej pasurisë së tyre në çfarëdo lloj gjendjeje qofshin, në vështirësi apo në lehtësi, fshehurazi dhe haptazi: "... të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve."**

Ata, me këtë veprim, përforcojnë dhembshurisë ndaj të tjerëve dhe dashuria për të mirën dhe mirësia shtohen në shpirtin e tyre. Për këtë, ata e kryejnë këtë vepër në çdo situatë qofshin.

Nuk ka dyshim se dhënia vetëm në mirëqenie, tregon se cilësitë humane nuk janë të plota në thellësi të shpirtit. Ato cilësi janë të plota në shpirtin e njeriut kur ai e kryen dhënien në çdo situatë a rrethanë.

Mund të thuhet: Si është e mundur që njeriu të japë kur është i varfër?

Përgjigjja është krejt e qartë.

**E para:** Me të vërtetë, i varfëri mund të japë aq sa ka mundësi, sepse dhënia nuk ka kufizime, as në pakicë, as në shumicë.

**E dyta:** Dhënia nuk kufizohet vetëm me dhënien e parasë e të pasurisë, por njeriu duhet të japë çdo gjë nga ajo që i ka dhuruar All'Ilahu i Lartësuar: pasuri, dituri, mund, fuqi, etj.

Me këtë, All'llahu i Lartësuar dëshiron të përforcojë shpirtin e sakrificës, dhënien e lëmoshës, deri edhe në shpirtrat e të varfërve, me qëllim që të largohen nga një prej moraleve të ulëta, që është koprracia.

Sikur çdo banor i tokës, i varfër apo i pasur, të japë një ndihmë të vogël për të ndihmuar të tjerët, duke përgatitur planprograme për zbutjen e varfërisë në shoqëri, pa dyshim që do të kryejnë punë të mëdha. Pa përmendur ndikimet shpirtërore që fitojnë këta dhënës. Duhet theksuar se të gjitha të mirat e kësaj pune i kthehet dhënësit apo shpenzuesit dhe se All'llahu nuk ka nevojë për dhënien dhe shpenzimin e njerëzve.

Ajo që tërheq vëmendjen është se cilësia e parë e të devotshmëve që përmendet në këtë ajet është dhënia. Në realitet, këto ajete përmendin të kundërtën e cilësive të kamatlinjve që përmendeshin në ajetet e mëparshme. Mos interesimi për pasurinë dhe shpenzimi i saj haptazi dhe fshehurazi për hir të All'llahut të Madhëruar janë prej cilësive të larta të të devotshmëve.

2- Vërtet, të devotshmit janë të aftë ta mposhtin zemërimin e tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: **“... e mposhtin zemërimin.”**

Fjala *el kadhm*, nga ana gjuhësore do të thotë *shtrëngimi i grykës së çelikut kur mbushet*, kur mbushet me ujë. Kjo fjalë përdoret edhe si metaforë për atë që mbushet plot me zemërim, por nuk hakmerret.

Ndërsa fjala *gajdh* do të thotë *zemërim i madh, irritim dhe mërzitje shpirtërore*, të cilat ndodhin kur njeriu sheh diçka që e urren.

Zemërimit dhe irritimi janë prej rasteve më të rrezikshme për njeriun. Sikur të mos kontrollohen, shndërrohen në një lloj çmendurie, ku njeriu nuk arrin dot të kontrollojë nervat, reagimet dhe veprimet e tij.

Për këtë, shumica e krimeve dhe e gabimeve që bën njeriu në jetën e tij bëhen kur ai është në këtë gjendje. Prandaj ky ajet e konsideron **mposhtjen e zemërimit** cilësi të dytë e të lartë të të devotshmëve.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Kush e mposht zemërimin dhe ai është në gjendje ta shfryjë atë, All'llahu ia mbush zemrën me siguri (qetësi) dhe besim."<sup>1</sup>

Nga ky hadith kuptojmë se mposhtja e zemërimit ndikon më shumë në përsosmërinë shpirtërore të njeriut dhe në forcimin e besimit të tij.

**3- Me të vërtetë, të devotshmit i falin ata që u bëjnë padrejtësi. Për këtë, All'llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: "... dhe ua falin fajet njerëzve."**

Sigurisht, mposhtja e zemërimit është një çështje shumë e pëlqyeshme, por nuk është e mjaftueshme, pasi nuk mund të shkulë rrënjët e armiqësisë nga zemra e njeriut.

Është më se e domosdoshme që për shkuljen e rrënjëve të këtyre papastërtive mposhtja e zemërimit të jetë e shoqëruar me

---

<sup>1</sup> "Usulul Kafijj", vëllimi 2, faqe 110.

një hap tjetër, që është falja e njerëzve. Për këtë, si mposhtja, ashtu edhe falja përmenden njëra pas tjetrës në ajet.

Duhet të theksojmë se qëllimi i faljes dhe i tolerancës është për ata që e meritojnë faljen dhe jo për armiqtë, të cilët falja dhe toleranca i çojnë në shtimin e krimeve dhe të padrejtësive.

#### 4- Të devotshmit janë bamirës: **“All’lahu i do bamirësit.”**

Kjo tregon për një shkallë më të lartë se falja. Me këtë, të devotshmit arrijnë një shkallë më të lartë të përsosmërisë shpirtërore.

Ky zinxhir i përsosmërisë nuk është i mjaftueshëm për t’i bërë ballë së keqes vetëm me mposhtjen e zemërimit. Përsëri nuk është e mjaftueshme që vetëm të falësh dhe të tolerosh ndaj atij që të ka bërë keq, duke shlyer dhe duke pastruar në këtë mënyrë shenjat e armiqësisë. Por duhet të shkulen njëherë e përgjithmonë rrënjët e armiqësisë nga zemra, duke qenë bamirës ndaj tij. Me anë të saj fitohet dashuria dhe respekti i armikut dhe ndalohet të bërit keq atij në të ardhmen.

Si përfundim themi se Kur’ani e urdhëron myslimanin, në fillim, të mposhtë zemërimin, pastaj të pastrojë zemrën me faljen ndaj armikut dhe më pas të pastrojë zemrën e kundërshtarit nga çdo mbetje armiqësie duke i bërë mirë atij. Me të vërtetë, ky është përshkallëzim madhështor prej cilësisë së mirë humane deri te ajo më e larta, është grada më e lartë e përsosmërisë së ndërgjegjes dhe e shpirtit të njeriut.

Nga burimet e shi’iave dhe të sunive, në fundin e komentimit të këtij ajeti thuhet: “Një robëreshë e Ali ibn Husejnit

një ditë po i hidhte ujë atij për të marrë abdes. Papritur ibriku i ra nga dora dhe u ça. Ai e ngriti kokën dhe e pa. Ajo i tha: "Me të vërtetë, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"e mposhtin zemërimin."**" Ai iu përgjigj: "Unë e mposhta zemërimin tim." Ajo ia ktheu: **"dhe ua falim fajet njerëzve..."**

Ai i tha: "Unë të fala. All'Ilahu i Lartësuar të faltë." Ajo i tha: **"All'Ilahu i do bamirësit."** Ai tha: "Shko, ti je e lirë për hir të All'Ilahut."<sup>1</sup>

5- Me të vërtetë, ata nuk rrinë vazhdimisht duke bërë mëkate. **"Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë All'Ilahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre..."**

Fjala *fahishetu* rrjedh nga fjala *fahsh*, që do të thotë çdo gjë e keqe që vjen nga mëkatet, që nuk veçohet vetëm për imoralitetin (kurvërinë), sepse *fahsh* do të thotë *çdo gjë që e kalon kufirin dhe përfshin çdo mëkat*.

Ajeti në fjalë tregon për një prej cilësive të të devotshmëve. Në shtesë të përmendjes së cilësive pozitive, kur bëjnë ndonjë mëkat: **"...e kujtojnë All'Ilahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre-e kush i fal gjynahet përveç All'Ilahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë."**

Nga ky ajet kuptojmë se njeriu që përmend All'Ilahun nuk bën mëkat. Kur bën mëkat, prej harresës apo pavëmendshmërisë, nuk qëndron gjatë në këtë harresë, por menjëherë kujton All'Ilahun dhe mundohet me gjithë forcat ta përmirësojnë gjendjen e tij.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Durrul Menthur", tefsiri "Nurul Thekalejn"; "Mustedrekul Vesail", vëllimi 1, faqe 345.

Me të vërtetë, të devotshmit kanë ndjenja të thella dhe e dinë se nuk ka mbështetës tjetër përveç All'Ilahut të Lartësuar dhe kërkojnë prej Tij falje të mëkateve. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“e kush i fal gjynahet përveç Allahut?”**

Duhet të dimë se Kur'ani, në shtesë të përmendjes së *fahishetit* përmend edhe padrejtësinë ndaj vetes, duke thënë: **“...ose i bëjnë padrejtësi vetes...”**

Ka mundësi që dallimi mes këtyre dy frazave është se *el fahishetu* tregon për mëkatet e mëdha, kurse padrejtësia ndaj vetes tregon për mëkatet e vogla.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar, për ta forcuar këtë cilësi, thotë: **“dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë.”**

Nga imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) transmetohet: *“Ngulmimi është të bësh mëkat dhe të mos i kërkossh falje All'Ilahut pa falur vetveten e pa u penduar për veprat e bëra. Ky është ngulmimi, këmbëngulja.”*<sup>1</sup>

Në librin “Emali” i Sudukut transmetohet nga Imam Xhaferr ibn Muhamed Sadik: Kur ka zbritur ky ajet: **“Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë All'Ilahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre...”**, Iblisi hipi në malin e Theurit, në Mekë dhe thirri me zë të lartë ushtarët e tij. Të gjithë u tubuan dhe ata thanë: **“O padroni ynë pse na thirrë?”**

Ai tha: **“Është shpallur ky ajet dhe kush është për të? Një prej djajve i tha: “Unë jam për të dhe do të bëj kështu e kështu.”**

Iblisi tha: **“Ti nuk je për atë!”**

<sup>1</sup> Tefsir “Ajjashi”, fundi i ajetit në fjalë. “Vesailu Shijah”, vëllimi 10, faqe 338.

Më pas tha një tjetër gjë, njësoj si i pari. Ai tha: "Ti nuk je për atë?

Cytësi tha: "Unë jam për atë. Si do të veprosh?" Cytësi i tha: "Do t'i përgatis, do t'i lë të dëshirojnë deri sa të mëkatojnë. Kur të mëkatojnë do t'ua harroj pendesën dhe kërkimin e faljes." Iblisi i tha: "Ti je për këtë."

Pastaj ia dha të drejtën atij që të veprojë këtë gjë (cytjen dhe pëshpëritjen) deri Ditën e Gjykimit."<sup>1</sup>

Është shumë e qartë se harresa buron nga indiferenca e besimit dhe nga cytjet e shejtanit. Ai që ia dorëzon vetveten shejtanit, i është nënshtruar ndikimit të tij, bashkëpunon me cytësin dhe i përgjigjet atij.

Por besimtarët vigjilentë i gjen në shkallën më të lartë të mbikëqyrjes së vetes. Sa herë që shfaqet tek ata gabimi apo bëjnë gjynah, shumë shpejt e pastrojnë zemrën e tyre nga mbeturinat e gabimit apo të mëkatit dhe ua mbyllin dritaret e zemrave ushtarëve të shejtanit, të cilët, sado që të përpiqen për të depërtuar në zemrat e tyre, nuk arrijnë ta bëjnë.

Këto janë cilësitë më të dukshme dhe më madhështore të të devotshmëve në sjelljet dhe veprat e tyre, të cilat i përmendën ajetet e mësipërme.

Tani erdhi radha që Kur'ani i shenjtë të përmendë shpërblimin dhe mirësitë e merituar që i pret këtij grupi njerëzish. E këto janë prej All'Ilahut të Lartësuar, që thotë: **"pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë."**

---

<sup>1</sup> "Vesailu Shija", vëllimi 16, faqe 66-67.

Ky ajet tregon shpërblimin e të devotshmëve, cilësitë e të cilëve u shprehën në ajetet e mëparshme. Ky shpërblim shprehet me faljen e mëkateve nga ana e All'llahut dhe me dhurimin e Xhennetit, ku burojnë lumenj pa ndërprerje.

Në të vërtetë, së pari, këtu tregohet për dhuratat dhe dhuntitë shpirtërore: falja e mëkateve, pastrimi shpirtëror dhe përsosmëria e moralit dhe e ndjenjave të brendshme, pastaj për dhuntitë materiale.

Pas këtij shpërblimi, All'llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: **“Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë** (vepra të bukura)!” Sa i mrekullueshëm është shpërblimi që i jepet vepruesve dhe jo dembelëve, të cilët i largohen përgjegjësive të tyre dhe nuk zbatojnë detyrat që kanë.

## Ajetet 137 - 138

قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِكُمْ سُنَنٌ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ

الْمُكَذِّبِينَ ﴿١٣٧﴾ هَذَا بَيَانٌ لِلنَّاسِ وَهُدًى وَمَوْعِظَةٌ لِّلْمُتَّقِينَ ﴿١٣٨﴾

**“Para jush kanë kaluar shumë shembuj (popujsh nga ndjekësit e profetëve që iu ndodhi ajo që po ju ndodh edhe ju). Prandaj udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ishte fundi i atyre që i përgënjeshtuan.**

**Këto janë lajme të qarta dhe udhërrëfyese për të devotshmit.”**

## Komentimi

### Shikim në historinë e të shkuarve dhe në gjurmët e tyre

Kur’ani e konsideron lidhjen e së kaluarës me të tashmen dhe të tashmen me të kaluarën një çështje të domosdoshme dhe të nevojshme për të kuptuar të vërtetën dhe realitetin, sepse lidhja ndërmjet këtyre dy kohëve (së kaluarës dhe së tashmes) zbulon përgjegjësinë e brezave të ardhshëm dhe i bën të zgjidhin detyrat që i dalin para. Për këtë, All’llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: **“Para jush kanë kaluar shumë shembuj (popujsh nga ndjekësit e profetëve që iu ndodhi ajo që po ju ndodh edhe ju). Prandaj**

**udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ishte fundi i atyre që i përgënjeshtuan.”**

Kuptimi i kësaj është se All’llahu ka vendosur ligje për popujt që nuk janë të posaçëm për ata, por ato janë ligje dhe rregulla të përgjithshme të jetës, si për të shkuarit, ashtu edhe për ata që do të vijnë. Këto ligje dhe rregulla janë për të ecur përpara e për të mbijetuar. Janë vendosur për përparimin e besimtarëve të devotshëm, të njësuar në unitet, të zgjuar e të kuptueshëm. Ata që nuk i zbatojnë këto ligje dhe rregulla, i janë drejtuar zhytjes në mëkate, shkatërrimit dhe zhdukjes.

Sigurisht, historia ka një rëndësi të madhe për çdo popull, sepse ajo flet nëpërmjet ngjarjeve të ndodhura, duke reflektuar mbi veçoritë e moralit dhe të veprave, qofshin ato të mira apo të këqija, zbulon shkaqet e rënies së shoqërive apo zhvillimin e tyre, shpëtimin apo humbjen e tyre në epoka të ndryshme. Me një fjalë të vetme: Historia është pasqyra e jetës shpirtërore dhe materiale e shoqërive njerëzore. Ajo është udhëzuesi dhe paralajmëruesi më i mirë për brezat që vijnë.

Për këtë, Kur’ani Famëlartë i fton myslimanët që të udhëtojnë në tokë, të shohin me kujdes, të meditojmë dhe të nxjerrim mësim nga gjurmët e popujve të shkuar, që dikur kanë qenë të pushtetshëm, por që, fatkeqësisht, janë shuar. All’llahu i Lartësuar thotë: **“Prandaj udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ishte fundi i atyre që i përgënjeshtuan.”**

Me të vërtetë, gjurmët e brezave të shkuar janë mësimi më i mirë për brezat e ardhshëm. Me studimin dhe kuptimin e tyre, mundet që njerëzit të njohin rrugën e drejtë të jetës e të jetesës.

## Udhëtimi në tokë

Gjurmët e mbetura në vende të ndryshme të botës, nga popuj të ndryshëm nuk janë gjë tjetër veçse argumente të gjalla historike që flasin. Ato na tregojnë të vërteta dhe të fshehta më shumë se sa historia e shkruar.

Me të vërtetë, gjurmët e mbetura nga epokat e mëparshme dhe ajo çfarë tregohet në format, pamjet, të gdhendurat, na tregojnë se si popujt e mëparshëm kanë jetuar. Na tregojnë për kulturën, parimet, madhështinë e këtyre qytetërimeve, ndërkohë që historia e shkruar sqaron vetëm ndodhitë e ndodhura apo flet për rrethanat e ngjarjeve. Sigurisht, shkatërrimi i fortifikatave të diktatorëve dhe ruajtja e gjurmëve madhështore, si: piramidat e Egjiptit, Kulla e Babilonit, pallatet e Kisras dhe gjurmët e popullit Sebbe, apo gjurmë të tjera të përhapura në katër anët e Tokës, edhe pse nuk flasin, përmbajnë me mijëra e mijëra biseda me mijëra e mijëra fjalë.

Një poet i madh i përshkruan këto ngjarje dhe gjurmë me shumë emocion, duke nxjerrë mësim, të cilat i ka dhënë nëpërmjet prozave dhe poezive. Shkrimet e shkrimtarit kanë ndikuar në zemrat e njerëzve, duke zbërthyer mesazhin që ato transmetojnë.

Një prej letrarëve e ka përshkruar në prozë këtë realitet: *Me të vërtetë, gjurmët tona tregojnë për ne/ Prandaj, shikoni gjurmët pas nesh.*

Leximi i një rreshti të vetëm nga kjo histori e gjallë dhe folëse – në realitet – duket sikur lexon një libër të madh historik.

Përjetimi i kësaj fjalie në zemrat dhe mendjet e njerëzve nuk llogaritet me asnjë gjë, sado madhështore të jetë. Dhe kjo ndodh sepse, kur njeriu qëndron para gjurmëve të së kaluarës, e imagjnon sikur ato gjurmë u rikthyen në jetë dhe shpirti i gjallësisë hyn në to. I duket sikur eshtrat e bëra pluhur po dalin nga toka dhe çdo gjë i duket sikur është kthyer siç ka qenë në fillim. I duket sikur çdo gjë flet e bisedon. Pastaj, kur ua rikthen shikimin, i gjen ato të heshtura, të vdekura e të harruara.

Gjykimi i këtyre dy rasteve na paraqet ne injorancën e atyre që kanë kryer me mijëra krime, më të rëndat e më të turpshmet, për të arritur kënaqësitë e tyre kalimtare.

Për këtë, Kur’ani Famëlartë i nxit myslimanët që të udhëtojnë dhe të vërejnë me kujdes gjurmët e së kaluarës, të varrosura nën tokë apo të mbetura mbi sipërfaqen e saj. Për të gjitha këto duhet të marrin këshilla dhe mësim. Sigurisht, Islami e lejon turizmin, udhëtimin, madje i ka dhënë një rëndësi të madhe. Ai nuk dëshiron udhëtim si ai që dëshirojnë turistët dhe kërkuesit e dëshirave dhe të epsheve. Por dëshiron udhëtim për të studiuar gjurmët e popujve të kaluar dhe të meditojnë dhe të nxjerrin mësim prej tyre. Kjo është ajo që Kur’ani Famëlartë thotë në disa ajete dhe urdhëron për këtë, si:

1 - Sureja “En- Neml”, ajeti 69: **“Thuaj: “Udhëtoni nëpër botë e shikoni si ka qenë fundi i keqbërësve!”**

2 - Sureja "El-Haxh", ajeti 46: **"Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë...?"**

3 - Sureja "El-Ankebut", ajeti 20: **"Thuaj: "Udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni se si Ai e ka zënë fill krijimin..."** Dhe shumë ajete të tjera.<sup>1</sup>

Me të vërtetë, këto ajete tregojnë se udhëtimi nëpër tokë, shikimi i gjurmëve të së kaluarës, zgjeron njohuritë, ndriçon zemrat dhe e shpëton njeriun nga ngurtësia.

Këtë të vërtetë e ka treguar me fjalët e tij prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në disa thënie të tij: "Nxirrni mësim nga dënimi i All'Ilahut që i ka goditur popujt e pabindur para jush. Merrni mësim nga banesat dhe gladiatorët e ushtrisë së tyre. I Kërkoni falje All'Ilahut për mëkatet e mëdha, sikurse kërkoni falje për ngjarjet e ndryshme. Bëni kujdes në atë çfarë u është zbritur popujve para jush. Mendoni dhe reflektoni nga veprat e turpshme që ata kanë vepruar dhe përkujtoni ata në të gjitha rastet, të mira apo të këqija. Kini kujdes, që të mos jini sikurse ata dhe, nëse i përkujtoni ata, në raste të ndryshme, zbatoni çdo urdhër që kanë zbatuar të fortit, që, me madhështinë e tyre, dëbuan armiqtë dhe falja i kaploi. Si rrjedhim, mbi ta do të zbresë mirësia dhe mrekullia hyjnore. Përçarja do të largohet dhe vëllazërimi do të jetë më i fortë se kurrë."<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Lexo: Sure "Jusuf", ajeti, 109, sure "Rrum", ajeti 9 dhe 42, sure "Fatir", ajeti 44, sure "Gafir", ajeti 21 dhe 82, sure "Muhamed", ajeti 10, sure "En'am", ajeti 11 dhe sure "Nahl", ajeti 36.

<sup>2</sup> "Nehxhul Belaga", fjala 192.

Fatkeqësisht, mësimi i Islamit është harruar, si disa mësimet e tjera islame të cilëve myslimanët nuk i kushtojnë shumë rëndësi. Ka disa dijetarë dhe ideologë islamë, të cilët kohën dhe vendin e kanë kufizuar në mendjet e tyre dhe kanë jetuar apo jetojnë në një botë tjetër nga kjo që ne jetojmë. Ata janë larg ndryshimeve shoqërore, duke e punësuar veten e tyre me çështje të pjesshme dhe të padobishme, duke lënë mënjanë çështjet thelbësore e të dobishme.

Në botë gjejmë shumë priftërinj dhe murgj të krishterë apo të feve të tjera, të cilët, edhe pse kanë qëndruar të vetmuar, në heshtjen e mureve të manastireve, kur kanë dalë nga ato mure, janë munduar të vendosin ura lidhëse me popujt, duke marrë përvojën e tyre.

A nuk është mirë që myslimanët të zbatojnë këtë mësim të qartë të Islamit dhe të dalin nga mendimi i ngushtë dhe i ngurtë në të cilin janë, derisa të ndryshojnë jetën e popullit islam, të lejojnë lulëzimin në vend të prapambetjes, të ecin drejt përparimit në vend që të qëndrojnë në vend?

Këto mësimet hyjnore u drejtohen të gjithëve, janë dobiprurëse për të gjithë. Ato nuk frymëzojnë vetëm të devotshmit. All'llahu i Lartësuar e mbyll ajetin e mëposhtëm duke thënë: **“Këto janë lajme të qarta dhe udhërrëfyese për të devotshmit.”**

Vërtet, të devotshmit janë ata që këshillohen me këto çështje, sepse ata kërkojnë për çdo gjë që ua forcon shpirtin e devotshmërisë dhe ua shton dijen për të vërtetën dhe të drejtën.

## Ajetet 139-143

وَلَا تَهِنُوا وَلَا تَحْزَنُوا وَأَنْتُمْ الْأَعْلَوْنَ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿١٣٩﴾ إِنْ يَمَسُّكُمْ  
 قَرْحٌ فَقَدْ مَسَّ الْقَوْمَ قَرْحٌ مِّثْلُهُ ۚ وَتِلْكَ الْأَيَّامُ نُدَاوِلُهَا بَيْنَ النَّاسِ وَلِيَعْلَمَ اللَّهُ  
 الَّذِينَ ءَامَنُوا وَيَتَّخِذَ مِنْكُمْ شُهَدَاءَ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ ﴿١٤٠﴾  
 وَلِيُمَحِّصَ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَيَمْحَقَ الْكَافِرِينَ ﴿١٤١﴾ أَمْ حَسِبْتُمْ أَنْ تَدْخُلُوا  
 الْجَنَّةَ وَلَمَّا يَعْلَمِ اللَّهُ الَّذِينَ جَاهَدُوا مِنْكُمْ وَيَعْلَمَ الصَّابِرِينَ ﴿١٤٢﴾ وَلَقَدْ كُنْتُمْ  
 تَمَنُّونَ الْمَوْتَ مِنْ قَبْلِ أَنْ تُلْقَوْهُ فَقَدْ رَأَيْتُمُوهُ وَأَنْتُمْ تَنْظُرُونَ ﴿١٤٣﴾

“Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi, jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.

Nëse ju ka goditur ndonjë plagë, edhe popullin (armik) e kanë goditur të tilla plagë. Ato ditë (fitoreje dhe humbjeje) Ne i ndërrojmë midis njerëzve, që All’llahu t’i dallojë besimtarët dhe për t’i bërë disa nga ju dëshmorë. All’llahu nuk i do keqbërësit.

E kështu, All’llahu i dëlir besimtarët e i shuan jobesimtarët.

A mendoni se do të hyni në Xhennet, pa i provuar All’llahu ata që kanë luftuar prej jush dhe pa i provuar ata që kanë duruar?

Ju e dëshironit vdekjen para se të ballafaqoheshit me të dhe ja pra, ju e patë atë me sytë tuaj.”

## Shkaku i zbritjes

Kanë ardhur transmetime të ndryshme për shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve. Nga këto transmetime kuptojmë se këto ajete janë vazhduese të ajeteve që flasin për Luftën e Uhudit.

Në të vërtetë, këto ajete konsiderohen si analizë dhe studim për rezultatet e Luftës së Uhudit. Në të njëjtën kohë, kjo betejë është ngushëllim për besimtarët, forcuese e zemrave dhe e shpirtrave të tyre. Sepse, siç e kemi thënë, për shkak të indiferencës së urdhrave të Profetit, nga disa harkëtarë, kjo betejë përfundoi me humbje. Në atë betejë ranë dëshmorë shumë persona dhe heronj prej myslimanëve. Ndër ta ishte edhe Hamzai, xhaxhai i Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Atë natë profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me një grup shokësh, shkoi tek të vrarët e nderuar. Ai u ul e qëndroi te çdo dëshmor, në shenjë respekti dhe nderimi, duke qarë dhe duke kërkuar falje për ta. Pastaj, në një atmosferë të mbushur me hidhërim e shqetësim, të gjithë dëshmorët u varrosën në Uhud. Në atë kohë myslimanët kishin nevojë për diçka që t'ia largonte dhembjen dhe hidhërimin, t'ia forconte zemrën dhe t'u jepte mësim. Për këtë zbritën ajetet e përmendura.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", fundi i ajeteve në fjalë. "Biharul Envar", vëllimi 20, faqe 22, 42, 65.

## Komentimi

### Studimi i rezultateve të Luftës së Uhudit

Në ajetin e parë prej ajeteve në fjalë, Kur'ani i paralajmëron myslimanët prej goditjes nga pikëllimi e prej dobësisë, për shkak të humbjes së një beteje të vetme, ta mposhtin hidhërimin dhe të qëndrojnë të fortë. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi, jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë."**

Sigurisht, nuk është e pëlqyeshme për myslimanët të ndiejnë plogështi e dobësim ose t'i kaplojë pikëllimi për ato që ndodhën. Njerëz të zgjuar janë ata që nxjerrin mësim nga humbja, sikurse përfitojnë nga fitoret. Njihen me pikat e dobëta të qenies së tyre apo me planet që bënë, duke e studiuar gabimin dhe humbjen që të rrënjët. Pastaj, përpiqen t'i zhdukin ato gabime dhe t'i plotësojnë boshllëqet, me qëllim që të triumfojnë, të mos bien pre e pikëllimit, që përmend edhe ajeti në fjalë, pasi pikëllimi çon në dobësim të trupit e të shpirtit. Gjithashtu, pikëllimi godet vullnetin dhe besimin.

Nëse shihet me vëmendje shprehja kur'anore: **"... sepse ju, gjithsesi, jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë"**, do të shohim se ajo është e pasur me kuptime. Ajo do të thotë se humbja e luftës ka ardhur për shkak të mospranisë së shpirtit të besimit të ju. Sikur ju të mos i shkelnit urdhrat e All'llahut, nuk do t'ju godiste ajo që ju goditi. Por, edhe pse ndodhi ajo që ndodhi, ju mos u pikëlloni.

Nëse ju qëndroni në rrugën e besimit, fitorja përfundimtare do të jetë e juaja. Humbja e një lufte të vetme nuk do të thotë humbje përfundimtare.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **“Nëse ju ka goditur ndonjë plagë, edhe popullin (armik) e kanë goditur të tilla plagë.”** Me këtë, All'llahu i Lartësuar u jep myslimanëve një mësim tjetër, për të arritur tek fitorja përfundimtare.

*Fjala karh do të thotë plagë që godet trupin për shkak të përplasjes me një diçka të jashtme.*

Kuptimi i ajetit është se vendosmëria juaj nuk duhet të jetë më e paktë se vendosmëria e armikut. Edhe pse u goditën rëndë dhe humbën shumë shpirtra e pasuri, në Betejën e Bedrit, në të cilën u vranë 70 persona prej tyre dhe shumë të tjerë u plagosën dhe u zunë rob, nuk qëndruan duarkryq. U organizuan dhe forcuan radhët ushtarake për t'ju luftuar me më shumë vendosmëri dhe forcë. Ata e kuptuan humbjen dhe panë brenda vetes së tyre, duke e kthyer humbjen në forcë. Nëse në Betejën e Uhudit u goditët me humbje të madhe, ju nuk duhet të qëndroni duarkryq, por të organizoheni dhe të mësoni prej asaj që ju ndodhi. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Nëse ju ka goditur ndonjë plagë, edhe popullin (armik) e kanë goditur të tilla plagë.”** Atëherë, përse gjithë ky pikëllim e ky dobësim?

Disa komentues të Kur'anit mendojnë se ky ajet bën fjalë për plagët që morën jobesimtarët në Betejën e Uhudit. Por ky mendim nuk është i saktë, sepse së pari, plagët me të cilat u goditën jobesimtarët në Uhud nuk kanë qenë si plagët që u goditën myslimanët.

Së dyti, ky mendim nuk përshtatet me fjalinë pasuese, komentimi i së cilës do të vijë më poshtë, që është thënia e All'llahut të Lartësuar: **"Ato ditë (fitoreje dhe humbjeje) Ne i ndërrojmë midis njerëzve, që All'llahu t'i dallojë besimtarët dhe për t'i bërë disa nga ju dëshmorë."**

Në këtë pjesë, All'llahu i Lartësuar tregon një nga ligjet hyjnore, që në historinë e jetës njerëzore ndodhin ngjarje të gëzuara dhe të hidhura, fitore dhe humbje, por janë të paqëndrueshme. Fitorja, humbja, triumfi dhe mposhtja ndryshojnë dhe shndërrohen. Për këtë, askush nuk mund të imagjinojë se humbja e një beteje të vetme dhe pasojat që vijnë pas saj do të jenë të përhershme. Por duhet të përfitohet prej ligjit të ndryshimit. Kjo bëhet duke analizuar shkaqet e humbjes dhe duke shndërruar humbjen në fitore. Jeta ka ngritje dhe zbritje, ku ngjarjet dhe rrethanat ndryshojnë vazhdimisht. Për këtë All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ato ditë<sup>1</sup> (fitoreje dhe humbjeje) Ne i ndërrojmë midis njerëzve..."**, me qëllim që nëpërmjet ndryshimit, të sqarohet ligji i përsosmërisë.

Pastaj All'llahu i Lartësuar tregon rezultatin e këtyre ngjarjeve të dhimbshme: **"...që All'llahu t'i dallojë besimtarët."** Pra, sigurisht që kjo është për të dalluar besimtarët e vërtetë nga pretenduesit e besimit. Me fjalë të tjera: Nëse nuk ndodhin ngjarje të dhimbshme në jetën e një populli ose të popujve dhe në historitë e tyre, nuk do të dalloheshin rreshtat, nuk do të dallohej e mira nga e keqja, sepse vetëm fitoret të mashtrojnë dhe

---

<sup>1</sup> Fjala *el ejjam* është shumësi i fjalës *jeumun*. I thuhet kështu edhe kohës prej lindjes së diellit e deri në perëndim. Ka raste që përdoret edhe për periudhat e mëdha triumfuese në jetën e popujve. Fjala *nudauiluha* vjen prej *el mudaueletu*, që do të thotë: Kur ndodh diçka prej disa popujsh te disa të tjerë.

triumfuesit i godet pavëmendshmëria. Ndërkohë që humbja përbën faktorin e zgjimit për të aftët dhe të gatshmit. Me anë të saj shfaqen vlerat dhe njihen njerëzit e vërtetë.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **"... për t'i bërë disa nga ju dëshmorë"**, që tregon një nga rezultatet e kësaj humbjeje të dhimbshme, rënia dëshmor e disa myslimanëve në këtë betejë. Duhet të mësoni se kjo fe nuk ka ardhur tek ju me lehtësi dhe nuk do të shuhet në të ardhmen.

Me të vërtetë, populli që nuk sakrifikon në rrugën e qëllimeve e tij të shenjtë, nuk i kushton rëndësi atyre qëllimeve dhe as nuk i vlerëson ashtu siç duhet. Ndërsa, nëse sakrifikon në rrugën e qëllimeve të saj, do të thotë se ia di vlerën dhe rëndësinë dhe i sheh ato qëllime me syrin e respektit dhe të madhështisë.

Mundet që kuptimi i fjalës *shuheda* në këtë ajet të jetë për ata që dëshmojnë. Atëherë, kuptimi i thënies së All'llahut **"dhe për t'i bërë disa nga ju dëshmorë"**, është që ju të jeni dëshmues të ndodhisë së kësaj betejë, që të mësoni se si moszbatimi i urdhrave çon në humbje dhe përfundon me thyerje lënduese.

Vërtet, këta dëshmues u mësojnë brezave të ardhshëm mësimet e triumfit dhe të humbjes, me qëllim që të mos i përsërisin gabimet që bënë dhe të përfundojnë siç përfunduan ata.

Në fund All'llahu e mbyll paraqitjen e ligjeve dhe të mësimëve, në këtë ajet me fjalën e Tij: **"All'llahu nuk i do keqbërësit."** All'llahu nuk i ndihmon dhe nuk i mbron keqbërësit.

Ata nuk mund të triumfojnë ndaj besimtarëve të drejtë, që zbatojnë mësimet qiellore dhe ndjekin ligjet e All'llahut në jetën e tyre.

## Ngjarjet e hidhura edukojnë

Sigurisht, Beteja e Uhudit, ajo që i goditi myslimanët dhe rezultatet e saj, zbuluan pikat e dobëta të shoqërisë dhe boshllëqet që ekzistonin në strukturën e saj. Këto ndodhi janë faktor për pastrimin e të metave dhe për plotësimin e boshllëqeve. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"E kështu, All'llahu i dëlir<sup>1</sup> besimtarët e i shuan jobesimtarët"**, që do të thotë se All'llahu i Lartësuar, me anë të kësaj ngjarjeje, ka dëshiruar të dëlirë besimtarët dhe t'u tregojë atyre pikat e dobëta. Atëherë, për të arritur fitoren në të ardhmen, duhet të sprovohen dhe të përgatisin veten.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Në ndryshimin e ngjarjeve njihet përsosmëria e njerëzve."*<sup>2</sup>

Disa humbje e mposhtje ndikojnë më shumë në mbrojtjen dhe edukimin e shoqërisë njerëzore se sa triumfi i arritur.

Vlen të tregohet se autori i tefsirit "El-Menar" transmeton nga profesori i tij, Myftiu i Egjiptit, dijetari Muhamed Abduh, se e ka parë në ëndërr të Dërguarin e All'llahut natën e së enjtes (në fillim të Dhil-hixhes të vitit 1320 sipas hixhretit) që, gjatë largimit të tij nga Uhudi, po u thoshte shokëve:

---

<sup>1</sup> Në original fjala *et temhis* me *sad* ka kuptimin e pastrimit të diçkaje nga të metat.

<sup>2</sup> "Nehxhul Belaga", Fjalët e urta, fjala 217.

“Nëse me lejohet të zgjedh mes humbjes dhe fitores (në Luftën e Uhudit), do të zgjidhja humbjen.”<sup>1</sup>

Kjo për shkak të edukimit të madh hyjnor që ka humbja për myslimanët, me qëllim që ata të jenë të përgatitur e të vëmendshëm dhe të mos mashtrohen.

Rezultati i këtij edukimi, sprovat dhe goditjet e ngjarjeve të njëpasnjëshme janë për të fituar fuqinë e mjaftueshme, për të shkatërruar plotësisht idhujtarinë. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: “... e i shuan jobesimtarët.”

Me të vërtetë, besimtarët, pasi u pastruan nga kjo e metë, arritën fuqinë e plotë që ta zhduknin idhujtarinë dhe të pastronin shoqërinë e tyre nga këto mbeturina. E gjithë kjo do të thotë, si fillim, pastrimi i vetvetes dhe më pas pastrimi i të tjerëve.

Në të vërtetë, pastrimi i shpirtit të besimtarit dhe i shoqërisë mund të krahasohet me ndriçimin e hënës, drita e së cilës humbet pak nga pak kur lind dielli dhe zbardh dita. Drita e saj kthehet vetëm kur largohet dielli dhe vjen errësira. Kështu shuhet edhe drita e idhujtarisë dhe dobësohet forca e jobesimtarëve, sa më shumë u shtohet pastërtia e dëlirësia besimtarëve myslimanë, duke larguar pikat e dobëta dhe pengesat.

Ka një lidhje ndërmjet dëlirësisë dhe ngritjes së besimtarëve në shkallët dhe gradat e pastërtisë, të devotshmërisë dhe të shuarjes së idhujtarisë. Kjo është një e vërtetë e madhe dhe e përrjetshme, të cilën e ka përkufizuar Kur’ani në këto dy fjali, e para, përbën hyrjen dhe e dyta, rezultatin.

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Menar”, vëll. 4, f. 46, fundi i ajetit në fjalë.

Pastaj Kur'ani Famëlartë na jep një mësim nga Beteja e Uhudit, për të korrigjuar mendimin e gabuar që mund të kenë myslimanët: **"A mendoni se do të hyni në Xhennet, pa i provuar All'Ilahu ata që kanë luftuar prej jush dhe pa i provuar ata që kanë duruar?"**

A mendoni se do të arrini gradën e lumturisë shpirtërore vetëm se zgjodhët emrin mysliman apo vetëm se mbartët besimin islam në mendje, pa i zbatuar mësimet e tij? Po të ishte çështja kështu, kjo gjë do të ishte shumë e lehtë. Sigurisht që nuk është kështu. Nëse nuk zbaton mësimet që mbart besimi në jetën e përditshme, askush nuk arrin lumturinë e madhe.

Pikërisht këtu duhet të dallohen dhe të njihen sakrifikuesit durimtarë nga të tjerët.

### **Hamendësime të kota**

Pas Luftës së Bedrit, në të cilën një grup heronjsh prej besimtarëve myslimanë ranë dëshmorë, disa myslimanë në çdo tubim dhe bisedë që bënin, dëshironin të kishin rënë dëshmorë, njëlloj si miqtë e tyre. Ata thoshin: "A sikur të binim dëshmorë në Betejën e Bedrit!"

Është e natyrshme që disa prej atyre njerëzve të ishin të singertë në qëllim dhe disa të tjerë të ishin gënjeshtarë, duke shfaqur këtë qëllim dhe fshihnin diçka tjetër. Por kjo gjendje nuk zgjati shumë. Shumë shpejt ndodhi beteja e frikshme dhe e dhimbshme e Uhudit. Në të muxhahidunët e vërtetë luftuan me mish e shpirt deri sa realizuan dëshirat e tyre. Por ata, që shtireshin si të vërtetë, kur panë shenjat e humbjes që goditi

myslimanët, u larguan të frikësuar dhe mendonin vetëm për veten e tyre. E lanë fushën e betejës në dorë të armikut të egër.

Prandaj zbriti ajeti, që qorton dhe i kritikon: **“Ju e dëshironit vdekjen para se të ballafaqoheshit me të dhe ja pra, ju e patë atë me sytë tuaj.”**

Atëherë, përse ju dezertuat dhe u larguat nga ajo që e dëshironit prej kohësh? Si largohet njeriu nga ajo që e dëshiron aq shumë, ndërkohë që e sheh atë?

### **Studim i shpejtë për shkaqet e humbjes në Uhud**

Nga ajetet e mëparshme pamë fraza ku secila zbulonte maskën e një prej sekreteve të humbjes në Betejën e Uhudit. Këtu po tregojmë faktorët më të dukshëm e më të rëndësishëm që çuan në këtë humbje, ku u nxorën shumë mësimë në të njëjtën kohë.

**1-** Gabimi në llogaritje të disa myslimanë të rinj sipas mësimëve islame. Ata mendonin se vetëm shfaqja e besimit ishte e mjaftueshme për arritjen e fitores. Dhe se All’llahu i Lartësuar do të zbriste ndihmën e Tij nga lart dhe do t’i ndihmonte me forcën e fshehtë në të gjitha fushat. Prandaj ata i harruan dhe i neglizhuan ligjet hyjnore rreth shkaqeve të natyrshme të fitores, si: Planifikimi i drejtë, përgatitja e forcave të duhura dhe strategjia e betejës.

**2-** Moszbatimi i urdhrave ushtarake, kundërshtimi dhe thyerja e urdhrave të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nga ana e harkëtarëve që të qëndronin në grykën e malit dhe t’u mbronin myslimanëve krahët. Ky ka qenë faktori i vërtetë i humbjes së betejës.

**3-** Dashuria për këtë botë dhe shqetësimi ndaj plaçkave të luftës i shtyu disa myslimanë të rinj në Islam të linin armët dhe të largoheshin nga pozicionet e tyre. Mos gjurmimi i armikut, hedhja e armëve, me qëllim që të mos vonoheshin për të mbledhur plaçka lufte, ishte faktori i tretë i humbjes së madhe, e cila u mësoi se në luftën në rrugën e All'llahut duhet të harrohen të gjitha këto çështje dhe të mendohet për qëllimin më madhor.

**4-** Vetëpëlqimi i lindur nga fitorja e lavdishme në Luftën e Bedrit, bëri që disa myslimanë të harronin forcën e armikut, duke përçmuar përgatitjen për luftë dhe duke e nënvlerësuar atë.

Këto ishin disa pika të dobëta të Betejës së Uhudit, të cilat duhet të treten në ujin e kësaj humbjeje të dhimbshme dhe të avullojnë.

## Ajetet 144- 145

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ أَفَإِنْ مَاتَ أَوْ قُتِلَ انْقَلَبْتُمْ عَلَى أَعْقَابِكُمْ وَمَنْ يَنْقَلِبْ عَلَى عَقْبَيْهِ فَلَنْ يَضُرَّ اللَّهَ شَيْئًا وَسَيَجْزِي اللَّهُ الشَّاكِرِينَ ﴿١٤٤﴾ وَمَا كَانَ لِنَفْسٍ أَنْ تَمُوتَ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ كِتَابًا مُؤَجَّلًا وَمَنْ يُرِدْ ثَوَابَ الدُّنْيَا نُؤْتِهِ مِنْهَا وَمَنْ يُرِدْ ثَوَابَ الْآخِرَةِ نُؤْتِهِ مِنْهَا وَسَنَجْزِي الشَّاكِرِينَ ﴿١٤٥﴾

“Muhammedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi All’llahut. Dhe All’llahu do t’i shpërblejë falënderuesit.

Çdo shpirt vdes vetëm me vendimin e All’llahut, në kohë të caktuar. Kush dëshiron mirësitë e kësaj bote, Ne do t’i japim atij prej saj, ndërsa kush dëshiron shpërblimin e Botës Tjetër, Ne do t’i japim atij prej saj. Ne do t’i shpërblejmë mirënjohësit.”

## Shkakut e zbritjes

Ajeti i parë i këtyre dy ajeteve, gjithashtu, paraqet një ngjarje tjetër nga ndodhitë e Luftës së Uhudit, thirrjen e papritur në mes të betejës nga myslimanët dhe politeistët se profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u vra.

Kjo thirrje ishte në të njëjtën kohë kur Amru ibn Kum'eteh el Harithij e goditi me gur Profetin, duke i shkaktuar thyerje dhe plagë në fytyrë. Fytyra iu mbulua me gjak.<sup>1</sup> Në këto momente armiku dëshironte ekzekutimin e të Dërguarit të All'llahut. Por Mus'ab ibn Umejr, i cili mbante flamurin e ushtrisë islame, u vra duke mbrojtur me trupin e vet Profetin. Armiku kujtoi se u vra Profeti, prandaj thirri se Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u vra.

Përhapja e këtij lajmi pati një ndikim sa pozitiv në anën shpirtërore të idhujtarëve, aq edhe negativ në zemrat dhe shpirtrat e myslimanëve, pasi një grup i madh myslimanësh u trondit dhe la fushën e betejës. Të tjerët menduan se me vrasjen e Profetit, të braktisin Islamin dhe të kërkonin siguri nga paria e idhujtarëve. Ndërsa, një pakicë prej myslimanëve, si imam Aliu, Ebu Dexhaneh, Talha e të tjerë, vendosën t'i bëjnë rezistencë armikut dhe u bënë thirrje njerëzve për qëndresë.

Tek grupi që mendoi të largohej nga fusha e betejës erdhi Enes ibn Nedhir dhe u tha: *"O popull, nëse Muhammedi është vrarë,*

---

<sup>1</sup> Në disa libra të historisë thuhet se këto plagë Profeti i mori kur disa persona prej armiqve e sulmuan atë. (Për sqarime shih: "Biharul Anuar"; vëll. 20, f. 27. "Tarihu Tabarij", vëll. 2, f. 201.)

*Zoti i Muhammedit nuk është vrarë. Luftoni në atë çfarë ka luftuar i Dërguari i All'llahut dhe vdisni për atë që ka vdekur ai."* Pastaj shtrëngoi armën e tij dhe luftoi ndaj jobesimtarëve derisa u vra. Nuk kaloi shumë kohë dhe u kuptua se i Dërguari i All'llahut është gjallë. Po ashtu u qartësua gabimi dhe përgënjeshtrimi i atij lajmi. Prandaj, zbriti ajeti i parë, që i qorton ashpër ata që menduan të braktisin Islamin.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", "Biharul Envar", vëllimi 20, faqe 59.

## Komentimi

### Nuk ka adhurim dhe mbivlerësim të individit

Ajeti i parë prej këtyre dy ajeteve, bazuar në ndodhitë e Betejës së Uhudit, u mëson myslimanëve një të vërtetë tjetër: **"Muhammedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa?"** Kjo e vërtetë është se Islami nuk është fe e adhurimit të personit. Nuk duhet të mendohet se, sikur Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të binte dëshmor në këtë betejë, mbaronte çdo gjë dhe shkarkohej pesha e luftës nga shpatullat e myslimanëve.

Por kjo detyrë është e vazhdueshme, pasi Islami nuk përfundon me vdekjen e Profetit apo me vrasjen e tij. Islami është feja e vërtetë, që ka ardhur për të qëndruar përgjithmonë deri në Ditën e Gjykimit. Me të vërtetë, adhurimi i personit dhe mbivlerësimi i tij është gjëja më e rrezikshme që mund të godasë çdo betejë ushtarake, duke shkaktuar humbjen e saj.

Me të vërtetë, lidhja e betejës ushtarake apo e fesë me një person të caktuar, edhe sikur ky person të jetë Profeti i fundit, do të thotë ndalim i çdo aktiviteti e përparimi. Kjo lloj lidhjeje është një nga shenjat e mangësisë së zhvillimit shoqëror.

Me të vërtetë, përqendrimi dhe vendosmëria e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të luftuar shenjtërimin dhe adhurimin e individit është një argument tjetër prej argumenteve të vërtetësisë dhe të sinqeritetit të tij. Sepse, sikur përpjekjet dhe thirrja të ishin për veten e tij, me qëllim që të realizonte interesat e tij personale, do të duhej që ta

rrënjoste në zemrat dhe në mendjen e masës këtë mendim. Do t'u thoshte njerëzve që të drejtohen vetëm kah ai dhe se të gjitha gjërat e kësaj feje janë të lidhura me personalitetin e tij, e nëse ai mungon ose do të ikte, do të mbaronte çdo gjë.

Por udhëheqësit e vërtetë e të sinqertë, si Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e bëjnë kurrë këtë veprim dhe as nuk nxisin në këto mendime. Përkundrazi, ata i luftojnë me të gjitha fuqitë dhe thonë se qëllimet tona janë më të larta se personaliteti ynë dhe se ato nuk mbarojnë me vdekjen apo mungesën tonë. Prandaj, për këtë Kur'ani Famëllartë thotë: **“Muhammedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa?”** Me këtë thënie, Kur'ani mohon mendimet që mund të kenë disa, se çdo gjë në këtë fe mbaron me mungesën e profetit udhërrëfyes.

Është e rëndësishme të theksojmë se në këtë ajet, Kur'ani përdor shprehjen për t'u kthyer në injorancë: **“... a mos do të ktheheni ju prapa?”**

Fjala *akabe* rrjedh nga shumësi i fjalës *akab*, që do të thotë *thembra e këmbës*. Kjo shprehje nënkupton kthimin prapa dhe renegatin e vërtetë. Kjo thënie është më domethënëse se sa fjala *redetun, ruxhuun* dhe *audetun*, të cilat kanë kuptimin e kthimit.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **“Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi All'llahut”**, që do të thotë se kthimi pas në mosbesim dhe adhurimi i idhujve ju bën dëm vetëm juve e jo All'llahut të Lartësuar. Kthimi prapa i kësaj rruge do të ishte vetëm ndalimi juaj nga rruga e mirësisë, e lumturisë. Ju shumë shpejt do të humbnit krenarinë dhe respektin e fituar.

Vetëm një numër i paktë luftëtarësh e vazhduan Luftën e Uhudit, pasi morën vesh lajmin e vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Është më se e natyrshme që kjo pakicë të arrijë krenarinë dhe shpërblimin nga All'llahu i Lartësuar: **"Dhe All'llahu do t'i shpërblejë falënderuesit."** Kjo është arsyeja se pse Kur'ani Famëlartë vlerëson qëndrimin e tyre, duke i lartësuar dhe duke i cilësuar ata falënderues, sepse ata kanë përfituar nga mirësitë në rrugën e All'llahut. Ky është singjeriteti më i madh i falënderimit.

Mësimi që na paraqet ky ajet, në luftën kundër adhurimit të personit dhe mbivlerësimit të individit, është më i madhi dhe më i përkryeri për të gjithë myslimanët në të gjitha kohët. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të mësojnë nga Kur'ani, që të mos i lidhin çështjet strategjike dhe jetësore me një individ të caktuar, por të përqendrohen e të bashkohen rreth bazave dhe parimeve të përhershme, të cilat nuk shuhet dhe nuk ndryshojnë me ndryshimin e personave apo me mungesën e tyre në betejë, për shkak të vrasjes apo të vdekjes, edhe sikur ky person të jetë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Me të vërtetë, kjo është shenjë e përhershme në çdo parim ose bazë e lëvizjes.

Duke u bazuar në këto që thamë, nëse të gjitha planprogramet do të ishin të lidhura me individë të veçantë, këto planprograme nuk do të ishin të sakta e të drejta, por do të shkatërroheshin në çdo moment.

Është për të ardhur keq se shumica e planprogrameve islame janë nga ky lloj. Sigurisht që ato janë të ngritura mbi personalitetin dhe individualizmin, prandaj shuhet shpejt me

mungesën e personit. Me të vërtetë, është detyrë e myslimanëve që të marrin mësim nga ky ajet dhe të ngrenë institucionet e tyre, duke përfituar nga dhuntitë e personave, por pa e lidhur të ardhmen e institucioneve me të ardhmen e personit, me qëllim që të mos shuhen me mungesën e tyre.

Siç thamë më lart, një grup i madh i myslimanëve u frikësuan dhe u shokuan me përhapjen e lajmit të vrasjes së Profetit në Betejën e Uhudit deri në atë gradë sa e lanë fushën e betejës dhe u larguan nga frika se mos vriten. Disa prej tyre menduan që të heqin dorë nga Islami. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Çdo shpirt vdes vetëm me vendimin e All'llahut, në kohë të caktuar.”** All'llahu i Lartësuar e përsërit qortimin ndaj tyre dhe u heq vërejtje se vdekja është në dorën e All'llahut dhe vendimi i takon vetëm Atij.

Nuk ka dobi largimi nga caktimi i All'llahut. E nëse është e vërtetë që Profeti u vra në fushën e betejës dhe ka rënë dëshmor, kjo nuk është veçse realizimi i ligjit të All'llahut. Përse u frikësuan myslimanët dhe e ndaluan luftën?

Nga ana tjetër, dezertimi dhe largimi nga lufta nuk e shtyn afatin e vdekjes. Edhe sikur beteja të vazhdonte, exheli nuk e ofron caktimin e vdekjes. Dezertimi nga fushëbeteja, ruajtja e vetvetes është një mashtrim që nuk ka dobi.

Ka një hulumtim rreth kuptimit të exhelit (caktimit të vdekjes) dhe ai është i patjetërsueshëm dhe i varur. Ndryshimin ndërmjet këtyre dy llojeve do ta shpjegojmë në komentimin e ajetit të dytë të sures “El-Enam”.

Pas paraqitjes së këtyre realiteteve, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Kush dëshiron mirësitë e kësaj bote, Ne do t'i japim atij prej saj, ndërsa kush dëshiron shpërblimin e Botës Tjetër, Ne do t'i japim atij prej saj"**, që do të thotë se çfarë punon njeriu, asnjëherë nuk humbet. Nëse qëllimi i tij ka qenë bota materiale, sikurse ka qenë qëllimi i disa luftëtarëve në Betejën e Uhudit, ai do të marrë atë që ka garuar dhe ka kërkuar.

Ndërsa, nëse qëllimi i tij është më i madh se ky, ai do të bëjë gjithçka për të arritur botën e përhershme, duke nxjerrë në pah mirësitë njerëzore. Në këtë mënyrë ai arrin qëllimin e tij dhe i jepet shpërblim në Botën Tjetër. Ky shpërblim është më i madh se çdo rezultat. Vetvetiu lind një pyetje: Atëherë përse nuk i derdh njeriu mundësitë e tij, duke shfrytëzuar mundësitë shpirtërore e materiale që i janë dhënë në rrugën e dytë, pasi ajo është rruga më e vlefshme dhe e përjetshme?

Për të përforcuar këtë realitet, All'llahu i Lartësuar thotë për herë të dytë: **"Ne do t'i shpërblejmë mirënjohësit."**

Është e vlefshme të meditojnë rreth foljes: **"do t'i shpërblejë."** Kjo folje është në vetën e tretë njëjës dhe sqaron premtimin e All'llahut në shpërblimin e tyre.

Në tefsirin "Mexhmaul Bejjan", në fundin e këtij ajeti, përmendet një thënie nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*): "Aliu është goditur dhe është plagosur me gjashtëdhjetë e një plagë në Betejën e Uhudit. Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi Ummu Selimin dhe Ummu Atijen që ta mjekonin. Ato të dyja thanë se, kur mjekonin një plagë, shpërthente plaga tjetër dhe se kishin frikë për të. Profeti hyri bashkë me shokët e tij që ta vizitonte. Me dorën e tij

preku një plagë dhe tha: *“Me të vërtetë, njeriu e ka marrë këtë në rrugë të All’llahut. Ai u provua dhe u fal (a’dhere).”*

Plaga që i Dërguari i All’llahut e fshinte mbyllej. Imam Aliu tha: *“Falënderimi i takon All’llahut që unë nuk u largova (nga lufta) dhe nuk u ktheva prapa.”* All’llahu e lavdëroi atë në dy vende të Kur’anit Famëlartë: **“Dhe All’llahu do t’i shpërblejë falënderuesit.”** dhe **“Ne do t’i shpërblejmë mirënjohësit.”**<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 4, f. 67.

## Ajetet 146 - 148

وَكَايْنٍ مِّنْ نَّبِيِّ قَتَلَ مَعَهُ رَبِّيُونَ كَثِيرٌ فَمَا وَهَنُوا لِمَا أَصَابَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ  
وَمَا ضَعُفُوا وَمَا أَسْتَكَانُوا ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الصَّابِرِينَ ﴿١٤٦﴾ وَمَا كَانَ قَوْلُهُمْ إِلَّا  
أَنْ قَالُوا رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَإِسْرَافَنَا فِي أَمْرِنَا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا  
عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿١٤٧﴾ فَآتَاهُمُ اللَّهُ ثَوَابَ الدُّنْيَا وَحُسْنَ ثَوَابِ  
الْآخِرَةِ ۗ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٤٨﴾

“Sa e sa profetë bashkë me shumë besimtarë të vërtetë luftuan e megjithatë nuk u përkulën para goditjeve që morën në rrugën e All’llahut, as nuk u dobësuan e as nuk u nënshtruan. All’llahu i do të duruarit.

Ata vetëm thoshin: “O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!

Dhe All’llahu u dhuroi atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të Jetës Tjetër. All’llahu i do punëmirët.”

## Komentimi

### Muhaxhidinët e parë

Ajetet e mëparshme paraqitën ngjarjet e Betejës së Uhudit. Ajetet në fjalë i nxisin myslimanët për sakrificë, vendosmëri. I nxisin duke iu përmendur sakrificat e shokëve të profetëve paraardhës. Po ashtu, ajetet përmbajnë edhe qortim për ata që u larguan nga Beteja e Uhudit. Në ajetin e parë të ajeteve në fjalë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Sa e sa profetë bashkë me shumë besimtarë të vërtetë luftuan e megjithatë nuk u përkulën para goditjeve që morën në rrugën e All'llahut...”**

Përkrahësit e profetëve u përballën me shumë vështirësi dhe u lënduan shumë në luftë kundër armikut. Pavarësisht të gjitha këtyre, ata nuk kanë ndier asnjëherë dobësim, nuk i janë përlurur e nuk i janë dorëzuar armikut. Është e natyrshme që All'llahu i do këta njerëz, të cilët janë të duruar dhe të vendosur në luftë. Për këtë, Ai thotë: **“... as nuk u dobësuan e as nuk u nënshtruan. All'llahu i do të duruarit.”**

Ata, kur përballeshin me probleme që u dilnin para, për shkak të disa gabimeve apo nga mos zbatimi i urdhrave, nuk mendonin të dorëzoheshin, të dezertonin apo të braktisnin fenë dhe besimin, por i drejtoheshin All'llahut të Lartësuar me lutje dhe i kërkonin që t'u jepte durim dhe ndihmë. **“Ata vetëm thoshin: “O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!”**

Me mendimin e tyre të drejtë dhe me veprat e tyre të mira, ata merituan shpërblimin. Ky është një shpërblim i dyfishtë: në këtë botë morën fitoren dhe çlirimin, ndërsa në Botën Tjetër atë që u ka premtuar All'llahu besimtarëve të singertë muxhahidinë (luftëtarë në rrugën e All'llahut të Lartësuar): **"Dhe All'llahu u dhuroi atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të Jetës Tjetër..."** Në fund të ajetit All'llahu i quan ata punëmirë: **"...All'llahu i do punëmirët."**

Në këtë mënyrë, Kur'ani Famëlartë u shpjegon myslimanëve të rinj një mësim të gjallë nga jeta dhe historia e popujve të mëparshëm, duke mësuar rreth sjelljeve të tyre me të dërguarin, se si u përballën me problemet dhe vështirësitë që hasën dhe si i zgjidhën ato. Qëllimi i këtij mësimi të vlefshëm është t'i edukojë dhe t'i përgatisë myslimanët për ngjarjet dhe luftërat e ardhshme.

### **Çështje të tjera që trajtohen në këto ajete**

Në këto ajete ka disa pika të tjera shumë të rëndësishme, që duhen parë me kujdes. Ato janë:

1- **Durimi** – siç e treguam dhe më parë do të thotë qëndrim dhe vendosmëri. Dhe për këtë ka ardhur në këtë ajet e shoqëruar me fjalët "dobësim dhe nënshtrim".

Këtë e tregon edhe prania e durimtarëve në një rresht me punëmirët, sepse në ajetin e parë All'llahu i Lartësuar thotë: **"All'llahu i do të duruarit."** Dhe në ajetin e tretë të ajeteve në fjalë (ajeti 148), All'llahu i Lartësuar thotë: **"All'llahu i do punëmirët."**

Kjo të jep të kuptosh se arritja e së mirës bëhet me durim dhe vendosmëri dhe se punëmirët përballen me mijëra e mijëra probleme. Nëse nuk do të ishin të pajisur me durim dhe vendosmëri, nuk do të vazhdonin në kryerjen e punëve të mira, por shumë shpejt do të binin në prehrin e problemeve.

2- Luftëtarët e vërtetë janë ata që shkakët e humbjes nuk ia veshin të tjerëve apo t'i mbështesin në faktorë fantazues e të pabazë, por i kërkojnë ato brenda vetes dhe mundohen t'i rregullojnë gabimet e tyre. Ata nuk përdorin fjalën *humbje*, por e konsiderojnë humbjen *shpërdorim*. Krejt e kundërta ndodh sot me ne, ku në të shumtën e rasteve përpiqemi ta anashkalojmë humbjen duke ua etiketuar shkakët e saj faktorëve të jashtëm. Kjo mënyrë e të menduarit nuk çon në rregullimin e gabimeve e as në largimin e pikave të dobëta në veten tonë.

3- Ajeti i tretë i ajeteve në fjalë (ajeti 148), tregon shpërblimin që merr individ i në këtë botë dhe shpërblimin e Botës Tjetër, i cili është më i mirë. Këto ajete tregojnë se shpërblimi i kësaj bote ndryshon nga shpërblimi i Botës Tjetër, sepse shpërblimi i kësaj bote, sido dhe sado që të jetë, pas një farë kohe do të përfundojë, ndërkohë që mirësitë e shpërblimit në Botën Tjetër nuk kanë të mbaruar, janë të përhershme, nuk ndërpriten dhe nuk mbarohen, nuk kanë as lodhje dhe as mund.

## Ajeti 149-151

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِن تَطِيعُوا الَّذِينَ كَفَرُوا يُرْذُوكُم عَلَى  
أَعْقَبِكُمْ فَتَنْقَلِبُوا خَاسِرِينَ ﴿١٤٩﴾ بَلِ اللَّهُ مَوْلَاكُمْ ۖ وَهُوَ خَيْرُ النَّاصِرِينَ  
﴿١٥٠﴾ سَنُلْقِي فِي قُلُوبِ الَّذِينَ كَفَرُوا الرُّعْبَ بِمَا أَشْرَكُوا بِاللَّهِ مَا لَمْ  
يُنْزَلْ بِهِ ۖ سُلْطَانًا وَمَأْوَاهُمُ النَّارُ وَبِئْسَ مَثْوَى الظَّالِمِينَ ﴿١٥١﴾

**“O ju që keni besuar! Nëse u bindeni jobesimtarëve, ata do t’ju kthejnë prapa (në të pafe) e ju do të jeni të humbur.**

**Por, All’Ilahu është Mbrojtësi juaj dhe Ai është Ndihmuesi më i mirë.**

**Ne do të mbjellim frikë në zemrat e jobesimtarëve, sepse ata adhurojnë veç All’Ilahut gjëra, për të cilat Ai nuk ka sjellë kurrfarë prove. Vendbanimi i tyre është zjarri e sa vendstrehim i shëmtuar është ky për keqbërësit!”**

## Komentimi

### Vërejtjet e njëpasnjëshme

Këto ajete, sikurse ajetet e tjera të mëparshme, kanë zbritur pas Betejës së Uhudit, me qëllim analizimin e ngjarjeve që ndodhën në këtë betejë dhe që sollën humbjen e saj...

Me të vërtetë, nga ajetet kuptohet se armiqtë e All'llahut, pas Betejës së Uhudit, përpiqeshin të përçanin rreshtat e myslimanëve, duke përhapur një varg thirrjesh helmuese, nganjëherë të mbuluara me petkun e këshillës. Ata përfituan edhe nga gjendja e thyer shpirtërore e myslimanëve dhe u përpoqën të mbillnin farën e braktisjes së Islamit në mesin e myslimanëve.

Në këtë situatë, edhe jehuditët edhe të krishterët i kanë ndihmuar hipokritët për realizimin e këtij plani smirak. Njësoj si ndodhi në kohën e betejës, në të cilën ata kishin dorë në përhapjen e lajmit të vrasjes së Profetit, me qëllim dobësimin dhe demoralizimin e anës shpirtërore të luftëtarëve myslimanë.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë (ajeti 149) thotë: **“O ju që keni besuar! Nëse u bindeni jobesimtarëve, ata do t’ju kthejnë prapa (në të pafe) e ju do të jeni të humbur.”** Ky ajet u tërheq vërejtje myslimanëve që të mos u binden jobesimtarëve, duke u thënë se t’u bindesh atyre, do të thotë të kthehesh në kohën e injorancës, pas asaj rruge madhështore në drejtim të përsosmërisë shpirtërore nën hijen e mësimave islame.

Me të vërtetë, bindja e jobesimtarëve në cytjet e tyre, dëgjimi i supozimeve dhe i thirrjeve të tyre do të thotë kthim në pikën e parë, që është mohimi, shkatërrimi dhe rënia në humnerat e errësirave.

Duke iu bindur atyre, myslimanët bëjnë një mëkat të madh, pasi shkojnë në humbje. A ka humbje më të madhe se sa shndërrimi i besimit në mosbesim, i dritës në errësirë, i udhëzimit në humbje dhe i lumturisë në mjerim?!

Më poshtë, All'llahu i Lartësuar u siguron myslimanëve se ai është ndihmësi më i mirë për ta: **"Por, All'llahu është Mbrojtësi juaj dhe Ai është Ndihmuesi më i mirë."**

All'llahu është ndihmësi më i madh që nuk thyhet, mbrojtësi më i mirë. Fuqia e Tij nuk krahasohet me asnjë fuqi tjetër. Sado që të jetë e madhe fuqia e krijesave, ato shkatërrohen, mposhten dhe zhduken, kurse All'llahu është i Plotfuqishmi mbi gjithçka.

Pastaj, All'llahu i Madhëruar flet për një shembull prej përkrahjes së Tij ndaj myslimanëve në kohën më të vështirë dhe në rrethanat më kritike. All'llahu thotë: **"Ne do të mbjellim frikë në zemrat e jobesimtarëve..."** Në këtë pjesë të ajetit, flitet për shpëtimin e myslimanëve pas Betejës së Uhudit.

Tregohet për ruajtjen e myslimanëve nga All'llahu, për zemërimin e Tij ndaj jobesimtarëve dhe i qetëson myslimanët për të ardhmen, duke ua shtuar vendosmërinë dhe duke i forcuar shpresën për ndihmën e vazhdueshme të All'llahut në të ardhmen.

Idhujtarët mekas, sikurse treguam më përpara në tregimin e ngjarjes së Uhudit, korrën fitore të madhe dhe arritën ta mposhtin ushtrinë myslimane. Jo vetëm kaq, ata kishin si qëllim mësymjen e Medines dhe ekzekutimin e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili i lajmëroi ata se nuk u vra në atë betejë.

Mirëpo, All'llahu i Lartësuar mbolli në zemrat e tyre një frikë të madhe. Si rrjedhim, ata u larguan nga qëllimi i tyre. Frika e madhe, e cila është veçori e jobesimtarëve dhe e idhujtarëve arriti të përfshijë të gjithë ekzistencën e tyre. Siç lexojmë edhe në transmetime, edhe pse ata triumfuan, por, kur u kthyen në Mekë, dukeshin si ushtri e mposhtur.

Shkurtimisht ajeti thotë: **“...Ne do të mbjellim frikë në zemrat e jobesimtarëve...”**, që do të thotë se, ashtu si mbollëm frikë në zemrat e jobesimtarëve në mbarim të Luftës së Uhudit, që ju e shikuat me sytë tuaj, Ne do të mbjellim frikë në zemrat e jobesimtarëve edhe më pas. Për këtë çështje nuk duhet të shqetësoheni, as për të ardhmen tuaj. Nuk duhet t'i frikësoheni askujt. Zemra juaj nuk duhet të preket dhe të lëkundet nga vesvesi dhe cytjet e tyre.

Është e vlefshme të kujtohet se ajeti analizon burimin e frikës që ndodhet në zemrat e jobesimtarëve dhe thotë: **“...sepse ata adhurojnë veç All'llahut gjëra, për të cilat Ai nuk ka sjellë kurrfarë prove.”**

Jobesimtarët kanë qenë një popull që kanë besuar në legjenda, që i janë shmangur rrugës së besimit të All'llahut, nuk kanë ndjekur asnjë argument, nuk kërkojnë argument për asgjë.

Dhe për këtë, shumica e gjërave madhore përpara syve dhe mendjeve të tyre ka qenë përçmuese. Ata adhuronin si Zot, gurët, yjet dhe drurët. Ishin të dobët përballë ndodhive dhe frikacakë. Nga kjo ngjarje patën frikë të madhe. Kjo situatë është e njëjtë me kohën e sotme.

Mendjemëdhenjtë e botës së sotme kanë frikë nga ndodhia më e vogël. E përshkruajnë grimcën mal dhe qimen tra. Kjo ndodh, sepse ata nuk mbështeten tek një mbështetës i sigurt dhe as te besimi i drejtë, pasi nuk kanë zgjedhur për veten e tyre mbështetës të fortë. Jobsimtarët i kanë bërë padrejtësi vetes së tyre dhe shoqërisë. Prandaj, All'illahu i lartësuar thotë: **"Vendbanimi i tyre është zjarri e sa vendstrehim i shëmtuar është ky për keqbërësit!"**

### **Fitorja me faktorin e frikës**

Nga transmetimet e shumta shikojmë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) triumfonte mbi armiqtë për shkak të frikës dhe tmerrit që hidhej në zemrat e tyre.<sup>1</sup>

Kjo tregon se gjendja emocionale është një ndër faktorët e triumfit në luftëra, sidomos në ditët e sotme, sepse nxjerr në pah anën e lartë shpirtërore të luftëtarëve, e cila konsiderohet prej çështjeve më të larta në taktikën ushtarake. Bazuar në këtë, themi se ana shpirtërore e luftëtarëve ndikon më shumë në triumf se sa lloji dhe sasia e armëve.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan"; "Vesailu Shijja", vëllimi 3, faqe 350.

Nisur nga kjo, Islami ngre lart ndjenjat e luftëtarëve, forcon shpirtin e besimit, u shton dashurinë për të luftuar në rrugë të All'llahut dhe krenarinë për të rënë dëshmor në rrugë të Tij, gjithmonë duke u mbështetur në All'llahun e Plotfuqishëm.

Me pranimin e Islamit, myslimanët kanë arritur vlerat më të mëdha të udhëzimit dhe të trimërisë. Kurse idhujtarët, të cilët adhuronin veçse idhujt që nuk sillnin as dëm e as dobi dhe nuk besonin në Botën Tjetër dhe në ringjalljen pas vdekjes, ishin të dobët shpirtërisht. Mbartnin ndjenjën e plogështisë dhe të humbjes.

Ky ndryshim midis dy anëve shpirtërore, idhujtarëve dhe besimtarëve myslimanë, ishte një ndër faktorët e fitores së myslimanëve.

## Ajetet 152- 154

وَلَقَدْ صَدَقَكُمُ اللَّهُ وَعْدَهُ إِذْ تَحُسُونَهُمْ بِإِذْنِهِ <sup>ط</sup> حَتَّىٰ إِذَا فَشِلْتُمْ  
وَتَنَزَّعْتُمْ فِي الْأَمْرِ وَعَصَيْتُمْ مِمَّنْ بَعْدَ مَا أَرْسَلَكُمْ مَا تُحِبُّونَ <sup>ج</sup> مِنْكُمْ مَّنْ  
يُرِيدُ الدُّنْيَا وَمِنْكُمْ مَّنْ يُرِيدُ الْآخِرَةَ <sup>ح</sup> ثُمَّ صَرَفَكُمْ عَنْهُمْ لِيَبْتَلِيَكُمْ وَلَقَدْ  
عَفَا عَنْكُمْ <sup>ط</sup> وَاللَّهُ ذُو فَضْلٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٥٢﴾ إِذْ تَصْعَدُونَ وَلَا  
تَلُودُونَ عَلَىٰ أَحَدٍ وَالرَّسُولُ يَدْعُوكُمْ فِي أُحْرَانِكُمْ فَأَتْبَبَكُمْ غَمًّا بِغَمٍ  
لِّكَيْلَا تَحْزَنُوا عَلَىٰ مَا فَاتَكُمْ وَلَا مَا أَصَابَكُمْ <sup>ط</sup> وَاللَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ  
﴿١٥٣﴾ ثُمَّ أَنْزَلَ عَلَيْكُم مِّن بَعْدِ الْغَمِّ أَمَنَةً نُّعَاسًا يَغْشَىٰ طَآئِفَةً مِّنْكُمْ <sup>ط</sup> وَطَآئِفَةٌ  
قَدْ أَهَمَّتَهُمْ أَنْفُسُهُمْ يَظُنُّونَ بِاللَّهِ غَيْرَ الْحَقِّ ظَنَّ الْجَاهِلِيَّةِ يَقُولُونَ هَلْ  
لَنَا مِنَ الْأَمْرِ مِنْ شَيْءٍ <sup>ط</sup> قُلْ إِنَّ الْأَمْرَ كُلَّهُ لِلَّهِ <sup>ط</sup> يُخْفُونَ فِي أَنْفُسِهِم مَّا لَا يُبْدُونَ  
لَكَ يَقُولُونَ لَوْ كَانَ لَنَا مِنَ الْأَمْرِ شَيْءٌ مَّا قُتِلْنَا هَاهُنَا <sup>ط</sup> قُلْ لَوْ كُنْتُمْ فِي  
بُيُوتِكُمْ لَبَرَزَ الَّذِينَ كُتِبَ عَلَيْهِمُ الْقَتْلُ إِلَىٰ مَضَاجِعِهِمْ <sup>ط</sup> وَلِيَبْتَلِيَ اللَّهُ مَا فِي  
صُدُورِكُمْ وَلِيُمَحِّصَ مَا فِي قُلُوبِكُمْ <sup>ط</sup> وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿١٥٤﴾

“Vërtet All’Ilahu e plotësoi premtimin e Vet, kur ju, me vullnetin e Tij, e thyet armikun deri kur dështuat. Por, kur ju u frikësuat, u grindët midis jush dhe kundërshtuat, pasi Ai ju tregoi atë që pëlqenit<sup>1</sup>. Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë Botën Tjetër. Pastaj Ai, për t’ju provuar, bëri që të zmbrapseni para armikut dhe pastaj, sigurisht që jua fali atë gabim. All’Ilahu ka mirësi të madhe për besimtarët.

Kur ju morët malin dhe nuk i vinit vesh askujt, të Dërguarin e kishit prapa e ju thërriste, All’Ilahu ju dënoi me dëshpërim pas dëshpërimit, që të mos pikëlloheni as për atë që ju doli duarsh, as për atë që ju goditi. All’Ilahu di gjithçka që punoni ju.

Pastaj, pas dëshpërimit tuaj, (All’Ilahu) ju dërgoi qetësinë - një gjumë, që kaploi një grup prej jush. Kurse grupi tjetër (hipokritët) kujdesej vetëm për veten, duke menduar për All’Ilahun të pavërtetën, ashtu si mendonin paganët. Ata thoshin: “Ku është fitorja që na ishte premtuar?” Thuaju (o Muhammed!): “Të gjitha janë në dorë të All’Ilahut!” Ata fshehin në vete atë që nuk duan të ta shfaqin ty. Ata thoshin: “Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu”. Thuaju: “Edhe sikur të kishit qenë nëpër shtëpitë tuaja, prapëseprapë atyre që u është shkruar të vriten, do të dilnin në vendin e vrasjes.” All’Ilahu e bëri këtë për të provuar atë që keni në kraharorët tuaj dhe për t’ju pastruar atë që keni në zemrat tuaja. Vërtet, All’Ilahu e di mirë se ç’keni në zemër.”

---

<sup>1</sup> Plaçkën e luftës.

## Komentimi

### Humbja pas fitores

Në periudhën e parë të Betejës së Uhudit luftëtarët myslimanë luftuan me trimëri. Ata ishin të bashkuar, kështu që arritën një fitore të shpejtë dhe e larguan ushtrinë armike për një kohë të shkurtër. Në ushtrinë myslimane mbizotëroi gëzimi dhe hareja. Por, thyerja e urdhrit të të Dërguarit të All'llahut prej harkëtarëve vrojtues, që qëndronin në grykën e malit, shkaktoi ndryshim.

Ky grup harkëtarësh, nën udhëheqjen e Abdullah ibn Xhubejrit, të cilët ishin në ruajtje të hapësirës të mali Ajnejn, kur mësuan humbjen e kurejshëve dhe se myslimanët ishin të zënë pas plaçkave të luftës, la pikën më të rëndësishme. Ky veprim u hapi rrugë kurejshëve t'i mësynin dhe t'i sulmonin myslimanët pas shpine. Ushtria islame u godit shumë ashpër.

Kur u kthyen myslimanët në Medine, pasi mbartën humbje të madhe, një prej tyre e pyeti shokun e tij: "A nuk na premtoi All'llahu i Lartësuar ndihmën e Tij dhe fitore? Përse humbëm në këtë betejë?"

Ajetet në fjalë i përgjigjen e kësaj pyetjeje dhe sqarojnë shkaqet e vërteta që çuan në humbje. Më poshtë po sqarojmë pjesët e këtyre ajeteve. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Vërtet All'llahu e plotësoi premtimin e Vet, kur ju me vullnetin e Tij e thyet armikun deri kur dështuat..."**

Me këtë shprehje, Kur'ani Famëlartë tregon se All'llahu i Lartësuar e mbajti premtimin e Tij, i ndihmoi myslimanët në fillim

të betejës, duke i luftuar armiqtë, duke i përçarë e duke i dëbuar. Kjo ndodhi pasi ata ndoqën mësimet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe zbatuan urdhrat e tij. Po ashtu, gjatë kohës që ata ishin të vendosur dhe të udhëzuar, fituan. Por, kur nënvleftësuan urdhrat e hollësishme të udhëheqjes profetike, të Dërguari të All'llahut të Lartësuar, ata humbën.

Kjo do të thotë se nuk duhet të ëndërrohet që premtimi për ndihmë është i pakushtëzuar e pa kushte. Por, çdo premtim hyjnor për ndihmë është i kushtëzuar me ndjekjen e mësimave të All'llahut, duke u kapur fort pas udhëzimeve të Tij.

Përsa i përket thënies se kur u premtoi All'llahu fitore myslimanëve në këtë betejë, ka dy supozime:

Supozimi i parë: Ky premtim mund të jetë prej premtimeve të përgjithshme që All'llahu u premton besimtarëve, gjithmonë kur i lajmëron se do t'i bëjë triumfues mbi armiqtë dhe të pafetë.

Supozimi i dytë: Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u premtoi myslimanëve, përpara se të futen në Luftën e Uhudit se janë fitimtarë. Premtimi i Profetit nuk ka dyshim se është premtim hyjnor.

Pas shpjegimit të këtij realiteti rreth ndihmës hyjnore, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Por, kur ju u frikësuat, u grindët midis jush dhe kundërshtuat, pasi Ai ju tregoi atë që pëlqenit...”**

Nga këto fjalë, të cilat tregojnë se çfarë ndodhi me harkëtarët në malin Ajnejn, kuptohet se ata harkëtarë, të cilët ishin urdhëruar të ruanin grykën e malit, kundërshtuan njëri-tjetrin për

zbatimin e urdhrit. Shumica e tyre e thyen urdhrin e Profetit, që të mos lëviznin nga vendi. Kjo kuptohet edhe nga përdorimi i fjalës *asejtum*.

Për këtë, Kur'ani Famëllartë thotë se ju e kundërshtuat urdhrin e Profetit, pasi prekët fitoren e dëshiruar. Vërtet ju sakrifikuat për të arritur fitoren, por neglizhuat në ruajtjen e saj. Kjo është e vërteta e përhershme: E vështirë është të arrish fitoren, po më e vështirë është ruajtja e saj. Sigurisht, ju u grindët midis jush dhe u përçatë në momentin më kritik: **"Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë Botën Tjetër."**

Në kohën që shumica prej tyre (siç e thamë edhe më lart), mendonin për plaçkat e luftës dhe i shkonte goja lëng për to, ku lanë edhe vendin e tyre të rrezikshëm te gryka e malit, një grup i vogël harkëtarësh, me në krye Abdullah ibn Xhubejrin, qëndruan në vendin e tyre duke luftuar armikun dhe duke kërkuar Botën Tjetër dhe shpërblimin e madh të All'Ilahut.

Këtu ndryshoi ecuria e çështjeve. All'Ilahu i Lartësuar ua ndërroi fitoren me humbje për t'ju sprovuar dhe për t'ju edukuar: **"Pastaj, Ai, për t'ju provuar, bëri që të zmbrapseni para armikut..."**

Pastaj, All'Ilahu ua fali juve çdo të keqe, gjynah dhe thyerjen e urdhrit të Profetit, ndërkohë që e meritoni ndëshkimin.

All'Ilahu e bën këtë sepse nuk e fsheh mirësinë e tij ndaj besimtarëve, nuk bën koprraci ndaj tyre: **"Pastaj, sigurisht që jua fali atë gabim. All'Ilahu ka mirësi të madhe për besimtarët."**

Sigurisht, All'Ilahu i Lartësuar i do besimtarët. Ai nuk i braktis ata dhe nuk i lë çështjet e tyre në dorë të të tjerëve, vetëm në raste të rralla, për t'i sprovuar me qëllim që gjithmonë të jenë të lidhur me legjislacionin qiellor, të jenë vigjilentë dhe t'i japin rëndësi përgjegjëse të tyre.

Më poshtë, All'Ilahu i Lartësuar u tregon myslimanëve qëndrimin e tyre në përfundim të Betejës së Uhudit: **“Kur ju morët malin dhe nuk i vinit vesh askujt, të Dërguarin e kishit prapa e ju thërriste.”** Këto fjalë do të thonë: Kujtoni momentin kur u larguat nga lufta, u shpërndatë nëpër mal e përgjatë luginës dhe e latë të Dërguarin e All'Ilahut vetëm në mesin e armiqve idhujtarë e mosbesuesve, kurse ai nga prapa ju thërriste juve duke ju thënë: “O robtë e All'Ilahut, ejani tek unë, ejani tek unë! Unë jam i Dërguari i All'Ilahut!” Ju kurrë nuk shikonit prapa dhe nuk iu përgjigjët thirrjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në atë kohë ju kaploi hidhërimi e trishtimi. **“All'Ilahu ju dënoi me dëshpërim pas dëshpërimit...”** Për veprimet që bëtë, ju goditi humbja: plagosjet, vdekja e një numri të madh shokësh, si dhe lajmi i vrasjes së Profetit. Goditja me këto hidhërime erdhi si rezultat i kundërshtimit tuaj të urdhrave të udhëheqjes profetike, nënvleftësimi i saj nga ju dhe mosqëndrimi juaj në vendin e caktuar. Sigurisht, mësymja e atyre pikëllimeve ishte që të mos mërzhiteshit për ato plaçka që nuk morët në luftë dhe të harronit plagët që morët në fushën e betejës për të arritur fitoren.

All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“...që të mos pikëlloheni as për atë që ju doli duarsh, as për atë që ju goditi.”**

Në vijim thotë: **“All'Ilahu di gjithçka që punoni ju.”**

Ai e di më së miri se kush qëndroi dhe u bind, kush ishte luftëtar i vërtetë e i sinqertë dhe kush iku e dezertoi. Bazuar në këtë dije të All'llahut, askush nuk duhet të mashtrojë veten e tij dhe të thotë variant tjetër të rrjedhjes së ngjarjeve në atë luftë.

Nëse vërtet jeni prej grupit të parë, atëherë falënderojeni me sinqeritet All'llahun e Lartësuar. Nëse nuk jeni kështu, atëherë pendohuni dhe kërkojini falje Atij.

### **Cytjet e injorancës**

Nata e humbjes së Luftës së Uhudit zbardhi me hidhërim e pikëllim të madh. Myslimanët mendonin se ushtarët triumfues kurejsh do të ktheheshin përsëri në Medine për të sulmuar pjesën e mbetur prej myslimanëve dhe për të vrarë edhe ushtarin e fundit mysliman.

Nuk ka dyshim që, sikur idhujtarët të ktheheshin, myslimanët do t'i bënin ballë me forcë të madhe. Në mesin e myslimanëve ishte një grup i sinqertë luftëtarësh, të cilët u penduan për largimin nga fusha e betejës, u penduan tek All'llahu dhe u qetësuan me premtimet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të ardhmen. Ata i kaploi gjumi i thellë dhe i qetë. Kërkonin të qetësoheshin, që të ishin të gatshëm për luftë.

Ndërsa hipokritët, që e kishin besimin e dobët e ishin frikacakë, nuk e shijonin ëmbëlsinë e gjumit dhe qetësinë e tij për shkak të iluzioneve dhe frikës që fantazonin. Dashje pa dashje, ata frikacakë qëndruan zgjuar dhe mbronin luftëtarët e vërtetë që po qetësoheshin me gjumë.

Për të gjitha këto, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Pastaj, pas dëshpërimit tuaj, (All'llahu) ju dërgoi qetësinë - një gjumë, që kaploi një grup prej jush. Kurse grupi tjetër (hipokritët) kujdesej vetëm për veten.”**

Vërtet, hipokritët, frikacakët dhe ata me zemra dhe besim të dobët, nuk i kaploi gjumi atë natë, pasi ishin të frikësuar për veten e tyre, ishin nën ndikimin e cytjeve të shejtanit, duke ua dobësuar sigurinë dhe besimin. E kundërta ishte me besimtarët e vërtetë, të cilët kënaqeshin me gjumin qetësues që i kishte kapluar. Ky është një prej ndikimeve të mëdha të besimit, sepse besimtari i vërtetë ndien qetësi dhe siguri në këtë jetë. Krejt ndryshe paraqitet gjendja emocionale e jobesimtarëve, e idhujtarëve dhe e hipokritëve, të cilët e kanë besimin e dobët, duke mos ndier siguri dhe qetësi.

Më pas Kur'ani Famëlartë, natyrshëm, paraqet atë që ndodhte në mesin e hipokritëve dhe të besimtarëve të dobët: **“...duke menduar për All'llahun të pavërtetën, ashtu si mendonin paganët.”**

Menduan për All'llahun e Lartësuar njëlloj si në kohën e injorancës (para Islamit), para se të lindte mbi ta dielli i Islamit. Ata mendonin se All'llahu i Lartësuar nuk do ta mbajë premtimin e tij dhe se premtimet e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk janë të vërteta dhe të realizueshme.

I thoshin njëri-tjetrit: **“Ata thoshin:”Ku është fitorja që na ishte premtuar?”** Vallë a do të fitojmë në këtë gjendje kritike që jemi? Ata nuk mendonin se ndihma e All'llahut do të vijë. Kjo ndihmë u dukej atyre e paarritshme. Por, All'llahu i Lartësuar iu

përgjigj: **"Thuaju (o Muhammed!): "Të gjitha janë në dorë të All'lahut!"**

Vallë si e shihni të largët fitoren apo e mendoni të parealizueshme kur çdo gjë është në dorën e All'lahut, i Cili është i Plotfuqishëm t'ju sjellë juve fitore kur ta meritoni?

Ata nuk i shfaqnin të gjitha ato që mendonin e bluanin në brendinë e tyre nga frika se mos ktheheshin në rreshtat e jobesimtarëve: **"Ata fshehin në vete atë që nuk duan të ta shfaqin ty."**

Ata mendonin se humbja në Betejën e Uhudit është prej shenjave se Islami nuk është i vërtetë. Për këtë: **"Ata thoshin: "Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu."** Pra, sikur ne të ishim në të vërtetë, nuk do të humbnim, por do ta fitonin, nuk do të humbnim gjithë këtë pasuri dhe njerëz.

Por All'lahu i Lartësuar u përgjigjet, duke u treguar dy faktorë të rëndësishëm.

E para: Ju nuk duhet të mendoni se largimi nga fusha e betejës dhe largimi prej vështirësive mund t'ju shpëtojë nga afati i caktuar i vdekjes (exheli), i cili është i caktuar për çdo njeri. All'lahu i Lartësuar për këtë gjë thotë: **"Thuaju: "Edhe sikur të kishit qenë nëpër shtëpitë tuaja, prapëseprapë atyre që u është shkruar të vriten, do të dilnin në vendin e vrasjes."** E me të vërtetë, atyre që u vjen vdekja dhe u ka arritur afati i caktuar, patjetër duhet të vdesin, kudo qofshin, në luftë apo në shtëpi, është e pakundërshtueshme.

Çdo popull e meriton humbjen, nëse shumica e tyre dobësohet, patjetër duhet të shijojnë vdekjen dhe nuk është e pakundërshtueshme se nuk do t'ju godasë vrasja. Vdekja në fushën e betejës dhe nën goditjen e armëve është më e vlefshme, pasi aty shkruhet heroizmi. Kjo është me e mirë se sa vdekja në shtrat.

Sa e bukur është fjala e Imam Aliut: *“Një mijë goditje me shpatë janë më të dashura tek unë se sa vdekja në shtrat.”!*

E dyta: Me të vërtetë, këto ngjarje duhet të ndodhin, pasi vetëm kështu zbulohet se çfarë fshihet në zemrat e gjithkujt, dallohen mburracakët dhe trimat e vërtetë. Përveç kësaj, këto ndodhi janë faktorë për edukimin e njeriut, me qëllim që të pastrojë zemrën, mendimet, të forcojë besimin. **“All’llahu e bëri këtë për të provuar atë që keni në kraharorët tuaj dhe për t’ju pastruar atë që keni në zemrat tuaja.”**

Në fund të këtij ajeti All’llahu i Madhëruar thotë: **“Vërtet, All’llahu e di mirë se ç’keni në zemër.”** All’llahu nuk shikon vetëm veprat tuaja, por sprovon zemrat tuaja, për t’i pastruar nga çdo gjë e idhujtarisë, e hipokrizisë, e dyshimit dhe e mosbesimit.

## Ajeti 155

إِنَّ الَّذِينَ تَوَلَّوْا مِنْكُمْ يَوْمَ الْتَقَى الْجَمْعَانِ إِنَّمَا اسْتَزَلَّهُمُ الشَّيْطَانُ بِبَعْضِ

مَا كَسَبُوا وَلَقَدْ عَفَا اللَّهُ عَنْهُمْ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿١٥٥﴾

**“Ata prej jush që kthyen shpinën ditën kur u ndeshën dy ushtritë, në të vërtetë, djalli i shtyu në gabim, për shkak të disa gjynaheve që kishin bërë. Por, në të vërtetë, All’llahu ua fali (gabimin), sepse All’llahu është Falës i madh dhe i Butë.”**

### Komentimi

#### Mëkati pason një mëkat tjetër

Ky ajet përsëri parashtron ngjarjet e Luftës së Uhudit. Ai tregon një realitet tjetër për myslimanët, se mëkatet dhe devijimet, që burojnë nga njeriu për shkak të cytjes dhe vesveseve të shejtanit, sjellin mëkate dhe gjynahe të tjera, si rezultat i aftësisë së fituar te njeriu prej mëkateve të mëparshme. Kjo aftësi hap rrugën e mëkateve dhe të gjynaheve të tjera.

Kjo gjë nuk ndodh kur zemrat janë të pastra prej mëkateve të mëparshme dhe nuk ndikohet nga cytjet dhe vesveset e shejtanit. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: **“Ata prej jush që kthyen shpinën ditën kur u ndeshën dy ushtritë, në të vërtetë, djalli i shtyu në gabim, për shkak të disa gjynaheve që kishin**

**bërë. Por në të vërtetë, All'Ilahu ua fali (gabimin), sepse All'Ilahu është Falës i madh dhe i Butë."**

Kështu, Kur'ani Famëlartë, i mëson myslimanët që ata ta shtojnë devotshmërinë në edukimin e vetes dhe pastrimin e zemrave të tyre, që të arrijnë fitore në të ardhmen. Ka mundësi që kuptimi i mëkatit që ata bënë të jetë dashuria ndaj kësaj bote, mbledhja e plaçkave të luftës dhe moszbatimin e urdhrave të të Dërguarit të All'Ilahut. Ose mund të jenë mëkate të tjera që i kanë bërë para Betejës së Uhudit, të cilat ia dobësuan fuqitë shpirtërore.

Dijetari i shquar Tabarsi përcjell nga Ebu Kasim Balkhi, thënie se me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) (në Luftën e Uhudit) qëndruan vetëm trembëdhjetë persona, pesë vetë nga muhaxhirët dhe tetë nga ensarët dhe së bashku me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) numri i tyre ka qenë 14. Tek të gjithë ka mendime të ndryshme. **Vetëm** rreth imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Talhas janë të një mendimi dhe thonë se kanë qëndruar.

## Ajeti 156 - 158

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا لَا تَكُوْنُوْا كَالَّذِيْنَ كَفَرُوْا وَقَالُوْا لِاٰخَوٰنِهِمْ اِذَا ضَرَبُوْا  
 فِي الْاَرْضِ اَوْ كَانُوْا غُزًى لَّوْ كَانُوْا عِنْدَنَا مَا مَاتُوْا وَمَا قُتِلُوْا لِيَجْعَلَ اللّٰهُ  
 ذٰلِكَ حَسْرَةً فِى قُلُوْبِهِمْ ۗ وَاللّٰهُ سَمِيْعٌ ۭ وَبَصِيْرٌ ﴿١٥٦﴾  
 وَلَئِنْ قُتِلْتُمْ فِى سَبِيْلِ اللّٰهِ اَوْ مُتُّمْ لَمَغْفِرَةٌ مِّنَ اللّٰهِ وَرَحْمَةٌ خَيْرٌ مِّمَّا  
 تَجْمَعُوْنَ ﴿١٥٧﴾ وَلَئِنْ مُّتُّمْ اَوْ قُتِلْتُمْ لِّاِلٰى اللّٰهِ تَحْشُرُوْنَ ﴿١٥٨﴾

**"O ju që keni besuar! Mos bëni si ata jobesimtarë (hipokritët) që u thoshin vëllezërve, kur këta niseshin në udhëtim ose në luftim: "Sikur të rrinit me ne, as nuk do të vdisnit, as nuk do të vriteshit" - që këtë All'Ilahu ta kthejë si pikëllim në zemrat e tyre. All'Ilahu është Ai që jep jetën dhe sjell vdekjen; All'Ilahu i sheh të gjitha punët që bëni ju.**

**Edhe nëse ju vriteni ose vdisni në udhë të All'Ilahut, falja dhe mëshira e All'Ilahut, me të vërtetë, janë më të mira nga ato që kanë grumbulluar ata.**

**Edhe po vdiqët apo u vratët, me siguri do të tuboheni tek All'Ilahu."**

## Komentimi

### Veprimi i hipokritëve

Beteja e Uhudit ishte shumë e rëndësishme tek myslimanët. Dhe kjo për arsye të dy anëve:

E para: Lufta e Uhudit është konsideruar pasqyra më e mirë e realitetit të myslimanëve, që i ndihmoi ata jo vetëm të shikonin pikat e dobësisë së tyre, por edhe t'i rregullonin ato. Kjo është arsyeja që Kur'ani Famëlartë është përqendruar në këto ngjarje dhe i kushton shumë rëndësi.

Ne mësojmë prej kësaj beteje mësimet të shumta dhe të vlefshme. Jo vetëm nga këto ajete, por edhe nga ajetet e mëparshme dhe të atyre që vijnë më pas, nxjerrim mësimet të shumta.

E dyta: Ndodhitë e kësaj beteje përgatitën një terren të përshtatshëm për hipokritët, për të kryer përpjekjet e tyre dashakeqëse. Për këtë qëllim zbritën shumë ajete për të penguar ndikimin e këtyre përpjekjeve dhe për dështimin e planeve të tyre të këqija.

Këto ajete, së pari, u drejtohen besimtarëve, me qëllim që të shkatërrojnë përpjekjet dëmtuese të hipokritëve dhe të jenë vigilentë ndaj tyre. **“O ju që keni besuar! Mos bëni si ata jobesimtarë (hipokritët) që u thoshin vëllezërve, kur këta niseshin në udhëtim ose në luftim: “Sikur të rrinit me ne, as nuk do të vdisnit, as nuk do të vriteshit”, All'illahu u tërheq**

vëmendjen myslimanëve që të mos bien pre e mashtrimeve të jobesimtarëve.

Këto fjalë, edhe pse i shqiptuan me nota dashamirësie dhe dhembshurie, në realitet, donin helmonin zemrat e myslimanëve dhe dobësimin e anës shpirtërore të tyre. Ju nuk duhet të ndikoheni prej kurtheve të tyre.

**"...që këtë All'llahu ta kthejë si pikëllim në zemrat e tyre."** Me këto fjalë kërkon të ngrejë moralin e tyre, për të forcuar besimin e tyre.

Me thënien e tij Kur'ani na mëson: *"O besimtarë. Nëse bini pre e fjalëve të hipokritëve, mashtroheni prej tyre dhe nëse ndiqni shembujt e tyre, fuqia juaj shpirtërore e morale do të dobësohet dhe nuk do të dilni në fushat e betejës për të luftuar për hir të All'llahut. Atëherë, hipokritët do të realizojnë qëllimin e tyre. Kurrë mos u mashtroni prej tyre dhe thënieve të tyre. Por, ngrihuni dhe hyni në fushat e betejave me shpirt të lartë sakrifikues, me vendosmëri të lartë dhe me bindje të plotë. Nëse veproni kështu, All'llahu do të mbushë me pikëllim zemrat e hipokritëve poshtërues.*

Pastaj Kur'ani Famëlartë u përgjigjet mashtrimeve dhe intrigave të hipokritëve me tri përgjigje logjike:

1- Jeta dhe vdekja janë në dorën e All'llahut. Pjesëmarrja në fushën e betejës nuk ndryshon asgjë nga ky realitet, pasi All'llahu është i Gjithëdijsëm për veprat e robërve të Tij: **"All'llahu është Ai që jep jetën dhe sjell vdekjen; All'llahu i sheh të gjitha punët që bëni ju."**

2- Nëse ju vriteni ose vdisni, ose ju vjen vdekja papritur, sikurse e mendojnë hipokritët, ju nuk humbisni asgjë, sepse mëshira e All'llahut dhe falja e Tij është më e madhe dhe më e vlefshme nga çdo gjë që grumbulloni me duart tuaja apo grumbullojnë hipokritët prej pasurive në këtë jetë: **“Edhe nëse ju vriteni ose vdisni në udhë të All'llahut, falja dhe mëshira e All'llahut, me të vërtetë, janë më të mira nga ato që kanë grumbulluar ata.”**

Në thelb, nuk lejohet krahasimi midis këtyre dy çështjeve. Ajo është çështje e pashmangshme kur u flitet mendjeve të lehta të cilat i japin përparësi ditëve të numëruara prej kësaj jete dhe pasurisë ndaj xhihadit dhe krenarisë së martirizimit. Para kënaqësisë së shpërblimit në rrugë të All'llahut, ata pëlqejnë kënaqësitë që fitojnë gjatë ditës, duke harruar që gjithçka, që është në këtë botë, është kalimtare.

Atëherë, nuk ka rrugë tjetër përpara atyre, veçse t'u thuhet se ajo çfarë arrijnë besimtarët nga vdekja dhe martirizimi në rrugë të All'llahut është më e mirë se gjithë ajo çfarë grumbullojnë jobesimtarët nga kjo botë kalimtare, nga adhurimi i pasurisë, e përzier me egot e dëshirat e lehta, të cilat kanë një çmim shumë të lirë.

3- Duke analizuar të gjitha këto, mund të themi se vdekja nuk është mbarimi dhe përfundimi i çdo gjëje. Edhe pse njerëzit e kanë frikë vdekjen, duhet të theksojmë se ajo (vdekja) është kalim nga një botë në një botë tjetër, më të gjerë, më të lartë e më të vlefshme, se jeta që bëhet në këtë botë. Jeta në Botën Tjetër është jetë e përjetshme. **“Edhe po vdiqët apo u vratë, me siguri do të tuboheni tek All'llahu.”**

Është e vlefshme të theksojmë se në këto ajete vdekja në udhëtim konsiderohet si martirizim në rrugën e All'llahut, sepse udhëtimi këtu ka kuptimin e udhëtimit që kryen njeriu për hir të All'llahut, siç është udhëtimi për në betejë apo udhëtimi për predikim. Kjo për faktin se udhëtimet që bëheshin në atë kohë kanë qenë të rrezikshme, të vështira dhe të lodhshme. Gjatë udhëtimit nuk kanë qenë të pakta rastet kur udhëtarët kanë humbur jetën për shkak të sëmundjeve të ndryshme.

Prandaj, kjo lloj vdekje ka po aq vlera sa edhe vdekja në fushë të betejës.

Disa komentues të Kur'anit janë shprehur se fjala udhëtime këtu përfshin udhëtimet e ndryshme tregtare. Ky mendim është shumë larg me kuptimin e ajetit, pasi jobesimtarët nuk ndiejnë keqardhje për këtë çështje, sepse ka qenë mënyrë përfitimi dhe grumbullimi të pasurisë.

Në shtesë të kësaj, themi se kjo tematikë nuk ka ndaluar në dobësimin e anës shpirtërore të myslimanëve pas Betejës së Uhudit. Po ashtu, mosbashkëpunimi i myslimanëve me jobesimtarët në këtë çështje, nuk u shkaktoi asnjë fatkeqësi e humbje jobesimtarëve.

Prandaj, kuptimi i vdekjes në udhëtim në këtë ajet, është për luftën që bëhet për hir të All'llahut të Lartësuar, gjatë udhëtimit, ose për kryerjen e qëllimeve të tjera që i përkasin programeve të Islamit.

## Ajetet 159 - 160

فَبِمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانْفَضُّوا مِنْ  
 حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ  
 فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ ﴿١٥٩﴾ إِنَّ يَنْصُرْكُمْ اللَّهُ فَلَا غَالِبَ  
 لَكُمْ وَإِنْ يَخْذُلْكُمْ فَمَنْ ذَا الَّذِي يَنْصُرْكُمْ مِنْ بَعْدِهِ ۗ وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ  
 الْمُؤْمِنُونَ ﴿١٦٠﴾

“Në sajë të mëshirës së All’liahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje All’liahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek All’liah. Vërtet, All’liah u do ata që mbështeten tek Ai.

Nëse ju ndihmon All’liah, s’ka kush t’ju mposhtë e, nëse ju lë pa ndihmën e Tij, kush është ai që do t’ju ndihmojë, përveç Tij?! Pra, vetëm tek All’liah le të mbështeten besimtarët.”

## Komentimi

### Urdhri për falje të përgjithshme

Këto ajete, edhe pse përmbajnë një seri mësimesh të përgjithshme, drejtuar profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në përmbajtje kanë programe themelore dhe përgjithësuese, për nga zbritja kanë lidhje me Betejën e Uhudit. Kjo për faktin se, pas kthimit të myslimanëve nga Uhudi, ata persona që u larguan nga fushëbeteja, u penduan për qëndrimin e tyre dhe i kërkuan falje të Dërguarit të All'llahut. All'llahu i Lartësuar e urdhëroi të Dërguarin e Tij që t'i falë të penduarit dhe t'i pranojë ata pendues me zemërgjerësi.

All'llahu i Lartësuar thotë: **"Në sajë të mëshirës së All'llahut, u solle butësisht me ta (o Muhammed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje."**

Para së gjithash, ky ajet tregon një nga veçoritë e moralit të të Dërguarit të All'llahut, që është butësia, dashamirësia dhe mëshira ndaj njerëzve.

Fjala *el fedhdhu*, nga ana gjuhësore, do të thotë *ashpërsi e fortë në fjalë*. Fjala *galijdhul kalbi*, do të thotë *zemër e ashpër, që nuk ka mëshirë dhe nuk ndien butësi*.

Këto dy fjalë, edhe pse kanë kuptim të përbashkët, *ashpërsinë*, kanë mënyra të ndryshme përdorimi. Për të treguar ashpërsinë e fjalës, në të shumtën e rasteve përdoret fjala e parë. Kurse fjala e dytë përdoret për të treguar më shumë ashpërsinë shpirtërore. Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar e përdor për zbukurimin e të Dërguarit të All'llahut me cilësinë e butësisë dhe të zemërgjerësisë ndaj gabimtarëve dhe injorantëve.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar e urdhëron të Dërguarin e Tij që t'i falë ata: **"Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje All'Ilahut për ata..."** Këto fjalë kanë kuptimin se All'Ilahu i Lartësuar kërkon nga i Dërguari i Tij që të heqë dorë nga e drejta e tij ndaj tyre nëse ndahen prej tij në momentet më kritike.

All'Ilahu i Lartësuar ndërmjetëson te i Dërguari i Tij, që të gjithë ata persona që e braktisën, t'i falë dhe njëkohësisht Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të ndërmjetësojë për ta dhe të kërkojë falje tek All'Ilahu i Lartësuar. Me fjalë të tjera, All'Ilahu i Lartësuar kërkon nga i Dërguari i Tij që t'i falë në atë çfarë është mes vetes dhe njerëzve. Kurse për atë çfarë është mes All'Ilahut dhe mes tyre, Ai i fal vetë ata. Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e zbatoi urdhrin e Zotit të tij dhe i fali të gjithë ata.

Është e qartë se ajo situatë patjetër kërkonte mëshirë, zemërgjerësi, falje dhe butësi nga ana e Profetit. Sikur Profeti të vepronte të kundërtën, njerëzit do të largoheshin prej tij. Ai grup njerëzish, me gjithë humbjen e madhe dhe përballjen e humbjes së njerëzve, për të cilën ata ishin shkaktarë, kishin më tepër nevojë për butësinë dhe zemërgjerësinë. Ky është ilaçi që do të shëronte plagët e tyre, qofshin ato trupore apo shpirtërore. Është ilaçi që të udhëzon në momentet më kritike, deri në qetësim, është ilaçi që sjell lumturinë në shpirt dhe të përgatit për t'u bërë ballë ngjarjeve në të ardhmen.

Në këtë ajet tregohet qartë për një nga cilësitë më të rëndësishme që duhet të ketë çdo udhëheqje dhe ajo është falja dhe zemërbutësia ndaj kundërshtarëve, rebelëve dhe mëkatarëve pendues. Është e pakundërshtueshme se kushdo që merr postin e udhëheqjes dhe nuk i ka këto cilësi të domosdoshme dhe vepron

me ashpërsi, dhunë e forcë, shumë shpejt do të përballlet me humbjen. Shumë shpejt planprogramet e tij do të dështojnë, përpjekjet do të zhduken dhe njerëzit rreth tij do të largohen duke u përçarë. Si rrjedhim, ai nuk do të mund të kryejë misionin e udhëheqjes. Për këtë, prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), duke treguar delikatesën e cilësive të udhëheqjes thotë: "*Mjeti i udhëheqjes është zemërgjerësia.*"<sup>1</sup>

### Urdhri për konsultim

Pas urdhrit për falje të përgjithshme, All'Ilahu i Lartësuar e urdhëron të Dërguarin e Tij që të konsultohet me myslimanët për një çështje dhe t'i mendojë mirë mendimet e tyre. Kjo për të ringjallur personalitetin e tyre dhe për të formuar një shpirt të ri, të pa hasur më parë. Ky urdhër për Profetin, që të konsultohet me myslimanët, është me qëllim që siç e thamë edhe më parë, profeti Muhammed u konsultua me myslimanët para Betejës së Uhudit dhe për mënyrën e përballjes me armikun.

Nga konsultimi u zbatua mendimi i shumicës prej tyre, vendosja në malin e Uhudit. Duke u bazuar në ngjarjet që ndodhën në luftë, humbja dhe numri i madh i të vrarëve e të plagosurve, shumica e myslimanëve mendonin që pas asaj humbjeje, Profeti nuk duhet të këshillohet më me askënd. Ai do të vepronte ashtu siç e mendonte vetë.

Por, Kur'ani e kundërshton këtë mendim dhe i përgjigjet duke e urdhëruar Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i kthehet konsultimit: "**... konsultohu me ata për çështje të ndryshme**", sepse konsultimi, edhe pse në disa vende nuk sjell dobi, është i dobishëm në përgjithësi.

---

<sup>1</sup> "Nehxhul Belaga", fjalë të shkurtra, fjala 176.

Po të krahasohen rezultatet e saj të dobishme me disa rezultate negative dhe jo të dobishme, do të duket se dobia është më e madhe. Gjithashtu, ndikimet e tij në ruajtjen dhe mbrojtjen e individëve dhe të shoqërive, në formimin dhe edukimin e personalitetit, janë të rëndësishme, sepse mbulon pikat e dobëta të personalitetit.

Le të shohim rastet kur i Dërguari i All'llahut të Lartësuar është konsultuar me shokët e tij.

Është e vërtetë se fjala *emër*, që ndodhet në thënien: “... **konsultohu me ata për çështje të ndryshme**” ka kuptim të gjerë dhe nënkupton të gjitha çështjet. Por është e natyrshme se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk është konsultuar asnjëherë me njerëzit për rregullat e All'llahut. Në këtë fushë, ai (Muhammedi, i Dërguari i All'llahut) ka ndjekur vetëm shpalljen e Zotit të tij. Kështu që konsultimi ka qenë rreth mënyrës së zbatimit të mësimëve dhe të rregullave të All'llahut në realitet.

Me fjalë të tjera themi: Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk është konsultuar me askënd në hartimin e ligjeve dhe të rregullave të Islamit, por është konsultuar me myslimanët për mënyrën e zbatimit të tyre dhe ka kërkuar mendimin e tyre për atë zbatim.

Për këtë, kur Profeti parashtronte një çështje, nganjëherë myslimanët shtronin këtë pyetje: “A është ky një ligj apo rregull hyjnor, që nuk na lejohet të japim mendim për të apo çështja ka lidhje me mënyrën e zbatimit?” Nëse kishte të bënte me mënyrën e zbatimit, njerëzit shprehnin mendimet e tyre. Nëse ishte ligj apo rregull hyjnor, kishin për detyrë vetëm ta merrnin dhe ta zbatonin.

Në Luftën e Bedrit Profeti zbriti afër ujit në Bedër. Habbab ibn Mundhir i tha: *"O i Dërguari i All'llahut, a e pe këtë vend? Në këtë vend na urdhëroi All'llahu i Lartësuar të qëndrojmë e ta zbatojmë këtë urdhër apo është mendim dhe strategji e luftës?"*

Profeti i tha: *"Po ky është një mendim dhe strategji lufte."*

Habbab ibn Mundhiri i tha: *"O i Dërguari i All'llahut ky nuk është vendi, prandaj ngriji njerëzit dhe të shkojmë më afër ujit."*

Kur Habab Ibn Mundhir mbaroi së foluri, profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) iu përgjigj: *"Këtë mendim e kam këshilluar."* Ai veproi sipas konsultimit.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri "El-Menar", vëll. 4, f. 200. "Mustedrek", i Hakim Nijshaburi, vëll.3, f. 427.

## Hulumtime

### 1 -Rëndësia e konsultimit në Islam

Konsultimi ka një rëndësi të veçantë në pikëpamjen islame. Profeti Muhammed, edhe pse zotëronte fuqi të mëdha mendore, të cilat ia lehtësonin atij çështjet pa pasur nevojë që të konsultohet me askënd, konsultohej me shokët e tij për çështjet e përgjithshme të myslimanëve, që kishin lidhje me zbatimin e ligjeve dhe të rregullave të All'lahut.

Ai e respektonte mendimin e konsultuesve. Kishte raste ku nuk e merrte për bazë mendimin e tij si respekt për ta dhe zbatonte mendimet e tyre, siç veproi në *Uhud*. Me veprimin e tij, ai kërkonte që myslimanët të ndienin vlerën e konsultimit dhe ta kishin bazë në ndërtimin e planprogrameve të tyre. Mund të thuhet se kjo vepër në vetvete ka qenë një prej faktorëve ndikues në suksesin e Profetit, për të arritur synimet e tij të larta islame.

Është e vërtetë se çdo popull që i administron çështjet e tij mbi bazat e konsultimit, gabimet do të jenë të pakta në administrim. E kundërta ndodh me ata individë që vuajnë nga imponimi i mendimit dhe e konsiderojnë të panevojshëm konsultimin.

Ata persona, sado që të jenë të lartë në mendime, janë më afër shkatërrimit, humbjes dhe janë më larg së vërtetës dhe udhëzimit. Përveç kësaj, imponimi i mendimit ekzekuton personalitetin e të tjerëve, paralizon lëvizjen e mendimit dhe zhvillimin e tij, duke çuar në ndrydhje të dhuntive të njeriut. Me këtë mënyrë, shkatërrohet forca më e madhe e një shoqërie, që është humanizmi.

Gjithashtu, shtojmë se ai që konsultohet me të tjerët në çështjet dhe veprat e tij të ndryshme, kur të arrijë sukses, nuk do të goditet nga smira e smirakëve, sepse të tjerët do ta ndiejnë veten e tyre partnerë në realizimin e triumfit e të suksesit. Nuk është e njohur që një njeri të ketë smirë vetveten për arritjet që kryen. Edhe kur e godet humbja, pas konsultimit, atë njeri nuk e fajësojnë gjuhët e njerëzve dhe nuk përballet me shigjetat e kritikës e të kundërshtimit, sepse njeriu nuk e kundërshton veprën e tij dhe nuk e kritikon veten për atë që veproi. Përkundrazi, do t'i ndajnë dhimbjet së bashku dhe do të jenë ortakë në humbje. E gjitha kjo sepse ata ishin partnerë në mendim dhe në planifikim. Nuk ka qenë i vetëm në veprim dhe në mendim.

Përveç këtyre, konsultimi ka një dobi tjetër, pasi është një mundësi e mirë për të njohur të tjerët, për të parë se kush të mbështet dhe kush të urren. Nuk ka dyshim se kjo njohje i hap rrugë suksesit.

Kanë ardhur transmetime të shumta që nxisin individët për në rrugën e konsultimit. Në një hadith të ardhur nga i Dërguari i All'llahut thuhet: *"Asnjëherë nuk ka rënë në mjerim rob i konsultim dhe nuk është lumturuar me lënien e tij."*<sup>1</sup>

Për këtë çështje, prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Kush imponon mendimin e tij, shkatërrohet. Kush konsultohet me të tjerët, është bërë ortak me mendimin e tyre."*<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Ruhul Xhinan", vëll. 5, f. 126.

<sup>2</sup> "Nehxhul Belaga", fjala 161.

Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i cili ka thënë: “Nëse prijësit tuaj janë me të mirët tuaj, të pasurit tuaj janë më zemërgjerë dhe, nëse çështjet i zgjidhni me konsultim, sipërfaqja e tokës është më e mirë për ju se brendia e saj. Nëse prijësit tuaj janë të këqij, të pasurit janë koprracë dhe konsultimi nuk ndodhet mes jush, brendia e tokës është më e mirë se sa sipërfaqja e saj.”<sup>1</sup>

## 2- Me kë duhet të këshillohesh?

Është e natyrshme se për konsultim ka njerëz të aftë. Nuk është e drejtë që konsultimi të bëhet me këdo, sepse ka mundësi që konsultimi me disa njerëz çon në prishjen e çështjes, në humbjen e përpjekjeve, në dështimin e punës dhe në mosarritjen e suksesit.

Për këtë gjë, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Mos u konsulto me:

1- Koprracin, që të largon nga mirësia dhe të përgatit varfëri.

2- Frikacakun, që të dobëson ndaj çështjeve.

3- Personin që të ruan, pasi të keqen ta zbukuron me padrejtësi.<sup>2</sup>

## 3-Detyra e konsultuesit

Thamë më lart se Islami i ka dhënë rëndësi të madhe çështjes së konsultimit. Në transmetime të ndryshme janë përcaktuar dhe detyrat që duhet të ketë konsultuesi.

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Ruhul Xhinan”, vëll. 5, f. 126. “Tuheful Ukul”, f. 136.

<sup>2</sup> “Nehxhul Belaga”, Letra e tij për Malikul Eshter, f. 430.

Konsultuesi nuk duhet të kursehet nga porositë dhe të mos i fshehin të mirat e kësaj pune. Tradhtia e konsultuesit ndaj atij që konsultohet me të konsiderohet prej mëkateve të mëdha në Islam. Jo vetëm kaq, rreth këtij rregulli Islami nuk bën dallim mes besimtarit dhe jobesimtarit. Kjo do të thotë se ai që ka marrë përsipër të japë porosi dhe konsultë, nuk ka të drejtë ta tradhtojë kërkuesin e porosisë e të konsultës. Të mos e porosisë sipas asaj që ai mendon vetë, qoftë konsultuesi mysliman apo jomysliman.

Në librin "Mesazhi i të drejtave", imam Zejnul Abidiyn, (*Paqja qoftë mbi ata të!*) ka thënë: *"E drejta e konsulentit është se, nëse ia nje mendimin, konsultohesh me të. Nëse jo, e udhëzon për tek ai që di. E drejta e konsultuesit ndaj teje është të mos e akuzosh nëse mendimi yt nuk përputhet me mendimin e tij."*<sup>1</sup>

#### 4- Konsultimi i Umer ibn Hatabit

Kur një grup dijetarësh dhe komentuesish nga Ehli Sunneti, arritën te ky ajet, ajeti i konsultimit, tregon për konsultimin gjashtësor<sup>2</sup> të Umerit për të zgjedhur prijësin e tretë. Nëpërmjet një shpjegimi të detajuar, janë përpjekur të përputhin kuptimin e këtij ajeti dhe të haditheve të konsultimit me atë proces dhe ide. Për këtë çështje, edhe pse është prej misionëve të librave të besimit, duhet të përmendim disa pika në formë të shpejtë e të përkufizuar:

**E para:** Zgjedhja e halifit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duhet të jetë vetëm nga All'Ilahu, sepse halifi duhet të ketë tipare si ato të Profetit për

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Nurul Thekalejn", vëll. 1, f. 405. "Men la jahdurul fakijf", vëll.2, f. 624.

<sup>2</sup> E kanë quajtur gjashtësor, sepse në këtë konsultim ishin gjashtë persona.

nga ruajtja nga mëkati e gabimi dhe të tjera të ngjashme si këto. Këto çështje askush nuk mund t'i dijë e t'i zbulojë vetëm se All'llahu i Lartësuar.

Me fjalë të tjera: Ashtu nuk mund të zgjidhet profet me konsultim, edhe imami (halifi i tij) nuk bëhet nëpërmjet konsultimit.

**E dyta:** Konsultimi gjashtësor, i lartpërmendur, nuk ka qenë në përputhje me etalonin dhe kushtet e konsultimit e të konsultës. Konsultimi që tha Umeri, edhe pse ka qëllimin e konsultimit të të gjithë myslimanëve, përse është veçuar me gjashtë persona? Nëse qëllimi i asaj konsulte ka qenë konsultimi me njerëz të zgjuar, që janë më të mirët e popullit, atëherë këto tipare nuk janë të kufizuara vetëm te këta gjashtë persona, sepse ka pasur edhe persona të tjerë, si: Selmani, i cili ka qenë këshilltari personal i Profetit; ka qenë Ebu Dherri, Mikdadi, Ibn Abasi e të tjerë, të cilët u lanë jashtë këtij konsultimi.

Bazuar në ato që u tha, kufizimi i konsultimit te këta gjashtë persona të caktuar i jep konsultimit më shumë ngjyrimë partiako - politike se sa ngjyrimë konsulte dhe konsultimi.

Qëllimi i kufizimit të konsultimit te këta gjashtë persona ka qenë që atë ta vendosin te personat që u dëgjohet fjala dhe kanë pushtet, me qëllim që vendimet e tyre të zbatohen e të mos kundërshtohen. Ky qëndrim i tyre, nuk ka qenë i drejtë. Kjo për faktin se kishte persona të tjerë, si: Sa'd ibn Ibadeh, i cili udhëhiqte ensarët, pa pasur mosmarrëveshje dhe, Ebu Dherr El Gafarri, të cilit i dëgjohej shumë fjala në fisin Gafar, të cilët u lanë jashtë pistës së konsultimit.

**E treta:** Ne dimë që në këtë konsultim u vendosën kushte të vështira dhe të rrepta, deri në atë masë, sa që ata që kundërshtonin

vendimet e marra nga ky grup, u kërcënuan me vdekje. Ndërkohë që në ligjin e konsultimit, të cilin e ka caktuar Islami, nuk gjenden kushte të tilla. Si mund të zbatohet ky konsultim?

## 5 - Faza e vendimit përfundimtar

Konsultuesi duhet të jetë i butë dhe zemërgjerë me konsultuesit. Gjithashtu, ai duhet të jetë i rreptë dhe i prerë në marrjen e vendimit përfundimtar.

Ai nuk duhet të jetë dyshues dhe as të dëgjojë mendime dyshuese për zgjidhjen e çështjeve, sidomos pas konsultimit, në të cilën ai duhet të thotë vendimin përfundimtar. Kjo është vendosmëria që përmendet në thënien e All'Ilahut të Lartësuar: **"Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek All'Ilahu."**

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se çështja e konsultimit përmendet në shumës **"këshillohu me ata"**, por vendimi i fundit është caktuar për Profetin, sepse pjesa tjetër e fjalisë së ajetit fillon me njëjës: **"Kur të vendosësh..."**

Ndryshimi në shprehje tregon për një pikë shumë të rëndësishme: ndryshimi i formës së çështjes, studimi i çështjeve sociale nga të gjitha anët duhet të bëhet në formë të përbashkët shoqërore, kurse vërtetimi i diçkaje dhe vendimi përfundimtar duhet të bazohet te një mendim. Përndryshe në shoqëri do të mbizotërojnë çrregullimi dhe rrëmuja. Kjo sepse, nëse do të ishin disa mendime, zbatimi i tyre do të sillte përçarjen në popull.

E njëjta situatë është edhe sot. Çështjet e ndryshme diskutohen dhe analizohen nga grupe të caktuara. Më pas vendimin e merr kryetari i grupit apo instancat shtetërore të drejtuara nga një person i caktuar.

Një tjetër çështje e rëndësishme që tregon fjalë e ajetit: **"Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek All'Ilahu"**, është se

marrja e vendimit përfundimtar duhet të shoqërohet me mbështetjen te All'llahu, që do të thotë: Ju duhet të kërkonit ndihmë nga All'llahu i Plotfuqishëm dhe mos e harroni Atë në kohën që përgatitni shkaqet dhe mjetet e ndryshme materiale që kanë të bëjnë me një çështje të caktuar.

Mbështetja tek All'llahu nuk do të thotë që njeriu të neglizhojë e të nënvleftësojë shkaqet materiale dhe mjetet e duhura për triumf, të cilat All'llahu i ka vendosur në botën materiale dhe e ka mundur njeriun të përfitojë prej tyre. Nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) transmetohet: *"Një ditë, një burrë prej banorëve të shkretëtirës, që do takonte Profetin e ka lënë devenë e tij të zgjidhur në shkretëtirë, duke menduar se me këtë veprim është mbështetur te All'llahu i Lartësuar."*

Profeti e pa dhe i tha: *"Lidhe devenë, pastaj mbështetu te All'llahu i Lartësuar."*<sup>1</sup>

Sigurisht që qëllimi i mbështetjes te All'llahu nuk është sipas këtij mendimi të gabuar të personit që përmendet te hadithi i lartpërmendur. Por kuptimi është që njeriu të mendojë edhe për shkaqet e ndryshme të çështjeve. Pas njohjes së shkaqeve të ecë përpara, duke e lidhur shpresën e tij në mbështetjen te All'llahu, në mbrojtjen dhe mëshirën e Tij.

Nuk ka dyshim se mbështetja te All'llahu i dhuron njeriut vendosmëri të madhe në veten e tij dhe një fuqi shpirtërore aktive, me të cilat mund t'u bëjë ballë të gjitha vështirësive, të zgjidhë dhe të largojë problemet që i dalin para. All'llahu i Lartësuar thotë në ajetin 2 të sures "El-Talak": **"Atij që është i devotshëm ndaj All'llahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi)."**

<sup>1</sup> "Irshadul Kulub", vëll. i 1, f. 121. "Fethul Bari", vëll. 10, f. 180.

Në mbyllje të këtij ajeti, All'llahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët të mbështeten tek Ai, sepse: **"Vërtet, All'llahu i do ata që mbështeten tek Ai."**

Ajo çfarë përfitohet nga ky ajet është se mbështetja tek All'llahu i Lartësuar duhet të jetë, sigurisht pas konsultimit dhe pas përfitimit prej të gjitha mundësive që u janë dhënë njeriut.

## 6- Rezultati i mbështetjes dhe frytet e tij

Pasi All'llahu i Lartësuar i nxit robtë e Tij të mbështeten te Ai, në këtë ajet, që është plotësues i ajetit të mëparshëm, sqaron rezultatin e mbështetjes, frytet dhe dobinë e madhe të saj, ku thotë: **"Nëse ju ndihmon All'llahu, s'ka kush t'ju mposhtë e, nëse ju lë pa ndihmën e Tij, kush është ai që do t'ju ndihmojë, përveç Tij?!"**

Me këtë All'llahu i Lartësuar tregon se forca dhe fuqia e Tij është mbi çdo forcë e fuqi tjetër. Nëse Ai dëshiron të mirësojë dikë apo ta përkrahë e ta mbrojë, nuk ka forcë a fuqi në Tokë që ta ndalojë, sado e madhe qoftë ajo. Kush beson All'llahun dhe i mbështetet Atij, ka burimin e të gjitha fitoreve.

Ky ajet, në thelb të tij, përmban nxitjen për besimtarët, që t'i mbështeten All'llahut Fuqiplotë e të Pamposhtur, pa harruar edhe shkaqet dhe mjetet e caktuara nga All'llahu.

Fjalët në ajetin e mëparshëm i drejtohen drejtpërdrejt Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe janë urdhër për të. Ajeti në fjalë (ajeti160) u drejtohet të gjithë besimtarëve, që edhe këta të mbështeten te Ai, ashtu si mbështetet Profeti.

All'llahu i Lartësuar e mbyll ajetin me këto fjalë: **"Pra, vetëm tek All'llahu le të mbështeten besimtarët."**

Përkrahja apo mospërkrahja e All'llahut për besimtarët nuk është pa llogari. Ato arrihen sipas punës dhe ndihmës që kanë dhënë. Kush kundërshton mësimet e All'llahut apo i lë pas dore ato, apo është i pavëmendshëm ndaj shkaqeve të caktuara, nuk e përfshin ndihma e All'llahut.

Krejt ndryshe ndodh me ata njerëz që janë të përgatitur për t'u përballuar me armikun, me rreshta të forcuar, me qëllime të pastra dhe me vendosmëri të lartë. Ata kanë përgatitur të gjitha mundësitë dhe mjetet e triumfit dhe i janë mbështetur All'llahut. Këtyre personave nuk ka për t'i munguar përkrahja dhe ndihma e All'llahut. Ai do të jetë me ta deri në fund. Deri sa të arrijnë fitoren.

## Ajeti 161

وَمَا كَانَ لِنَبِيٍّ أَنْ يَغُلَّ ۚ وَمَنْ يَغْلُلْ يَأْتِ بِمَا غَلَّ يَوْمَ الْقِيَمَةِ ۚ ثُمَّ تُوَفَّى  
كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿١٦١﴾

**“Është e pamundur për ndonjë profet që të përvetësojë në mënyrë të pandershme prenë e luftës. Kushdo që bën një gjë të tillë, do të vijë (i ngarkuar me të) në Ditën e Kiametit e pastaj do t’i jepet çdokujt ajo që ka merituar dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”**

### Komentimi

#### Tradhtia është e ndaluar rreptësisht

Duke parë ajetet e mëparshme, të cilat kanë zbritur pas ajeteve që flasin për Betejën e Uhudit dhe duke parë hadithet që përcjellin një grup komentuesish të Kur'anit nga gjenerata e parë, ajeti në fjalë konsiderohet si kundërpërgjigje ndaj justifikimeve të disa luftëtarëve. Sqarimi i kësaj çështjeje është: Disa harkëtarë, kur deshën të linin vendin e tyre delikat në mal, me qëllim që të mblidhnin plaçkat e luftës, udhëheqësi i tyre i urdhëroi që të qëndronin në pozicionet e caktuara, sepse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk do t’i linte pa u dhënë nga plaçkat e luftës.

Por ai grup lakmues ndaj kësaj bote kalimtare, fshehu të vërtetën, duke thënë se kemi frikë që i Dërguari i All'llahut nuk do të na kujtojë kur t’i ndajë plaçkat e luftës dhe ne nuk do të

marrim asgjë. Pasi thanë këto fjalë, lanë pozicionet e tyre të luftimit dhe shkuan për të mbledhur plaçkat e luftës. Me lënien e pozicionit të tyre të caktuar nga Profeti, ndodhi ajo që ndodhi, fatkeqësia dhe humbja.

Kur’ani Fisnik u kundërpërgjigjet hamendësimit të tyre: **“Është e pamundur për ndonjë profet që të përvetësojë në mënyrë të pandershme prenë e luftës.”**

Ju mendonit dhe hamendësuat se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do t’ju tradhtonte. Por Profeti nuk mashtron dhe nuk tradhton askënd.

Me të vërtetë, All’llahu i Lartësuar, me anë të këtij ajeti i pastron të gjithë profetët dhe të dërguarit nga tradhtia, duke thënë se, në parim, kjo çështje nuk është e drejtë për profetët dhe nuk përputhet me pozitën madhështore që ata kanë. Pra, tradhtia dhe mashtrimi nuk përshtaten me profecinë. Nëse i Dërguari do të ishte tradhtar e mashtrues, nuk do t’i besohej shpallja dhe predikimi i mesazhit të All’llahut.

Ky ajet ua mohon plotësisht mashtrimin dhe tradhtinë profetëve, qoftë tradhti në ndarjen e plaçkave të luftës, tradhti në ruajtjen e amanetit të njerëzve apo tradhti në deformimin e shpalljes së mesazheve qiellorë, etj.

Është e çuditshme që dikush t’i besojë besnikërisë së Profetit në ruajtjen e shpalljes dhe në predikimin dhe përcjelljen e saj, pastaj të mendojë, - All’llahu na ruajtë - që Profeti të tradhtojë e të mashtrojë në ndarjen e plaçkave të luftës apo të veprojë në atë që nuk është e drejtë, apo të gjykojë me padrejtësi, etj.

Është e qartë se tradhtia dhe mashtrimi është e ndaluar për çdo njeri, qoftë ky profet apo njeri i zakonshëm. Përderisa fjala është për fajësimet e atij grupi mosbindës dhe për hamendësimet e gabuara të tyre rreth profetit të nderuar, ky ajet në fillim flet për

profetët dhe më pas thotë që: **"Kushdo që bën një gjë të tillë, do të vijë (i ngarkuar me të) në Ditën e Kiametit"**, që do të thotë: Sigurisht që kushdo që tradhton, në Ditën e Kiametit, do të mbartë mbi shpatullat e tij dëshminë e tradhtisë dhe kështu do të turpërohet përpara të gjithëve, kur të zbulohet tradhtia dhe mashtrimi i tij.

Më poshtë ajeti thotë: **"Pastaj do t'i jepet çdokujt ajo që ka merituar dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi"**, shpjegon se njerëzit do të gjejnë po të njëjta punë e vepra në Botën Tjetër. Nuk i bëhet askujt padrejtësi, sepse gjithsecili do të shohë po atë punë dhe vepër që ka bërë në këtë jetë, e mirë apo e keqe qoftë.

Ajeti i mësipërm dhe hadithet e ardhura nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kanë ndikuar në urrejtjen e tradhtisë dhe të mashtrimit, duke rritur ndërgjegjen dhe moralin e myslimanëve. Si rezultat i këtij edukimi, nuk ka pasur tradhti dhe mashtrim jo vetëm në ndarjen e plaçkave të luftës, por edhe në pasurinë e përgjithshme. Është për t'u çuditur se, kur është bërë ndarja e pasurisë, ka pasur dhe pasuri, të cilat ishin shumë të vogla për nga vëllimi, por shumë të shtrenjta nga vlera, janë sjellë para Profetit që të ndahen.

Janë po të njëjtët arabë që kanë qenë në kohën e injorancës (para Islamit): të ashpër, të ftohtë, kusar rrugësh, ndërsa tani, nën hijen e edukimit islam, kanë arritur në shkallën më të lartë të udhëzimit, të besnikërisë, janë në rrugën e drejtë, të pastër dhe të devotshëm. Ata kanë arritur në atë gjendje të lartë shpirtërore dhe u duket se shohin tradhtarët se si në Ditën e Gjykimit mbartin mbi shpatullat e tyre atë çfarë kanë tradhtuar e mashtruar. Sigurisht që ky besim i ka ndaluar ata nga mashtrimi dhe tradhtia. Jo vetëm

kaq, besimi i bën ata që të mos mendojnë për tradhtinë e për mashtrimin.

Tabariu, në librin e historisë së tij, ka shkruar: “Kur myslimanët zbritën për të mbledhur plaçkat e luftës, një person ka ardhur te përgjegjësi i këtyre plaçkave dhe ka dorëzuar plaçkën që kishte mbledhur. Ata që ishin me të u habitën me veprimin e tij dhe thanë: “Është hera e parë që shohim diçka të tillë!” Kur e pyetën nëse kishte marrë gjë, ai iu përgjigj: “Beto hem në All’llah, se po të mos besoja në All’llahun, nuk do t’ua sillja juve.”

Të pranishmit e kuptuan se ky njeri ka pozitë të lartë. Ata e pyetën: “Kush je ti?”

Ai u tha: “Beto hem në All’llahun, nuk ua them që të më lavdëroni e as që të tjerët të më lavdërojnë. Por unë e lavdëroj dhe e falënderoj All’llahun e Lartësuar dhe jam i kënaqur me shpërblimin e Tij.”

## Ajeti 162-163

أَفَمِنْ أَتْبَعِ رِضْوَانِ اللَّهِ كَمَنْ بَاءَ بِسَخَطِ مَنِ اللَّهِ وَمَأْوَهُ جَهَنَّمَ ۚ وَبِئْسَ  
الْمَصِيرُ ﴿١٦٢﴾ هُمْ دَرَجَتٌ عِنْدَ اللَّهِ ۖ وَاللَّهُ بِصِرِّهِمْ بَايِعْمَلُونَ ﴿١٦٣﴾

**“Vallë, a mund të krahasohet ai që kërkon kënaqësinë e All’llahut me atë që ka merituar zemërimin e All’llahut dhe strehimi i tij është Xhehenemi?! Eh, sa strehim i keq është ai!**

**Tek All’llahu ata kanë shkallë të ndryshme; All’llahu i sheh të gjitha veprat që ata bëjnë.”**

### Komentimi

#### Kundërshtarët e xhihadit (luftës)

Ajetet e mëparshme trajtuan disa anë të Luftës së Uhudit, problemet dhe rezultatet e saj. Këtu i vjen radha hipokritëve dhe atyre që e kishin besimin të dobët prej myslimanëve, të cilët nuk morën pjesë në Luftën e Uhudit duke qenë hipokritë.

Nga hadithet e transmetuara lexojmë se kur Profeti urdhëroi për të dalë në Uhud, disa munafikë e kundërshtuan atë, duke thënë se nuk do të bëhet luftë. Shembullin e tyre e ndoqën disa myslimanë me besim të dobët. Atëherë zbriti thënia e All’llahut: **“Vallë, a mund të krahasohet ai që kërkon kënaqësinë e All’llahut...”** duke iu përgjigjur ftesës së Profetit dhe duke zbatuar urdhrin e tij për të dalë në fushën e betejës

**“...me atë që ka merituar zemërimin e All’llahut dhe strehimi i tij është Xhehenemi?!”**

Pastaj All’llahu i Madhëruar thotë: **“Tek All’llahu ata kanë shkallë të ndryshme...”**, që do të thotë se çdo njeri ka vendin e tij dhe pozitë te All’llahu. Ajeti tregon se jo vetëm hipokritët janë ndryshe nga muxhahidinët (përpjekësit, sakrifikuesit, luftëtarët) por, secili pjesëtar i këtyre dy grupeve ka shkallë të posaçme që i përshtatet përpjekjeve dhe sakrificave të tij në rrugën e All’llahut apo armiqësisë së tij ndaj All’llahut.

Transmetohet nga Imam Ali ibn Musa Rida (*Paqja qoftë mbi të!*) i cili ka thënë: *“Gradat dhe shkallët janë sa gjerësia ndërmjet qiellit e Tokës.”*<sup>1</sup>

Në një hadith tjetër thuhet: *“Me të vërtetë, banorët e Xhennetit do t’i shohin ata që kanë arritur grada të larta sikurse ju shikoni yjet në horizont.”*<sup>2</sup>

Duhet të dimë se fjala *derexhe* ka kuptimin e mjetit që përdor njeriu për të hipur në vende të larta. Kurse shkallëve që përdoren për të zbritur nga lart poshtë u thuhet *derken*. Për këtë, në Kur’anin e shenjtë, në suren “El-Bekare”, ajeti 253, thuhet për profetët: **“...kurse të tjerë i ngriti në shkallë të larta.”** Kurse për hipokritët, në suren “En-Nisa”, ajeti 145 thuhet: **“Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehennemit...”**

Meqenëse ajeti 163 flet për të dy grupet, për këtë është përdorur fjala *derexhe* - *shkallë* dhe *grada*. **“Tek All’llahu ata kanë shkallë të ndryshme.”**

All’llahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet me thënien: **“All’llahu i sheh të gjitha veprat që ata bëjnë.”** Sigurisht,

<sup>1</sup> Tefsiri “Nurul Thekalejn”, vëllimi 1, faqe 406.

<sup>2</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”; fundi i ajetit në fjalë.

All'llahu i Lartësuar është i Gjithëditur për të gjitha punët e njerëzve. Ai di edhe gradën që meriton gjithkush dhe kjo gardë është në përputhje me qëllimin, besimin dhe punën e tij.

### **Metoda ndikuese dhe edukuese kur'anore**

Ka shumë të vërteta që kanë lidhje me çështjet fetare, morale dhe shoqërore, të cilat Kur'ani i shenjtë i paraqet në formë pyetëso, duke ia lënë dëgjuesit dhe lexuesit të zgjedhë me anë të të menduarit të shëndoshë, të analizuarit dhe të nxjerrë përfundimet.

Këtë mënyrë, të cilën mund ta quajmë "*Mënyrë edukuese jo e drejtpërdrejtë*", ka një ndikim të madh në realizimin e qëllimeve të dëshiruara nga planprogramet e moralit dhe të etikës.

Dihet se njeriu, në përgjithësi, i jep rëndësi gjërave që ai i arrin vetë, si rezultat i mendimit të tij. Nëse i shtohet ndonjë çështje, ku duhet të japë një mendim të specializuar, nganjëherë bën rezistencë dhe ndoshta e shikon atë sikurse të ishte një mendim i huaj dhe i panjohur.

Nëse atij i parashtrohet një çështje në formën e pyetjes dhe i kërkohet të japë përgjigje sipas bindjes së tij personale, ai do ta dëgjojë përgjigjen në thellësi të ndërgjegjes së tij. Atëherë ai nuk mund t'i rezistojë e as nuk mund ta mohojë atë përgjigje. Por e shikon me shikimin e njohësit.

Me të vërtetë, kjo mënyrë drejtimi dhe udhëzimi ka një ndikim shumë të madh, jo vetëm te kundërshtarët, por edhe tek fëmijët dhe tek të rinjtë.

Kur'ani Fisnik, këtë mënyrë të mrekullueshme edukimi e përmend në shumë vende. Ndër to përmendim:

Në suren “Ez-Zumer”, ajeti 9: **“Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!”**

Në suren “El-Enam”, ajeti 50: **“Thuaj: “A barazohet i verbri me atë që sheh? A s’po mendoni?”**

Në suren “Er-Rrad”, ajetin 16: **“Thuaj: “A janë të njëjtë i verbëri dhe ai që sheh? Ose a janë njësoj terri dhe drita?”**

## Ajeti 164

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ يَتْلُوا عَلَيْهِمْ  
 ءَايَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِن كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي  
 ضَلَالٍ مُّبِينٍ

"All'Ilahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur'anin) e urtësinë, edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në humbje të madhe (të qartë)."

## Komentimi

### Mirësia e madhe e All'Ilahut

Ky ajet bën fjalë për mirësinë më të madhe të All'Ilahut, e cila është dërgimi i profetit të ndershëm dhe vula e profetëve, hazretit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Me të vërtetë, kjo është një përgjigje e fortë ndaj pyetjes që mund të bëjë dikush pas leximit të ajeteve që flasin për Betejën e Uhudit. Përse humbëm dhe përse na goditën gjithë këto ngjarje?" Kur'ani Fisnik u përgjigjet atyre: **"All'Ilahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre."**

Vërtet ju humbët Betejën e Uhudit dhe ju goditi ajo që ju goditi prej fatkeqësive, por nuk duhet të harroni se All'llahu ju ka dhuruar dhuratën më të madhe, të Dërguarin e fundit, i cili ju udhëzon dhe ju edukon juve, ju shpëton nga humbja. Sado të mundoheni ta ruani këtë mirësi të madhe, këtë dhuratë të çmuar dhe sado që t'ju kushtojë kjo, është shumë e paktë para vlerës së vërtetë që ka.

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se ai fillon me fjalën *menne*, e cila në fillim nuk mund të duket e përshtatshme. Por, nëse do të shohim rrënjën e kësaj fjale dhe originën e saj gjuhësore, çështja do të na sqarohet plotësisht. Fjala *menne*, siç thotë Ragib Asfahani në librin e tij “El Mufredat”, ka kuptimin e asaj që peshon. Për këtë, mirësisë së rëndë i thuhet *el minnetu*. Thuhet *menne filani filanin* - e rëndoi me mirësi të çmueshme dhe të rëndë.

Ndërsa *minnetu* përdoret për dikë që i ka bërë mirë dikujt. Kjo në vetvete është një dhuratë e çmuar.

Nëse kjo dhuratë, kur jepet, ekzagjerohet me fjalë, kthehet nga një dhuratë në një veprim të shëmtuar.

Dhurata ka dobi dhe të nxit për vepra të mira. Ndërsa ekzagjerimi me fjalë kufizon veprimet e mëtejshme të mira.

Veçimi i besimtarëve në përmendje në këtë ajet, ndërkohë që qëllimi i dërgimit është për mbarë njerëzimin, është bërë sepse besimtarët janë ata që përfitojnë më shumë nga kjo mirësi e madhe dhe ata e pasojnë atë ashtu siç duhet.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar thotë: “ **...nga gjiri i tyre.**” Një prej karakteristikave të këtij të dërguari është se ai është nga i njëjti lloj, prej njerëzve. Ai nuk është prej llojit të engjëjve.

Kjo me qëllim që të kuptojë të gjitha nevojat e njerëzve në mënyrën më të mirë. Të ndiejë dhimbjet dhe lëndimet e njerëzve,

problemet dhe fatkeqësitë e tyre. Te jetë i njohur me kërkesat e jetës dhe me çështjet e saj. Pastaj të veprojë atë që duhet të veprojë, që është edukimi dhe udhëzimi në rrugën e ndritur të dijes e të njohjes.

Pjesa më e madhe e programit edukativ të profetëve përbëhej nga predikimi i tyre praktik. Veprat e tyre ishin shembulli më i mirë dhe mënyra më e mirë për t'i edukuar të tjerët, sepse informimi me gjuhën e veprës ndikon dhe lë më shumë gjurmë. Kjo arrihet kur predikuesi është prej llojit të njerëzve, mbartës i veçorive dhe i tipareve njerëzore.

Nëse profetët do të ishin prej llojit të engjëjve, njerëzit do të thoshin se profetët nuk bëjnë mëkate, sepse janë engjëj, të cilët janë krijesa pa mëkate. Ato nuk kanë epshe dhe instinkte, as nuk nxehen, as nuk bërtasin dhe as që nuk kanë nevojë për gjë.

Prandaj profetët janë zgjedhur nga radhët e njerëzve, njerëz me instinkte dhe nevoja, që të jenë shembull për njerëzit dhe argument për ta. Nëse do të ishte e kundërta, nuk do të realizoheshin qëllimet e mesazhit dhe të profetësisë.

Më pas All'llahu i Lartësuar thotë misionet më të rëndësishme të këtij Profeti: **"...i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur'anin) e urtësinë."**

Sipas këtij ajeti, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kryen tre çështje ndaj tyre:

1 - Leximi i ajeteve të All'llahut në prani të tyre, duke i urdhëruar që të përsiatin ajetet dhe fjalët e All'llahut.

2 - Mësimi i tyre me kuptimin që këto të vërteta t'ua rrënjosë në thellësi të zemrave të tyre.

3- Pastrimi i shpirtave dhe zhvillimi i aftësive të tyre njerëzore dhe humane.

Me të vërtetë, ata që i largohen këtyre të vërtetave njerëzore, nuk është e lehtë që t'i nënshtrohen edukimit. Ky grup, patjetër, që në fillim duhet të dëgjojë për një kohë ajetet e All'llahut (Kur'anin), me qëllim që të largohet egërsia nga zemra e tyre. Kështu përgatiten për të hyrë në periudhën e mësimit. Pas kësaj mund të këpusin frytet e edukimit.

Ka një mendim tjetër për komentimin e këtij ajeti. Qëllimi i pastrimit është pastrimi nga mbeturinat e injorancës, të idhujtarisë (shirkut), nga mendimet e gabuara, nga morali i keq shtazor. Sepse, nëse ndërgjegjja e njeriut nuk është e pastruar, nuk mund ta mësojë Librin e All'llahut, as urtësinë dhe as dijen e vërtetë. Kjo është njësoj si një tabelë, e cila nuk pranon ngjyra të bukura nëse nuk fshihen ngjyrat e këqija që ndodhen mbi të.

Kjo është arsyeja që fjala *pastrim* përmendet para fjalës *mësim* në këtë ajet. Kuptimi i urtësisë është për njohjen e Islamit dhe mësimeve të tij madhështore.

## Kur njihet vlera e dërgimit të Profetit?

Rëndësia e kësaj mirësie madhështore (dërgimit të Profetit) qartësohet kur krahasohet gjendja e së kaluarës me të tashmen. Kjo është ajo çfarë thotë All'llahu i Lartësuar në këtë ajet: **"edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në humbje të madhe (të qartë)."** Duket sikur Kur'ani u thotë atyre: Mendoni të shkuarën e keqe që keni jetoni dhe shikoni se si jeni tani me ardhjen e Islamit.

Është e rëndësishme të meditojmë se Kur'ani e përshkruan kohën para Islamit më thënien: **"në humbje të madhe (të qartë)."**

Vërtet, humbja është e ndryshme. Prej humbjes është mosdallimi mes së drejtës dhe të padrejtës, të gabimit me të vërtetën. Para ardhjes së Islamit dhe para dërgimit të profetit Muhammed, në kohën e injorancës, banorët e Gadishullit Arabik ishin në humbje të madhe. Në atë shoqëri sundonte fatkeqësia, injoranca, prapambetja, degjenerimi, etj. Pas ardhjes së Islamit, gjendja e tyre ndryshoi. Këtë të vërtetë nuk mund ta fshehë askush.

## Ajeti 165

أَوَلَمَّا أَصَبْتُمْ مُمْصِيَةً قَدْ أَصَبْتُمْ مِثْلَهَا قُلْتُمْ أِنَّا هَذَا قُلٌ هُوَ مِنْ عِنْدِ  
أَنفُسِكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٦٥﴾

“Kur ju goditi fatkeqësia, ndërkohë ju i kishit goditur më parë armiqtë tuaj dyfish, ju thatë: “Prej nga na erdhi neve kjo?!” Thuaj (o Muhammed): “Kjo ndodhi prej jush.” Vërtet, All’lillahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”

### Komentimi

#### Studime të tjera rreth Betejës së Uhudit

Ky ajet përmban studime e mësimë të tjera rreth Betejës së Uhudit.

Disa myslimanë kanë ndier një pikëllim të thellë për rezultatin e kësaj beteje. Ata nuk mund ta fshihnin pikëllimin e sa herë që e kujtonin atë, pikëllimi dhe trishtimi zbriste në zemrat e tyre. All’lillahu i Lartësuar i kujton ata me tre pika të rëndësishme:

1- Duhet të mos pikëlloheni e të mos hidhëroheni ndaj rezultateve të ndonjë beteje, por duhet t’i llogaritni dhe t’i mendoni këto çështje, që të nesërmen të mos bëni të njëjtin gabim. Duhet ta studioni nga të gjitha këndvështrimet.

Mos harroni se ajo që ju ka goditur ju në këtë beteje, armiqtë tuaj i ka goditur në betejën e mëparshme. Mjafton të

bëjmë një krahasim midis dy betejave të zhvilluara: Betejës së Bedrit dhe Betejës së Uhudit.

Në Betejën e Bedrit, myslimanët vranë shtatëdhjetë armiq dhe po kaq zunë robër. Ndërsa në Betejën e Uhudit u vranë shtatëdhjetë myslimanë dhe nuk u zu rob asnjë. **"Kur ju goditi fatkeqësia, ndërkohë ju i kishit goditur më parë armiqtë tuaj dyfish."**

Sigurisht që kjo është me të vërtetë përgjigjja e pyetjes së parashtruar.

2- *Ju thatë: "Prej nga na erdhi neve kjo?!" Thuaj* (o Muhamed): **"Kjo ndodhi prej jush."** Sigurisht kjo është pasojë e qëndrimit tuaj në atë betejë. Shkaqet e humbjes kërkojini brenda vetes suaj. Ju thyhet urdhrin e të Dërguarit të All'Ilahut. Latë pozicionet e luftës në atë mal. Ju nuk ishit optimist për këtë betejë dhe nuk e çuat deri në fund, por u larguat për plaçkën e luftës. Kështu i latë rrugë të lirë armikut t'ju sulmonte. Ju u larguat nga fusha e betejës dhe nuk rezistuat kur ju sulmoi armiku nga ana e malit që ju e lëshuat.

Të gjitha këto të meta e mëkate, gjithë kjo plogështi është shkak i kësaj humbjeje fatkeqe, e cila çoi në vrasjen e atij grup të madh myslimanësh.

3- Ju nuk duhet të pikëlloheni e të shqetësoheni për të ardhmen, sepse All'Ilahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Nëse ju e ndreqni veten tuaj dhe i largoni ato dobësi e të meta, All'Ilahu do t'ju ndihmojë dhe fitorja do të jetë në duart tuaja. **"Vërtet, All'Ilahu sështë i Fuqishëm për çdo gjë."**

## Ajetet 166-167

وَمَا أَصْبَكُمْ يَوْمَ التَّقَىٰ الْجَمْعَانِ فَبِإِذْنِ اللَّهِ وَلِيَعْلَمَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٦٦﴾  
 وَلِيَعْلَمَ الَّذِينَ نَافَقُوا وَقِيلَ لَهُمْ تَعَالَوْا قَاتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَوْ ادْفَعُوا قَالُوا  
 لَوْ نَعْلَمُ قِتَالًا لَا تَبْعَنَكُمُ ۚ هُمْ لِلْكَفَرِ يَوْمَئِذٍ اقْرَبُ مِنْهُمْ لِلْإِيمَنِ ج  
 يَقُولُونَ بِأَفْوَهِهِمْ مَا لَيْسَ فِي قُلُوبِهِمْ ۚ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يَكْتُمُونَ ﴿١٦٧﴾

“Ajo që ju gjeti atë ditë, kur u ndeshën dy ushtritë, ishte me vullnetin e All’liahut - për të zbuluar se kush janë besimtarët e vërtetë.

Dhe, për të zbuluar se kush bën dyfytirësi. Atyre iu tha: “Ejani të luftoni në rrugën e All’liahut ose të paktën, mbrohuni!” Ata thanë: “Sikur ta dinim që do të bëhej luftë e vërtetë, me siguri, do t’ju pasonim.” Atë ditë ata ishin më afër mohimit sesa besimit, sepse me gojën e tyre flisnin atë që nuk e kishin në zemrat e tyre; All’liahut e di mirë çfarë fshehin ata.”

## Komentimi

### Rreshtat duhet të dallohen

Këto dy ajete flasin për një të vërtetë të madhe, që është: çfarëdo qoftë goditja (si ajo në Luftën e Uhudit), e cila nuk ka qenë pa shkaqe, ajo (goditja) është mjeti më i mirë për të dalluar luftëtarët e vërtetë nga hipokritët dhe të atyre me besim të dobët.

Për këtë, në pjesën e parë të ajetit 166 thuhet: **"Ajo që ju gjeti atë ditë, kur u ndeshën dy ushtritë, ishte me vullnetin e All'llahut."** Kuptimi i këtij ajeti është se ajo që ju goditi juve, ditën kur u ndeshët, myslimanë dhe idhujtarë, ishte me vullnetin dhe me dëshirën e All'llahut, sepse çdo dukuri në gjithësi është e krijuar nga All'llahu i Lartësuar dhe ka një shkak apo arsye të veçantë pse është krijuar.

Në thelb, kjo botë e krijuar, ecën sipas ligjit të shkaqeve. Ky është një realitet i vërtetë që nuk ndryshon.

Nëse një grup kapet pas kësaj bote kalimtare, pas pasurisë, duke neglizhuar dhe duke thyer urdhrat e udhëheqësve të tyre falës e zemërgjerë, fati i tyre është humbja dhe dështimi. Ky është edhe kuptimi i tokfjalëshit "me lejen e All'llahut", sepse leja e All'llahut dhe dëshira e Tij janë ato ligje dhe shkaqe që ka vendosur në galaktikë dhe në jetën e njerëzve.

Pastaj All'llahu i Lartësuar vazhdon: **"Për të zbuluar se kush janë besimtarët e vërtetë dhe për të zbuluar se kush bën dyfityrësi."**

Në të vërtetë, ajeti tregon një prej ndikimeve të asaj lufte që është dallimi i besimtarëve nga hipokritët dhe dallimi i atyre me besim të fortë prej atyre me besim të dobët.

Në Luftën e Uhudit janë dalluar tri grupe prej myslimanëve:

**Grupi i parë: Janë pakica.** Ata qëndruan dhe u përballën me armikun deri në fund. Një pjesë e tyre u vra, ndërsa pjesa tjetër mori plagë të rënda.

**Grupi i dytë: Të Lëkundshmit.** Ata ranë pre e frikës dhe nuk mundi të qëndronte deri në fund, por u largua nga fushëbeteja.

**Grupi i tretë: Hipokritët.** Ata u kthyen në mes të rrugës dhe nuk morën pjesë në luftë, duke u justifikuar me argumente të kota e të pabaza. Ky grup u kthye në Medinë. Kryetari i këtij grupi ishte Abdullah ibn Ebij Selul dhe treqind persona prej përkrahësve dhe ndjekësve të tij.

Sikur të mos ndodhte ngjarja e Uhudit, nuk do të dalloheshin rreshtat e myslimanëve, nuk do të dilnin në pah tiparet dhe veçoritë e çdo personi. Të gjithë do të mendonin se ata janë besimtarë të vërtetë, të devotshëm dhe se janë modeli që duhen të ndiqen.

Në të vërtetë ajeti tregon për dy çështje:

**E para:** Shkakun kryesor të humbjes.

**E dyta:** Rezultatin e humbjes.

Ajeti përmban një pikë që duhet përmendur: “... dhe për të zbuluar se kush bën dyfytirësi.” dhe nuk ka thënë hipokritët.

Thënë me fjalë të tjera: *hipokrizia* në këtë ajet përmendet në formë foljore dhe nuk përmendet si *cilësi*, sepse hipokrizia nuk kishte arritur në atë shkallë sa të gjithë të cilësohen me këtë epitet. Në librat e historisë ne lexojmë se disa persona nga ky grup u penduan, u udhëzuan në rrugën e drejtë të All'llahut dhe hynë në rreshtin e besimtarëve të vërtetë. Më poshtë Kur'ani paraqet dialogun mes disa myslimanëve dhe hipokritëve para betejës: **"Atyre iu tha: "Ejani të luftoni në rrugën e All'llahut ose të paktën, mbrohuni!"**

Ibn Abasi transmeton se kur Abdullah ibn Umer ibn Huzam pa tërheqjen e Abdullah ibn Ebij Selulit dhe largimin e tij nga ushtria islame, duke u kthyer në Medinë, i tha: *"Ejani të luftoni në rrugën e All'llahut. Nëse nuk doni të luftoni në rrugën e All'llahut, mbroni veten tuaj apo shenjtët tuaj."*<sup>1</sup>

Mirëpo ata u shfaqësuan duke përmendur shkaqe të kota: **Ata thanë: "Sikur ta dinim që do të bëhej luftë e vërtetë, me siguri, do t'ju pasonim."** Këto fjalë nënkuptojnë se ata thanë: "Ne mendojmë se nuk do të ketë luftë, prandaj nuk është nevoja e pranisë sonë me ju."

Sipas një komentimi tjetër, hipokritët thanë se, sikur ta dinim se me të vërtetë do të bëhej luftë, ne do t'ju ndihmonim e do t'ju ndiqnim. Por ne e konsideruam këtë një kërcënim, si pasojë e mospërputhjes së mendimeve të jobesimtarëve dhe myslimanëve. Pra, lufta mes tyre nuk ka qenë logjike. Përveç kësaj, ushtria myslimane u vendos në vendin e papërshtatshëm.

---

<sup>1</sup> Tefsir "Mexhamul Bejjan", fundi i ajetit në fjalë. "Biharul Anuar", vëll. 20, f. 37 (është për t'u përmendur se në disa burime thuhet: Abdullah ibn Umer dhe Huzam el Ensarij).

Këto ishin vetëm justifikime të kota, sepse lufta do të bëhej dhe se myslimanët triumfuan në fillim të saj. Ata humbën për shkak të gabimeve dhe moszbatimit të urdhrit të udhëheqësit të tyre. Po të mos kishin ndodhur ato gabime, nuk do të humbnin. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Atë ditë ata ishin më afër mohimit se sa besimit.”** Nga kjo fjali kuptohet se për besimin dhe mohimin ka grada që kanë lidhje me besimin e njeriut dhe formën e veprimit e të reagimit të tij.

Pastaj All'llahu tregon arsyen e tyre: **“... sepse me gojën e tyre flisnin atë që nuk e kishin në zemrat e tyre...”** Sigurisht që ata njerëz shfaqën të kundërtën e asaj që fshihnin në brenditë e tyre. Flasin të kundërtën e asaj që besojnë. Ata këmbëngulën që të luftonin brenda mureve të Medines: ose prej frikës së goditjeve të armikut, ose nuk e donin Islamin, prandaj nuk shkuan në luftë.

Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“All'llahu e di mirë çfarë fshehin ata.”** Me të vërtetë, All'llahu e di më së miri se çfarë fshehin ata në zemrat e tyre. Qëllimet e tyre do t'ua zbulojë myslimanëve në këtë botë dhe do t'i ndëshkojë ata në Botën Tjetër për gjithçka që kanë bërë dhe për të gjitha qëllimet keqdashëse ndaj Islamit dhe myslimanëve.

## Ajeti 168

الَّذِينَ قَالُوا لِلْخَوَانِمِ وَقَعْدُوا لَوْ أَطَاعُونَا مَا قُتِلُوا قُلْ فَادْرَءُوا عَنَّا

أَنفُسِكُمُ الْمَوْتَ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٦٨﴾

**"Atyre që nuk luftuan dhe thanë për vëllezërit e vet: "Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë", thuaju: "Prapësojeni vdekjen nga vetja, nëse flisni të vërtetën!"**

### Komentimi

#### Pretendimet e kota të hipokritëve

Hipokritët nuk u mjaftuan me mosluftimin me besimtarët dhe me përpjekjen për të dobësuar anën shpirtërore të të tjerëve. Por, ata fajësonin luftëtarët pasi u kthyen nga beteja, duke thënë: **"Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë."**

Në këtë ajet, Kur'ani Famëlartë u përgjigjet: **"Atyre që nuk luftuan dhe thanë për vëllezërit e vet: "Sikur të na kishin dëgjuar ne, nuk do të ishin vrarë", thuaju: "Prapësojeni vdekjen nga vetja, nëse flisni të vërtetën!"**

Me këto fjalë që thoni ju pretendoni se dini botën e të fshehtave dhe jeni të ditur për ngjarjet e së ardhmes. Nëse jeni të vërtetë në këtë që thoni, ndalojeni vdekjen nga vetvetja juaj e kthejeni atë pas, pasi, sipas këtij pretendimi, ju duhet ta dini

shkakun e vdekjes suaj dhe jeni në gjendje ta largoni apo ta ndaloni atë.

I drejtojmë disa pyetje: Ju nuk luftoni në betejat e luftës e të nderit. A mund t'i garantoni vetes suaj jetë të gjatë dhe të përhershme? A jeni në gjendje ta ndaloni përgjithmonë vdekjen tuaj?

E nëse ju nuk jeni të aftë ta ndaloni vdekjen, që është e patjetërsueshme për çdo njeri, përse ju po vdisni të përçmuar në shtratin e vdekjes dhe nuk zgjidhni martirizimin dhe vdekjen fisnike në fushën e xihadit kundër armiqve të All'llahut e të mesazhit?

Ajeti në fjalë përmban një pikë tjetër, e cila duhet përmendur, që është: Në këtë ajet, Kur'ani thotë se besimtarët janë vëllezër me hipokritët. Ndëkohë që asnjëherë besimtarët nuk kanë qenë vëllezër me hipokritët. Përse gjithë ky qortim dhe fajësim për hipokritët? Kuptimi është: "O hipokritë. Ju i konsideroni besimtarët vëllezërit tuaj. Si u larguat prej tyre dhe nuk i përkrahët në këto momente të rrezikshme? Për këtë, All'llahu i Madhëruar, në thënien "...**për vëllezërit e vet...**" e sqaron me thënien tjetër: "**Atyre që nuk luftuan...**", pra, ata që nuk morën pjesë në betejë.

A është e drejtë që njeriu ta quajë vëlla tjetrin, pastaj ta poshtërojë dhe të mos e përkrahë kur ka më shumë nevojë për ndihmë? A mund të rrijë duarkryq vëllai për vëllain?!

## Ajetet 169-171

وَلَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ قُتِلُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَمْوَاتًا ۚ بَلْ أَحْيَاءٌ عِنْدَ رَبِّهِمْ يُرْزَقُونَ  
﴿١٦٩﴾ فَرِحِينَ بِمَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۚ وَيَسْتَبْشِرُونَ بِالَّذِينَ لَمْ يَلْحَقُوا  
بِهِمْ مِنْ خَلْفِهِمْ ۖ أَلَّا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٧٠﴾ يَسْتَبْشِرُونَ  
بِنِعْمَةِ اللَّهِ وَفَضْلٍ وَأَنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١٧١﴾

**"Kursesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e All'lahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.**

**Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë All'lahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre, sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas).**

**Ata gëzohen me dhuntitë dhe mirësinë e All'lahut, sepse All'lahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve."**

## Komentimi

### Jeta e përjetshme

Disa komentues thonë se ajetet në fjalë kanë zbritur për dëshmorët e Luftës së Uhudit, të tjerë mendojnë se kanë zbritur për dëshmorët e Luftës së Bedrit.

E vërteta është se këto ajete kanë zbritur pas Luftës së Uhudit, duke u bazuar në lidhjen që kanë këto ajete me ajetet e mëparshme. Meqenëse përmbajtja e tyre është e përgjithshme, përfshin edhe dëshmorët që kanë rënë në Betejën e Bedrit, të cilët kanë qenë 14.

Në lidhje me këtë, Imam Muhamed Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Këto ajete kanë zbritur për dëshmorët e Bedrit dhe të Uhudit së bashku.”<sup>1</sup>

Ibn Mes’udi transmeton nga i Dërguari i All’llahut se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shkoi tek dëshmorët e Uhudit, kur ata ishin në Xhennet dhe u tha: “A keni nevojë për gjë?”

Ata iu përgjigjën: “Çfarë të dëshirojmë tjetër kur ne shëtisim ku të duam në Xhennet?!”

Këtë ua tha atyre tre herë. Kur kuptuan se nuk kishin çfarë të thonin, thanë: “Zoti ynë, dëshirojmë ta na i bashkosh shpirtrat tanë te trupat, që të luftojmë përsëri në rrugën Tënde, të biem përsëri dëshmor.”

<sup>1</sup> Tefsiri “Nurul Thekalejn”, vëllimi 1, faqe 409.

All'Ilahu i Lartësuar tha: *"Këtë gjë e kam caktuar më parë. Ata nuk do të kthehen."*

Ata i thanë: *"Na e përshëndet me selam Profetin dhe tregoi për gjendjen tonë fisnike e i thuaj të mos shqetësohet për ne."*Më pas zbritën këto ajete.<sup>1</sup>

Ajo që duket është se disa e kishin besimin të dobët, pas Betejës së Uhudit dhe ndienin keqardhje për dëshmorët e Betejës së Uhudit. Ata thoshin me njëri-tjetrin se si të kënaqemi me këto mirësi, kur vëllezërit dhe djemtë tanë kanë vdekur, janë zhdukur dhe nuk i shijojnë këto mirësi? Këto fjalë boshe të tyre dhe që ishin në kundërshtim me realitetin, ndikuan në dobësimin e anës shpirtërore të të afërmve të dëshmorëve.

Atëherë zbritën këto ajete, për të mohuar të gjitha këto mendime dhe për të treguar pozitën e lartë që kanë dëshmorët. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e All'Ilahut.** Pjesa e parë e ajetit i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'u thotë të tjerëve që të bëjnë vetëm llogarinë e tyre. Fjalja e fundit e ajetit tregon pozicionin se ku ndodhen dëshmorët në rrugë të All'Ilahut. **"...Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre."**

Qëllimi i jetës në këtë ajet është për Jetën e Berzahut, që është jeta pas vdekjes dhe para ringjalljes, nuk bëhet fjalë për jetë trupore dhe materiale. Të gjithë njerëzit bëjnë Jetën e Berzahut, por dëshmorët kanë një lloj jete shumë të lartë.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Durrul Menthur", vëllimi 2, faqe 95-96.

Kjo është pika e kërimit në këtë ajet të Kur'anit, që i kanë ndarë dëshmorët nga pjesa tjetër e njerëzve.

Me të vërtetë, jeta e tyre, e Berzahut është e mbushur me mirësi e dhurata të mëdha shpirtërore, si jeta e të gjithë njerëzve të tjerë në Berzah. Por jeta e dëshmorëve në Berzah nuk mund të krahasohet me asnjë lloj jete.

Ajeti tjetër tregon disa veçori të jetës së dëshmorëve (shehidëve) në Berzah. Dëshmorët janë të kënaqur për atë që u ka falur Zoti i tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë All'llahu nga dhuntitë e Tij...”**

Shkak tjetër i kënaqësisë dhe i gëzimit të martirëve, përveç mirësive të shumta që gjejnë në Xhennet, shohin edhe vendet e vëllezërve të tyre muxhahidë, të cilët presin të shijojnë krenarinë e martirizimit në rrugën e All'llahut. **“...dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre.”**

Më pas, All'llahu i Madhëruar thotë: **“...sepse nuk do të frikësohen dhe nuk do të pikëllohen.”** Kjo nënkupton se dëshmorët nuk frikësohen për fatin e tyre, nuk kanë frikë nga Bota Tjetër dhe njëkohësisht nuk pikëllohen se çfarë kanë lënë pas.

Ka komentim tjetër për këtë pjesë të ajetit: Dëshmorët ndihen të kënaqur kur shikojnë përpjekjet e vëllezërve të tyre për të arritur gradat më të larta, si dhe dëshirën e tyre për të rënë dëshmor. Dëshmorët nuk ndiejnë aspak frikë për veten e tyre, për të ardhmen dhe asnjë pikëllim për të shkuarën.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sipas komentit të parë për emrat te thënia: **“...sepse nuk do të frikësohen dhe nuk do të pikëllohen.”** nënkupton muxhahidët që jetojnë dhe nuk kanë rënë dëshmorë. Kurse sipas komentimit të dytë, për emrat nënkuptojnë vetë dëshmorët.

All'Ilahu i Lartësuar vazhdon e thotë: **"Ata gëzohen<sup>1</sup> me dhuntitë dhe mirësinë e All'Ilahut."**

Ky pjesë e ajetit e qartëson më shumë gjendjen e dëshmorëve. Ata janë të gëzuar e të kënaqur sepse:

**E para:** Mirësitë dhe dhuratat që u dhurohen janë të panumërta. Kjo mirësi e madhe e All'Ilahut nuk është vetëm për ta, por për të gjithë dëshmorët që bien në rrugë të All'Ilahut.

**E dyta:** Nga ana tjetër, ata shohin se All'Ilahu i Lartësuar nuk ia humb shpërblimin besimtarëve, qofshin ata dëshmorë apo jo. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"... sepse All'Ilahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve."**

Sigurisht që ata e kanë parë me sytë e tyre, e kanë dëgjuar me veshët e tyre atë që u është premtuar. Me të vërtetë, ky është gëzim i madh.

## **Dëshmia e qëndrimit të shpirtit**

Këto ajete të Kur'anit konsiderohen prej ajeteve të qarta rreth qëndrueshmërisë së shpirtit. Këto ajete flasin për jetën e dëshmorëve pas vdekjes dhe vrasjes. Disa mendojnë se qëllimi i përjetësisë, që jepet në këtë ajet, është me kuptim figurativ në përjetësimin e emrit të tyre, pasi vepra e tyre do të jetojë në kohë.

Ky mendim i tyre është i gabuar, sepse ajetet në fjalë thonë qartë se dëshmorët ushqehen nga Zoti i tyre dhe se ata janë të

---

<sup>1</sup> Në ajet, në gjuhën arabe, është përdorur folja *jestebshirune*, që do të thotë kënaqësi dhe gëzim për shkak të përgëzimit apo të shikimit të mirësisë për vete apo për të tjerët. Kjo fjalë nuk ka kuptimin e përgëzimit apo të myzhdesë.

gëzuar në të gjitha anët. Gjithashtu, këto ajete janë argument i qartë për çështjen e Berzahut dhe për mirësitë e kësaj jete.

Me shpresën e të Madhit Zot, më gjerësisht për këtë jetë do të flasim te ajeti 100 i sures “El-Muminun:” **“Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.”**

### Shpërblimi i Dëshmorëve

Flitet shumë për pozitën dhe vlerat e dëshmorëve. Çdo popull i vlerëson dhe i respekton dëshmorët e tij. Nuk ka asnjë shembull të ngjashëm me nderimin dhe pozitën që i jep Islami dëshmorëve në rrugën e All’llahut. Kjo e vërtetë nuk është ekzagjerim.

Hadithi i mëposhtëm është një shembull i qartë i respektit dhe i vlerësimit që i jep feja e drejtë islame dëshmorëve në rrugën e All’llahut. Nën hijen e mësimave të dëshmorëve, grupe të vogla arritën të fitojnë fuqi të mëdha, me anë të së cilës kanë gjunjësuar perandoritë më të fuqishme dhe kanë mposhtur fuqi më të mëdha. Hadithi është si vijon:

Imam Ali ibn Musa Rida (*Paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar nga Hysejn ibn Ali: “Ndërkohë që princi i besimtarëve po ligjëronte për veçoritë e Xhihadit, një djalë i ri u ngrit dhe tha: “O prijësi i besimtarëve, më trego mua për mirësitë e luftës në rrugë të All’llahut!”

Ai ia ktheu: “Të njëjtën gjë i kam pyetur edhe unë të Dërguarit të All’llahut kur udhëtonim me deve Udabaa (rracë deveje te arabët) dhe ai m’u përgjigj:

*"Nëse luftëtarët shkojnë në luftë, All'llahu u ka shënuar shpëtim prej zjarrit.*

*Kur ata përgatiten për luftë, All'llahu u krenohet engjëjve me ta.*

*Kur luftëtarët përshëndeten me familjarët e tyre, muret qajnë dhe shtëpitë pastrohen nga çdo mëkat. Çdo luftëtar i shkruhet një ditë adhurim sa adhurimi i njëmijë njerëzve adhurues.*

*Kur arrijnë ballë ballë me armikun, askush nuk e di shpërblimin e tyre te All'llahu.*

*Kur përballen me armikun, kur përplasen shpatat dhe lëshohen shigjetat dhe fillojnë duelet, melekët i mbulojnë këta luftëtarë me krahët e tyre dhe i luten All'llahut për fitore dhe qëndrueshmëri. Pastaj thërret një zë "Xheneti është nën hijet e shpatave." Atëherë goditja mbi dëshmorin është më e lehtë se pirja e ujit të freskët në ditët e verës.*

*Kur goditet dëshmori (shehidi) mbi kalë, nuk bie në tokë, deri sa All'llahu i Lartësuar i dërgon bashkëshorten e tij prej hyrive të Xhennetit dhe e përgëzon atë për atë çfarë i ka premtuar All'llahu prej mirësisë dhe nderimit. Kur bie në tokë, Toka i thotë: "Mirëserdhe o shpirt i pastër, që ke dalë nga trupi i pastër. Gëzohu se ty të pret ajo çfarë syri nuk e ka parë, as veshi nuk e ka dëgjuar dhe as mendja nuk mund ta imagjinojë." All'llahu u thotë: "Unë jam Mëkëmbësi i tij në familjen e tij (dëshmorit). Ai që i do ata, më do Mua. Ai që i zemëron ata, më ka zemëruar mua."<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> Kjo është një përmbledhje e transmetimit që e përmend komentuesi i madh islam, eruditi Tabarsij, në tefsirin e tij "Mexhmaul Bejjan"s, në fund të ajeteve në fjalë.

## Ajetet 172-174

الَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِلَّهِ وَالرَّسُولِ مِنْ بَعْدِ مَا أَصَابَهُمُ الْقَرْحُ لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا مِنْهُمْ وَاتَّقُوا أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿١٧٢﴾ الَّذِينَ قَالُوا لَهُمُ النَّاسُ إِنَّ النَّاسَ قَدْ جَمَعُوا لَكُمْ فَاخْشَوْهُمْ فَزَادَهُمْ إِيمَانًا وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ ﴿١٧٣﴾ فَانْقَلَبُوا بِنِعْمَةِ مِّنَ اللَّهِ وَفَضْلٍ لَّمْ يَمَسَّهْمُ سُوءٌ وَاتَّبَعُوا رِضْوَانِ اللَّهِ وَاللَّهُ ذُو فَضْلٍ عَظِيمٍ ﴿١٧٤﴾

“Ata që iu përgjigjën All’Ilahut dhe të dërguarit pas plagëve që i goditi dhe për ata që prej tyre vepruan mirë dhe u përkushtuan, ka shpërblim të madh.

Ata të cilëve njerëzit u thanë: “Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni atyre!” e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton All’Ilahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”

Ata u kthyen me dhuntitë dhe mirësitë e All’Ilahut, nuk i gjeti asgjë e keqe dhe fituan kënaqësinë e All’Ilahut. All’Ilahu është Zotërues i mirësive të mëdha.”

## Komentimi

### Beteja Hamraul Esed

Në ajetet më lart thamë se ushtria triumfuese e Ebu Sufjanit ndaj myslimanëve, nxitoi të kthehet në Mekë. Kur arriti në vendin e quajtur Er Reuha, u pendua që u kthye në Mekë dhe vendosi të kthehej dhe ta sulmonte ushtrinë islame. Ai dëshironte ta zhdukte Islamin, me qëllim që të mos mbetej asnjë gjurmë prej tij dhe prej myslimanëve.

Kur e mori vesh këtë lajm, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi ushtarët e tij të Uhudit që të përgatiten dhe të dalin edhe një herë në fushën e betejës dhe të luftojnë me ushtrinë e idhujtarëve. Në luftë do të merrnin pjesë edhe të plagosurit.

Një nga shokët e Profetit, që kishte marrë pjesë në Luftën e Uhudit, tregon: "Në luftë mora pjesë së bashku me vëllain tim. U kthyem nga lufta të plagosur. Kur Profeti bëri thirrje që të dilnin në luftë, thamë: "Nuk e lëmë vetëm Profetin në betejë." Betohem në All'llahun, ne nuk kishim as deve për të hipur dhe ishim të plagosur. Por dolëm me të Dërguarin e All'llahut. Unë kisha plagë më të lehta se vëllai im. Ecëm së bashku me të Dërguarin e All'llahut, deri sa arritëm në Hamraul El Esed.

Kur lajmi i shkoi Ebu Sufjanit dhe e kuptoi vendosmërinë e myslimanëve, ku në mesin e tyre ishin edhe të plagosurit, u frikësua dhe u trondit. Ai mendoi se radhët e myslimanëve janë forcuar me ushtarë të rinj.

Për këtë çështje ndodhi edhe një ngjarje që ia dobësoi akoma më shumë anën shpirtërore idhujtarëve dhe i plogështoi më shumë.

Ajo ngjarje ishte: Pranë Profetit kalon Muabed El Khuzaij, i cili në atë kohë ishte mushrik (idhujtar, politeist). Kur e pa gjendjen e Profetit dhe të shokëve të tij tha: “O Muhammed, betohem në All’llah, më ka ardhur keq për atë që të ka goditur ty dhe popullin tënd. Dëshirojmë që All’llahu t’ju shërojë.”

Kur u largua nga Profeti, takoi Ebu Sufjanin dhe ata që ishin me të në Reuha. Ata kishin vendosur që ta luftonin përsëri Profetin. Kur Ebu Sufjani e pa Muabedin, i tha: “Kush është pas teje o Muabed?”

Ai iu përgjigj: “Muhammedi, i cili ka dalë me shokët e tij për t’u përballuar me ju. Unë nuk kam parë tubim të njëjtë si ai. Ata ishin të zemëruar me ju.”

Ebu Sufjani tha: “O i mjeri ti, çfarë po thua?”

Muabedi iu përgjigj: “Betohem në All’llah, të shoh ty deri sa të shikosh balluket e kuajve.”

Ebu Sufjani ia ktheu: “Ne jemi mbledhur për t’i thyer e për t’i zhdukur ata.” Muabedi i tha: “Betohem në All’llah dhe të ndaloj nga kjo vepër.”

Ebu Sufjani, së bashku me ata që e shoqëronin, u tronditën dhe u kthyen me shpejtësi në Mekë, për të gjetur një rast tjetër, momentin e duhur.

Ai i tha një grupi prej fisit Benijj Abdul Kajs, të cilët po shkonin në Medine për të blerë grurë, që t'i thoshte profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ishte nisur për t'i sulmuar dhe për t'i shkatërruar. Pastaj u largua për në Mekë.

Ky grup e takoi Profetin në Hamraul Esed dhe ia transmetoi fjalët e Ebu Sufjanit.

Profeti tha: "Na mjafton All'llahu i Lartësuar! Sa Mbështetës i mirë është Ai!"

Ai qëndroi në këtë vend tre ditë duke pritur idhujtarët. Gjatë këtyre ditëve nuk pa asnjë gjurmë të ushtrisë së idhujtarëve. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u kthye në Medine.

Ajetet në fjalë tregojnë për këtë ngjarje dhe paqartësitë e saj.<sup>1</sup>

All'llahu i Lartësuar, në ajetin 172, thotë: **"Ata që iu përgjigjën All'llahut dhe të Dërguarit pas plagëve që i goditi dhe për ata që prej tyre vepruan mirë dhe u përkushtuan, ka shpërblim të madh."**

Ky ajet qartëson veçoritë e një grupi të caktuar, që janë të sinqertë në kryerjen e veprimeve dhe që kanë shpërblim të madh. Sepse në mesin e tyre kishte persona që nuk zotëronin atë sinqeritet të plotë e të duhur.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Nurul Thekalejn", "Mexhmaul Bejjan", Tefsiri "El-Menar" dhe libra të tjerë.

Fjala *minhum* - për ata tregon për grupin e luftëtarëve që nuk iu përgjigjen thirrjes për të dalë në luftë, duke nxjerrë argumente të kota.

Më pas Kur'ani Famëlartë sqaron një nga shenjat e gjalla të qëndrueshmërisë dhe të vendosmërisë së tyre: **“Ata të cilëve njerëzit u thanë: “Shumë njerëz po mbliidhen kundër jush, prandaj frikësohuni atyre!” e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton All’llahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”**

Njerëzit, për të cilët bën fjalë kjo pjesë e ajetit **“të cilëve njerëzit u thanë”**, janë karvani i Abdul Kajsit apo e Naim ibn Mes’udit, i cili solli lajmin, sipas një transmetimi.<sup>1</sup>

Pasi e tregon qartë këtë vendosmëri dhe besim të palëkundshëm, Kur’ani Fisnik përshkruan rezultatin e veprës së tyre: **“Ata u kthyen me dhuntitë dhe mirësitë e All’llahut.”** A ka mirësi më të madhe, se sa mposhtja e armikut më të rrezikshëm pa përplasje dhe kthimi i luftëtarëve shëndoshë e mirë në Medine?!

Na mbetet të mësojmë ndryshimin midis dhuntisë dhe mirësisë. Ndryshimi mund të jetë se mirësia është shpërblimi me masën e meritës, kurse dhuntia është përfitimi i tepërt mbi sasinë e meritës.

Këtë çështje e qartëson All’llahu i Lartësuar me fjalën e Tij: **“...nuk i gjeti asgjë e keqe dhe fituan kënaqësinë e All’llahut. All’llahu është zotërues i mirësive të mëdha.”**

---

<sup>1</sup> “Biharul Enuar”, vëllimi 19, faqe 147.

Me të vërtetë, ajo është një mirësi e madhe që i pret besimtarët e devotshëm dhe luftëtarët e sinqertë.

### **Edukimi hyjnor dhe shpërblimi i menjëhershëm**

Me të vërtetë, krahasimi i ndjenjave të myslimanëve në Betejën e Bedrit me ngjarjen Hamraul Esed, të cilën e shpjeguem më lart, të shkakton habi.

Si është e mundur që një grup i thyer, që nuk ka as forcë të lartë shpirtërore, as numër të mjaftueshëm pjesëtarësh, ku disa pjesëtarë kishin plagë të shumta, të ndryshojë strukturën e ushtrisë brenda një nate e një dite dhe të përgatitet aq mirë, sa të kërkojë me vendosmëri të përballet edhe një herë me armikun?

Kur'ani Famëlartë thotë: **"Atyre të cilëve njerëzit u thanë: "Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni atyre!" e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: "Neve na mjafton All'lahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!"** Ky është ndikimi i besimit me qëllim. Sa më shumë t'i shtohen problemet dhe vështirësitë njeriut besimtar, aq më shumë është i vendosur ta çojë misionin e tij deri në fund. Në këtë mënyrë gjithë qenia e tij forcohet dhe ai është i zoti t'i bëjë ballë vështirësive që i dalin para.

Vërtet, ky ndryshim i habitshëm, i shpejtë dhe madhështor në këtë periudhë të shkurtër kohore na sqaron ndikimin e madh të edukimit të Kur'anit, me të cilin ushqehet besimtari.

## Ajeti 175

إِنَّمَا ذَلِكُمُ الشَّيْطَانُ يُخَوِّفُ أَوْلِيَآءَهُ ۚ فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُوا إِن كُنتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿١٧٥﴾

**“Vetëm djalli i frikëson ithtarët e vet. Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!”**

### Komentimi

Ky ajet vjen pas ajeteve që kanë zbritur rreth Betejës së Hamraul Esedit.

Fjala *dhalikum* tregon për personat që i frikësonin myslimanët dhe tregon forcën e kurejshëve dhe dobësinë e anës shpirtërore të myslimanëve. **“Vetëm djalli i frikëson ithtarët e vet. Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!”**

Kuptimi i këtij ajeti është se veprimi i Naim ibn Mesudit apo i karvanit të Abdul Kajsit, janë prej veprave të shejtanit, që kërkon të frikësojë ithtarët e tij. Këto vesvese dhe dyshime ndikojnë veçanërisht te ndjekësit e shejtanit dhe të ithtarëve të tij. Besimtarëve të vërtetë nuk iu dridhen këmbët nga këto intriga dhe vesvese të shejtanit.

Naim ibn Mesudi apo karvani i Abdul Kajsit u cilësuan si “shejtanë”, sepse puna e tyre është prej punëve të shejtanit. Çdo vepër të keqe e të shëmtuar, që kundërshton fenë e All’llahut, Kur’ani Fisnik e quan punë të shejtanit, sepse me vesvesin dhe

cytjet e tij e nxit njeriun, duke e larguar nga rruga e drejtë, ose janë emërtuar të tillë se "shejtanë" janë po ata persona.

Kështu që ky kuptim është prej kuptimeve në të cilat thuhet emri i djallit për njeriun djallëzor. Kjo për shkak se fjala shejtan ka kuptim më të gjerë se sa përshkrimi i veprave të këtyre personave dhe ndjekësve të tij. Kjo fjalë përfshin çdo mashtrues dhe humbës, qoftë njeri apo qenie tjetër, siç lexojmë në ajetin 112 të sures "El-En'Am": **"Kështu, çdo profeti Ne i kemi caktuar armiq djajtë e njerëzve dhe të xhindeve..."**

Në mbyllje të këtij ajeti, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!"** Kjo do të thotë se besimi në All'llahun dhe frika ndaj dikujt tjetër përveç Atij, nuk mund të bashkohen. Këtë gjë e thotë edhe ajeti 13 i sures "El-Xhinn": **...e kush beson në Zotin e vet, nuk ka përse të frikësohet se mos dëmtohet, as se mos i bëhet padrejtësi."**

Nëse tek dikush ekziston frika ndaj diçkaje tjetër përveç All'llahut, kjo tregon se besimi i tij është i dobët dhe ndikohet nga vesveset e shejtanit dhe cytjet. Ne e dimë se s'ka strehues e as ndikues tjetër përveç All'llahut në këtë botë. Asnjë fuqi nuk mund të krahasohet me fuqinë e Tij të pakufishme.

Për këtë, sikur besimtarët të krahasojnë mbështetësin e tyre (që është All'llahu Fuqiptotë) me mbështetësin e idhujtarëve dhe të hipokritëve (që është shejtani), do të mësojnë se nuk ka forcë tjetër që mund të krahasohet me All'llahun. Prandaj, ata nuk frikësohen asnjë fije floku.

Në përmbledhje, themi se, aty ku është besimi, është fisnikëria dhe trimëria, të cilat gjatë sjetës nuk mund të ndahen.

## Ajetet 176 - 177

وَلَا تَحْزَنْكَ الَّذِينَ يُسْرِعُونَ فِي الْكُفْرِ إِنَّهُمْ لَن يَضُرُّوا اللَّهَ شَيْئًا يُرِيدُ اللَّهُ  
أَلَّا يَجْعَلَ لَهُمْ حِطًّا فِي الْآخِرَةِ وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿١٧٦﴾ إِنَّ الَّذِينَ اشْتَرُوا  
الْكُفْرَ بِالْإِيمَانِ لَن يَضُرُّوا اللَّهَ شَيْئًا وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٧٧﴾

“Ti mos u brengos nga ata që nxitojnë në mohim, sepse, në të vërtetë ata nuk mund ta dëmtojnë All’Ilahun aspak. All’Ilahu dëshiron që të mos i shpërblejë me kurrfarë dhurate në Botën Tjetër; dhe për ata ka ndëshkim të madh.

Ata që e ndërrojnë besimin e vërtetë me mohim, nuk mund t’i bëjnë kurrfarë dëmi All’Ilahut e për ta ka ndëshkim të dhembshëm.”

## Komentimi

### Mbështetja shpirtërore e Kur'anit për Profetin

Në këtë ajet: **"Ti mos u brengos nga ata që nxitojnë në mohim, sepse, në të vërtetë ata nuk mund ta dëmtojnë All'llahun aspak."** All'llahu i Lartësuar i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

All'llahu i Lartësuar e ngushëllon të Dërguarin e Tij pas ngjarjes së dhimbshme të Uhudit, duke i thënë: **"Ti mos u brengos nga ata që nxitojnë në mohim."** edhe pse ata garojnë me ty në çdo moment, **"ata nuk mund ta dëmtojnë All'llahun aspak."** Me këtë garim ata dëmtojnë veten e tyre. Përfituesit dhe dëmtuesit janë vetëm krijesat, sepse All'llahu është i Vetëmjaftueshmi, Absolut dhe besimi apo mohimi i njerëzve nuk sjellin dobi e as nuk e dëmtojnë Atë. Janë njerëzit ata që kanë dobi prej besimit të tyre, sepse me anë të besimit, arrijnë përsosmërinë. Nëse nuk besojnë, ata i bëjnë dëm vetes, pasi mosbesimi i çon në humbje e në shkatërrim.

Duhet shtuar se All'llahu i Lartësuar nuk harron qëndrimin e tyre barbar dhe kundërshtimin e urdhrave të Tij. Në Ditën e Kiametit All'llahu do t'i ndëshkojë për veprimet që kanë bërë. **"All'llahu dëshiron që të mos i shpërblejë me kurrfarë dhurate në Botën Tjetër; dhe për ata ka ndëshkim të madh."**

Në të vërtetë, ajeti thotë: Nëse ata garojnë në mosbesim, kjo nuk do të thotë që All'llahu nuk ka mundësi t'i frenojë e t'i ndalojë, pasi All'llahu kërkon që njerëzit të jenë të lirë në zgjedhjen e qëndrimeve e të rrugës që duan.

S'ka dyshim se, duke zgjedhur rrugën e mosbesimit, do t'u ndalohen mirësitë e All'lahut në Botën Tjetër.

Duke u bazuar në këtë, ky ajet jo vetëm që mohon imponimin (el-xhebr), por ai është prej argumenteve të qarta të lirisë së dëshirave të njeriut.

Ajeti në vazhdim jep një shpjegim të qartë të këtij realiteti: **“Ata që e ndërrojnë besimin e vërtetë me mohim, nuk mund t'i bëjnë kurrfarë dëmi All'lahut”**, që do të thotë se mohuesit dhe jobesimarët që garojnë në rrugën e mosbesimit, nuk janë të vetmit në këtë gjendje, por edhe ata që ecin në rrugën e mosbesimit me forma të ndryshme apo e këmbëjnë besimin me mosbesimin. Të gjithë ata nuk e dëmtojnë All'lahun, por ata dëmtojnë vetëm veten e tyre.

Pastaj All'llahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet duke thënë: **“për ta ka ndëshkim të dhembshëm.”** Ky dënim është sepse ata që u përmendën në ajetin paraardhës janë të drejtuar më shpejt kah mosbesimi. Për këtë, të gjithë ata që nuk ndjekin rrugën e All'lahut do të marrin dënimin që meritojnë në Jetën Tjetër.

## Ajeti 178

وَلَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّمَا نُمَلِّهِمْ  
خَيْرٌ لِّأَنفُسِهِمْ ۚ إِنَّمَا نُمَلِّهِمْ  
لِيَزِدَّادُوا إِثْمًا ۚ وَهُمْ عَذَابٌ مُّهِينٌ ﴿١٧٨﴾

**"Le të mos mendojnë kurrësesi jobesimtarët se për ata është mirë që ua zgjasim jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t'i shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues."**

### Komentimi

#### Të rënduarit me mëkate

Pas forcimit shpirtëror të profetit në ajetet e mëparshme dhe qetësimi i tij për atë që veprojnë armiqtë e Islamit, për të ndaluar përhapjen e tij, All'llahu u drejtohet me këtë ajet armiqve, duke u treguar të ardhmen e pashpresë të tyre. Ky ajet ka lidhje me ngjarjet e Uhudit.

Ky ajet është plotësues për kërkimet e studimet që flasin për këtë ngjarje. Në ajetet që kemi studiuar, All'llahu i drejtohej herë besimtarëve, herë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kurse në këtë ajet u drejtohet idhujtarëve dhe mohuesve.

All'llahu i Lartësuar në këtë ajet thotë: **"Le të mos mendojnë kurrësesi jobesimtarët se për ata është mirë që ua**

**zgjasim<sup>1</sup> jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t'i shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues."**

Me anë të këtij ajeti, All'llahu i Lartësuar u tërheq vërejtje idhujtarëve dhe jobesimtarëve që të mos mendojnë se shumica numerike, fitoret që arrijnë në disa raste, liria e veprimit dhe ana ekonomike që kanë janë argument se janë të mirë dhe këto janë shenjë se All'llahu është i kënaqur me ta. Kurrsesi.

Në këto ajete kur'anore përfitohet se All'llahu i Lartësuar u heq vërejtje mëkatarëve që nuk janë zhytur në gabime të mëdha. Arsyeja e këtij veprimi është se All'llahu Mëshirëplotë i lajmëron për ndëshkimet që ata do të marrin herën tjetër, nëse nuk ndjekin rrugën e së drejtës dhe të së mirës, rrugën e All'llahut. Kështu, All'llahu i përgatit ata që të ndjekin të vërtetën.

Ky grup akoma nuk e ka humbur mundësinë e udhëzimit. Nëse ata pendohen për veprimet e bëra, do t'i përfshijë mëshira e All'llahut. Sprovat që kalojnë janë mirësi për ta. Ato janë si zilja e alarmit për t'i zgjuar nga gjumi. All'llahu i Lartësuar, në ajetin 41 të sures "Er-Rum" thotë: **"Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (All'llahu) do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen."**

Por atyre që vazhdojnë në mëkate, që janë zhytur në to, që mizoria e tyre ka arritur kulmin, All'llahu i Lartësuar i poshtëron ata. Sigurisht, Ai ua zgjat jetën që t'u rëndohen shpinat me

---

<sup>1</sup> Në këtë ajet, në gjuhën arabe është përdorur fjala *numlij* që vjen nga fjala *el imlau*, që do të thotë *ndihmë* dhe *përkrahje*. Në të shumtën e rasteve kjo fjalë përdoret për të treguar kohëzgjatjen dhe shtyrjen e afatit që është një lloj ndihme. Në këtë ajet, kjo fjalë ka kuptimin e dytë, pra të kohëzgjatjes dhe të shtyrjes së afatit.

mëkatet e tyre dhe të meritojnë dënimin më të madh, që është ndëshkim i dhimbshëm e poshtërim për ta.

Këta njerëz kanë shkatërruar të gjitha urat, i kanë ndërprerë të gjitha lidhjet me All'llahun, nuk i kanë lënë vetes së tyre asnjë rrugë për t'u kthyer tek Zoti i tyre, si rrjedhim, kanë humbur të gjitha mundësitë për të pranuar udhëzimin hyjnor dhe mëshirën që rrjedh prej Tij.

Me të vërtetë, ky ajet: **"Le të mos mendojnë kurrsesi jobesimtarët se për ata është mirë që ua zgjasim jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t'i shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues"**, e forcon këtë kuptim.

Heroina e Islamit, Zejneb e bija e Ali ibn Ebu Talibit, këtë ajet e përmendi në fjalimin e saj kritikues, para tiranit të Shamit, Jezid ibn Muavije, ishte vërtetues i mëkatarëve dhe i kriminelëve, të cilët i shkatërruan urët e kthimit në vetat e tyre me veprat e këqija që bënë. Ajo i tha: *"O Jezid! A kujtove se jemi pa vlerë tek Allahu dhe se ti je i nderuar tek Ai? E kjo për rrezikshmërinë e madhe që tregon para Tij?! Ngre hundën dhe kontrollon dhembshurinë, tej mase i gëzuar, kur e sheh dynjanë të lidhur para teje dhe kur sheh se punët të shkojnë mbarë, ndërkohë që grabit pronat dhe pushtetin tonë? Ngadalë! Ngadalë! A e harrove fjalën e All'llahut të Madhëruar: **"Le të mos mendojnë kurrsesi jobesimtarët se për ata është mirë që ua zgjasim jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t'i shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues."***<sup>1</sup>

<sup>1</sup> "El Luhuf," f. 181. "Biharul Anuar", vëll. 45, f. 133 dhe 157.

## Përgjigjja e pyetjes

Ky ajet i përgjigjet pyetjes që bëjnë shumë njerëz: “Përse mburren disa mëkatarë dhe kriminelë për mirësitë dhe nuk marrin ndëshkimin e drejtë për krimet që kanë bërë?”

Me të vërtetë, Kur’ani Famëlartë i përgjigjet kësaj pyetjeje të përhapur tek njerëzit: Këta njerëz i kanë humbur të gjitha mundësitë për të ndryshuar dhe për të ndrequr veten e tyre. Në të gjitha këto veprime ata mbështeten te vetja, duke përgatitur vetë rënien e tyre. Nga veprimet e bëra meritojnë gjykim të ashpër.

Ajo çfarë përfitojmë nga ky ajet është se All’llahu i Madhëruar ua shton shumë mirësitë disave. Në fillim ua jep gradualisht. Kur janë në kulmin e mirësisë së tyre, ua rrëmben çdo gjë, duke i bërë të mjerë. Humbja e kësaj mirësie është ndër realitetet më të rënda dhe më të hidhura që mund të kalojë njeriu, siç thotë All’llahu i Madhëruar: **“Kur ata i harruan paralajmërimet Tona, Ne ua hapëm dyert e çdo mirësie. Por, sapo po gëzoheshin me atë që u dhamë, Ne i dënuam befasisht dhe atëherë ata u zhytën në dëshpërim.”**<sup>1</sup>

Shembulli i tyre është si shembulli i një personi që ngjitet në pemë. Sa më shumë që ngjitet, aq më shumë gëzohet, derisa arrin majën e saj. Papritur fryn një erë e fortë dhe ai bie menjëherë në tokë e thyen eshtrat e tij. Gëzimi i tij i madh shndërrohet në një pikëllim të thellë.

<sup>1</sup> Sure “En’am”, ajeti 44.

## Çështje gjuhësore dhe letrare

Ajo çfarë treguam qartëson komentimin e këtij ajeti. Germa *lam* në fjalën e All'Ilahut të Lartësuar **"për t'i shtuar gjynahet"**, që në shqip do të thotë *për* është përdorur për të treguar kuptimin ndëshkues dhe jo kuptimin për të arritur tek qëllim.

Qartësimi i kësaj është: Arabët e kanë përdorur germën *lam* për të qartësuar qëllimin e njeriut dhe kërkesën e tij, sikurse tek fjala e All'Ilahut të Lartësuar: **"për t'i nxjerrë njerëzit me lejen e zotit të tyre e nga errësira në dritë."**<sup>1</sup>

Është e pakundërshtueshme se udhëzimi i njerëzve e nxjerrja e tyre nga errësira në dritë është dëshira e All'Ilahut të Madhëruar.

Ka mundësi që arabët germën *lam* ta përdornin për të sqaruar rezultatin e punës së njeriut dhe të qëndrimit të tij siç thotë All'Ilahu i Lartësuar: **"Por atë e mori nga lumi familja e Faraonit, me qëllim që një ditë ai të bëhej armik dhe t'u sillte mjerim atyre, sepse Faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre kanë qenë gjynahqarë."**<sup>2</sup>

Nuk ka dyshim se ata e morën foshnjën për t'u bërë të lumtur. Kjo çështje nuk është e veçantë vetëm për gjuhën dhe në letërsinë arabe, por është e njohur edhe në gjuhët dhe letërsitë e tjera.

Nga këtu qartësohet përgjigjja e pyetjes tjetër: "Përse All'Ilahu i Lartësuar ka thënë **"për t'i shtuar gjynahet?"** Kuptimi i saj është se Ne, sigurisht duam që atyre t'u shtohen mëkatet.

---

<sup>1</sup> Sure "Ibrahim", ajeti 1.

<sup>2</sup> Sure "El- Kasas", ajeti 8.

Kjo pyetje apo paqartësi mund të jetë nëse germa *lam*, që përmendet në këtë ajet, të jetë me kuptimin e dëshirës dhe e qëllimit të bazuar në shkak dhe arsye dhe jo të jetë me kuptimin e ndëshkimit. Kuptimi i thënies është se fundi i tyre ndëshkues është për shkak të gjynaheve të tyre.

Duke u bazuar në këtë arsyetim, kuptimi i ajetit është se Ne e shtyjmë afatin e tyre të vdekjes, që mëkatet e tyre të shtohen. Ajeti nuk thotë absolutisht për imponimin e njeriut, por ai është argumenti më i mirë për lirinë dhe përzgjedhjen e njeriut në veprat e tij.

## Ajeti 179

مَا كَانَ اللَّهُ لِيَذَرَ الْمُؤْمِنِينَ عَلَىٰ مَا أَنْتُمْ عَلَيْهِ حَتَّىٰ يَمِيزَ الْخَبِيثَ مِنَ الطَّيِّبِ ۚ وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُطْلِعَكُمْ عَلَى الْغَيْبِ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَجْتَبِيٰ مِنْ رُسُلِهِ ۖ مَنْ يَشَاءُ ۖ فَعَامِنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ ۚ وَإِنْ تُؤْمِنُوا وَتَتَّقُوا فَلَكُمْ أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿١٧٩﴾

“All’llahu nuk i lë besimtarët në gjendjen që ndodheni ju, por do ta ndajë të keqin prej të mirit. All’llahu nuk do t’ua zbulojë të fshehtën, por All’llahu zgjedh kë të dojë nga të dërguarit e Tij. Besoni në All’llahun dhe në të dërguarit e Tij! Nëse besoni dhe i frikësoheni All’llahut, ju do të keni shpërblim të madh.”

## Komentimi

### Myslimanët në fushën e provimit dhe të ndarjes

Çështja e hipokritëve nuk është trajtuar para Luftës së Uhudit, sepse myslimanët nuk kanë ditur se ka armik tjetër përveç mohuesve dhe idhujtarëve. Humbja që patën në Betejën e Uhudit nxori në pah shumë dobësi, dalloi rreshtat e myslimanëve. Myslimanët nga kjo luftë mësuuan se ka një armik më të rrezikshëm se idhujtarët, hipokritët, prandaj ishte e detyrueshme që të diheshin lëvizjet dhe veprimtaritë e tyre. Çështja e dallimit të hipokritëve ishte prej rezultateve shumë pozitive e të rëndësishme të Betejës së Uhudit.

Ky ajet është nga ajetet e fundit që flasin rreth Luftës së Uhudit dhe ngjarjet e saj. Paraqet e qartëson këtë të vërtetë në formë ligji të përgjithshëm, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“All'llahu nuk i lë besimtarët në gjendjen që ndodheni ju, por do ta ndajë të keqin prej të mirit.”** Patjetër që duhet të dallohen rreshtat dhe të plotësohet veprimi i ndarjes mes të mirit, të pastrit dhe mes të keqit e të ndytit.

Ky është një ligj i përgjithshëm dhe i përhershëm i All'llahut. Jo të gjithë që pranojnë besimin islam, do të pranohen në rreshtat e myslimanëve, por do të sprovohen, për të zbuluar të vërtetën e tyre dhe për të parë se sa janë të denjë për të qëndruar në këto rreshta.

Këtu mund të shtrohet pyetja, (sipas disa haditheve na ka ardhur se kjo pyetje është shtruar edhe në mesin e myslimanëve në atë kohë):

"Nëse All'llahu di gjithë të fshehtat e njeriut, përse nuk i lajmëron njerëzit – nga rruga e dijes së fshehtë (gajbit), që ata ta dinë dhe të dallojnë besimtarin nga hipokriti?"

All'llahu i Lartësuar i përgjigjet kësaj pyetjeje në pjesën e dytë të këtij ajeti: **"All'llahu nuk do t'ua zbulojë të fshehtën"**, që do të thotë se All'llahu i Madhëruar nuk ua zbulon juve të fshehtat, sepse zbulimi i të fshehtave, sikurse mendojnë shumica, mund të zgjidhte problemin, por do të çonte në lindjen e problemeve shoqërore, duke e çuar atë drejt shkatërrimit. Do të çonte në shkëputjen e marrëdhënieve shoqërore, do të fikte dritën e shpresës në zemrat e njerëzve dhe njerëzit do ta ndërprisnin aktivitetin dhe lëvizjen e tyre.

Më e rëndësishmja e të gjitha këtyre është se duhet të qartësohet vlera e njeriut vetëm me anë të qëndrimeve, punëve dhe sjelljeve të tij. Edhe provimi dhe sprova nga ana e All'llahut këtë kuptim ka. Për këtë, rruga e vërtetë për njohjen dhe vlerësimin e njerëzve janë vetëm punët e tyre.<sup>1</sup>

Nga ky ligj, All'llahu i Lartësuar veçon profetët: **"...por All'llahu zgjedh kë të dojë nga të dërguarit e Tij."** Kjo ka

---

<sup>1</sup> Kjo pyetje ishte shtruar edhe në komentimin e ajetit 155 të sures "El-Bekare" në të cilin thuhej: **"Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe uri..."**. Ne iu përgjigjëm kësaj pyetjeje se provimi i All'llahut në realitet është një lloj edukimi praktik për njerëzimin dhe nuk ka kuptimin e njoftimit dhe të lajmërimit. Për sqarime të mëtejshme shiko komentimin e këtij ajeti në xhuzin e parë të këtij komentimi.

kuptimin se All'Ilahu, nga mesi i të dërguarve të Tij, zgjedh profetët, që t'ua zbulojë disa prej të fshehtave të kësaj bote. Megjithatë, punët mbessin kushti themelor e i përhershëm për njohjen dhe vlerësimin e njeriut.

Nga kjo shprehje kuptohet se profetët nuk dinë gjë nga e fshehta. Nëse dinë diçka nga e fshehta, kjo është se All'Ilahu, me dëshirën e Tij, ua ka mësuar këtë të fshehtë.

Është më se e qartë se dëshira e All'Ilahut në këtë ajet, përveç ajeteve të tjera, është “dëshira e shoqëruar me urtësinë”, që do të thotë se All'Ilahu i Lartësuar ia zbulon të fshehtën (gajbin) atij që i duket i përshtatshëm dhe meritues për të.

Në mbyllje të këtij ajeti, All'Ilahu i Lartësuar u kujton njerëzve: Meqenëse sot janë në fushën e provimit, të ndarjes e të dallimit të mirit nga i keqi, i besimtarit nga hipokriti, atëherë duhet të përpiqen dhe ta kalojnë me sukses këtë provim dhe të dalin kryelartë dhe fitimtarë. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Besoni në All'Ilahun dhe në të dërguarit e Tij! Nëse besoni dhe i frikësoheni All'Ilahut, ju do të keni shpërblim të madh.”**

Ajo për të cilën ia vlen të meditosh në këtë ajet është përshkrimi i besimtarëve me fjalën *et tajiib - i mirë, i singhtë dhe i devotshëm*. Dihet se i pastërti është i qëndrueshëm në pastërtinë e krijuar të tij dhe kjo pastërti nuk ndotet nga papastërtitë. Uji i pastër i besimit ushqen zemrat e tyre, duke i bërë të ndihen krenarë për jetën dhe veprat, si në këtë jetë ashtu edhe në Jetën Tjetër.

## Ajeti 180

وَلَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ يَبْخُلُونَ بِمَا ءَاتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ هُوَ خَيْرًا لَّهُمْ بَلْ هُوَ شَرٌّ لَّهُمْ سَيُطَوَّقُونَ مَا بَخِلُوا بِهِ يَوْمَ الْقِيَمَةِ وَلِلَّهِ مِيرَاثُ السَّمَوَاتِ  
وَالْأَرْضِ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿١٨٠﴾

“Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë All’llahu, kurrsesi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ta! Jo, kjo është më keq për ata! Ajo që kanë grumbulluar do t’u ngarkohet atyre në qafë Ditën e Kijametit. E All’llahut është trashëgimia e qiejve dhe e Tokës dhe All’llahu e di mirë ç’punoni ju.”

## Komentimi

### Qaforja e rëndë e robërisë

Ky ajet tregon për të ardhmen e koprracëve, për gjendjen e tyre në Ditën e Kijametit. Ata përpiqen gjatë gjithë jetës së tyre për të fituar sa më shumë pasuri. Pastaj nuk e shpenzojnë atë në rrugë të All’llahut dhe në dobi të robërve të tij.

Ajeti në fjalë, nuk flet qartë për zekatin apo për detyrimet e tjera financiare, por hadithet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe thëniet e komentuesve të Kur’anit e kanë përkufizuar këtë ajet se është për zekatin.

Këtë e përforcon edhe premtimi për ndëshkim, sepse premtimi për ndëshkim nuk mund të jetë në përputhje me shpenzimin e pëlqyeshëm (mendube, mustehabe).

Së pari, ajeti thotë: **“Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë All’llahu, kurrësi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ta!”** Më pas, All’llahu i Lartësuar përshkruan të ardhmen e tyre në Ditën e Gjykimit: **“Ajo që kanë grumbulluar do t’u ngarkohet atyre në qafë Ditën e Kijametit.”**

Sigurisht, pasuria që ata kanë mbledhur dhe u bënë koprracë ndaj saj, do t’u ngarkohet në qafë atë Ditë të Frikshme.

Nga kjo pjesë e ajetit kuptojmë se pasuria që nuk shpenzohet dhe nuk përfitojnë të tjerët prej saj, por shpenzohet për qejfe dhe zbavitje, apo shpenzohet pa kriter, apo shpenzohet për të plotësuar dëshirat e çmendura dhe jo në rrugë të All’llahut, do të jetë shkak për një dënim të dhembshëm të mbledhësve. Ajo do të jetë pranga që e burgosin të zotin e saj, pasi siç e dimë, në mbledhjen e pasurisë ka një kufi dhe nëse kalohet, pasuria kthehet në një skllavëri të rëndë, në një mëkat të shëmtuar.

Kjo pasuri nuk do të jetë qafore e rëndë për zotëruesin e saj vetëm në atë Ahiret, por e tillë është edhe në këtë jetë. A ka çmenduri më të madhe sesa kur njeriu grumbullon pasuri, mundohet ta ruajë, e numëron çdo ditë dhe së fundmi nuk përfiton prej saj as ai e as të tjerët? A nuk është kjo pasuri barrë e rëndë për të?!

Në tefsirin “Ajjashi” përmendet një hadith nga imam Bakiri (paqja qoftë mbi të!): *“Kush e ndalon zekatin e nuk e jep nga pasuria e tij, në Ditën e Gjykimit All’llahu i Lartësuar ia shndërron atë pasuri në*

*një gjarpër të madh. Pastaj i thuhet: "Ndiq atë, ashtu si të ka ndjekur ajo ty në këtë botë."*<sup>1</sup>

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është thënia për pasurinë: **"...me të mirat që ua ka dhënë All'llahu..."** Nga kjo thënie kuptohet se pronari i vërtetë dhe burimi i këtyre pasurive është vetëm All'llahu. Prandaj, njeriu nuk duhet të jetë koprrac dhe dorështrënguar në ato që i ka dhënë All'llahu, por duhet t'i shpenzojë në rrugën e Dhuruesit dhe të Dhënësit të asaj pasurie.

Disa komentues janë të mendimit se ky ajet përfshin të gjitha mirësitë e All'llahut, përfshirë edhe dijen. Por ky mendim nuk përputhet me të dukshmen e frazave të ajetit.

Më pas ajeti tregon një pikë tjetër: **"E All'llahut është trashëgimia e qiejve dhe e Tokës"**, që do të thotë se pasuria, shpenzohet apo nuk shpenzohet në rrugë të All'llahut, në fund ajo do të ndahet nga pronari i saj. All'llahu është trashëguesi i vërtetë i pasurive të qiejve dhe të Tokës dhe çfarë ndodhet në to. Është më e vlefshme të theksohet se njeriu duhet të përfitojë dobi shpirtërore nga pasuria e tij dhe të mos mbartë mëkatën dhe barrën e saj.

Në mbyllje të këtij ajeti, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...All'llahu e di mirë ç'punoni ju."** Sigurisht që All'llahu i di mirë veprat tuaja. Ai e di kur jeni koprracë, e di se si e shpenzoni pasurinë tuaj. Gjithsecili do të marrë atë që meriton.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Ajjashi", vëllimi 1, faqe 208.

## Ajetet 181-182

لَقَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ فَقِيرٌ وَنَحْنُ أَغْنِيَاءُ سَنَكْتُبُ مَا  
قَالُوا وَقَتْلُهُمُ الْأَنْبِيَاءَ بِغَيْرِ حَقٍّ وَنَقُولُ ذُوقُوا عَذَابَ الْحَرِيقِ ﴿١٨١﴾ ذَلِكَ  
بِمَا قَدَّمْتُمْ أَيْدِيكُمْ وَأَنَّ اللَّهَ لَيْسَ بِظَلَّامٍ لِّلْعَبِيدِ ﴿١٨٢﴾

“Sigurisht që Allahu i ka dëgjuar fjalët e atyre (çifutëve) që thanë: “All’llahu është i varfër, kurse ne jemi të pasur.” Ne do ta shënojmë atë që thanë, si dhe vrasjen e profetëve nga ana e tyre pa kurrfarë të drejte dhe do t’u themi atyre: “Shijoni dënimin në zjarr!

Ky është ndëshkimi i veprave të duarve tuaja, se All’llahu nuk është i padrejtë ndaj robërve të Vet.”

## Shkaku i zbritjes

Ky ajet ka zbritur si përgjigje dhe qortim për jahudinjtë.

Transmetohet nga ibn Abbasi: "Profeti Muhammed i shkroi një letër jahudinjtë të Beni Kajnaka'a dhe i ftoi ata të falin namazin, të japin zekatin dhe të japin kredi për hir të All'llahut, të shpenzojnë në rrugën e All'llahut. (Ai e quajti kredi të mirë, që t'i vinte në lëvizje ndjenjat e tyre ndaj njerëzve.)

Profeti hyri në Bejul Medaris, shkolla në të cilën jahudinjtë mësonin fenë e tyre dhe ia dorëzoi letrën Fenhasit, një prej të mëdhenjtë jahudinj. Kur e lexoi letrën, tha me ironi: "Nëse ajo që thoni është e vërtetë, atëherë All'llahu është i varfër dhe ne jemi të pasur. Po të ishte i pasur, nuk do të huazonte prej nesh."

Këtu e kishte fjalën për thënien e All'llahut: **"Kush është ai, që do t'i japë vullnetarisht All'llahut një hua të mirë..."**<sup>1</sup> Krahës kësaj, Muhammedi beson se All'llahu ju ka ndaluar prej kamatës. Ai ju premton se do t'ua shtojë mirësitë, nëse shpenzoni duke treguar thënien e All'lahut: **"...kurse e rrit përfitimin e bamirësisë..."**<sup>2</sup> Por Fenhas mohoi që ai ka thënë diçka të tillë. Për këtë zbritën dy ajetet në fjalë.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Sure "Hadijd", ajeti 11 dhe sure "El-Bekare", ajeti 245.

<sup>2</sup> Sure "El-Bekare", ajeti 276.

<sup>3</sup> Esbabu Nuzul, i Uakidij, f. 88 dhe 99. Tefsiri "Ruhul Bejan", Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i komentimit të ajetit në fjalë.

## Komentimi

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **“Sigurisht që All’llahu i ka dëgjuar fjalët e atyre (çifutëve) që thanë: “All’llahu është i varfër, kurse ne jemi të pasur.”** Kuptimi i kësaj thënieje është se, nëse ata do t’ua fshihnin njerëzve atë që thanë, por kurrësi All’llahut, sepse Ai është Dëgjues dhe e dëgjon atë fjalë për fjalë. Prandaj nuk është nevoja e mohimit. All’llahu i Madhëruar dëgjon edhe zërat shumë të dobët, të cilët veshët e njerëzve nuk i dëgjojnë. **“Sigurisht që All’llahu i ka dëgjuar fjalët e atyre (çifutëve) që thanë: “All’llahu është i varfër, kurse ne jemi të pasur.””**

Pastaj, All’llahu i Madhëruar thotë: **“...Ne do ta shënojmë atë që thanë...”** pra, çdo gjë që thanë, Ne jo vetëm që e kemi dëgjuar, por do ta shënojmë të plotë.

Është e natyrshme se kuptimi i shënimit nuk është si shënimi i njohur në këtë jetë. Por kuptimi i tij është ruajtja e gjurmëve të punës, e cila qëndron e përhershme sipas ligjit të qëndrueshmërisë së përhershme “fuqi- materie.”

Edhe shënimi i punëve nga ana e engjëjve, të cilët All’llahu i ka caktuar për shënimin e veprave të njerëzve, është shënim ndryshe për ruajtjen e punëve. Ai shënim është në shkallë të lartë.

Më pas All’llahu thotë: **“...si dhe vrasjen e profetëve nga ana e tyre pa kurrfarë të drejte...”** Ne nuk do të mjaftohemi vetëm me shënimin e fjalëve të kota të tyre, por do të shënojmë edhe veprimin e tyre të poshtër, vrasjen e të dërguarve.

Kjo do të thotë se kundërshtimi dhe luftimi i profetëve nga ana e jahudinjeve nuk është diçka e re. Kjo nuk është hera e parë ku jahdinjtë tallen me një të dërguar. Historia e tyre është e mbushur plot me tallje, krime, vrasje dhe poshtërsi. Poshtërsia dhe kriminaliteti i tyre arriti deri në vrasjen e një grupi të dërguarish. Prandaj, askush nuk duhet të habitet prej fjalëve mohuese të tyre.

Mund të thuhet se vrasja e profetëve nuk kishte lidhje me jahudinjtë e kohës së profetit Muhammed. Atëherë, përse të ngarkohen me faj e gjynahe këta? Ne themi se kjo u përshtatet edhe atyre, sepse ata kanë qenë pro veprave të të parëve të tyre jahudinj. Për këtë ata janë pjesëtarë në gjynah dhe në mëkat ndaj asaj pune mëkatore.

Kurse shënimi dhe regjistrimi i punëve të tyre nuk bëhen pa qëllim. Të gjitha ato do t'ia paraqesim në Ditën e Gjykimit. Ne do t'u themi atyre se ky është rezultati i punëve të tua. Ato janë trupëzuar në formën e ndëshkimit përvëlues: **"...dhe do t'u themi atyre: "Shijoni dënimin në zjarr!"**

Vërtet, ky dënim i rëndë që do të merrni është për shkak të rezultatit të punëve tuaja. Ju i bëtë padrejtësi vetes tuaj: **"Ky është ndëshkimi i veprave të duarve tuaja, se All'llahu nuk është i padrejtë ndaj robërve të Vet."**

Nëse ju dhe të ngjashmit me ju prej kriminelëve dhe mëkatarëve, nuk do të merrni aq sa meritoni për punët tuaja të poshtra, ky është kulmi i padrejtësisë. Nëse All'llahu nuk do të gjykonte drejt, do të ishte padrejtësi për njerëzit.

Por All'llahu nuk i bën padrejtësi askujt dhe Ai urdhëron që sunduese të jetë drejtësia në çdo çështje të jetës.

Në librin “Nehxhul Belaga, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) thotë: *“Betohem në All’llah se të mirat e një populli i cili jetonte me to u zhdukën prej gjynaheve që bënë, sepse All’llahu nuk i bën padrejtësi askujt.”*<sup>1</sup>

Ky ajet radhitet prej ajeteve që në nga njëra anë mohojnë thënien e atyre që thonë për detyrimin (xheberijin), nga ana tjetër, përgjithëson çështjen e drejtësisë në çdo vepër të All’llahut. Pra, të gjitha veprat e All’llahut janë në përputhje me drejtësinë.

Për më shumë sqarim themi se njerëzit do të shpërblehen dhe do të ndëshkohen nga ana e All’llahut sipas punëve dhe veprave të tyre, si dhe duke u bazuar në zgjedhjen e tyre. **“Ky është ndëshkimi i veprave të duarve tuaja...”**

Në fund ajeti thotë: **“...se All’llahu nuk është i padrejtë ndaj robërve të Vet.”** Pra, ligji i Tij në shpagim bazohet në drejtësi absolute. Ky është i njëjti besim në drejtësinë e All’llahut, të cilin besojnë disa grupe, si: shiat dhe mu’tezilet prej Ehli Sunnetit.

Mirëpo një grup tjetër prej Ehli Sunnetit, që quhen El Eshaireh, kanë një besim të habitshëm në këtë çështje. Ata thonë: *“Vërtet, All’llahu është Zotëruesi i gjithçkaje, vepron çfarë të dojë dhe sundon si të dojë. Nëse i fut të gjitha krijesat në Xhennet, nuk është padrejtësi. Nëse i fut në zjarr, nuk është padrejtësi ... nuk mund të imagjinohet padrejtësia prej Tij dhe nuk i vishet Atij padrejtësi.”*<sup>2</sup>

Ajeti në fjalë i hedh poshtë dhe i kundërshton plotësisht këto lloj mendimesh dhe thëniesh. Ai thotë shumë qartë: **“Ky**

<sup>1</sup> Nehxhul Belaga, fjalimi 178.

<sup>2</sup> Shih El Milêl dhe Nihal i Shehristanit. Botuar në Bejrut, vëll. 1, f. 101. Tahkijik: Muhamed el Kijlanij.

**është ndëshkimi i veprave të duarve tuaja, se All'llahu nuk është i padrejtë ndaj robërve të Vet."**

Fjala *dhal'lam* që gjendet në ajet është në shkallën sipërore dhe ka kuptimin e padrejtësisë së shumtë.

Edhe pse All'llahu nuk i bën padrejtësi askujt, ka mundësi që përdorimi i kësaj fjale në këtë vend është: në qoftë se All'llahu i detyron njerëzit të bëjnë mohim, gjynah apo një punë tjetër të keqe, pastaj i dënon ata për atë që bënë, kjo nuk është padrejtësi e vogël, por padrejtësi shumë e madhe (*dhal'lamen*).

## Ajetet 183-184

الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ عَهِدَ إِلَيْنَا أَلاَّ نُؤْمِنَ لِرَسُولٍ حَتَّى يَأْتِينَا بَقُرْبَانٍ  
تَأْكُلُهُ النَّارُ قُلْ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّن قَبْلِي بِالْبَيِّنَاتِ وَبِالذِّى قُلْتُمْ فَلِمَ  
قَتَلْتُمُوهُمْ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٨٣﴾ فَإِنْ كَذَّبُوكَ فَقَدْ كَذَّبَ رَسُولٌ مِّن  
قَبْلِكَ جَاءُوا بِالْبَيِّنَاتِ وَالزُّبُرِ وَالْكِتَابِ الْمُنِيرِ ﴿١٨٤﴾

“Atyre që thonë: “All’lillahu na ka urdhëruar që të mos i besojmë asnjë të dërguari, derisa të na sjellë një kurban që ta përpijë zjarri”, thuaju (o Muhammed): “Të dërguarit para meje ju kanë sjellë juve prova të qarta, si dhe atë që thoni ju, atëherë, pse i vratë ata, nëse thoni të vërtetën?”

“Nëse ata ty (o Muhammed) të quajnë për gënjeshtar, edhe të dërguar të tjerë që kanë ardhur para teje janë përgënjeshtuar, ndonëse kanë sjellë shenja të qarta, shkrime dhe Librin e ndritur.”

## Shkaku i zbritjes

Një grup prej parisë së jahudive shkoi tek i Dërguari i All'llahut dhe i tha: "O Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me të vërtetë, All'llahu na ka premtuar në Teurat që të mos i besojmë asnjë të dërguari (profeti) derisa të na sjellë një kurban që ta përpijë zjarri. Meqë ti thua se je i Dërguari i All'llahut, na e sill ne atë kurban, që ne të të besojmë ty se je i Dërguari i All'llahut." Atëherë All'llahu zbriti këto dy ajete.<sup>1</sup>

## Komentimi

### Idetë e gabuara të jahudive dhe shpjegimet e tyre

Jahuditë debatonin dhe sillnin argumente me qëllim që të mos bashkoheshin me flamurin e Islamit. Prej ideve të gabuara të tyre ishte edhe ajo që përmend ajeti i parë prej ajeteve në fjalë: **Atyre që thonë: "All'llahu na ka urdhëruar që të mos i besojmë asnjë të dërguari, derisa të na sjellë një kurban që ta përpijë zjarri..."**

Komentuesit kanë thënë: "Jahuditë thonin se kjo mrekulli duhet të ishte e posaçme për profetët. Pra, të presin kurban dhe të zbresë një zjarr prej qielli dhe ta përpijë atë kurban të tyre.

Ky veprim do të ishte argument për vërtetësinë e profecisë dhe prerësi i kurbanit është prej të afërmve të All'llahut.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", Tefsiri "Kurtubij", "Biharul Enuar", vëllimi 9, faqe 73 dhe 192.

Sikur jahuditë të ishin të singertë në kërkesën e tyre dhe vërtet ata të kërkonin shfaqjen e mrekullisë dhe jo kokëfortësinë dhe mospranimin, mund të ishin të justifikuar. Mirëpo, historia e tyre e zymtë dhe qëndrimi i padrejtë i tyre ndaj Profetit flet krejt ndryshe nga ajo çfarë thonë ata.

Historia tregon se ata nuk kanë qenë asnjëherë kërkues të së vërtetës dhe të dijes, por çdo ditë kanë sjellë një ide të gabuar apo ndonjë propozim, për t’iu kundërvënë Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kur’ani, me mirësinë e tij nuk u ka krijuar vështirësi njerëzve, por përkundrazi, ka sjellë argumente të qarta e të forta. E vërteta është se jahuditë kanë lexuar në librat e tyre për Profetin e fundit që do të vijë, madje librat e tyre ua kanë treguar shenjat e ardhjes së tij. Ata e mohuan dhe e refuzuan të vërtetën.

Por Kur’ani Famëlartë u përgjigjet atyre duke u thënë: “... **thua ju (o Muhammed): “Të dërguarit para meje ju kanë sjellë juve prova të qarta, si dhe atë që thoni ju, atëherë, pse i vratë ata, nëse thoni të vërtetën?”** Kjo pjesë e ajetit tregon për Zekerijën, Jahjanë dhe për një grup profetësh, të cilët janë vrrarë nga duart e bijve të Izraelit.

Disa komentues të kohës së sotme, si autori i tefsirit “El-Menar”, mendojnë diçka tjetër rreth çështjes së kurbanit. Shkurtimisht po e përmbledhim:

Me të vërtetë, qëllimi i tyre nuk ka qenë që Profeti të presë kurban dhe të zbresë nga qielli zjarr në formën e mrekullisë dhe ta përpinte atë kurban.

Por qëllimi i tyre ishte se në mësimet e fesë së tyre gjendej një lloj kurban, i cili therej në mënyrë të veçantë dhe në ceremoni të caktuar. Pastaj këtë kurban e digjin në zjarr. Ky është shpjegimi që jepet në kapitullin e parë të librit të Leviteve nga Teurati (Testamenti i vjetër).

Ata thonin: "All'llahu na ka premtuar se të tilla mësimet dhe i tillë kurban do të jenë në çdo fe qiellore. Përderisa shembullin e këtij kurban nuk e gjejmë në mësimet e fesë islame, ne nuk të besojmë ty o Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).<sup>1</sup>

Por ky mendim është larg komentimit të këtij ajeti, sepse:

**Së pari:** Kjo fjali e ajetit është e lidhur me frazën "argumente të qarta". Qëllimi i tyre ka qenë një vepër mrekullie dhe kjo nuk përshtatet me këtë mendim.

**Së dyti:** Me të vërtetë, therja e një kafshe, pastaj përpirja, djegia e saj me zjarr është një veprim i pabazë dhe pagan. Ky nuk mund të jetë prej mësimëve të Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) dhe as prej rregullave qiellore.

Në ajetin e mëposhtëm All'llahu i Lartësuar, thotë: "**Nëse ata ty (o Muhammed) të quajnë për gënjeshtar, edhe të dërguar të tjerë, që kanë ardhur para teje janë përgënjeshtuar...**"

Me këtë ajet All'llahu e qetëson të Dërguarin e Tij duke i thënë se, nëse të mashtrojnë e të përgënjeshtrojnë ty, ti mos u shqetëso e as mos u pikëllo për këtë. Kjo është metoda dhe edukata e tyre.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "El-Menar" komentimi i këtij ajeti.

Kështu janë sjellë edhe me profetët që kanë qenë përpara teje. Ata i kanë përgënjeshtuar dhe e kanë kundërshtuar me kokëfortësi thirrjen e tyre.

Ata profetë nuk kanë thënë veçse argumente për të vërtetuar sinqeritetin dhe madhështinë e misionit të tyre **“...kanë sjellë shenja të qarta, shkrime dhe Librin e ndritur.”**

Duhet që të shikojmë me kujdes fjalën *zibur*, që është shumësi i fjalës *zebur*, që do të thotë *libër, temat e të cilit janë të qarta*.

Rrënja e fjalës *zebur* do të thotë *shkrime* dhe jo shkrim i plotë, por shkrim i sigurt dhe i shpjeguar.

Ndryshimi mes fjalës *zibur* dhe *libër i ndritur*, edhe pse të dyja janë të po të njëjtit lloj, është se ai libër mund të tregojë librat e profetëve përpara Musait; dhe e dyta, tregon për Teuratin dhe Ungjillin. Kur’ani Fisnik i përshkruan ata të dy me dritë, në suren “El-Maide” në ajetin 44 dhe në ajetin 46: **“Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita...” “...Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë...”**

Disa komentues mendojnë se përdorimi i fjalës *zebur* nënkupton të gjithë ata libra qiellorë që përmbajnë këshilla dhe ndëshkime (sikurse ka qenë Zeburi, i cili i është atribuar profetit Daud (*Paqja qoftë mbi të!*). Por përdorimi i fjalës *“Librin e ndritur”* apo *“Libër qiellor”* nënkupton përmbajtjen e tij, ligjet, rregullat dhe procedurat individuale e shoqërore.

## Ajeti 185

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ وَإِنَّمَا تُوَفَّقُونَ أُجُورَكُمْ يَوْمَ الْقِيَمَةِ فَمَنْ زُحْزِحَ عَنِ النَّارِ وَأُدْخِلَ الْجَنَّةَ فَقَدْ فَازَ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَعُ  
الْغُرُورِ

“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t’u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehennemit dhe hyn në Xhennet, ai ka fituar. Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.”

## Komentimi

### Vdekja dhe ligji i saj i përgjithshëm

Pas hulumtimit dhe fjalëve rreth kokëfortëve dhe të pabindurve jobesimtarë, vjen ky ajet, që tregon për vdekjen, që është ligj i përgjithshëm dhe për të ardhmen e njerëzve në Ditën e Gjykimit. Ky ajet është një qetësim për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për besimtarët. Gjithashtu, i tërheq vërejtje kundërshtarëve mëkatarë.

Ajeti në fillim tregon rregullin e përgjithshëm, që përfshin të gjitha gjallesat në këtë botë dhe thotë: **“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen...”**

Njerëzit, edhe pse mundohen ta harrojnë dhe ta injorojnë vdekjen, nuk do të munden asnjëherë, sepse ajo nuk na harron ne.

Me të vërtetë, kjo botë ka mbarim dhe fundi është i pakundërshtueshëm. Patjetër do të vijë ajo ditë kur njeriu do ta vizitojë vdekja. Atëherë përpara tij nuk do të ketë asgjë, atij nuk i mbetet vetëm se të ndahet nga kjo botë.

Kuptimi i fjalës *nefs* në këtë ajet përfshin shpirtin dhe trupin së bashku, edhe pse në Kur'an fjala *nefsun* ndonjëherë përdoret vetëm për shpirtin.

Fjala *do ta shijojë* përshkruan ndjenjën e plotë, sepse njeriu mund ta shikojë ushqimin me sytë e tij ose ta prekë me dorë, por të gjitha këto i realizon vetëm nëpërmjet shijimit. Por edhe vdekja – në rregullin e krijimit – është si një ushqim për njeriun.

Pas kësaj, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“...Shpërblimet do t'u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit...”** Pra, s'ka dyshim se pas kësaj jete do të jetë një periudhë tjetër dhe ajo është periudha e shpërblimit dhe e ndëshkimit ndaj veprave. Këtu (në këtë botë) ka punë dhe jo llogari e atje (në Botën Tjetër) ka llogari dhe jo punë.

Fjala *do t'u plotësohen* që ka kuptimin e dhënies së plotë, zbulon se në Ditë e Kiametit njeriu do të shpërblehet për çdo gjë që ka punuar në këtë jetë, pa iu hequr e pa iu pakësuar asgjë.

Nuk është e ndaluar që njeriu të shohë në botën e ndërmjetme, në Berzah disa rezultate të punëve të tij dhe të

provojë diçka prej shpërblimit apo dënimit, sepse shpërblimi dhe dënimi në Berzah nuk përbëjnë shpërblimin apo dënimin e plotë.

Pastaj All'llahu i Lartësuar vazhdon e thotë: **"...kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehennemit dhe hyn në Xhennet, ai ka fituar."**

Fjala *zahzehe* do të thotë mundim dhe përpjekje e njeriut për ta nxjerrë vetveten nga presioni dhe ndikimi i një diçkaje dhe shpëtimi prej forcës tërheqëse të saj.

Ndërsa fjala *faze*, nga ana gjuhësore, do të thotë *shpëtim nga shkatërrimi, të arrish qëllimin që i ke vënë vetes*. Kuptimi i fjalisë është se ata, që kanë mundur të çlirojnë veten e tyre nga tërheqja e zjarrit, duke hyrë në Xhennet, vërtet kanë shpëtuar nga shkatërrimi dhe kanë arritur atë që kanë dëshiruar.

Zjarri i tërheq drejt vetes njerëzit me gjithë forcën e tij. Forcat e zjarrit janë: Epshet kalimtare, kënaqësitë e palejuara seksuale dhe pasuria jo e lejuar.

Nga ky përshkrim përfitohet se njerëzit, sikur të mos garonin dhe të mos derdhnin mund e djersë për ta shpëtuar e liruar vetveten nga këto pranga mashtruese, do të ishin gjatë gjithë kohës skllevër të kësaj bote. E nëse mundohen të edukojnë veten e tyre duke u mbrojtur nga tërheqja dhe mashtrimet dhe kanë arritur gradën *shpirti i qetë*, ata janë të shpëtuar dhe ndiejnë siguri dhe qetësi.

Pastaj All'llahu i Lartësuar në fund të këtij ajeti thotë: **"...Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese."** Kjo fjali është plotësuese e kërkimit të mëparshëm dhe thotë të

vërtetën e jetës, e cila është vetëm lojë, kënaqësi dhe mashtrim për njeriun. Nëse njeriu e kupton këtë jetë dhe e njeh mirë nga afër, ndien boshllëk. A nuk është kënaqësia e kësaj bote vetëm një mashtrim?

Po ashtu themi se nga larg, kënaqësitë materiale duken sikur janë të pastra nga çdo defekt dhe e metë. Por kur njeriu u afrohet atyre dhe i prek ato, do të shohë se përmbajnë të gjitha llojet e ngjyrave të lodhjes dhe të mundimit. Ky është një lloj tjetër mashtrimi i kësaj bote materiale.

Në të shumtën e rasteve njeriu harron se do të vijë një ditë dhe jeta e tij do të mbarojë, do të vdesë.

Këto fjalë janë përsëritur disa herë në Kur'an e në hadithe. Qëllimi i përsëritjes së tyre është që kjo jetë të mos jetë qëllimi kryesor i njeriut. Sepse, nëse ky do të jetë qëllimi, atëherë fundi do të jetë zhytja në llojet e ndryshme të krimeve dhe të mëkateve, do të largohen më shumë nga e vërteta dhe përsosmëria njerëzore.

Kurse, shfrytëzimi i anës materiale të kësaj jete si mjet për të arritur përsosmërinë shpirtërore dhe humane është punë e domosdoshme dhe e lavdërueshme.

## Ajeti 186

لَتُبْلَوْنَ فِي أَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ وَلَتَسْمَعُنَّ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا  
الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَمِنَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا أَذًى كَثِيرًا وَإِنْ تَصْبِرُوا  
وَتَتَّقُوا فَإِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ ﴿١٨٦﴾

**“Ju, me siguri, do të sprovoheni në pasurinë e në jetën tuaj dhe do të dëgjoni shumë fyerje nga popujt që iu është dhënë Libri para jush, si dhe nga paganët. Por, nëse ju duroni dhe jeni të devotshëm, atëherë kjo është vërtet prej vendosmërisë së çështjeve.”**

### Shkaku i zbritjes

Kur myslimanët emigruan nga Meka për në Medine dhe u larguan nga shtëpitë e tyre, idhujtarët, me ushtarët e tyre, shtrinë duart e tyre në pasurinë e myslimanëve dhe morën çdo gjë.

Kur erdhën në Medine, myslimanët u përballën me përçmimet e jahudinjtë të Medines, veçanërisht të Ka'b ibn Eshrefit, i cili ishte poet gjuhëhidhur. Ka'b ibn Eshrefi e luftoi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët, duke i nxitur idhujtarët e mohuesit kundër tyre.

Ai thurte poezi dashurie për gratë e myslimanëve, duke përshkruar bukuritë e tyre. Kjo paturpësi dhe çmenduri e tij e shtyu Profetin të urdhërojë ta vrisnin dhe ashtu u bë.

Ky ajet, sipas disa haditheve të transmetuara nga komentuesit e Kur'anit, tregon këto çështje dhe i nxit myslimanët që të bëjnë rezistencë.<sup>1</sup>

## Komentimi

### Mos t'ju lodhë juve rezistenca

All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ju, me siguri, do të sprovoheni në pasurinë e në jetën tuaj...”** Sigurisht që jeta e kësaj bote, në themel është arenë provimi dhe vendi ku do të sprovoheni. Prandaj, duhet që njeriu t'i rezistojë çdo vështirësi dhe problemi të papritur. Në realitet, ky ajet është një lloj vërejtjeje ndaj myslimanëve, që të mos mendojnë se problemet dhe fatkeqësitë e tyre mbaruan qoftë edhe me vrasjen e Ka'b ibn Eshrefit, i cili i poshtëronte myslimanët me gjuhën e tij.

Dhe për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“...dhe do të dëgjoni shumë fyerje nga popujt që iu është dhënë Libri para jush, si dhe nga paganët...”** Në të vërtetë, çështja e kundërshtimit për të këqijat e mohuesve, sharjet dhe ofendimet e ithtarëve janë një nga provat që u cekën në fillim të këtij ajeti.

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, komentimi i ajetit në fjalë. Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëllimi 4, faqe 133.

Arsyeja se pse i jepet kaq rëndësi në këtë ajet është se janë të paktë njerëzit që dinë si të veprojnë dhe si të durojnë në situata të vështira dhe këto ngjarje ndikojnë shumë në shpirtrat e tyre. Një poet ka thënë:

*Plagët e shpatës kanë një shërim,  
por plagët e gjuhës nuk shërohen.*

Pas kësaj, All'Ilahu i Lartësuar u heq vërejte duke thënë:  
**"...Por, nëse ju duroni dhe jeni të devotshëm, atëherë kjo është vërtet prej vendosmërisë së çështjeve."**

Nën shembullin e këtyre ngjarjeve të vështira dhe momenteve kritike, Kur'anit Famëllartë u sqaron detyrat myslimanëve, duke u bërë thirrje që të durojnë dhe të jenë të devotshëm në adhurimet e tyre. Rezultatet e këtyre çështjeve janë të dukshme dhe çdo njeri i zgjuar duhet të mbajë qëndrimin e tij për këto ngjarje.

Fjala *azm*, nga ana gjuhësore, do të thotë *vendim i palëkundur*. Përdoret zakonisht për çështjet e qarta. Frazja *azmul umur* nënkupton veprat e qarta e të drejta, që çdo njeri i zgjuar mund të përfitojë dhe të nxjerrë mësimë prej tyre, ose ka kuptimin e çdo çështjeje të bindur ndaj saj.

Shoqërimi i durimit me devotshmërinë në këtë ajet ka mundësi të tregojë se disa njerëz mund të durojnë, por përsëri ankohen dhe shfaqin atë që i goditi. Mirëpo, besimtarët e vërtetë dhe të sigurtë janë ata që bashkojnë gjithmonë durimin me devotshmërinë dhe nuk ndjekin shembullin e këtij reagimi dhe i largohen ankesës dhe pakënaqësisë.

## Ajeti 187

وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ لَتُبَيِّنُنَّهُ لِلنَّاسِ وَلَا تَكْتُمُونَهُ  
فَنَبَذُوهُ وَرَاءَ ظُهُورِهِمْ وَأَشْرَوْا بِهِ ثَمَنًا قَلِيلًا فَبُئْسَ مَا يَشْتَرُونَ ﴿١٨٧﴾

**“Kujtoje (o Muhammed) kohën kur All’llahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t’ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai. Pastaj ata e hodhën pas shpine (premtimin) dhe e ndërruan atë me një vlerë të vogël. Eh, sa këmbim të shëmtuar që bënë ata!”**

### Komentimi

Pas tregimit të disa veprave çnjerëzore të ithtarëve të Librit (jahudinjeve dhe të krishterëve) dhe kundërshtimeve të tyre ndaj së vërtetës, ky ajet tregon një tjetër punë prej atyre punëve të tyre dhe një tjetër kundërshtim të tyre. All’llahu i Lartësuar thotë: **“Kujtoje (o Muhammed) kohën kur All’llahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t’ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai...”** Pra, kujtojeni kohën kur All’llahu e mori një premtim të tillë.

Ajo që tërheq vëmendjen te shprehja *se do t’ua shpjegojnë atë* është se ka ardhur me germën *lam*, që është *lami përbetues* dhe germën *nun*, që është *nuni përforcues* dhe ky është përfundimi i përforcimit dhe i sigurisë.

Pastaj vjen pjesa tjetër e fjalisë dhe nuk do të fshehin asnjë gjë nga ai. Ky është një urdhër i qartë për mosfshehjen e së vërtetës.

Nga të gjitha këto thënie qartësohet se All'llahu i Lartësuar, nëpërmjet profetëve të mëparshëm, u ka marrë besën ithtarëve të Librit për të shfaqur dhe për të sqaruar të vërtetat. Pavarësisht nga të gjitha këto, ithtarët e tradhtuan besën dhe e injoruan premtimin, duke fshehur realitetin e librave qiellorë. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Prandaj ata e hodhën pas shpine (premtimin)..."**

Me të vërtetë, kjo shprehje është një metaforë e bukur për moszbatimin e detyrës dhe për mosinteresimin, sepse, nëse njeriu vendos të bëjë diçka dhe dëshiron ta përvetësojë, e vendos para syve dhe e shikon gjithmonë. Nëse ai nuk e dëshiron dhe do ta harrojë, përnjëherë e largon nga sytë e tij dhe e hedh atë pas shpine.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar tregon për kujdesin dhe dëshirën e madhe të jahudinjve për gjërat e kësaj bote: **"... dhe e ndërruan atë me një vlerë të vogël. Eh, sa këmbim të shëmtuar që bënë ata!"** Me të vërtetë, dëshira e tyre e zjarrtë ndaj kësaj bote, e cila ka arritur në adhurim dhe ndërgjegjësimi i tyre mendor, i bëri ata të fshehin të vërtetat në shkëmbim të përfitimeve materiale. Por ajeti thotë se ata nuk fituan veçse një vlerë të vogël dhe se kjo është e shëmtuar.

Sikur ata të kishin fituar një pasuri të madhe në këmbim të fshehjes së të vërtetave, e cila është një krim i madh, mund të thuhej se sasia e madhe e pasurisë ua mbylli veshët dhe nuk dëgjonin asnjë fjalë, ua verboi sytë dhe nuk shikonin asgjë.

Mirëpo ajo që fton në habi e çudi është se ata i shitën të gjitha këto, pra, i fshehën të vërtetat, për pak para dhe për pak vlera. (Sigurisht që këtu bëhet fjalë për dijetarët e tyre të ulët e të pavlerë).

## Dijetarët dhe detyrat e tyre madhore

Ky ajet, edhe pse ka zbritur për dijetarët e ithtarëve të Librit (jahudinje dhe të krishterëve), në realitet u tërheq vëmendjen të gjithë dijetarëve fetarë, që të informojnë me ndershmëri të vërtetat dhe t'u qartësojnë njerëzve rregullat e All'llahut. Kjo është detyrë e tyre e caktuar nga All'llahu dhe për këtë u ka marrë atyre besën dhe premtimin.

Pjesa e ajetit në fjalë *se do t'ua shpjegojnë atë* dhe ajo që buron prej saj në gjuhësi, zbulon se nuk është qëllimi vetëm leximi i ajeteve të All'llahut apo përhapja e përmbajtjes së librave qiellorë, por qëllimi është paraqitja e të vërtetave të këtyre librave para njerëzve. Ato duhet t'u sqarohen të gjithë njerëzve në formën më të qartë, me qëllim që ato të vërteta t'i shijojnë me shpirt dhe me zemër.

Ata që mohojnë të shprehin të vërtetat e All'llahut dhe nuk ua qartësojnë ato myslimanëve, padyshim që i përfshin ky ajet dhe fundi i tyre do të jetë i ngjashëm me atë të dijetarëve jahudinj dhe të krishterë.

Nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është transmetuar: "*Kush e fsheh diturinë ndaj*

*atyre që e duan atë, në Ditën e Gjykimit lidhet me zinxhir prej zjarri të Xhehennemit."*<sup>1</sup>

Hasan ibn Amar ka thënë: "Pasi Zuhriju mbaroi bisedën e takova te dera e tij, dhe i thashë: "A mund të më flasësh?"

Ai tha: "A nuk e di se unë e mbarova."

Unë i thashë: "Ose më fol ti mua, ose të flas unë ty."

Ai më tha: "Më flit."

Unë i thashë: "Më ka treguar Hakem ibn Ujejn nga Nexhm el Xhezar, i cili ka thënë: "E kam dëgjuar Ali ibn Ebu Talibin duke thënë: "All'Ilahu nuk i ka marrë premtimin të paditurve që të mësojnë, deri sa ua ka marrë dijetarëve që t'i mësojnë.""<sup>2</sup>

Ai uli kokën pasi dëgjoi thënien time dhe pastaj tha: "Dëgjo se çfarë do të të tregoj."

Dhe më tregoi mua dyzet hadithe."<sup>3</sup>

Për të njohur më shumë për tradhtinë e dijetarëve jahudinj dhe priftërinjë të krishterë lexo ajetet 79-173 të sures "El-Bekare" dhe ajetet 71-77 të sures "Al-Imran".

---

<sup>1</sup> "Kenzul Ummal", vëllimi 10, faqe 191, 217; "Zubdetul Bejan", faqe 206.

<sup>2</sup> "Nehxhul Belaga", Thëniet e shkurtra, fjala 478.

<sup>3</sup> Tefsiri "Ruhul Xhinan", "Mexhmaul Bejan", "Biharul Envar", vëllimi 2, faqe 80.

## Ajetet 188 - 189

لَا تَحْسَبَنَّ الَّذِينَ يَفْرَحُونَ بِمَا آتَوْا وَتُحِبُّونَ أَنْ تَحْمَدُوا بِمَا لَمْ يَفْعَلُوا فَلَا  
تَحْسَبَنَّهُمْ بِمَفَازَةٍ مِنَ الْعَذَابِ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٨٨﴾ وَلِلَّهِ مُلْكُ  
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٨٩﴾

“Mos mendo se ata që gëzohen për çfarë kanë punuar dhe dëshirojnë të lavdërohen për çfarë nuk kanë punuar, pra, kurrësi mos mendo se ata do t’i shpëtojnë ndëshkimit; për ata ka ndëshkim të dhembshëm.

All’lلاهut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe All’lلاhu është i Fuqishëm për çdo gjë.”

## Shkaku i zbritjes

Dijetarët e hadithit dhe komentuesit e Kur'anit Famëlartë kanë treguar shkaqe të shumta për zbritjen e këtij ajeti. Një prej tyre është se jahudinjtët ishin të kënaqur me falsifikimin e librave qiellorë dhe me fshehjen e të vërtetave të librave qiellorë, duke menduar se do të arrijnë rezultat. Në të njëjtën kohë dëshironin që njerëzit t'i quanin të ditur dhe t'i konsideronin mbrojtës të fesë. Atëherë, zbriti ky ajet, për t'iu kundërpërgjigjur supozimit të tyre të gabuar.<sup>1</sup>

Disa të tjerë kanë thënë se ky ajet ka zbritur për çështjen e hipokritëve, sepse ata mblidheshin dhe binin dakord që të kundërshtonin çështjen e xhihadi me Profetin, duke thënë argumente të kota. Kur luftëtarët ktheheshin nga lufta, ata shprehnin keqardhje ose betoheshin se, sikur të mos kishin pasur arsye, do të dilnin të luftonin në rrugë të All'llahut. Ata dëshironin që t'u pranohej justifikimi dhe të lavdëroheshin për ato që nuk kishin bërë. Këto ajete zbritën për t'iu kundërpërgjigjur këtyre mendimeve të kota.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> "Esbabul Nuzul i Uakidij", faqe 91, Tefsiri "Mexhmaul Bejan", komentimi i këtij ajeti.

<sup>2</sup> Komentimet: "Mexhmaul Bejan", "El Menar", "Xhamiul Bejan" dhe komentime të tjera, komentimi i ajetit në fjalë.

## Komentimi

### Të mahnitur me veten e tyre

Ata që bëjnë vepra të këqija janë në dy grupe.

**Grupi i parë:** Janë ata persona që u vjen turp nga veprat e bëra, menjëherë sapo e kuptojnë se veprat e tyre janë të këqija. Këtë gjë nuk do ta bënte, nëse nuk do të ishte i shtyrë prej epsheve. Ky grup e ka të lehtë të shpëtojë, sepse pendohet pas çdo bërje të veprave të këqija dhe ndërgjegjësohet për atë që ka bërë.

**Grupi i dytë:** Janë ata njerëz, të cilët jo vetëm nuk pendohen e as nuk turpërohen për ato që bëjnë, por janë të kënaqur dhe krenarë për veprat që kanë bërë. Përveç kësaj, ata duan që njerëzit t'i falënderojnë për atë që nuk kanë bërë asnjëherë nga veprat e mira.

All'Ilahu i Lartësuar, në ajetin 188, thotë: **“Mos mendo se ata që gëzohen për çfarë kanë punuar dhe dëshirojnë të lavdërohen për çfarë nuk kanë punuar, pra, kurrë mos mendo se ata do t'i shpëtojnë ndëshkimit...”** Sigurisht, mos mendoni se, ata që justifikohen për qëndrimin e tyre, ne do t'i shpëtojmë nga ndëshkimi. Me të vërtetë, shpëtimi është për ata që, më e pakta, kanë turp për veprat e tyre të këqija dhe pendohen se nuk kanë bërë asnjë vepër të mirë.

Me të vërtetë, ata që mahniten me veten e tyre, jo vetëm që janë të humbur dhe të ndaluar nga shpëtimi, por: **“...për ata ka ndëshkim të dhembshëm.”**

Nga ky ajet mund të përfitojmë se gëzimi i njeriut për veprat e mira që ka bërë është e pëlqyeshme (nëse kjo nuk e kalon limitin e ekuilibrit dhe nuk është shkak për t'u mahnitur dhe për t'u mburrur prej tyre).

Ne nuk duhet të mendojmë se ky ajet është vetëm për hipokritët në fillim të Islamit ose për ata që i përfaqësojnë - në çdo kohë, në çdo vend, në të gjitha rrethanat dhe shoqëritë e ndryshme - por dhe për ata që gëzohen dhe krenohen me veprat e tyre të këqija apo i nxitin të tjerët që t'i lavdërojnë për atë çfarë bëjnë, me gojë apo me shkrim.

Me të vërtetë, atyre në shtesë të dënimit të dhembshëm në Botën Tjetër do t'i godasë në këtë botë hidhërimi dhe zemërimi i njerëzve. Kjo do të çojë në ndarjen e tyre nga të tjerët.

Pastaj All'llahu i Lartësuar, në ajetin tjetër, thotë:  
**"All'llahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe All'llahu është i Fuqishëm për çdo gjë."**

Këto fjalë, në thelbin e tyre, janë përgëzim për besimtarët dhe kërcënim për mohuesit dhe idhujtarët. Ato transmetojnë këtë mesazh: Nuk duhet që besimtarët të ndjekin rrugën e gabuar për të arritur zhvillimin dhe përparimin, sepse, ata janë në gjendje të ecin përpara e të kenë zhvillim, duke ndjekur rrugët e lejuara e të legjitueshme nën hijen e fuqisë së All'llahut të Madhëruar, Krijuesit të Tokës dhe të qiejve.

Gjithashtu, hipokritët dhe mëkatarët kurrë të mos mendojnë se do të arrijnë zhvillimin apo do t'i shpëtojnë ndëshkimit të All'llahut, duke përdorur dhe duke ndjekur rrugë jo të lejuara dhe të jashtëligjshme!

## Ajetet 190-194

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ لَآيَاتٍ لِأُولِي  
 الْأَلْبَابِ ﴿١٩٠﴾ الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَمًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِهِمْ  
 وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَطْلًا  
 سُبْحَنَكَ فَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿١٩١﴾ رَبَّنَا إِنَّكَ مَن تَدْخِلِ النَّارَ فَقَدْ أَخْرَجْتَهُ  
 وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ ﴿١٩٢﴾ رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ  
 أَنْ ءَامِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا ۖ رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا  
 وَتَوَفَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ ﴿١٩٣﴾ رَبَّنَا وَءَاتِنَا مَا وَعَدْتَنَا عَلَىٰ رُسُلِكَ وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ  
 الْقِيَمَةِ ۚ إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ ﴿١٩٤﴾

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët.

Për ata që e përmendin All’llahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.

**O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për të padrejtët nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi.**

**O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: "Besoni Zotin tuaj!" Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët!**

**O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!"**

## **Rëndësia e këtyre ajeteve**

Nuk ka dyshim se të gjitha ajetet kur'anore kanë një rëndësi të madhe, sepse janë fjala e All'llahut të Madhëruar. Ajetet e Kur'anit kanë zbritur për ta edukuar dhe për ta shpëtuar njeriun. Por ka ajete që dallojnë nga disa të tjerë. Prej atyre janë edhe pesë ajetet në fjalë, të cilat konsiderohen prej atyre madhështore. Këto ajete përmbajnë mësimet të larta fetare e shpirtërore, të përfshira në lutje e përgjërime. Ajo çfarë fitojmë nga Kur'ani është një mirësi qiellore, që vë në lëvizje ndjenjat e ndërgjegjes dhe mendjen. Për rëndësinë e këtyre ajeteve kanë ardhur hadithe të shumta.

Transmetohet nga Ata'u ibn Rebah se i ka thënë Aishes, që t'i tregonte disa prej gjërave më të veçanta e më të çuditshme që ka parë te i Dërguari i All'llahut. "Aishja më tregoi një ngjarje, që me të vërtetë më ka lënë gojëhapur: "Një natë, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur u shtrimë për të fjetur më tha: "Më lejo të adhuroj All'llahun tim." Ai u ngrit, mori abdes dhe filloi të falej. Qante derisa lotët rridhnin në faqe e në gjoks. Kur ra në ruku, përsëri qante.

Qau edhe kur ra në sexhde. Në çdo rekat adhurimi vetëm qante. Në këtë gjendje vazhdoi deri sa erdhi Bilali për të thirrur ezanin për namazin e sabahut. Unë (pra, Aisheja) i thashë: “O i Dërguari i All’llahut, pse qan, kur All’llahu i Lartësuar t’i ka falur mëkatet e shkuara dhe të së ardhmes?”

Profeti u përgjigj: “E si të mos jem rob falënderues? E përse të mos e bëj këtë, ndërkohë që sonte më ka zbritur ajeti:” **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin All’llahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”** Pastaj tha: “I mjeri ai që i lexon këto ajete dhe nuk mediton për to.”<sup>1</sup> Fraza e fundit e këtij ajeti i fton të gjithë njerëzit të meditojnë rreth këtij ajeti. Kjo thënie është përcjellë në transmetime të tjera me fraza të ndryshme.

Nga prijësi i besimtarëve është transmetuar se i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur ngrihej të falte namaz nate, pastronte dhëmbët, pastaj shikonte qiellin dhe lexonte këto ajete.<sup>2</sup>

Transmetohet nga imamët e Ehli Bejtit, të cilët urdhëronin besimtarët që këto pesë ajete t’i lexonin në kohën e faljes së namazit të natës.<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Tefsiri “Durrul Menthur”, vëllimi 2 faqe 110-111, Tefsiri “Ruhul Xhinan”, vëllimi 5 faqe, 205.

<sup>2</sup> Tefsiri “Nuru Thekalejn”, Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”.

<sup>3</sup> Tefsiri “Nuru Thekalejn”, Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”.

Neuf Elbekalij ka thënë: "Një natë fjeta tek prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*). Gjatë gjithë natës ka falur namaz. Çdo një orë dilte e shikonte qiellin. Më pas lexonte Kur'an dhe i përsëriste këto 5 ajete. Pas një farë kohe më pyeti: "O Neuf, po fle apo je zgjuar?"

Iu përgjigjja se isha zgjuar. Ai më tha: "O Neuf, kënaqësia më e madhe për ata që i largohen kësaj bote është përmallimi për Botën Tjetër. Këta kanë marrë për shtrojë tokën, dheun vend fjetjeje, ujin e saj mirësi, Kur'anin petk dhe lutjen slogan."<sup>1</sup>

## Komentimi

### Rrugët më të qarta për të njohur All'llahun

Ajetet kur'anore nuk janë vetëm për t'u lexuar. Ato janë zbritur që njerëzit të kuptojnë dhe të mësojnë qëllimet e tyre. Leximi është hyrje për të arritur qëllimin e përsiatjes dhe të kuptimit. Prandaj All'llahu i Lartësuar në ajetin 190 thotë: **"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët..."**<sup>2</sup>

Ky ajet i nxit njerëzit të mendojnë rreth këtij krijimi madhështor, që gjithsecili, sipas mundësisë dhe aftësisë që ka, të përfitojë nga ky oqean i madh dijesh, që nuk i dihet as fillimi dhe as fundi, të shuajë etjen nga burimet e sekreteve të këtij krijimi madhështor.

---

<sup>1</sup> "Irshadul Kulub", vëllimi 1, faqe 20, "Nehxhul Belaga", fjala 104.

<sup>2</sup> Thënia *ulil elbab*, që përmendet në këtë ajet dhe në ajetet të tjera të Kur'anit të Shenjtë, tregon për të zotët e mendjes, sepse fjala *lubbi* i diçkaje është më e mira dhe më e pastra e saj. S'ka dyshim se mendja është gjëja më e mirë që ka njeriu dhe ajo është bërthama e ekzistencës së tij.

Me të vërtetë, ky univers, ajo çfarë është në qiejt, në ujë dhe në tokë është një libër madhështor, germat dhe fjalët e tij janë argument i qartë për ekzistencën e All'llahut, për krijimin e përsosur të Tij dhe për njëshmërinë e Tij.<sup>1</sup>

Me të vërtetë, kjo arkitekturë e mahnitshme që gjendet në gjithësi, tërheq zemrat dhe bën për vete çdo mendje të zgjuar. Çdo mendimtar e bën të kuptojë Krijuesin në çfarëdo gjendjeje që ai ndodhet: në këmbë, ulur, shtrirë, duke fjetur. All'llahu i Lartësuar për këtë thotë: **"... për ata që e përmendin All'llahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës..."** Kjo thënie do të thotë se mendimtarët janë të zhytur thellë e më thellë në mendime rreth gjithësisë dhe sistemit të saj.

Në këtë ajet, së pari, tregohet përkujtimi dhe përmendja e All'llahut të Lartësuar. Më pas, së dyti, meditimi. Kjo do të thotë se vetëm përmendja e All'llahut nuk është e plotë. Përmendja jep frytet e saj të vlefshme kur është e shoqëruar me meditimin.

Po ashtu, edhe mendimi në krijimin e qiejve dhe të Tokës nuk jep rezultat nëse nuk është i shoqëruar me përkujtimin dhe përmendjen e All'llahut të Lartësuar.

Janë të shumtë dijetarët që merren me studimin e universit, qoftë në qiell, në ujë dhe në tokë, por që asnjëherë nuk e përkujtojnë Krijuesin e gjithçkaje, All'llahun. Ata i studiojnë këto vetëm nga ana shkencore. Për këtë ata nuk vjelin frytet e duhura të kërkimeve që kanë lidhje me realitetin edukativ dhe rolin e tij

---

<sup>1</sup> Në këtë tefsir, pikërisht në komentimin e ajetit 164 të sures "El-Bekare", kemi folur për kuptimin e ndryshimit të natës dhe të ditës dhe për sekretet e tyre, prandaj mund ta lexoni.

në jetën njerëzore. Shembulli i tyre është si puna e atij që ka ushqim për të forcuar trupin, por që fatkeqësisht, i njëjti ushqim nuk ndikon në forcimin e mendjes dhe të shpirtit të tij.

Me të vërtetë, meditimi në sekretet e krijimit dhe në sistemin e qiellit dhe të Tokës i jep njeriut një kuptim të veçantë dhe lë gjurmë të mëdha në mendjen e tij. Gjurma e parë është zbulimi i qëllimit të krijimit, se ky univers nuk është krijuar kot apo si lojë. Njeriu që kërkon qëllimin në gjërat më të vogla të këtij universi, kurrësi nuk mund të besojë se ky univers gjigant është krijuar pa asnjë qëllim.

Sikur të shikonim përbërjen e bimëve ose të specieve të ndryshme, do të kuptonim qëllimin e qartë të krijimit të tyre. Le të japim disa shembuj: zemra e njeriut është e ndërtuar nga 2 veshore dhe 2 barkushe. Ana e majtë ka gjak të pastër, kurse ana e djathtë gjak të papastër. Nga ana e majtë del arteria aortë, e cila shpërndan gjak në të gjithë trupin, kurse arteriet koronare janë enë që ushqejnë vetë zemrën. Po ashtu, edhe në kapakët e syrit apo te thonjtë, ka një të fshehtë dhe mirësi në krijimin e tyre.

A mundet që, këto pjesë kaq të vogla përballë madhësisë së universit, të mos kenë një qëllim në krijim? Sigurisht që gjithçka është krijuar sipas një qëllimi të caktuar, e madhe apo e vogël qoftë. Kushdo, që ka mend dhe mediton rreth krijimit, thotë: **"O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh!"**

Duke u nisur dhe nga ky ajet, mendarët thonë që kjo botë kaq e madhe, që nuk i dihet kufiri dhe ky sistem i përkryer është krijuar nga një mendje shumë e zgjuar dhe për një qëllim. Të gjitha këto tregojnë njëshmërinë e All'llahut.

Ata që mendojnë e dinë qëllimin e krijimit dhe menjëherë përkujtojnë All'llahun. E si mund të mendojë njeriu, që, duke qenë pjesë e këtij universi, të jetë krijuar papritur ose ka ardhur në këtë botë pa ndonjë qëllim të caktuar?

Në të vërtetë, njeriu nuk ka ardhur në këtë botë vetëm për të jetuar një periudhë të caktuar e pastaj të larohet prej saj. Sepse kjo nuk e meriton gjithë atë lodhje dhe mundim të njeriut në këtë jetë dhe nuk është në përputhje me urtësinë e All'llaut dhe as me pozitën e vetë njeriut. Por e gjithë jeta e kësaj bote është një urë kalimi për në Botën Tjetër. Atje njeriu do të marrë shpërblimin sipas punëve dhe veprave që ka bërë në këtë jetë. E për këtë në Kur'an thuhet: **“Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”**

Pastaj All'llahu i Lartësuar vazhdon: **“O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për të padrejtët nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi.”**

Nga këto shprehje kuptohet se mendarët, para se të kenë frikë nga zjarri i Xhehennemit kanë frikë nga poshtërimi. Kjo është gjendja e të gjithë atyre që kanë personalitet të fortë, dhe janë të gatshëm të përballojnë çdo problem dhe fatkeqësi në rrugën e mbrojtjes së personalitetit të tyre. Prandaj, ndëshkimi më i rëndë për ta në Ahiret është poshtërimi para All'llahut dhe para njerëzve.

Pika e vlefshme që shikohet në këtë ajet është fjala e All'llahut të Lartësuar: **“Dhe për të padrejtët nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi.”**

Kuptimi i këtij ajeti është se të zgjuarit, pasi i kanë mësuar qëllimet edukative, i konsiderojnë punët e mira si mjetin e vetëm

për shpëtimin e njeriut. Për këtë, të padrejtët nuk kanë ndihmues, sepse ata e humbën ndihmuesin bazë që është puna e mirë.

Përqendrimi te fjala *dhulm* që do të thotë *padrejtësi*, është se ajo ose është mëkati më i rrezikshëm në mesin e mëkateve, ose të gjitha gjynahet që bën njeriu janë padrejtësi ndaj vetes së tij.

All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: "Besoni Zotin tuaj!" Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirë!"** Ky ajet do të thotë: Zoti ynë, ne tani kemi besuar me gjithë qenien tonë, por ne na rrethon nga të gjitha anët tufani i instinkteve dhe ndoshta rrëshqasim dhe bëjmë mëkat. Prandaj, o Zoti ynë, na fal mëkatet, na i mbulo të metat dhe na bë që të vdesim me njerëzit e mirë e të devotshëm.

Këta lutës kanë një lidhje të mahnitshme me shoqërinë. Ata kanë braktisur vetminë, egoizmin deri në atë gradë, saqë kërkojnë në lutje, që jo vetëm kjo jetë të jetë si jeta e të mirëve, por edhe vdekja, sido qoftë ajo, vdekje natyrale apo në fushën e betejës, të jetë si vdekja e të mirëve dhe All'Ilahu do t'i ringjallë me ta.

Sepse vdekja si ajo e të këqijve dhe bashkimi me ta është e llahtarshme dhe një përfundim i keq.

**Pyetje:** Këtu lind pyetja se çfarë do të thotë të të mbulojnë të këqijat pas kërimit të faljes së tyre?

**Përgjigja:** Duke parë dhe duke lexuar ajetet e tjera të Kur'anit sqarohet e vërteta e kësaj pyetjeje. Ajeti 31 i sures "En-Nisa": **"Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t'jua falim të këqijat tuaja..."**

Nga ky ajet kuptojmë se të këqijat konsiderohen si mëkate të vogla. Për këtë, të zotët e mendjes që logjikojnë, i luten All'llahut të Lartësuar që t'ua falë mëkatet e mëdha, t'ua mbulojë gabimet e vogla dhe t'ua fshijë gjurmët e saj nga ekzistenca.

Pastaj kërkojnë nga Zoti i tyre, pasi kanë ndjekur rrugën e besimit, të njëshmërisë (teuhidit), iu përgjigjen thirrjes së profetëve dhe i kryen detyrat që u janë ngarkuar, që t'u japë atë që u është premtuar nga goja e profetëve: **“O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu....”** që do të thotë: o Zoti ynë ne zbatuam ato që na ishin ngarkuar, prandaj na e jep atë që na ke premtuar dhe mos na poshtëro e mos na skandalizo: **“...dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!”**

Përmendja e fjalës el *khizju* - *poshtërim*, përforcon këtë të vërtetë të rëndësishme, që është se për mendimtarët poshtërimi, për nga rëndësia që ka në formimin e personalitetit, është gjëja më e rëndë e më e keqe që mund ta godasë njeriun.

Në librin “Mustedrekul Vesail”, transmetuar nga Ebu Futuh Err-Rrazij, tregohet se i Dërguari i All'llahut ka thënë: *“Kush dëshiron të kërkojë tek All'llahu diçka, le të thotë pesë herë “Rabena” “O Zoti ynë” dhe kërkesa e tij plotësohet.* Dëshmi e kësaj thënieje është thënia e All'llahut të Madhëruar: **“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto...”** e deri në fund të këtyre ajeteve. Pastaj All'llahu i Madhëruar, në ajetin 195 të kësaj sureje thotë: **“Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre...”<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> “Mustedrekul Vesail”, vëllimi 5, faqe 219, Tefsiri “Kurtubijj”, vëllimi 4, faqe 318.

Është më se e qartë se ndikimi i vërtetë dhe i thellë i këtyre ajeteve realizohet, nëse pajtohet gjuha (fjala) me atë që thotë zemra dhe veprohet me gjymtyrë (punohet). Duhet që përmbajtja e këtyre ajeteve, të cilat zbulojnë rrugët e mendimit të të zotëve të mendjes dhe dashurinë e madhe që kanë për All'llahun, të ngulitet në mendjen dhe në zemrën e çdo lexuesi, me qëllim që të arrijnë në të njëjtën gradë që arritën të zotët e mendjes dhe të vjelin të njëjtat fryte që vjelin edhe të zotët e mendjes që përmenden në këto ajete.

## Ajeti 195

فَاسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا أُضِيعُ عَمَلَ عَمَلٍ مِّنْكُمْ مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أَنْتِي<sup>ط</sup>  
بَعْضُكُمْ مِّنْ بَعْضٍ<sup>ط</sup> فَالَّذِينَ هَاجَرُوا وَأُخْرِجُوا مِن دِيَرِهِمْ وَأُودُوا فِي  
سَبِيلِي وَقَتَلُوا وَقُتِلُوا لَا كُفِّرَنَّ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَلَا أُدْخِلَنَّهُمْ جَنَّتِ تَجْرَى مِنْ  
تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ثَوَابًا مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ <sup>قُلْ</sup> وَاللَّهُ عِنْدَهُ حُسْنُ الثَّوَابِ ﴿١٩٥﴾

Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: “Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëlloj. Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrat e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga All’llahu. Shpërblimi më i mirë është tek All’llahu.”

## Shkaku i zbritjes

Ky ajet vjen pas ajeteve që flisnin për të zotët e mendjeve të ndritura dhe për rezultatin e punëve të tyre. Fillimi i këtij ajeti me germën *fe*, që këtu ka funksionin e ndarjes, është argumenti më i qartë që ky ajet ka lidhje me ajetet e mëparshme.

Edhe pse është i tillë, janë përmendur disa transmetime për shkaqet e zbritjes së këtij ajeti. Por në të vërtetë, nuk e mohojnë lidhjen e tij me ajetet e mëparshme.

Një nga këto hadithe është edhe transmetimi i Umu Selemes, një nga bashkëshortet e profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajo i ka thënë Profetit: *"O i Dërguar i All'llahut, si është çështja e burrave, të cilët janë përkujtuar në emigrim dhe gratë jo?"* Atëherë All'llahu i Lartësuar zbriti këtë ajet.<sup>1</sup>

Po ashtu transmetohet se kur Imam Aliu ka emigruar me disa gra, që quheshin Fatime (Fatime bint Esed, Fatimeja e bija e Profetit dhe Fatime bint Zubejr) nga Meka për në Medine, ishte edhe Umu Ejmen, një nga bashkëshortet e Profetit. Gjatë rrugës zbriti ky ajet.<sup>2</sup>

Ashtu siç e thamë edhe më lart, shkaqet e përmendura të zbritjes nuk e mohojnë lidhjen mes këtij ajeti dhe ajeteve të mëparshme. Gjithashtu, nuk ka papajtueshmëri mes këtyre dy shkaqeve të zbritjes.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", komentimi i ajetit në fjalë. "Mustedrek Hakim Nejsaburi", vëll. 2, f. 300.

<sup>2</sup> Tefsiri "Mijzan", vëllimi 4, faqe 91, "Biharul Enuar", vëllimi 19, faqe 66-67.

## Komentimi

### Rezultat i mirë për qëndrimin e të zotëve të mendjes

Në pesë ajetet e mëparshme Kur'ani Famëlartë paraqiti besimin e të zotëve të mendjes, programin e tyre shkencor, kërkesat dhe lutjet e tyre.

Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre.”** Thënia *rabbuhum* - Zoti i tyre, tregon për butësinë dhe mëshirën e All'llahut.

Më pas, ajeti thotë: **“Unë nuk do t'ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër.”** Kjo thënie është sqarim për paqartësinë që mund të vërtitet në mendje se nuk ka lidhje mes shpëtimit dhe veprës së njeriut. Në këtë frazë tregohet qartë se vepra është baza. Gjithashtu, tregon edhe për vepruesin e këtyre veprave, derisa qartëson se boshti kryesor i pranimit të lutjeve është kryerja e veprave të mira, që burojnë nga besimi i singertë. E me të vërtetë, përgjigja e menjëhershme e lutjeve vjen nga pranimi i veprave të mira.

All'llahu i Lartësuar thotë: **“...qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëlloj...”** Askush të mos mendojë se ky premtim i All'llahut është i posaçëm vetëm për meshkujt dhe jo për femrat, sepse puna e çdokujt vlerësohet njëlloj, qoftë e mashkullit apo e femrës. Të gjithë njerëzit kanë një prejardhje **“Ju jeni njëlloj”**, që do të thotë se ju lindni nga njëri-tjetri dhe nuk ka ndryshim ndërmjet burrit dhe gruas. Përderisa nuk ka dallim mes gjinive, përse të jetë ndryshimi në shpërblim dhe në ndëshkim?

Ka mundësi që shprehja **"...Ju jeni një lloj..."**, tregon se të gjithë ju jeni ndjekës të një feje dhe të një besimi, jeni përkrahësit e një të vërtete të vetme dhe nuk do të ketë kuptim që All'Ilahu të dallojë ndërmjet një grupi dhe një tjetri, ndërmjet një gjinie dhe një tjetre.

All'Ilahu i Lartësuar më pas vazhdon me fjalën e Tij: **"Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrata e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t'ua mbuloj veprat e këqija..."** Kjo do të thotë se All'Ilahu i Lartësuar është betuar në veten e tij se për hir të asaj lodhjeje dhe mundimi do t'ua falë atyre mëkatet dhe do t'i pastrojë nga të këqijat. Në shtesë të mbulimit dhe të faljes së të këqijave: **"...dhe do t'i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga All'Ilahu."**

Ky është shpërblim i All'Ilahut për sakrificat dhe flijimin: **"...si shpërblim nga All'Ilahu. Shpërblimi më i mirë është tek All'Ilahu."** Me këtë fjalë, All'Ilahu i Lartësuar tregon se shpërblimi i All'Ilahut nuk mund të krahasohet me shpërblimin që mund të fitojnë në këtë botë prej njerëzve.

Nga ky ajet përfitojmë shumë se njeriu duhet të pastrohet patjetër nga mbeturinat e mëkateve, së pari, nën hijen e veprave të mira e të sinqerta, pastaj të afrohet sa më pranë All'Ilahut dhe të hyjë në mëshirën dhe në Xhennetin e premtuar. S'ka dyshim se Xhenneti është vendi i të pastërve. Në të nuk hyjnë të papastërit.

### **Vlera shpirtërore e mashkullit dhe e femrës**

Ky ajet, ashtu si ajetet e tjera të Kur'anit, tregon se tek All'Ilahu i Lartësuar janë të barabartë, si mashkulli, ashtu edhe femra, në çështjen e arritjeve të gradave shpirtërore. Ndryshimi i

gjinisë nuk është shkak që ata të diferencohen në shpërblimin e punëve që kryejnë, por të dy së bashku të arrijnë vlerat e mëdha shpirtërore. As dallimet trupore dhe ndryshimi i përgjegjësive nuk janë shkak i dallimit mes tyre. Ata të dy konsiderohen në të njëjtën nivel - nga ky aspekt - prandaj janë treguar së bashku (në këtë ajet).

Ndryshimi i tyre në detyra dhe në shpërndarjen e përgjegjësive i ngjan shumë marrëdhënies midis presidentit dhe këshilltarit të tij. Presidenti duhet të jetë më i aftë, më i zgjuar dhe më i specializuar në fushën e dijes së tij. Ky ndryshim i gradave të përgjegjësive dhe pranimi i detyrave nuk është argument i prerë se personaliteti i presidentit e ekzistenca e vlerës së tij është më e madhe se sa personaliteti i këshilltarit të tij.

All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Ata që bëjnë vepra të këqija, do të dënohen vetëm sipas veprave të bëra; ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, qofshin meshkuj apo femra, do të hyjnë në Xhennet. Aty do të begatohen pa kufizim.”<sup>1</sup>**

Në një ajet tjetër thotë: **“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.”<sup>2</sup>**

Këto ajete dhe ajetet e tjera kur'anore kanë zbritur në kohën kur shoqëria njerëzore dyshonte tek humanizmi i femrës.

Ata besonin se femra është krijesë e mallkuar dhe se është burim i të gjitha të këqijave dhe e mëkateve, i vdekjes dhe i shkatërrimit.

<sup>1</sup> Sure “El-Gafir” ajeti 40.

<sup>2</sup> Sure “En-Nahl” ajeti 97.

Popujt e mëparshëm e kanë shikuar femrën si një krijesë negative deri në atë gradë sa thoshin se adhurimet e saj dhe çdo gjë që kryen në rrugën e All'llahut, nuk pranohen te All'llahu. Shumë grekë besonin se gruaja është krijesë e papastër dhe e keqe dhe se ajo është vepër e shejtanit.

Romakët dhe disa grekë të tjerë besonin se femra nuk ka shpirt njerëzor dhe se burri është i vetmi që e mbart këtë shpirt. Ajo që tërheq vëmendjen është se deri vonë, dijetarët e krishterë në Spanjë kërkonin të zbulonin se a zotëron shpirt njerëzor femra njësoj si mashkulli? “A është shpirti i saj i përjetshëm pas vdekjes apo jo?” Ata kanë arritur në përfundimin se femra ka shpirt *berzehijeti*, i cili është një lloj shpirti mes njerëzores dhe shtazores dhe nuk ka shpirt të përjetshëm në mesin e femrave, përveç shpirtit të Merjemes (Maries nënës së Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*)).<sup>1</sup>

Nga këtu qartësohet mendimi i të pavëmendshmëve ndaj së vërtetës, të cilët e akuzojnë Islamin si fe të meshkujve dhe jo të femrave.

Disa ndryshime në llojin e përgjegjësisë shoqërore dhe ndryshimi në përbërjen trupore dhe emocionale mes mashkullit dhe femrës nuk e ul gruan, femrën dhe as vlerën e saj shpirtërore. E për këtë, femra dhe mashkulli, nga kjo anë, nuk ndryshojnë. Dyert e lumturisë dhe të përsosmërisë njerëzore janë të hapura përpara të dyve, ashtu si e thamë edhe më lart, kur përmendëm thënien e All'llahut: “**...Ju jeni një lloj ...**”

---

<sup>1</sup> Shih librin e Uester Markut dhe librin “Hukukul mer’ati fil islam”, si dhe librat hulumtues rreth dijeve të njeriut dhe religionit të tij.

## Ajetet 196-198

لَا يَغُرَّنْكَ تَقَلُّبُ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي الْبِلَادِ ﴿١٩٦﴾ مَتَّعُ قَلِيلٌ ثُمَّ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ  
وَبِئْسَ الْمِهَادُ ﴿١٩٧﴾ لَكِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا رَبَّهُمْ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرَى مِنْ تَحْتِهَا  
الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا نُزُلًا مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ لِلْأَبْرَارِ ﴿١٩٨﴾

**“Ti mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë!**

**Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehennemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!**

**Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht, si dhuratë prej All’lilahu. Dhe ajo që është tek All’lilahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë.”**

## Shkaku i zbritjes

Shumica e politeistëve mekas kanë qenë tregtarë dhe grumbullonin pasuri të shumtë me këtë veprimtari. Edhe jahudinjtët e Medines ishin tregtarë dhe siguronin fitime. Krejt ndryshe ishte gjendja e myslimanëve. Për shkak të emigrimit të tyre, si dhe për shkak të bllokadës që i kishin vënë idhujtarët e Mekës, gjendja e tyre ekonomike ishte shumë e keqe. Ata jetonin në vështirësi të madhe.

Krahasimi i këtyre dy gjendjeve shtron disa pyetje: Si është e mundur që armiqtë e All'Ilahut të kenë mirësi dhe një jetë të lulëzuar e të bollshme, ndërsa besimtarët të jetojnë në skamje dhe në varfëri? Atëherë zbritën ajetet në fjalë, për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", Tefsiri "El-Menar", Tefsiri "Mijzan" në komentimin e këtij ajeti.

## Komentimi

### Pyetje shqetësuese

Pyetja e lartpërmendur në shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve, të cilën e shtronin myslimanët në kohën e Profetit, shtrohet në çdo kohë dhe në çdo vend. Ata mendojnë se si ka mundësi që mëkatarët, faraonët, të devijuarit dhe zullumqarët të jetojnë në mirësi, të bëjnë jetë aristokrate, ndërkohë që jeta e besimtarëve të devotshëm është e mjeruar.

Si është e mundur që me gjithë mëkatet dhe gjynahet që bëjnë, ata jetojnë jetë luksoze, kurse besimtarët, që mbartin besimin, devotshmërinë dhe bëjnë punë të mira jetojnë në vështirësi e varfëri?! Kjo gjë bëri që disa individë me besim të dobët të lëkunden dhe të dyshojnë.

Po ta studiojmë këtë pyetje, duke analizuar faktorët që kanë çuar në këtë situatë, do të zbulonim përgjigje të shumta. Disa përgjigje i japin këto ajete dhe disa të tjera zbulohen me pak meditim dhe hulumtim.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **“Ti mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë!”** Edhe pse All’llahu i drejtohet profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thirrja këtu është për të gjithë besimtarët.

Pastaj All’llahu i Lartësuar thotë: **“Kjo mirëqenie është e shkurtër.”**

Këto suksese materiale, që i kanë idhujtarët, që i arrijnë nga çdo rrugë, nuk janë veçse një mirëqenie e shkurtër dhe kënaqësi kalimtare.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...strehimi i tyre është Xhehennemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!"** Kënaqësitë materiale do të kenë një përfundim të keq. Përgjegjësia ndaj kësaj pasurie materiale do t'i çojë në një të ardhme të brishtë, në Xhehennem, i cili do të jetë vendi i fundit i tyre. Sa strehim i keq është ai!

Ky ajet tregon dy çështje të rëndësishme:

**E para:** Me të vërtetë, shumica e fenomeneve të epërsisë së atyre mëkatarëve të padrejtë kanë dimensione të kufizuara. Po ashtu, edhe lodhjet, mundimet dhe vështirësitë e besimtarëve janë të përkohshme dhe të kufizuara. Dëshmia më e mirë për këtë tematikë është ajo çfarë shikojmë në jetën e myslimanëve dhe në jetën e armiqve të tyre në fillim të ardhjes së Islamit.

Shteti islam atëherë ishte si një pemë e re, me degë shumë të holla dhe delikate, që mezi i përballonte sulmet e armiqve, të cilët i sulmonin pa mëshirë, sidomos pas shpërnguljes së myslimanëve. Kjo gjë i ndodh gjithkujt që ngrihet në revolucion ndryshimi e reformimi shpirtëror në një shoqëri të mbuluar nga e keqja, degjenerimi dhe shkatërrimi.

Ne e dimë se kjo gjendje nuk vazhdoi gjatë. Shteti islam, kur i forcoi rrënjët, duke forcuar njëkohësisht pasurinë dhe ekonominë, ndryshoi situatën.

Të pasurit idhujtarë dhe armiqtë që kënaqeshin me mirësitë e kësaj jete e humbën këtë mirësi e kënaqësi. Ky është edhe qëllimi i fjalës së All'Ilahut, kur thotë: **“Kjo mirëqenie është e shkurtër.”**

**E dyta:** Sukseset materiale që korrnin disa mëkatarë ishin për shkak se ata nuk kufizoheshin në asgjë për të grumbulluar pasuri. Përdornin të gjitha rrugët dhe mjetet për grumbullimin e saj, qofshin të ligjshme apo të paligjshme, të lejuara (hallall) apo të palejuara (haram). Jo vetëm kaq, ata ia lejonin vetes së tyre të grumbullonin pasuri në llogari të të varfërve, duke ua pirë gjakun. Ndërkohë që besimtarët kushtëzoheshin me parime, drejtësi e barazi në këtë fushë. Nuk ia lejonin vetvetes fitimin e pasurisë me çdo rrugë apo mënyrë. Për këtë nuk mund të krahasohen besimtarët me jobesimtarët.

Myslimanët kanë ndjenjën e përgjegjësisë së fitimit dhe të shpenzimit të pasurisë. Kurse jobesimtarët nuk e kanë këtë ndjenjë. Përderisa kjo jetë është jetë e zgjedhjes dhe e lirisë, është e natyrshme që All'Ilahu i ka lënë të lirë këto dy grupe për të vepruar. Fundi i tyre do të jetë i bazuar te veprat që bënë me duart e tyre. Kjo është arsyeja se pse All'Ilahu thotë në fund të ajetit: **“...strehimi i tyre është Xhehennemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!”**

### Njohja e pikave të dobëta dhe të forta

Është edhe një arsye tjetër që mohuesit kanë sukses dhe përparim, ndërsa besimtarët prapambetje. Grupi i parë, edhe pse i mungonte besimi, nganjëherë, ishte i fortë dhe shpeshherë kornte suksese dhe fitonte pasuri.

Ndërsa, grupi i dytë, myslimanët, kishin pika të dobëta, të cilat çonin në prapambetjen dhe rënien e tyre.

Ka njerëz, të cilët janë të lidhur shumë me All'llahun, janë serioz në punët e tyre, janë të vendosur e të palëkundur, bashkëpunojnë me të tjerët, janë të njohur me kërkesat dhe të rejat e kohës, etj. S'ka dyshim se këta njerëz janë të suksesshëm në jetën e tyre materiale dhe shpirtërore. Kjo ndodh se ata zbatojnë me korrektësi mësimet e fesë dhe programin e saj, por pa i dhënë këtyre punëve ngjyra fetare.

Nga ana tjetër, ka njerëz besimtarë që i kryejnë me sinqeritet parimet fetare, por për arsye të mosinformimit të tyre nga mësimet e fesë dhe nga indiferenca, vuajnë nga frika, nuk janë të vendosur, janë të lëkundur në bashkëpunim e unifikim. Është e natyrshme që këtë grup do ta godasin humbje të njëpasnjëshme. Mirëpo këto humbje nuk janë për shkak të besimit të tyre në All'llahun e Lartësuar. Ato janë për shkak të pikave të dobëta që kanë në veten e tyre.

Ata mendojnë, (ose hamendësojnë) se do të fitojnë në të gjitha fushat e jetës, vetëm se falin namazin, agjërojnë, e të tjera adhurime. Ndërkohë që feja ka ardhur me një paketë programesh praktike të gjalla, për të përparuar dhe për të pasur sukses në këtë botë. Injorimi i programit të fesë të çon në prapambetje, në humbje.

Për çdo gjë ka një shkak dhe çdo sukses ka çelësin e tij të veçantë. Feja islame ka sjellë të gjitha çelësat e sukseseve dhe i ka sqaruar mësimet nëpërmjet këshillave të saj. Është e pamundur që të realizohet suksesi pa këto mësimet dhe pa këto mënyra.

Përmbledhja e fjalisë është se secili grup ka pikat e tij të forta e të dobëta dhe këto pika, të forta apo të dobëta, kanë shenjat e veta për rezultatet e arritura. Ka raste që ndikimet mund të keqkuptohen dhe mund të vlerësohen nga njeriu.

Për shembull: Ka jobesimtar, i cili për shkak të përpjekjeve të vazhdueshme të tij në punë, fiton dhe arrin sukses. Por, nëse ai nuk e ka besimin te All'llahu, nuk ka mirësinë e qetësisë shpirtërore.

Mbetet të themi se ato tre faktorë të përparimit të jobesimtarëve dhe të prapambetjes së besimtarëve nuk vërtetohen në një vend të vetëm dhe në një çështje të vetme, sepse secila çështje ka karakteristikat dhe faktorët e saj të posaçëm.

All'llahu i Lartësuar, pasi shpjegon të ardhmen e mohuesve në ajetin paraardhës (196), në ajetin në vijim flet për të ardhmen e besimtarëve: **“Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht...”**

Ata që ndjekin parimin e drejtësisë e të vërtetës për të korrur fitimet materiale apo përballen me bllokada dhe presione të shumta ekonomike dhe i përballojnë me devotshmëri këto situata të vështira, All'llahu i Lartësuar do t'ua kompensojë të gjitha këto me Xhennet (kopshte), ku rrjedhin lumenj të përhershëm. All'llahu i Lartësuar thotë: **“...si dhuratë prej All'llahut. Dhe ajo që është tek All'llahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë.”**

Fjala *nuzul*, nga ana gjuhësore do të thotë *respekt dhe mikpritje për miqtë*. Të tjerë kanë thënë se është gjëja e parë që u shërbehet miqve kur vijnë për vizitë, pije ose fruta.

Duke u bazuar në kuptimin e kësaj fjale, kuptimi i ajetit është se kopshtet (Xhennetet), të treguara me të gjitha ato mirësi dhe dhurata materiale, janë gjërat e para që u jepen dhe u shërbejnë besimtarëve të sigurtë në Ditën e Kiametit. Por mikpritja më e rëndësishme janë mirësitë shpirtërore dhe dhuntitë për të cilat All'llahu i Madhëruar thotë: **"Dhe ajo që është tek All'llahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë."**

## Ajeti 199

وَإِنَّ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَمَنْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَمَا أُنْزِلَ إِلَيْكُمْ وَمَا أُنْزِلَ إِلَيْهِمْ  
خَشِعِينَ لِلَّهِ لَا يَشْتُرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ ثَمَنًا قَلِيلًا ۖ أُولَٰئِكَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ  
رَبِّهِمْ ۖ إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿١٩٩﴾

“Midis ithtarëve të Librit, me siguri ka të atillë që e besojnë All’llahun dhe atë që ju është shpallur juve, si dhe atë që u është shpallur atyre, duke qenë të përlur para All’llahut dhe pa i këmbyer shpalljet e Tij me ndonjë vlerë të paktë. Ata do të kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre. Vërtet, All’llahu është i shpejtë në llogari!”

## Shkaku i zbritjes

Ky ajet, sipas mendimit të shumicës së komentuesve, ka zbritur për besimtarët e ithtarëve të Librit, të cilët e lanë fanatizmin e verbuar dhe iu bashkëngjitën rreshtave të myslimanëve. Ata ishin një numër i konsideruar prej të krishterëve dhe jahudinjeve.

Mirëpo, sipas mendimit të disa komentuesve, ky ajet ka zbritur për Nexhashin, mbretin e drejtë të habeshive, edhe pse kuptimi i ajetit është më i gjerë.

Nexhashi ka vdekur në vitin e nëntë të hixhretit, në muajin Rexheb. Kur profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mori vesh lajmin e vdekjes së Nexhashit, me anë të frymëzimit nga ana e All'Ilahut, tha: *"Dilni dhe faleni namazin e një vëllai, i cili ka vdekur jashtë vendit tuaj."*

I thanë: "Kush është ai?" Profeti iu përgjigj: *"Nexhashi."* Profeti shkoi në Baki'ë dhe që atje atij iu zbulua Habesheja, shikoi shtratin e Nexhashiut dhe ia fali namazin.

Disa hipokritë thanë: *"Shikojeni këtë, ia fali namazin një të krishteri habeshi, të cilin jo vetëm që s'e ka parë kurrë, por edhe nuk ka qenë në fenë e tij."* Atëherë, All'Ilahu zbriti këtë ajet duke iu përgjigjur thënies së tyre.<sup>1</sup>

Nga ky transmetim kuptohet se Nexhashi e kishte pranuar Islamin, por nuk e kishte shprehur hapur.

## Komentimi

### Ithtarët e Librit nuk janë të barabartë

Më parë kemi thënë se Kur'ani Fisnik, kur ka trajtuar çështje të ndjekjes së legjislacioneve (sherieve) të tjera, nuk i shikon me një vështrim të njëjtë dhe nuk i llogarit me llogari të përbashkëta. Hulumtimet e tij nuk bazohen në kombësi e racë. Ai (Kur'ani) bazohet në parimet e besimit.

---

<sup>1</sup> "Esbabul Nuzul Vakidijj" faqe 93, "Mustedrekul Vesail", vëllimi 2, faqe 275.

Për këtë ai i kritikon punët dhe veprat e tyre. Kur'ani nuk i gjykon njerëzit sipas kombësisë apo racës. Çështjet që i shtron për trajtim përfshin të gjithë popujt dhe të gjitha kombet. All'Ilahu nuk i harron veprat e asaj pakice besimtare, e cila dallohej nga shumica për nga sinqeriteti dhe veprat e mira.

Edhe këtu flitet për një prej atyre çështjeve, ku një pakicë besimtarësh iu përgjigj thirrjes së profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe ndoqën të vërtetën. Ajeti në fjalë, pas qortimeve të shumta ndaj ithtarëve të Librit, për shkak se fshihnin të vërtetat, flet për atë pakicë besimtare, duke përmendur pesë veçori të tyre:

1- All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Midis ithtarëve të Librit, me siguri ka të atillë që e besojnë All'Ilahun.”** Ata e besojnë All'Ilahun e Lartësuar me bindje e me përlulje të plotë.

2- **“Dhe atë që ju është shpallur juve.”** Me të vërtetë ata i besojnë Kur'anit Fisnik.

3- **“Si dhe atë që u është shpallur atyre.”** Sigurisht besimi i tyre në Profetin buron në besimin te ajo që u është zbritur nga librat qiellorë, të cilët kanë lajmëruar për këtë profet dhe u bëjnë thirrje që t'i besojnë atij kur të shfaqet.

4- **“Duke qenë të përlulur para All'Ilahut.”** Ata e pranojnë urdhrin e All'Ilahut të Lartësuar dhe i nënshtrohen dëshirës së Tij. Kjo bindje dhe përlulje është shkak i besimit të tyre të vërtetë. Ai i dalloi ata nga fanatikët e verbër dhe i liroi nga robëria dhe mendjemadhësia në drejtim të të logjikuarit të drejtë.

**5- "Dhe pa i këmbyer shpalljet e Tij me ndonjë vlerë të paktë."** Ata nuk janë si disa dijetarë jahudinj, të cilët i ndryshojnë argumentet, provat (ajetet) e All'llahut për të ruajtur pozitën e tyre, si dhe për të komanduar popullin dhe shoqërinë e tyre, me qëllim që të arrijnë përfitime materiale.

Sintagma *me ndonjë vlerë të paktë* tregon fyerjen e atyre dijetarëve që kanë deformuar ajetet e zbritura. Kjo sintagmë tregon se çdo shpërblim, pa shpërblimin hyjnor është përçmues dhe çdo përfitim, që arrin njeriu duke hedhur poshtë argumentet e All'llahut, është pa vlerë.

Ky grup i ithtarëve të Librit (që i pranuan e i besuan argumentet e All'llahut të Lartësuar), për shkak të cilësive të larta njerëzore që kishin dhe për qëndrimin e qartë e të gjallë që mbajtën në përhapjen e fesë islame, do të kenë tek Zoti i tyre shpërblim. All'llahu i Lartësuar për këtë thotë: **"Ata do të kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre."**

Sintagma *Zoti i tyre* tregon për kulmin e butësisë së Tij dhe dhurimin e mëshirës së Tij të gjithë atyre që janë udhëzuar nga All'llahu i Lartësuar dhe që ecin në rrugën e Tij. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Vërtet, All'llahu është i shpejtë në llogari!"**

Ai nuk e vonon shpërblimin për besimtarët. Gjithashtu, nuk ia vonon ndëshkimin jobesimtarëve të devijuar. Gjithashtu, nga njëra anë, është sihariq për besimtarët e vërtetë dhe punëmirë. Dhe, nga ana tjetër, është kërcënim për të padrejtët dhe mëkatarët.

## Ajeti 200

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَصْبِرُوا وَصَابِرُوا وَرَابِطُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٢٠٠﴾

**“O ju që keni besuar! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë dhe jini të devotshëm ndaj All’llahut, që të shpëtoni!”**

### Komentimi

Ky ajet është ajeti i fundit i sures “Al-Imran” dhe përmban një program të përbërë prej katër pikash të rëndësishme. All’llahu i lartësuar u drejtohet besimtarëve: **“O ju që keni besuar!”**

#### 1) **“Bëhuni të durueshëm...”**

Neni i parë i këtij programi, që i siguron krenarinë dhe triumfin myslimanëve, është vendosmëria dhe durimi për t’i bërë ballë ngjarjeve dhe ndodhive. Durimi është çelësi i suksesit material dhe shpirtëror. Kjo çështje meriton një shpjegim të plotë për ndikimin e madh në jetën e njeriut. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Durimi është prej besimit dhe koka është prej trupit.”*<sup>1</sup>

#### 2) **“...dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë...”**

Kur’ani Fisnik i këshillon besimtarët, në fillim, të jenë të duruar dhe të jenë të udhëzuar (i cili përfshin të gjitha llojet e Xhihadit, si Xhihadi me vetveten dhe vendosmëria për t’i bërë ballë të gjitha problemeve të jetës).

---

<sup>1</sup> “Nehxhul Belaga”, fjalë të shkurtra, fjala 82.

Pastaj, përsëri i këshillon për durim e qëndrueshmëri përballë armikut. Kjo ka një dobi se, nëse populli nuk fiton luftën me vetveten e nuk e ndreq, tregon pikat e dobëta të tij, është e pamundur të fitojë ndaj armikut. Humbjet e mëdha përpara armikut janë për shkak të humbjeve përballë luftimit të vetvetes.

Nga kjo pjesë e ajetit mësohet se myslimanët duhet ta shtojnë durimin dhe qëndrueshmërinë dhe ta kultivojnë atë tek të tjerët, ashtu si e shtojnë armiqtë durimin dhe qëndrueshmërinë për t'u bërë ballë besimtarëve.

### 3) "... bëhuni të vendosur dhe vigjilentë..."

Shprehja *ue rribitu* rrjedh nga rrënja e fjalës *rribat*, që do të thotë *lidhja e diçkaje në një vend* (si lidhja e kalit në një vend). Kjo është arsyeja që "shtëpisë së miqve" i kanë thënë *rribat*. Thuhet se e ka lidhur në zemrën e tij, që do të thotë i ka dhënë qetësi. Fjala *murrabitatu* do të thotë *mbikëqyr kufijtë, duke i ruajtur ato*.

Kjo shprehje është një urdhër i qartë për myslimanët, që të jenë gjithmonë të përgatitur për t'u bërë ballë armiqve, të jenë të aftë e të zgjuar dhe në mbikëqyrje të vazhdueshme të kufijve të vendeve islame, që të mos sulmohen befasisht nga armiqtë. Madje i nxit që të jenë vigjilentë për t'i bërë ballë shejtanit e për ta luftuar atë, për të luftuar epshin e dëshirat.

Sipas imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), fjala *murrabitatu* ka të bëjë me pritjen nga namazi në namaz.<sup>1</sup> Ai që e ruan zgjuarsinë (nuk fle) e shpirtit dhe të ndërgjegjes së tij me këto adhurime të

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", "Vesailu Shijja", vëllimi 4, faqe 117.

vazhdueshme e pa ndërprerje, është si ushtari i armatosur për t'u përballuar me armikun.

Fjala *murabeta* ka një kuptim të gjerë, që përfshin të gjitha llojet e mbrojtjes së individit dhe të shoqërisë.

Në jurisprudencën islame, në kapitullin e xhihadit (luftës për në rrugë të All'llahut të Lartësuar), është një temë me titullin "Murrabeta" me kuptimin e gatishmërisë dhe të përgatitjes për të mbrojtur kufijtë dhe sulmet e armiqve.

Fjalë *el murrabitun* është përdorur edhe për dijetarët, sikurse ka ardhur në disa hadithe nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): "Dijetarët e shi'ave janë rojtarët e kufijve nga të cilët mund të vijë djalli me ushtrinë e tij. Ata i ndalojnë ato që të sulmojnë të dobëtit prej shi'ave tanë dhe i ndalojnë që djalli të mos i sundojë."<sup>1</sup>

Pasi lexojmë këtë hadith, kuptojmë se dijetarët janë në një pozitë më të lartë se ushtarët dhe udhëheqësit, të cilët ruajnë kufijtë dhe vrojtojnë nga aty armiqtë e Islamit.

Nga kjo kuptohet se dijetarët e mbrojtësit e fesë janë ndër njerëzit më të besueshëm, që krahasohen me ushtarët, por që ruajnë vlerën e Islamit. Nëse ushtarët ruajnë kufijtë gjeografikë, dijetarët ruajnë kufijtë shpirtërorë, pasi, nëse depërton mendimi dhe kultura e një populli te një popull tjetër e u paraqitet si mashtrim i armiqve, nuk do të mundën ta mbrojnë me sukses. Shumë shpejt do ta godasë humbja ushtarake e politike.

<sup>1</sup> "Ihtixhaxh Tabrisij", vëllimi 1, faqe 17, "Biharul Envar", vëllimi 2, faqe 5.

#### 4) "...dhe jini të devotshëm ndaj All'llahut..."

Kjo pjesë e fjalisë është mësimi dhe urdhri i fundit i këtij planprogrami. Është një mburojë e vërtetë dhe mësimet islame urdhërojnë për devotshmëri. Duhet që durimi, vigjilenca, udhëzimi dhe qëndrueshmëria, të bashkohen me elementin e devotshmërisë ndaj All'llahut të Lartësuar, që të mos shpërthejë egoizmi, hipokrizia apo qëllimet personale. All'llahu i Lartësuar vazhdon e thotë: "Që të shpëtoni."

Kështu e mbyll ky ajet planprogramin, duke përmendur rezultatin që e pret cilindo që e zbaton atë në jetën e tij. Ky është shpëtimi dhe suksesi që arrijnë njerëzit, duke zbatuar urdhrat dhe mësimet e All'llahut. Nëse nuk e zbatojnë, nuk arrijnë suksesin e as shpëtimin.

Vetvetiu shtrohet pyetja: Përse disa shprehje dhe fjalë të Kur'anit Fisnik fillojnë me fjalën *leale*, që do të thotë *ndoshta* ose *që të*, ashtu si mbaron ky ajet: "që të shpëtoni", apo "që të jeni të devotshëm, apo "që të mëshiroheni?" Siç e dimë, kjo fjalë nënkupton mëdyshje që nuk i përshtatet All'llahut të Gjithëditur për gjithçka. Disa armiq të Islamit e morën këtë çështje si argument, që të thonë se premtimet e Islamit për shpërblime nuk janë të vërteta. Në to ka dyshime, sepse në të shumtën e rasteve këto premtime fillojnë me fjalën *leale*.

Kjo lloj thënie përshkruan dhe sqaron madhështinë e këtij Libri të shenjtë dhe realitetin e tij në qartësimin e çështjeve të ndryshme. Kur'ani përdor fjalën *leale* në të gjitha ato vende ku rezultati ka kushte të paracaktuara.

Dëgjimi me vëmendje dhe heshtje kur lexohet Kur'ani nuk mjaftojnë për të fituar mëshirën e All'llahut. Por patjetër ajetet duhet të kuptohen, të dihet kuptimi i tyre, të zbatohen këshillat, mësimet, urdhëresat e ndalesat e tyre. Kjo është arsyeja që pse All'llahu i Lartësuar thotë në Kur'an: **"Kur të lexohet Kur'ani, dëgjojeni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni."**<sup>1</sup> Bazuar në këtë që u tha, sikur Kur'ani të thoshte se ju patjetër do të mëshiroheni, do të ishte larg realitetit, sepse, që të arrihet kjo, duhet të plotësohen edhe kushte të tjera, të cilat nuk duhet të injorohen. Kur thotë fjalën *leale hum, që ata të, Ai i ka parë dhe i di ata që i kanë plotësuar kushtet*.

Ka pasur raste që disa dijetarë kanë thënë që kuptimi i fjalës *leale*, nuk është përdorur këtu me kuptimin e saj të vërtetë, por kjo është në kundërshtim me të dukshmen e saj, pa pasur argument.

Ky ajet, tregoi për katër mësimet të rëndësishme të Islamit. Por, që myslimanët të mos bëhen të pavëmendshëm ndaj programeve edukative islame, ka përdorur fjalën *leale*, për t'i kujtuar se ka kushte dhe kritere që ndikojnë në fitimin e mëshirës. Prandaj, këto kushte dhe kritere nuk duhen neglizhuar.

Sikur myslimanët, këtë ajet, ta bënin slogan dhe planprogram të jetës së tyre të përditshme dhe t'i zbatonin dobisht e tij, do të zgjidhnin shumë probleme, prej të cilave po vuajnë sot.

---

<sup>1</sup> Sure "El-Araf", ajeti 204.

Goditjet e rënda që merr Islami dhe myslimanët këto ditë janë për shkak të injorimit apo të harrimit të një pjese apo e këtyre katër këshillave islame.

Sikur myslimanët t'ia kthenin vetes shpirtin e qëndrueshmërisë dhe të udhëzimit, sikur të shtonin përpjekjet për t'i bërë ballë forcës së armikut, sikur të meditonin rreth asaj që thuhet në këtë ajet, do t'i shtonin forcat për të ruajtur kufijtë gjeografikë, mendorë, kulturorë dhe të besimit.

Sikur të ruanin gjendjen e tyre të gatishmërisë dhe të armatoseshin me armën e devotshmërisë e të sinqeritetit, do ta pastronin shoqërinë nga mbeturinat e degjenerimit e të shkatërrimit, si dhe do të garantonin shpëtimin dhe fitoren.

O Zoti ynë, na mundëso që të kapemi pas mësimave të Librit Tënd qiellor e të madhëruar në jetën tonë të përditshme. Na e shto mëshirën Tënde të madhe dhe na garanto neve me zemërgjerësinë Tënde! Amin! O Zoti i botëve.

**Fundi i sures "Al Imran"**

**SURE "EN-NISÂ"**

**Medinase - 176 vargje**

**Bismil-lâhirr Rrahmânirr Rrahîm**

## **Me emrin e All'lahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**

Përpara se të hyjmë në shpjegimin e ajeteve të kësaj sureje, e ndiejmë për detyrë që t'i kujtojmë lexuesit të nderuar disa pika të rëndësishme që janë:

### **1-Tematika e zbritjes së kësaj sureje**

Të gjitha ajetet e kësaj sureje (përveç ajetit 58) janë të shpallura në Medinen e Ndritur. Kjo sure, sipas renditjes së zbritjes është shpallur pas sures "El-Mumtehine", sepse renditja e sotme e sureve të Kur'anit, sikurse e dimë, nuk përputhet me renditjen e shpalljes. Me kuptimin që shumica e sureve që janë shpallur në Mekkë, sipas renditjes aktuale, janë të renditura në xhuzin e fundit të Kur'anit. Shumica e sureve, që janë shpallur në Medine, janë të renditura në xhuzet e para të Kur'anit.

Ne këtë e kemi thënë edhe në fillim të xhuzit të parë të këtij komentimi. Me të vërtetë, ka argumente që dëshmojnë se grumbullimi i Kur'anit dhe renditja e sureve në formën e tanishme është bërë që në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Bazuar mbi këtë argument, Profeti i nderuar ka urdhëruar që suret të renditen në këtë formë që ne i gjejmë tani të renditura në Kur'an (duke filluar me suren e parë "El-hamin" ("El-Fatiha" dhe duke përfunduar me suren e fundit "En-Nas"). Atë e ka bërë për arsye të ndryshme. Një prej arsyeve është rëndësia e tematikave që përmbajnë suret. Kështu që ne edhe sot e gjejmë

renditjen e sureve në këtë formë, pa asnjë ndryshim renditjeje në shtim ose në heqje të germave, ajeteve ose të sureve të Kur'anit.

Me të vërtetë, kjo sure, për nga numri i fjalëve dhe germave, konsiderohet surja më e gjatë e Kur'anit, pas sures "El-Bekare". Kjo sure ka 176 ajete. Është quajtur surja "En-Nisa" sepse përmbledh kërkitime të shumta tematikore dhe shpjegime të qarta rreth rregullave dhe të drejtat që u takojnë grave.

## 2-Përmbajtja e kësaj sureje

Kjo sure, sikurse e përmendëm edhe më lart, është shpallur në Medine, kur Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte në fillim të formimit të shtetit islam dhe të formimit të një shoqërie të drejtë e të udhëzuar.

Kjo sure përmban një grumbull ligjesh, të cilat kanë një ndikim të madh në rregullimin dhe në ndërgjegjen e shoqërisë dhe në formimin e një mjedisi të rregullt dhe sa më të pastër shoqëror. Nga ana tjetër, shumica e këtyre personave të kësaj shoqërie të re që kanë hyrë në Islam kanë qenë prej idhujtarëve dhe të infektuar nga mikrobet dhe mbeturinat e injorancës.

Për këtë arsye, para çdo gjëje, duhet të pastrohen mendjet, zemrat dhe shpirtrat e tyre nga mbeturinat e injorancës, pastaj të vendosen ligjet dhe rregullat për të kthyer dhe për të rindërtuar shoqërinë në vend të zakoneve të injorancës.

Tematikat e ndryshme, për të cilat kjo sure flet janë:

1- Thirrja për në besim dhe në drejtësi. Shkëputjet e lidhjeve me armikun e përбетuar dhe me kundërshtarët e pabindur.

2- Përmendja e disa historive të popujve të mëparshëm, me qëllim njohjeje për fundin e shoqërive jo të drejta.

3- Ndhimesa e nevojtarëve dhe mbrojtja e tyre, siç janë jetimët dhe qartësimi i mësimëve të domosdoshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

4- Legjislacioni i trashëgimisë dhe trashëgimia në një formë të natyrshme dhe të drejtë, në këmbim të largimit të formës së keqe, e cila zbatohet në kohën para Islamit, ku të dobëtëve u ndalohej trashëgimia me argumente të kota e të pabaza dhe për shkaqe të padrejta.

5- Ligje dhe rregulla që kanë lidhje me martesën dhe që ruajnë pastërtinë në përgjithësi.

6- Ligje të përgjithshme, që ruajnë dhe garantojnë pasurinë e përgjithshme.

7- Ruajtjen dhe përmirësimin e themeleve bazë të gjendjes së unitetit në shoqëri dhe në veçanti të familjes.

8- Detyrimet dhe të drejtat e individëve në shoqëri.

9- Informimi i myslimanëve se kush janë armiq të shoqërisë islame dhe paralajmërimi i tyre.

10- Shteti islam dhe domosdoshmëria e bindjes ndaj udhëheqësit e këtij shteti.

11- Nxitja e myslimanëve që t'i kundërvihen armiqve dhe t'i luftojnë ata.

12- Eksplorimi i armiqve, të cilët mund të bashkëpunojnë në veprime të fshehta kundër myslimanëve.

13- Rëndësia e emigrimit (hixhretit) dhe domosdoshmëria e saj në kohën e përballjes me një shoqërie të prishur, e cila nuk ndikohet dhe nuk ndryshon.

14- Kërkimi tjetër rreth sistemit të trashëgimisë dhe domosdoshmëria e ndarjes së pasurisë ndërmjet trashëguesve.

### 3- Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Në një transmetim nga Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Kush lexon suren “En-Nisa” është sikurse i ka dhënë lëmoshë çdo besimtari dhe ka trashëguar një trashëgimi. Atij i jepet shpërblim sikurse ai që ble dhe e liron një rob.”<sup>1</sup>

Është mëse e qartë se qëllimi në këtë transmetim nuk është vetëm që të lexohet kjo sure, por të kuptohet përmbajtja e saj, e cila çon në zbatimin e mësimave të kësaj sureje në jetën individuale dhe atë shoqërore. Të kuptohet dhe të përfitohet nga çdo individ dhe shoqëri në jetën e tyre të përditshme. Sikur myslimanët të frymëzohen nga mësimet e kësaj sureje në jetën e tyre të përditshme, padyshim që do ta fitonin këtë shpërblim.

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, “Mustedreku Uesail”, vëllimi 4, faqe 338.

## Ajeti 1

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا  
زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ  
وَالْأَرْحَامَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ﴿١﴾

**“O njerëz! Jini të devotshëm ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe jini të devotshëm ndaj All’lauhut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, All’lahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”**

## Komentim

### Luftimi i dallimeve dhe i përvetësimeve

Thënia e parë e kësaj sureje: **“O njerëz”** i drejtohet gjithë njerëzimit, sepse në këtë sure trajtohen çështje që i nevojiten çdo individ në jetën e tij të përditshme.

Nga ana tjetër, ky ajet fton në devotshmëri, e cila është themeli dhe baza e çdo programi ndreqës dhe rregullues për shoqërinë. Zbatimi i të drejtave, ndarja me drejtësi e pasurisë, mbrojtja e jetimëve, ruajtja e të drejtave të familjes e të ngjashme si këto, janë çështjet që nuk mund të realizohen pa devotshmërinë ndaj Zotit. Për këtë, kjo sure, e cila i përmban të gjitha këto çështje, fillon me thirrjen për zbatimin e devotshmërisë **“...Jini të devotshëm ndaj Zotit tuaj...”**

Për njohjen e All’llahut, i cili është Mbikëqyrësi i punëve të njeriut. Ky ajet tregon një rën prej cilësive të Tij, që konsiderohet si baza e unitetit shoqëror në botën njerëzore: **“...i Cili ju krijoi prej një njeriu...”**

Bazuar në këtë thënie, nuk mund të justifikohet dallimi në racë, në gjuhë, në vend, në fise dhe të ngjashme si këto, të cilat shkaktajnë probleme në jetën tonë të përditshme. Mbi të gjitha këto çështje nuk ka vend për krenari të rrejshme dhe lartësim të zyrtë në shoqërinë myslimane, sepse të gjithë njerëzit, pavarësisht ndryshimit të tyre: në gjuhë, në ngjyrë, në racë dhe vend, e kanë origjinën e tyre nga një babë dhe një nënë (Ademi dhe Havaja).

Rëndësia e luftimit të dallimit qartësohet më shumë nëse i kthehemi dhe e shikojmë se çfarë pasojash kishte sistemi i padrejtë

fisnor, para ardhjes së Profetit. E njëjtë me këtë shprehje gjendet edhe në vende të tjera në Kur'anin Famëlartë. Gjithsecilën do ta shpjegojmë në vendin e vet.

Tani duhet të shikojmë se cili është qëllimi i thënies: "*prej një njeriu të vetëm*". A është qëllimi i kësaj thënieje një person i veçantë apo është një lloj i vetëm (gjinia mashkullore)? Nuk ka dyshim se, sipas pamjes së jashtme të ajetit, bëhet fjalë për një person të vetëm, për njeriun e parë, të cilin Kur'ani e quan Adem dhe e konsideron babanë e të gjithë njerëzimit.

Në shumë ajete, Kur'ani u thotë njerëzve "*bijtë e Ademit*". Mundësia që qëllimi i thënies "*prej një njeriu të vetëm*" të jetë për llojin e vetëm (gjinia mashkullore) është shumë e largët nga e dukshmja e këtij ajeti.

Disa komentues të Kur'anit, thënieën e All'Ilahut të Lartësuar: "**...ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij...**" e kanë kuptuar se Havaja është krijuar nga trupi i Ademit. Për këtë kanë sjellë disa hadithe e transmetime jo të konsiderueshme, të cilat thonë se Havaja është krijuar nga brinja e Ademit.<sup>1</sup> (Këtë çështje e gjejmë të qartë në Teurat në librin "*Zanafilla*").<sup>2</sup>

Por, duke parë dhe duke studiuar edhe ajetet e tjera kur'anore, çdo dyshim rreth komentimit të këtij ajeti largohet.

Do të sqarohet se kuptimi i kësaj thënieje është se All'Ilahu i Lartësuar e ka krijuar bashkëshorten e Ademit nga lloji i vet (nga

---

<sup>1</sup> "Men la jahdarhu el fakijh", vëllimi 3, faqe 380, "Uesailu Shia" vëllimi 26, faqe 287-288.

<sup>2</sup> Libri "*Zanafilla*", Kapitulli i dytë, fraza 21-22 thotë: "...prandaj Zoti i hodhi Ademit një gjumë të rëndë. Pasi e zuri gjumi, ia nxori një brinjë dhe e veshi me mish. Nga ajo brinjë Zoti krijoi gruan (Havanë) dhe e solli te Ademi."

lloji njerëzor). Në suren “Err-Rrum”, ajeti 21, lexojmë: **“Dhe prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja që të qetësoheni pranë tyre.”** Gjithashtu, në suren “En-Nahl”, ajeti 72, thuhet: **“All’llahu i ka krijuar për ju gratë nga lloji juaj.”**

Kuptimi i ajetit **“All’llahu i ka krijuar për ju gratë nga lloji juaj”** është që All’llahu i krijoi gratë nga lloji i juaj dhe nuk i ka krijuar nga një pjesë e trupit tuaj.

Sipas transmetimit nga Imam Muhamed Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), sikurse e gjejmë në komentimin e “Ajashijit”, Imami e ka refuzuar me forcë mendimin e krijimit të Havasë prej brinjës së Ademit. Ai ka shpjeguar se Havaja është krijuar nga mirësia e së njëjtës tokë që është krijuar Ademi.

### **Si ka qenë martesë e bijve të Ademit?**

All’llahu i lartësuar thotë: **“...kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra...”** Nga kjo pjesë e ajetit ne përfitojmë se paraardhësit e Ademit dhe shtimi i tyre ka ndodhur vetëm nëpërmjet Ademit dhe Havasë, pa qenë ndonjë faktor i tretë në këtë shtim.

Dhe me frazeologji tjetër: Ekzistenca e llojit të njerëzimit përfundon tek Ademi dhe bashkëshortja e tij, pa pasur ndërhyrje tjetër, mashkull ose femër, përveç këtyre të dyve. Kjo është arsyeja që i detyron bijtë e Ademit që të jenë vëllezër e motra dhe që të martohen ndërmjet njëri-tjetrit.

Dhe nëse do të ishte shtimi i llojit të njerëzimit me martesë, jo nga lloji i tyre, nuk do të kishte kuptim dhe nuk do të ishte e saktë fjala e All’llahut: **“prej atyre të dyve.”**

Për këtë temë janë transmetuar shumë hadithe. Nuk ka vend për habi e për çudi, sepse, sipas argumenteve të ardhura nga disa hadithe të transmetuara nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), martesë mes vëllait dhe motrës ka qenë e lejuar, përderisa nuk kishte ardhur ndonjë argument që ta ndalonte atë.

Është e pakundërshtueshme se ndalimi i diçkaje i takon vetëm All'Ilahut. Çfarë e ndalon, kur domosdoshmëria e madhe dhe dobia e caktuar e diçkaje në një kohë të jetë e lejuar e pastaj të ndalohej?

Përveç kësaj, kanë ardhur disa hadithe të tjera, që thonë se bijtë e Ademit nuk janë martuar me motrat e tyre. Këto thënie e kundërshtojnë me forcë mendimin e parë dhe i kundërshton edhe ata që e thonë këtë mendim (martesën mes vëllezërve dhe motrave).

Nëse na kërkohet që të zgjidhnim në mesin e këtyre haditheve të mospërputhur me njëri-tjetrin, do të merrnim ajetin e qartë të Kur'anit, do të zgjidhnim grupin e parë, sepse mendimi i grupit të parë përputhet me ajetin e Kur'anit, sikurse e cekëm më parë.

Ka edhe një supozim tjetër, që thotë se bijtë e Ademit u martuan nga ajo pakicë njerëzish që mbetën dhe që kanë ekzistuar përpara Ademit dhe pasardhësve të tij, sepse, sipas disa transmetimeve, Ademi nuk ishte njeriu i parë që e banoi tokën.

Janë zbuluar fakte dhe janë bërë studime dhe verifikime shkencore se lloji njerëzor ka ekzistuar në tokë që në kohë shumë të lashta. Në një kohë që nuk është përshkruar nga historia e Ademit e gjatë jetës së tij në tokë. Atëherë duhet të pranohet teoria, që para Ademit kanë jetuar njerëz të tjerë ndër shekuj të

harruar (të panjohur), që kanë mbetur në prag të ardhjes së Ademit. Dhe çfarë është ajo e cila i ndalon bijtë e Ademit të martohen me atë lloj të njerëzimit të mëparshëm, që kanë qenë në prag të eliminimit e të zhdukjes?

Por edhe ky supozim nuk përputhet me ajetin kur'anor. (Kjo temë kërkon një hulumtim më të gjerë, mundësia e të cilit nuk është këtu).

### Thirrja për ruajtjen e lidhjeve farefisnore

Pasi përmendi se mes njerëzve ka afrimitet dhe lidhje, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Dhe jini të devotshëm ndaj All'llahut, me emrin e të cilit ju kërkonit të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore.”** Me të vërtetë, rëndësia e devotshmërisë ndaj All'llahut dhe roli i saj në ndërtimin e një shoqërie me baza të drejta është një shkak që të përmendet përsëri në fund të këtij ajeti. All'llahu i Lartësuar i bën thirrje njerëzimit që të jetë i devotshëm dhe ta zbatojë atë. Qëllim i kësaj çështjeje është se All'llahu i Lartësuar i shton devotshmërisë një fjali tjetër: **“...Dhe jini të devotshëm ndaj All'llahut, me emrin e të cilit ju kërkonit...”**, që do të thotë jini të devotshëm ndaj All'llahut, i Cili për ju është shumë i madh dhe përmendi emrin e Tij kur kërkonit të drejtat dhe nevojat tuaja.

Pas kësaj, All'llahu thotë: *uel-erham*, që do të thotë *dhe ruani lidhjet farefisnore dhe mos i shkëputni ato.*”

Përmendja e kësaj teme kaq të madhe, së pari, tregon se sa rëndësi i jep Kur'ani ruajtjes dhe lidhjeve farefisnore, ku fjalën *erham* e përmend menjëherë pas emrit të All'llahut. Së dyti, është një çështje që u shpjegua në fillim të ajetit, ku të gjithë ju jeni të

krijuar nga një baba dhe një nënë e vetme, që do të thotë se të gjithë bijtë e Ademit kanë lidhje dhe marrëdhënie farefisnore. Prandaj, të gjithë të duan njëri-tjetrin, të jenë të mëshirshëm dhe të mos bëjnë dallim mes njëri-tjetrit, nisur nga raca, fisi, ngjyra apo gjuha. Të gjithë njerëzit të jenë sikur janë individët e një farefisi.

Pastaj ky ajet mbyllet me fjalën e All'Ilahut të Lartësuar:  
**"...se vërtet All'Ilahu është përherë mbikëqyrës mbi ju."**

Fjala *rakijbun* - *mbikëqyrje*, rrjedh nga rrënja e fjalës *et terekub*, që do të thotë *mbikëqyrje nga një vend i lartë*. Pastaj është përdorur me kuptimin e ruajtësit dhe të mbrojtësit, sepse ruajtja është nga domosdoshmëritë e mbikëqyrjes dhe të kontrollit.

Mbikëqyrësit vështron nga një vend i lartë dhe vendi i tij mund të jetë i dukshëm. Po ashtu mund të jetë edhe mbikëqyrje shpirtërore.

All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"se vërtet, All'Ilahu është mbikëqyrës mbi ju"**, që do të thotë se Ai përllëgarit qëllimet dhe punët tuaja dhe se Ai i shikon dhe i di të gjitha ato. Sikurse, me të vërtetë, Ai ju ruan juve përpara ndodhive. (Përdorimi i fjalës *kane* në kohën e shkuar përdoret për përforsim).

## Ajeti 2

وَأَتُوا الْيَتَامَىٰ أَمْوَالَهُمْ ۖ وَلَا تَتَبَدَّلُوا الْخَبِيثَ بِالطَّيِّبِ ۖ وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَهُمْ  
إِلَىٰ أَمْوَالِكُمْ ۚ إِنَّهُ كَانَ حُوبًا كَبِيرًا ﴿٢﴾

**“Jepuni pasurinë jetimëve. Mos ua ndërroni sendet e tyre të mira me tuajat të këqija. Mos e harxhoni pasurinë e tyre duke e përzier me pasurinë tuaj. Se kjo, me të vërtetë është gjynah i madh.”**

### Shkaku i zbritjes

Transmetohet se një burrë nga fisi gatfan ka pasur pasuri të madhe të djalit të vëllait të vet, i cili ishte jetim. Kur arriti moshën e pjekurisë, djali i kërkoi xhaxhait pasurinë e tij, por ky refuzoi t’ia jepte. Djali u ankua te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe atëherë zbriti ky ajet: **“Jepuni pasurinë jetimëve...”** Kur e dëgjoji Gatfaniu këtë ajet, u trondit dhe tha: **“I kërkoj All’llahut falje nga gjynahu i madh.”**<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsir “Kurtubijj”, vëllimi 5 faqe 8, komentimi i ajetit në fjalë. Esbabu Nuzul i El Uahidijj, faqe 94.

## Komentimi

### Jo tradhti e mashtrim në pasurinë e jetimit

Në shoqëritë njerëzore ndodh shpesh që fëmijët të humbasin baballarët e tyre për shkak të aksidenteve, katastrofave dhe fatkeqësive të ndryshme. Në shoqëritë e sëmura, që vuajnë nga konfliktet, luftërat dhe përçarjet e vazhdueshme, siç ka qenë shoqëria arabe në kohën para Islamit, çështja e fëmijëve jetimë ka qenë e rëndësishme të trajtohet, pasi numri i fëmijëve jetimë është më i madh. Është detyrë e shtetit islam, por edhe e çdo myslimani që të interesohen për jetimët dhe për çështjet e tyre.

Ky ajet përmban tre mësimë për çështjen e pasurisë së jetimëve.

**I pari: "...Jepuni pasurinë jetimëve..."** Kjo thënie do të thotë se, kur jetimi të mbushë moshën e pjekurisë, është detyrë që pasuria e tyre, që ndodhet tek ju, t'u dorëzohet atyre. Ju duhet të veproni si besnikë, kujdestarë dhe mbrojtës dhe jo të veproni si sundues apo pronarë.

**I dyti: "...Mos ua ndërroni sendet e tyre të mira me tuajat të këqija..."** që do të thotë, mos ua merrni pasurinë e mirë dhe me vlerë duke e ndërruar me pasuritë tuaja të këqija e të pavlera. Në të vërtetë, ky mësim, në esencën e tij, ka për qëllim që të ndalojë veprën e disa mbikëqyrësve të pasurisë së jetimëve që të mos ua marrin pasurinë e mirë e me vlerë dhe t'u jepnin atyre pasurinë e keqe, me argumente që ndërrimi i pasurisë është në dobi të interesit të jetimëve apo nuk ka ndryshim mes pasurisë së tij dhe asaj të zëvendësuar, apo të thonë se, nëse pasuria e jetimit

qëndron e pandryshuar, mund të prishet, ose të humbë, e të tjera argumente të pabaza.

**I treti: “...Mos e harxhoni pasurinë e tyre duke e përzier me pasurinë tuaj...”,** që do të thotë se mos e bashkoni pasurinë e jetimit me pasurinë tuaj dhe rezultat i këtij bashkimi të jetë zotërimi i të gjithë pasurisë; ose mund të ketë kuptimin që mos bashkoni pasurinë tuaj të keqe me pasurinë e mirë të jetimit dhe si rezultat të dëmtohet jetimi dhe t’i humbë e drejta e vet. Fjala *ila*, që ndodhet në ajet, ka kuptimin *mean - me*, (me atë, apo me pasurinë)

**Cfarë do të thotë gjynah i madh? (*el huub*)**

Pastaj, për të sqaruar rëndësinë që ka kjo temë dhe për ta forcuar akoma më shumë, në mbyllje të këtij ajeti, All’Ilahu i Lartësuar thotë: “...**Se kjo, me të vërtetë është gjynah i madh.**”

Er Ragibu në fjalorin e tij “El Mufredat”, thotë: “E vërteta e fjalës *el huubetu* është nevoja që e shtyn nevojtarin për të bërë gjynah. Përderisa marrja e pasurisë së jetimit, në të shumtën e rasteve, bëhet nga nevoja apo me argumentin e nevojës, Kur’ani e ka përdorur këtë fjalë në vend të fjalës *gjynah (ithm)*, për të treguar këtë të vërtetë.”

Vështrimi dhe studimi i ajeteve të ndryshme të Kur’anit rreth kësaj teme zbulon se Islami i jep një rëndësi shumë të madhe kësaj teme. Ai i kërcënon mashtruesit dhe tradhtarët e pasurisë së jetimit me një ndëshkim të rreptë. I bën thirrje mbikëqyrësve të jetimëve me fjalë të qarta e të prera, që t’ua ruajnë dhe t’ua mbrojnë mirë pasurinë jetimëve. Këtë do ta shpjegojmë më qartë në ajetet e ardhshme të kësaj sureje, në ajetin 152 të sures “El-En’am” dhe në ajetin 34 të sures “El-Isra.”

Me të vërtetë, gjuha e fortë në këto ajete kur'anore ndikoi shumë në shpirtin e myslimanëve. Ata i frikësoheshin përzierjes me jetimët dhe ortakërisë së tyre në ushqim. Për këtë, ata përgatisin ushqim të veçantë për vetveten dhe fëmijët e tyre dhe ushqim të veçantë për jetimët, dhe nuk e përzierin ushqimin e jetimëve me ushqimin e tyre, nga frika e padrejtësisë që mund t'u bëhej atyre.

Kjo gjë ishte e vështirë, si për jetimët, ashtu edhe për kujdestarët e jetimëve. Prandaj, All'Ilahu i Lartësuar, në ajetin 220 të sures "El-Bekare", ka urdhëruar: **"Nëse jetoni bashkë me ata, dijeni se janë vëllezërit tuaj."** Nëse përzierja e ushqimit të jetimit me ushqimin e tyre është në dobi të jetimit, nuk ka gjë, nuk është gjynah.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Për më shumë shpjegime kthehu tek ky ajet (220), në po këtë tefsir, në suren "El-Bekare."

### Ajeti 3

وَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا تُقْسِطُوا فِي الْيَتَامَىٰ فَانكِحُوا مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النِّسَاءِ  
مَثْنَىٰ وَثُلَاثَ وَرُبْعَ ۖ فَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا تَعْدِلُوا فَوَاحِدَةً أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ  
ذَٰلِكَ أَدْنَىٰ أَلَّا تَعُولُوا ﴿٤﴾

“Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimëve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy; me tri; apo me katër; e nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua ose me atë që e keni në pushtetin tuaj. Në këtë mënyrë do ti ruheni padrejtësisë më të lehtë.”

#### Shkaku i zbritjes

Për këtë ajet kanë përcjellë një shkak të posaçëm zbritjeje. Në kohën para Islamit ka qenë e njohur se shumica e njerëzve në Hixhaz e merrnin përsipër mbikëqyrjen e jetimeve dhe martoheshin me to. Pastaj pronësonin pasurinë e tyre.

Kishte raste që martoheshin me to pa prikë - *mehër* ose i jepnin më pak se sa u takonte. I divorconin ato për një shkak krejt të vogël ose për një mospëlqim të pabazë.

Nga ana tjetër, as nuk i respektonin dhe as nuk i vinin në pozitën e duhur si bashkëshorte apo si femra të zakonshme.

Për këtë u zbrit ky ajet, i cili i porosit kujdestarët e jetimeve që, nëse dëshirojnë martesën me to, të bëjnë drejtësi ndaj tyre, ose të zgjedhin bashkëshorte të tjera për t'u martuar, nëse nuk bëjnë drejtësi.<sup>1</sup>

All'llahu i Lartësuar, në këtë ajet, thotë: **"Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy; me tri; apo me katër..."** Ky ajet ka ardhur pas ajetit të mëparshëm, i cili nxiste për ruajtjen dhe për garantimin e pasurisë së jetimëve nga shkatërrimi dhe shpërdorimi i saj. Ky ajet kur'anor ka zbritur që të përmendë një të drejtë prej të drejtave të jetimeve dhe kjo e drejtë është e veçantë për jetimet.

## Komentimi

Duke parë atë që përmendëm në shkakun e zbritjes, qartësohet komentimi i këtij ajeti dhe qëllimi i tij. Sikurse qartësohet edhe përgjigjja për pyetjen që lind këtu: "Përse ajeti fillon me përmendjen e jetimëve dhe mbaron me çështjen e martesës?

Gjithashtu, qartësohet çfarë mund të jetë e paqartë nga mospërputhja e fillimit dhe e përfundimit të këtij ajeti. Ashtu si fillimi dhe mbarimi lidhen në një pikë, e cila është çështja e martesës.

Ajeti thotë: Nëse martesë dhe jetesë juaj me jetimet nuk janë të bazuara mbi parimin e drejtësisë dhe të harmonisë, është më e

---

<sup>1</sup> Fikhul Kur'an, vëllimi 2 faqe 95-96-97. Tefsiri "Kurtubijj", vëllimi 5, faqe 11.

mirë të mos martoheni me to. Martohuni me gra të tjera, pos tyre, me qëllim që të mos u bëhet padrejtësi jetimeve dhe të mos shkelen të drejtat e tyre.

Për atmosferën që përcjell ky ajet ka mendime të ndryshme. Ndërsa për qëllimin e zbritjes së këtij ajeti komentuesit kanë rënë dakort se fjalët u drejtoheshin kujdestarëve të jetimeve, që t’ua ruajnë atyre pasuritë njësoj si jetimëve.

Ky ajet përmban një mësim dhe porosi tjetër për kujdestarët. Për këtë herë mësimet dhe porositë kanë lidhje me çështjen e martesës së jetimeve dhe kujdestarët duhet të jenë të drejtë ndaj tyre në çështjen e martesës njësoj siç veprojnë në çështjen e pasurisë së tyre.

Ata kujdestarë duhet të shohin interesin e jetimeve në martesë, përndryshe të zgjedhin bashkëshorte tjetër në vend të jetimes. Këtë ajet e përforcon dhe e sqaron ajeti 127 i po kësaj sureje, i cili i nxit që të mbajnë drejtësi në martesë me jetimet, siç do të vijë më pas shpjegimi në vendin e vet.

Ka shumë hadithe që janë transmetuar në libra të ndryshëm, të cilët dëshmojnë në këtë drejtim, e përforcojnë këtë komentim. Ajo që është transmetuar nga Imam Aliu është zëvendësuar ose janë hequr pjesë të shumta nga ajeti i Kur’anit, veçanërisht në fillim apo në fund të këtij ajeti nuk janë të sakta nga ana e zinxhirit të transmetimit.<sup>1</sup>

<sup>1</sup>“Biharul Anuar”, vëllimi 8, 9 faqe 47. “El Ihtixhaxh i Tabrasijj”, vëllimi, 1 faqe 254.

Këto hadithe dhe të tjera të ngjashme me to, të cilat tregojnë se në Kur'an ka heqje, shtesë e devijime të tjera, janë të trilluara nga armiqtë e Islamit dhe në veçanti nga munafikët, me qëllim që ta godasin rëndësinë dhe pozitën e Kur'anit.

Kjo ndodh sepse disa nuk kanë mundur ta përshtatin fillimin e këtij ajeti me fundin e tij dhe të përcaktojnë lidhjen e natyrshme ndërmjet të dyjave (e drejta e jetimeve dhe martesë me to). Për këtë, ata hamendësuan se ka heqje. Ky hamendësim përparoi derisa mori pamjen e një hadithi të transmetuar. Ndërkohë që me pak mendim dhe arsyetim sqarohet lidhja e fortë mes fjalëve dhe fjalive të ajetit.

**"...me dy; me tri; apo me katër..."**. Në gjuhësi fjala *methna* do të thotë *dy nga dy, thulatha - tre e nga tre dhe ruba' - katër e nga katër*. Meqenëse fjalët në këtë ajet kur'anor janë për të gjithë myslimanët, kuptimi i saj është që, nëse nuk bëni drejtësi në martesën me jetimet, hiqni dorë nga ajo martesë dhe martohuni me të tjera, por që edhe atyre mos u bëni padrejtësi. Ju lejohet që prej tyre të martoheni me dy, me tri apo me katër. S'ka dyshim se martesë me më shumë se një grua (poligamia), me kushtet e saj të posaçme, nuk është më shumë se me katër gra.

Duhet patjetër që të tërheqim vërejtje, sepse germa *uau* këtu ka kuptimin *eu*, që do të thotë *ose*. Kështu që kuptimi i kësaj fjalie nuk është lejimi i martesës me dy, tri dhe katër. Që të gjitha bashkë, po të mbliidhen bëjnë nëntë. Po të ishte ky kuptimi, atëherë do të përmendej qartë duke thënë: Martohuni me nëntë dhe nuk do të përmendej në këtë formë të paqartë.

Për më tepër, ndalimi i martesës me më shumë se me katër gra është prej domosdoshmërive të Jurisprudencës islame, që

flasin për këto çështje. Dhe mbi të gjitha, ky ajet kur'anor është argument i qartë për lejimin e poligamisë, sipas kushteve të cilat do t'i përmendim së afërmi.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **"...e nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua..."**, që do të thotë se martesë me më shumë se një grua është e lejuar nëse mund të ruhet drejtësia e plotë mes grave. Por nëse ju keni frikë se nuk do bëni drejtësi mes tyre, atëherë mjaftohuni me një grua që të mos i bëni padrejtësi të tjerave.

Pastaj All'llahu i Lartësuar urdhëron: **"...ose me atë që e keni në pushtetin tuaj..."**, që do të thotë se ju lejohet juve të martoheni me robëreshat që i keni në pushtetin tuaj, në vend të një gruaje të dytë, sepse robëreshat kanë kushte më të lehta. Megjithatë, edhe ato duhet të kenë të drejtat e tyre legjitime.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Në këtë mënyrë do t'i ruheni padrejtësisë më të lehtë"**, pra, martesë me një grua ose me një robëreshë dhe mosmartesë me një grua të dytë, është më afër ndalimit të padrejtësisë dhe ju ruan juve prej të bërit keq të tjerëve. Për çështjen e robërisë në Islam do të flasim me detaje në komentimin e ajetit 4 të sures "Muhammed".

## Dy hulumtime

### 1-Cili është qëllimi te drejtësia mes grave?

Përpara se të sqarojmë filozofinë e poligamisë (martesë me më shumë se një grua) në sheriatin islam, si fillim duhet të shpjegohet se cili është qëllimi i drejtësisë mes grave, e cila është kusht në

lejimin poligamisë. Pra, çfarë kuptimi ka drejtësia e përmendur këtu?

A është drejtësia në intimitet, në plotësimin e nevojave të domosdoshme për jetesën, të cilat janë prej çështjeve materiale apo ka për qëllim drejtësinë e zemrës, të ndjenjave dhe të emocioneve? Me fjalë më të qarta: Drejtësi në dashuri dhe në dëshirë, duke i shtuar edhe drejtësinë nga ana materiale.

Nuk ka dyshim se ruajtja e drejtësisë në animin e zemrës, dëshirës, epshit është diçka jashtë forcës njerëzore. Kush është ai që mund ta kontrollojë dashurinë e tij nga të gjitha anët dhe që të ketë aq sa dëshiron? Dihet që shtytësit dhe faktorët e dashurisë janë jashtë rrethit të fuqisë së tij.

Për këtë, All'llahu i Lartësuar nuk e ka obliguar që të ruhet një drejtësi e tillë, ku thotë po në këtë sure ("En-Nisa") në ajetin 129 **"...ju nuk do të mund të silleni drejt midis grave tuaja edhe sikur të dëshironi..."** Sado që të mundoheni se do të mbani drejtësi mes grave, për nga animi i zemrës, nuk do të mundeni.

Atëherë nuk është gabim që në dashuri zemra të anojë nga një njëra anë, e cila nuk obligon për zgjedhjen ose preferencën e disa grave nga ana materiale. Ajo që e detyron burrin është ruajtja e drejtësisë ndërmjet grave nga ana e jashtme materiale, në veçanti të llojit të marrëdhënieve ndërveprore, pasi është e pamundur që të ruhet drejtësia nga ana e ndjenjave shpirtërore.

Nga këto fjalë del në pah se ata që mundohen të bashkojnë fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"e nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjitha grave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua"** me fjalën e All'llahut të Lartësuar në ajetin 129: **"ju nuk do të mund të silleni drejt midis grave tuaja, edhe sikur të**

**dëshironit**”, për të ndaluar poligaminë me argumentin e pamundësisë së ruajtjes së drejtësisë mes grave, kanë rënë në një gabim të madh. Ashtu si e shpjeguam më lart, drejtësia është e pamundur që të ruhet në çështjet e ndjenjave shpirtërore.

Por ky nuk është prej kushteve të lejimit të martesës me shumë gra (poligaminë). Prej kushteve të lejimit të poligamisë është që drejtësia të ruhet në çështjet praktike.<sup>1</sup>

Këtë e dëshmon çfarë ka ardhur më tej në vazhdim të ajetit 129 të po kësaj sureje, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“Andaj mos anoni krejtësisht vetëm nga njëra, duke e lënë tjetrën si të varur”**, që do të thotë se ju, nëse nuk mund të ruani drejtësinë e plotë në dashurinë e grave, të paktën mos anoni në dashuri të zjarrtë kah disa grave dhe të harroni të tjerat.

Përmbledhja e thënieve dhe rezultati i tyre është se ata që u kapën fort pas një pjese të këtij ajeti, duke harruar pjesën tjetër dhe u përfshinë në refuzimin e poligamisë, ranë në një gabim të madh, që habitet çdo kërkues dhe çuditet çdo studiues.

Për më tepër, çështja e lejimit të poligamisë me kushtet e saj, është e konstatuar dhe e qartë në librat e Jurisprudencës islame, në burimet e shi’iave dhe të Ehli Sunnetit. Nuk ka vend për debat e për polemikë. Kjo temë është nga domosdoshmëritë e jurisprudencës islame dhe prej çështjeve të natyrshme të saj. Hulumtimin tani e kthejmë kah njohja e filozofisë së këtij ligji të Islamit.

---

<sup>1</sup> “Usulul Kafijj”, vëllimi 5, faqe 362-363.

## **2- Poligamia domosdoshmëri shoqërore**

Ajeti në fjalë e ka lejuar poligaminë (por me kushte të rënda dhe me kufij të caktuar). Ky lejim ndikoi te disa njerëz, duke iu kundërvënë dhe duke nxjerrë probleme. Ky ligj i Islamit u përball me një sulm të madh prej kundërshtarëve, të cilët nxituan në marrjen e vendimit rreth këtij ligji, duke u bazuar te emocionet. Ata nuk u bazuan në studime të thella, as në thellim e verifikim.

Më kundërshtarët dhe më sulmuesit e këtij ligji janë perëndimorët. Ata pyesin se si e lejon Islami që burri të jetë i martuar dhe të marrë gra të tjera, njësoj siç ka qenë e përhapur në kohën e injorancës (para Islamit)?

Kurrë, asnjëherë feja islame nuk e lejon poligaminë ashtu siç e imagjinojnë ata dhe asnjëherë nuk e ka lejuar poligaminë pa kusht e pa kriter, ose pa as një ligj apo kufizim.

Dhe për t'i qartësuar këto të vërteta, themi: Me të vërtetë, studimi i mjediseve të ndryshme para Islamit na zbulon se poligamia, pa përcaktim numri dhe pa kushte e kritere, ka qenë një çështje e zakonshme dhe e përhapur deri në atë shkallë, sa që disa idhujtarë, kur pranuan Islamin, kishin nga shumë, gra. Madje një prej tyre kishte dhjetë gra ose më pak.

Nga këtu del se poligamia nuk është se e ka shpikur Islami. Ajo që bëri Islami ishte vendosja e kësaj çështjeje brenda kornizës së nevojës dhe domosdoshmërisë njerëzore dhe vendosi disa kushte të rënda.

Me të vërtetë, boshti kryesor i legjislacionit islam është nevoja e njerëzimit. Ato ligje bazohen në ruajtjen e domosdoshmërive të njerëzve në këtë jetë. Ato nuk bazohen në

pretendime sipërfaqësore dhe as në emocione të drejtuara gabimisht. Edhe poligamia, një prej ligjeve të Islamit, e tillë është. Askush nuk mund ta mohojë se burri ka më shumë mundësi që të përballët me rrezik dhe vdekje se sa gruaja, për shkak të ndodhive të ndryshme që i rrethojnë ata. Burrat përbëjnë pjesën më të madhe të viktimave të luftërave dhe të betejave.

Sikurse nuk mundet kush të mohojë se jetëgjatësia e burrave, nga ana e marrëdhënieve intime, është më e madhe se sa jetëgjatësia e grave në këtë fushë. Gratë e humbin fuqinë e marrëdhënies intime (dhe fuqinë e lindjes) në moshë më të re, ndërsa burrat e ruajnë fuqinë për një kohë edhe më të gjatë.

Po ashtu, gratë në kohën e menstruacioneve (ciklit mujor) apo edhe në një periudhë të shtatzënisë kanë pengesa që i ndalon që të kryejnë marrëdhënie intime, kurse burrat nuk kanë asnjë lloj pengese të tillë.

Në shtesë të asaj që u tha, ka gra që i humbasin burrat e tyre për disa arsye. Për ato nuk është e lehtë që të tërheqin vëmendjen e burrave dhe të jenë përsëri gruaja e parë. Nëse nuk u lejohet poligamia, ato detyrohen të mbeten pa burra.

Në gazeta të ndryshme lexojmë se gratë e veja ankohen për vështirësitë dhe problemet e jetës për shkak të kufizimit të poligamisë apo të mospranimi të saj. Këto të veja e konsiderojnë ndalimin e poligamisë prej ligjeve të padrejta për to.

Duke parë këto të vërteta, kur çrregullohet ekuilibri ndërmjet raportit burra dhe gra, e gjejmë vetveten tonë të detyruar që të zgjedhim një ndër këto tri rrugë.

**E para:** Çdo burrë të jetë i kënaqur me një grua të vetme në të gjitha gjendjet e tij dhe numri i tepërt i grave të mbetet pa bashkëshortë deri në fundin e jetës së tyre, duke izoluar nevojën e tyre të natyrshme dhe të shtypin instinktet e brendshme përvëluese.

**E dyta:** Të martohet burri me një grua sipas ligjit, pastaj të lihet i lirë që të kryejë marrëdhënie intime me kë të dojë ai prej grave që i kanë humbur burrat e tyre, për një shkak apo për një tjetër apo t'i zërë dashnore për të shkuar në shtrat me to.

**E treta:** Atij që ka mundësi dhe nuk ka asnjë problem nga ana e marrëdhënieve intime, materiale apo edhe morale, t'i lejohej që të martohet me më shumë se një grua. Po ashtu, t'i lejohej edhe atij që krijon marrëdhënie të drejta ndërmjet grave dhe fëmijëve. Atyre t'u lejohej që të martohen me më shumë se një grua, por me kusht që të mos e kalojë martesën me më shumë se katër gra. Këto janë tri rrugët zgjedhëse dhe nuk ka të katërt.

Nëse zgjedhim rrugën e parë, obligohemi që të kundërshtojmë natyrën njerëzore dhe instinktin, të luftojmë të gjitha nevojat shpirtërore dhe trupore që ka njeriu, të injorojmë ndjenjat e këtij grupi femrash.

Në këtë luftë dhe dyluftim nuk ka fitore. Edhe sikur ky propozim të jetë i suksesshëm dhe i mbarësuar, anët antinjerëzore janë më të dukshme në të. Me një frazë tjetër, poligamia, në raste të nevojshme, nuk duhet të shqyrtohet apo të analizohet vetëm në aspektin e gruas së parë, por duhet të analizohet dhe të studiohet edhe në shikimin e gruas së dytë.

Ata që e shqyrtojnë këtë çështje dhe shohin problemet e gruas së parë në martesën me shumë gra, janë të ngjashëm me ata

që e vështrojnë një çështje trekëndore vetëm nga një kënd, sepse çështja e poligamisë përbëhet nga tre kënde. Prandaj, duhet të shihet ana e burrit, ana e gruas së parë dhe ana e gruas së dytë. Vendimi duhet të bazohet pas shqyrtimit të çështjes nga të gjitha anët dhe të realizohet mbi bazën e ruajtjes së interesit të përgjithshëm.

Nëse zgjedhim rrugën e dytë, është obligim që nga ana legislative të pohojmë paturpësinë dhe degjenerimin. Në shtesë të kësaj, gratë dashnore, të cilat e dorëzojnë vetveten e tyre sa të një burrë tek tjetri, për të plotësuar nevojat e tyre seksuale, humbasin sigurimin dhe të ardhmen. Kjo do të thotë shkatërrim të personalitetit të tyre. Ato bëhen plaçkë vetëm për kënaqësi. S'ka dyshim që këtë çështje nuk mund ta pranojë asnjë njeri, i cili është i zoti i mendjes dhe i logjikës.

Kështu që nuk mbetet veçse rruga e tretë. Ajo është rruga që i përgjigjet nevojës së natyrshme dhe emocionale të femrës. Kjo rrugë i largon dhe e ruan këtë grup grash për të mos rënë preh e veprave të këqija, e imoralitetit dhe e shpëton shoqërinë prej kënetës së gjynaheve dhe të mëkateve.

Është mëse e obligueshme të jemi të vetëdijshëm se lejimi i poligamisë është me të vërtetë një domosdoshmëri shoqërore e njerëzore, është prej ligjeve të prera islame. Por përmbushja e kushteve dhe e kriterëve në këtë kohë ndryshon me atë të kohëve të mëparshme, sepse jeta në kohët e mëparshme ka qenë e thjeshtë dhe me më pak kërkesa, nga ku edhe ruajtja e drejtësisë dhe e barazisë ndërmjet grave ka qenë më e lehtë dhe më e arritur.

Kurse, ata që duan ta zbatojnë këtë ligj të Islamit në kohët e sotme, është mëse e domosdoshme të ruajnë drejtësinë dhe

barazinë nga të gjitha aspektet e jetës. Ta zbatojnë këtë çështje nëse janë të aftë t'u qëndrojnë besnikë të gjitha kushteve dhe kritereve të tij.

Dhe mbi të gjitha, askush nuk duhet ta zbatojë këtë çështje vetëm për të përmbushur nevojat e tij seksuale kafshërore. Ajo çfarë tërheq vëmendjen është se ata të cilët e ndalojnë poligaminë (sikurse janë perëndimorët), gjatë gjithë historisë së tyre janë përballur me situata të cilat i kanë strehuar ata në këtë parim.

Në Luftën e Dytë Botërore, në shtetet që u prekën nga katastrofa e luftës dhe veçanërisht Gjermania, u duk kërkesa shumë e madhe për këtë temë. Kjo e shtyu një grup studiuesish dhe mendimtarësh të gjenin zgjidhjen e këtij problemi dhe iu kthyen çështjes së ndalimit të poligamisë. Kjo arriti deri aty sa që ata kërkuan nga Universiteti i El Az'harit në Kajro, një program islami rreth poligamisë për ta studiuar.

Por, nën presionin e rreptë të kishës, u detyruan që ta ndalonin vazhdimin e studimit të këtij programi. Rezultati i këtij ndalimi ishte përhapja e imoralitetit dhe shthurja seksuale në të gjitha ato shtete që u prekën prej luftës dhe prej fatkeqësive.

Duhet thënë se nuk mund të mohohet ajo që ndiejnë një grup burrash nga dëshira që kanë për t'u martuar me më shumë se një grua. Nëse ky anim dhe kjo dëshirë buron nga egoja, mania dhe magjepsja, nuk duhet marrë në konsideratë. Ndërsa, nëse dëshira buron nga sterilizimi i gruas për të lindur fëmijë dhe nga dëshira e burrit për të pasur fëmijë, siç ndodh në shumë raste, ky anim për martesë është i arsyeshëm, i logjikshëm dhe i pranueshëm.

Po ashtu, dëshira për t'u martuar me grua tjetër, përpos gruas së parë, buron te dëshira e madhe seksuale që ka burri, sepse gruaja e parë nuk ia plotëson këtë nevojë dhe nuk i përgjigjet atij. Për këtë, burri e sheh veten e vet të detyruar që të marrë një grua të dytë, me qëllim që të mos i ngopë nevojat e tij seksuale në rrugë joligjore.

Në këtë mënyrë, nuk ka logjikë të shëndoshë që mund ta mohojë këtë anim që burri zotëron dhe për këtë arsye marrëdhënia me gratë është faktor i përhapur edhe në ato vende që e ndalojnë poligaminë. Ndodh që një burrë të kryejë marrëdhënie seksuale me shumë gra të tjera në rrugë jolegjitime.

Historiani i njohur francez Gustaf Lubon e konsideron ligjin e poligamisë, të cilin e ka lejuar (vendosur) Islami, brenda kushteve dhe limiteve të veçanta, një nga dallimet e kësaj feje. Kur krahason poligaminë dhe lidhjet intime të lira jolegjitime të përhapura në Perëndim, ai thotë: "Në Perëndim, ku klima dhe natyra nuk ndihmojnë për poligami, edhe pse ligjet perëndimore e ndalojnë poligaminë, shumë pak i zbatojnë këto ligje dhe i thyejnë ato duke bërë marrëdhënie të fshehta mëkatare..."<sup>1</sup>

Sigurisht, ne nuk mund të mohojmë se atje janë disa pretendues islamikë që e shfrytëzojnë këtë ligj të Islamit, pa ruajtur shpirtin e Islamit në të. Ata e përdorin këtë ligj për të përhapur shkatërrimin dhe të shkelin të drejtat e grave të tyre. Mirëpo kjo vepër e tyre nuk ka të bëjë me ligjin e Islamit dhe nuk është prej rregullave të tij. Vallë, a nuk ka ligj dhe rregull të mirë, të cilin e kanë shfrytëzuar lakmitarët dhe interesaxhinjtë në formë të keqe?!

<sup>1</sup> Hadharatul Arab, faqe 398.

**Pyetje:** Këtu dikush mund të pyesë: Ka mundësi që kushtet dhe kriteret e lartpërmendura mund të gjenden te gruaja apo te femrat. A lejohet që gruaja të përzgjedhë për veten e saj dy burra, sikurse i lejohet burrit dy gra?

**Përgjigje:** Përgjigjja rreth kësaj pyetjeje nuk është aq e vështirë sa mund të mendohet.

**Së pari:** Me të vërtetë, dëshira seksuale te meshkujt (në ndryshim me atë se çfarë është e përhapur ndërmjet njerëzve) është disa herë më e fortë se sa dëshira e grave. Sëmundja psikike për të cilën flasin më shumë librat e psikologjisë dhe të mjekësisë është "Ftohja seksuale" tek femrat. Ndërkohë që tek meshkujt është e kundërta. Dhe kjo nuk është e kufizuar vetëm për njerëzit, sepse edhe në botën shtazore meshkujt janë të parët që shfaqin dëshirën e seksit më shpejt se femrat.

**Së dyti:** Poligamia, (martesa me më shumë se një grua) për burrat nuk përbën asnjë problem shoqëror ose të drejtash. Ndërsa lejimi i martesës së gruas me më shumë se një burrë shkakton probleme të mëdha dhe më i vogli është humbja e gjenezës, ku në këtë formë nuk dihet se kujt baba i përket fëmija. Nuk ka dyshim se ky fëmijë me baba të panjohur nuk do të ketë interesimin e duhur nga asnjë prej meshkujve.

Disa dietetarë mendojnë se fëmija me baba të panjohur, nuk gjen atë dashurinë e duhur nga nëna dhe as interesimin e saj. Në këtë mënyrë fëmija i lindur nga një femër e dy meshkuj goditet nga mosinteresimi shpirtëror. Po ashtu, përderisa nuk dihet se kush është babai i tij humbet edhe anën e të drejtave.

Ndoshta nuk është nevoja të kujtojmë përdorimin e ilaçeve penguese për shtatzëninë, sepse ka shumë gra që i përdorin këto

mjete për parandalimin e shtatzënisë, apo gabojnë në përdorimin e tyre dhe lindin fëmijë. Për këtë, asnjë grua nuk ia lejon vetes së saj që të martohet me më shumë se një burrë, duke u mbështetur në këto mënyra parandaluese.

Për këto arsye nuk i lejohej gruas të martohet me më shumë se një burrë. Ndërsa përta i përket burrave, brenda kushteve dhe kriterëve që i cekëm më lart, është një çështje e logjikshme dhe e realizueshme.

## Ajeti 4

وَأَتُوا النِّسَاءَ صَدُقَاتِهِنَّ نِحْلَةً فَإِنْ طِبَّنَ لَكُمْ عَنْ شَيْءٍ مِّنْهُ نَفْسًا فَكُلُوهُ

هِنِيئًا مَّرِيئًا ﴿٤﴾

**"Dhe jepuni me gjithë zemër grave tuaja dhuratën e kurorëzimit e, nëse ato ua falin me dëshirën e vet diçka prej atyre dhuratave, pranojeni atë pa frikë dhe me kënaqësi."**

### Komentimi

Fjala "*en-nihletu*", në këtë ajet, nga ana gjuhësore, do të thotë *borxh*. Gjthashtu, ka edhe kuptimin e *dhënies*. Ragib Asfahani, në librin e tij "El Mufredat" thotë: "Unë mendoj se etimologjia e kësaj fjale është prej fjalës "*en nehl*", bazuar te folja e saj, sepse folja e saj është dhuratë që i jep dhuruesi."

Ndërsa fjala "*sadukatihinne*" është shumësi i fjalës "*sidak*", e cila do të thotë *pajë, prikë* (mehr).

Ky ajet kur'anor, që vjen pas hulumtimit rreth përzgjedhjes së gruas, përmban në esencën e vet një nga të drejtat e pakundërshtueshme që i takojnë grave. Këtë e argumenton duke thënë: **"Dhe jepuni me gjithë zemër grave tuaja dhuratën e kurorëzimit..."**, që dotë thotë, jepuni grave *mehrin* e plotë dhe interesohuni për të njësoj siç interesoheni për borxhet e tjera. Shlyejini ato të plota pa asnjë mangësi. (Në këtë formë e kemi huazur fjalën "*en-nihletu*", me kuptimin e borxhit).

Nëse e marrim fjalën “*en-nihletu*” me kuptimin e dhënies dhe të dhurimit, atëherë komentimi i ajetit do të jetë: Jepuni atyre (grave) dhuratën e plotë, e cila është dhuratë prej All’llahut të Lartësuar për gratë, me qëllim që të kenë të drejta të shumta në shoqëri. Me këtë çështje të kompensohet dobësia e tyre fizike.

Në fillim të këtij ajeti, All’llahu i Lartësuar urdhëron me qartësi që t’u jepet grave mehri i plotë, pa mangësi, për të ruajtur të drejtat e tyre legjitime që u takojnë. Më pas sqaron rëndësinë e respektit të ndjenjave që duhet të kenë të dy palët. Me qëllim që të forcohen lidhjet, harmonia, dashuria, marrëdhëniet shpirtërore ndërmjet tyre, All’llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: “**...nëse ata ua falin me dëshirën e vet diçka prej atyre dhuratave, pranojeni atë pa frikë dhe me kënaqësi...!**”, që do të thotë, nëse gruaja nuk e merr të gjithë mehrin dhe i jep me dëshirën e saj diçka burrit prej atij mehri, atëherë burri mund ta përdorë atë.

Me të vërtetë, Islami e ka vendosur këtë parim që të mos jetë rrjeti familjar dhe jeta bashkëshortore fushë prej paketës ligjore të pafrytshme, por për bashkimin e ndjenjave njerëzore dhe në këtë jetë të mbizotërojë harmonia krah për krah me procedurat dhe të drejtat për të cilat ne i prekëm më lart.

## Hulumtim

### Mehri, mbështetje shoqërore për gruan

Gruaja, në kohën e injorancës (para Islamit), nuk ka pasur asnjë vlerë ose pozitë. Kur martohej, dhuratën e gruas, që është e drejta e plotë e saj, burri ia jepte kujdestarëve të saj dhe kujdestarët e konsideronin si të drejtë të tyre dhe jo të saj. Kishte raste që martesën e një gruaje e vendosnin si prikë për gruan tjetër. Për shembull: Një burrë të martonte motrën e vet me një person dhe ky i fundit t'i jepte për grua motrën e vet. Pra, të merrnin e të jepnin mes njëri-tjetrit. Kjo ishte dhurata e dy bashkëshorteve.

Feja islame i ka shkatërruar të gjitha këto tradita e zakone të padrejta dhe e ka konsideruar mehrin të drejtë legjitime dhe të veçantë që i takon gruas. I ka këshilluar shumë herë burrat në ajetet e Kur'anit Famëlartë, që ta ruajnë këtë të drejtë që i takon gruas.

Në Islam, për dhuratën që i bëhet gruas, nuk ka një limit të caktuar. Ajo është çështje që bien dakord bashkëshortët ndërmjet tyre. Në shumë transmetime thuhet që dhurata të jetë sa më e pakët. Por ky nuk është një rregull i domosdoshëm, por është një çështje e pëlqyeshme (mustehab).

Këtu shtrohet pyetja: Nëse burri dhe gruaja përfitojnë në mënyrë të barabartë nga martesë dhe lidhja martesore ngrihet mbi bazën e interesave të dy palëve, përse duhet që burri të japë mehr, pak apo shumë, për gruan? A nuk përbën kjo çështje keqbërje ndaj personalitetit të gruas? A nuk është kjo çështje si shitblerje në legjislacionin e martesës?

Me të vërtetë, këto çështje i nxisin disa që ta kundërshtojnë me forcë parimin e mehrit. Ky drejtim, në veçanti, është fuqizuar nga disa mutegaribine, të cilët e gjejnë këtë tek martesat që bëhen në Perëndim. Ndërkohë që mohimi i mehrit nga legjislacioni i martesës nuk është vetëm çështje e ngritjes apo e uljes së personalitetit të gruas, por e paraqet pozicionin e saj e saj në rrezik.

Është mëse e saktë që gruaja dhe burri përfitojnë nga legjitimiteti i martesës dhe formimi i jetës bashkëshortore në një mënyrë të barabartë. Por nuk mund të mohojmë se, nëse ndodh divorci, ajo që dëmtohet më tepër është gruaja.

Me të vërtetë, burri, duke qenë se ka aftësi të veçanta fizike, zakonisht, ka pushtet dhe pozicion më të madh në shoqëri. Kjo është një e vërtetë e qartë, sado të përpiqen disa të mohojnë këtë kur flasin rreth grave.

Por gjendja sociale dhe jeta njerëzore, deri edhe në shoqëritë perëndimore e evropiane, ku gruaja gëzon të drejta, "*liri të plotë*", na sqaron se frerët e punëve fitimprurëse, në përgjithësi, janë në dorën e burrave.

Në shtesë të kësaj, burrat kanë më shumë mundësinë e zgjedhjes së bashkëshorteve dhe ndërtimin e jetës familjare, kurse për gratë nuk gjendet kjo mundësi.

Femrat që u ka kaluar mosha e rinisë dhe kanë humbur bukurinë e tyre, kanë më pak shpresa të martohen.

Duke vështruar me kujdes këto që u thanë, sqarohet se mundësitë që humbet gruaja për martesë janë më të shumta se sa mundësitë që humbet burri në këtë rast. Në të vërtetë, mehri është

si kompensim për atë që humbet gruaja dhe garanci për jetën dhe të ardhmen e saj. Përveç kësaj, mehri është mjet frenues për burrin që të mos mendojë për ndarje.

Është e vërtetë se, sipas këndvështrimit të legjislacionit islam, mehri është e drejtë e gruas në ndërgjegjen e burrit që në kohën e kurorëzimit të martesës mes burrit dhe gruas. Dhe është e drejta e gruas që ta kërkojë mehrin menjëherë.

Por në përgjithësi, dihet se mehri merr formën e borxhit në ndërgjegje, atëherë ai është si depozitim për gruan, që të përfitojë në të ardhmen. Gjithashtu, konsiderohet mbështetja më e mirë për të ruajtur të drejtat e saj.

Ndihmon për të ruajtur lidhjen martesore nga rrëshqitja dhe çrregullimi. (Sigurisht, për këtë çështje ka përjashtime, por ajo që përmendëm në të shumtën e rasteve është e vërtetë).

Ndërsa komentimi i gabuar i disave në çështjen e mehrit, që e konsiderojnë atë si çmim për gruan, nuk ka lidhje me legjislacionin islam. Sepse Islami nuk e cilëson mehrin që ia jep burri gruas si çmim, sikurse nuk i jep gruas cilësinë e mallit, i cili mund të shitet e të blihet.

Argument më i mirë për këtë është përmbajtja e kontratës së martesës, në të cilën burri dhe gruaja janë dy shtyllat bazë në lidhjen bashkëshortore. Ndërkohë që mehri konsiderohet si çështje shtesë në kontratën e martesës, me argumentin se, nëse nuk shënohet mehri, nuk priset kontrata e martesës. Ndryshe është te bashkëpunimet e tjera financiare. Nëse nuk përmendet vlera apo çmimi, priset kontrata.

Nga të gjitha ato çfarë u tha më sipër, konkludojmë se mehri është kompensim për humbjet e ardhshme të gruas. Gjithashtu, është një mbështetje e fortë, e cila e ndihmon për të respektuar të drejtat e saj. Mehri nuk është çmim për gruan. Edhe fjala *en-nihletu*, e cila përmendet në këtë ajet dhe që ka kuptimin e dhënies, dhuratës, tregon për këtë çështje.

## Ajetet 5-6

وَلَا تُؤْتُوا السُّفَهَاءَ أَمْوَالَكُمُ الَّتِي جَعَلَ اللَّهُ لَكُمْ قِيَمًا وَارْزُقُوهُمْ فِيهَا  
وَاكْسُوهُمْ وَقُولُوا لَهُمْ قَوْلًا مَعْرُوفًا ﴿٥﴾ وَابْتَلُوا الَّتِي تَمْنَىٰ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغُوا النِّكَاحَ  
فَإِنْ ءَانَسْتُمْ مِنْهُمْ رُشْدًا فَادْفَعُوا إِلَيْهِمْ أَمْوَالَهُمْ ۖ وَلَا تَأْكُلُوهَا إِسْرَافًا وَبِدَارًا أَنْ  
يَكْبَرُوا ۚ وَمَنْ كَانَ غَنِيًّا فَلْيَسْتَعْفِفْ ۚ وَمَنْ كَانَ فَقِيرًا فَلْيَأْكُلْ بِالْمَعْرُوفِ ۚ فَإِذَا  
دَفَعْتُمْ إِلَيْهِمْ أَمْوَالَهُمْ فَأَشْهَدُوا عَلَيْهِمْ ۚ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ حَسِيبًا ﴿٦﴾

“Mos e lini në dorë të të paaftëve mendërisht pasurinë tuaj që All’llahu jua ka dhënë si mjet jetese për ju; ushqejini dhe vishini ata prej saj dhe u thoni atyre fjalë të mira.

Vëriini në provë jetimët, derisa të bëhen për martesë! Nëse vëreni se janë pjekur, atëherë jepuani pasurinë e tyre! Mos nxitoni në shpenzimin e pasurisë së tyre në mënyrë të panevojshme dhe para se ata të rriten! Kush është pasanik, le të përmbahet në marrjen e pasurisë së tyre e, në qoftë se është i varfër, le të harxhojë aq sa është e arsyeshme dhe e drejtë. Kur t’jua dorëzoni pasurinë e tyre, bëjeni këtë në prani të dëshmitarëve. All’llahu është i mjaftueshëm si llogaritës.”

## Komentimi

Ajetet në fjalë janë plotësuese e hulumtimeve në lidhje me jetimët, të cilët u përmendën më parë. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Mos e lini në dorë të të paaftëve pasurinë tuaj”**, por prisni derisa ata të bëhen të aftë dhe të piquen mendërisht në çështjet që kanë lidhje me ekonominë, për arsye që pasuria juaj të mos priset e të mos shkatërrohet.

### Kush është (sefijhu) i paaftë mendërisht?

Ragibi, në “Mufredatin” e tij ka thënë: “Fjala *es sefhu* ka kuptimin *e metë në trup* (për shkak të saj ndodh mosekuilibri në ecje). Thuhet se ka kuptimin e shqetësimit të shumtë (*zimamu sefijh*). Dhe është përdorur për mendjelehtësinë nga mungesa e logjikës në çështjet që kanë lidhje me këtë jetë dhe me Jetën Tjetër.

Por është e qartë se qëllimi i fjalës *es sefhu* në këtë ajet është papjekuria e duhur për çështjet ekonomike, ku njeriu nuk është në gjendje (i aftë) të drejtojë punët e tij ekonomike dhe të ndreqë pasurinë e tij në mënyrë të rregullt e të drejtë.

Ai nuk është në gjendje (i aftë) të sigurojë dobitë e tij në shkëmbimet financiare. Pra, ndodhet përballë humbjes dhe dëmtimit. Këtë kuptim e tregon edhe ajeti pasardhës, në të cilin All'llahu i Lartësuar thotë: **“Nëse vëreni se janë pjekur, atëherë jepuani pasurinë e tyre.”**

Kështu që ajeti në fjalë, edhe pse flet për jetimët, përmban rregull dhe ligj të përgjithshëm, që thotë se nuk i lejohet rreptësisht askujt që t’ia japë pasurinë atij që e mbikëqyr ose e lidh jeta me të, në qoftë se ai është i paaftë mendërisht e i papjekur.

Nuk ka dallim mes pasurisë private dhe pasurisë së përgjithshme (Pasuria e shtetit islam).

Në një transmetim nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) lexojmë se një burrë, i quajtur Ibrahim ibn Abdul Hamid, thotë: "E pyeta Ebu Abdullahin për thënien e All'llahut të Lartësuar: **"Mos e lini në dorë të të paaftëve pasurinë tuaj."** Ai më tha: "Çdo person që pi pije dehëse është i paaftë mendërisht<sup>1</sup>, prandaj mos ua jepni pasurinë tuaj."

Në një transmetim tjetër thuhet se është e ndaluar që pijaneci të lihet besnik në pasuri. Dhe përkufizimi i thënies është se përshkrimi i pirësit të alkoolit me paaftësinë mendore është transmetuar në shumë hadithe. Kjo është për shkak se pirësi i alkoolit humbet kapitalin e tij material dhe shpirtëror. A ka më mendjelehtë se njeriu që humbet pasurinë dhe mendjen e tij dhe ta pasojë çmendurinë, duke shpenzuar të gjitha fuqitë e tij trupore dhe shpirtërore në rrugën e saj, duke sjellë edhe dëme shoqërore?!

Në transmetime të tjera vërejmë se çdo njeri i pabesueshëm cilësohet si mendjelehtë, i paaftë dhe atij i ndalohet dorëzimi i pasurisë vetjake dhe shoqërore. Jusuf Ibn Jakubi ka thënë: "E pyeta Ebu Abdullahin (Imam Sadikun) për thënien e All'llahut të Lartësuar: **"Mos e lini në dorë të të paaftëve pasurinë tuaj."** Ai më tha: "Atij që nuk i zihet besë."<sup>2</sup>

Nga të gjitha këto transmetime kuptohet se fjala *es sefilh-paaftësi mendësie, mendjelehtësi*, ka kuptim të gjerë. Ndalimi këtu përfshin dorëzimin e pasurisë vetjake dhe atë shoqërore. Qëllimi

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Burhan" vëllimi 1, komentimi i këtij ajeti. "Uesailu Shijja", vëllimi 19, faqe 368.

<sup>2</sup> Tefsiri "Burhan", vëllimi 1, komentimi i këtij ajeti, Tefsiri "Nurul Thakalejn" vëllimi 1, faqe 442.

në këtë çështje është se në disa raste ndalimi është ndalim i rreptë (nehji tahrijmij) dhe në raste të tjera ndalimi arrin në shkallën e papëlqimit (nehju kerahetu).

Këtu shtrohet pyetja: Meqenëse ky ajet flet për pasurinë e jetimëve, përse All'illahu i Lartësuar thotë *pasurinë tuaj* dhe nuk ka thënë *pasurinë e tyre*?

Ka mundësi që sekreti me këtë përshkrim mund të jetë qartësimi i një çështjeje shumë të rëndësishme shoqërore dhe ekonomike, që është: Islami i konsideron individët e shoqërisë një dhe nuk mund të ndahen interesat e një individit nga ato të të tjerëve. Po kështu, humbja e një individi është humbje edhe për të tjerët. Për këtë shkak Kur'ani përdor këtu përemrin pronor *tuaj* në vend të përemrit dëftor *atyre* dhe ka thënë: *Pasurinë tuaj* dhe nuk thotë *pasurinë e atyre*.

Kjo do të thotë se këto pasuri – në të vërtetë – nuk kanë lidhje vetëm me jetimët, por edhe me ju. Nëse ato pasuri i godet dëmi, edhe ju dëmtoheni në një mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Prandaj është obligim që ta ruani sa më mirë dhe me çdo kusht pasurinë.

Për këtë frazeologji ka edhe një komentim tjetër, që thotë se qëllimi i përdorimit të togfjalëshit *pasurinë tuaj* është për pasurinë e mbikëqyrësve dhe jo për pasurinë e jetimëve. Atëherë kuptimi është: Nëse ju dëshironi t'i ndihmoni jetimët, të cilët nuk kanë arritur moshën e pjekurisë, ndoshta u keni dhënë atyre diçka nga pasuria e juaj, nën ndikimin e ndjenjave shpirtërore dhe zemërgjerësia për ata dhe i keni zgjedhur për disa punë që nuk mund t'i kryejnë, këtë gjë ju mos e veproni. Është detyra juaj që të veproni diçka tjetër në vend të këtij veprimi jo logjik. Të

shpenzoni për ushqimin, veshmbathjen dhe strehimin e tyre derisa të arrijnë moshën e pjekurisë. Kur të arrijnë këtë gradë dhe kanë arritur arsyetimin e plotë, jepuni atyre çfarë të doni dhe zgjidhni për ta çfarë pune që ju të dëshironi.

Në të vërtetë ky është një mësim i madh shoqëror, të cilin na e mëson Kur'ani, duke na ndaluar që t'i punësojmë ata që nuk janë në gjendje t'i kryejnë disa punë, me justifikimin e ndihmës apo nën ndikimin e ndjenjës së butësisë dhe të zemërgjerësisë. Këto punë, edhe pse mund të kenë ndopak përfitim, ka mundësi që t'i sjellin shoqërisë pasoja, dëmtime dhe katastrofa të mëdha. Prandaj, është e domosdoshme që çështja e këtij grupi njerëzish të administrohet prej shoqërisë nëpërmjet dhënies së dhuratave apo përpjekjes për t'i punësuar ata në punë të vogla dhe të lehta (të përshtatshme për ata).

Nga këtu qartësohet se disa jolargëpamës për zgjedhin të dobët dhe të paafët për disa përgjegjësi predikuese dhe fetare si butësi dhe zemërgjerësi ndaj tyre. Padyshim që kjo është prej punëve më dëmtuese dhe më e largëta prej logjikës dhe arsyes.

### **Pasuria juaj mjet jetese për ju**

Kur'ani Famëlartë e përshkruan pasurinë në ajetin në vazhdim: **"...All'Ilahu jua ka dhënë si mjet jetese për ju..."** Kjo është një thënie e bukur dhe e mrekullueshme për pasuritë. Ajo është kuptimi i jetës së njeriut dhe i shoqërisë.

Pa të shoqëria nuk mund të jetë e fortë. Sigurisht, nuk lejohet që pasuria t'u jepet të paafëve mendërisht (mendjelehtëve) dhe shpërdoruesve, të cilët nuk dinë ta menaxhojnë atë, përkundrazi e prishin dhe e shpërdorojnë duke i sjellë shumë dëme shoqërisë.

Nga kjo frazë ne mësojmë mjaft mirë se sa rëndësi dhe përkushtim i jep Islami çështjeve të pasurive dhe të ekonomisë. Të kundërtën lexojmë në Ungjill: *“Jezusi u tha nxënësve të vet: “Të vërtetën po ju them; vështirë është të hyjë i pasuri në Mbretërinë e qiellit.”<sup>1</sup>*

Ndërkohë që Islami e shikon se populli i varfër nuk mund të qëndrojë kurrë mbi këmbët e veta. Me të vërtetë, është e habitshme kur shohim një grup që kanë arritur përparim në fushat e zhvillimit ekonomik, edhe pse janë të frymëzuar nga mësimet e gabuara. Ndërkohë që ne vuajmë nga kjo gjendje, edhe pse zotërojmë mësimet nxitëse dhe frytdhënëse. Por nuk kemi pse të habitemi, sepse ata iu larguan mashtrimeve dhe devijimeve dhe arritën aty ku arritën. Ndërkohë ne i lamë këto mësimet madhështore dhe ramë në këtë vobekësi, depresion dhe prapambetje.

### Dy mësimet në çështjen e jetimëve

All’llahu i Lartësuar, për çështjen e jetimëve, na urdhëron për dy çështje të rëndësishme:

**E para:** Furnizimi i jetimëve dhe veshmbathja e tyre derisa ata të arrijnë moshën e pjekurisë. All’llahu i Lartësuar thotë: **“...ushqejini dhe vishini ata prej saj dhe u thoni atyre fjalë të mira...”** Është e nevojshme që të shpjegojmë se All’llahu i Lartësuar në këtë ajet ka përmendur fjalën *“fijha”*, që do të thotë *në pasurinë e jetimëve* dhe nuk ka përmendur fjalën *“minha”* që do të thotë *prej pasurisë së tyre*.

---

<sup>1</sup> Ungjilli sipas Mateut 19-23.

Nga kjo fjali kuptohet se menaxhimi i çështjes së jetimeve dhe shpenzimi për ta duhet të kryhet nga përfitimet e pasurisë së tyre. Nëse All'llahu i Lartësuar të thoshte jepuni atyre prej saj, do të kuptohej se kujdestari do të harxhonte pak e nga pak pasurinë e tyre. Kështu që deri në mbërritjen e kohës së pjekurisë jetimët do të humbnin një pjesë të madhe nga pasuria e tyre, kur ata të arrijnë në moshën e pjekurisë. Por Kur'ani, duke përdorur fjalën *minha* në vend të fjalës "*fijha*", porosit kujdestarët e jetimëve që të kujdesen dhe ta ruajnë pasurinë e tyre dhe të mundohen që të shpenzojnë për ta nga përfitimet e pasurisë së vet.

**E dyta:** Bashkëbisedimi me jetimët me fjalë të mira dhe të buta. All'llahu i Lartësuar thotë: "**...u thoni atyre fjalë të mira...**" kjo është për t'u larguar atyre atë çfarë ndiejnë nga mungesa shpirtërore dhe problemet psikike, si dhe për t'i ndihmuar e për t'i këshilluar ata derisa të arrijnë pjekurinë e mendore. Për këtë, ndërtimi i personalitetit të jetimit dhe udhëzimi logjik janë detyrë e kujdestarëve dhe prej përgjegjësive të tyre.

### **Një tjetër mësim në çështjen e jetimëve dhe të pasurisë së tyre**

Këtu është një mësim tjetër për çështjen e jetimëve dhe për pasurinë e tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: "**...Vëri në provë jetimët, derisa të bëhen për martesë...!**"

Kur ata të arrijnë moshën madhore, në të cilën juve vëreni tek ata aftësinë e tyre për menaxhimin e pasurisë në mënyrë të logjikshme, atëherë jepuni atyre pasurinë. "**...Nëse vëreni se janë pjekur, atëherë jepuni pasurinë e tyre...!**" Këtu patjetër duhet të cekim disa pika.

**1-** Me të vërtetë, nga fjala *hata*, që do të thotë *derisa*, përfitohet se është e nevojshme që jetimi të provohet derisa të

arrijë moshën për martesë. Kjo çështje të kryhet në një formë të vazhdueshme, derisa të dallohet pjekuria e tij, deri në kohën e martesës, për të menaxhuar çështjet e tij ekonomike në mënyrën më të mirë.

Po ashtu, nga përmbajtja përfitohet se qëllimi me provim është edukimi shkallë-shkallë dhe i vazhdueshme i jetimëve. Kjo do të thotë: Mos i lini jetimët dhe mos i neglizhoni ata derisa të arrijnë pjekurinë. Pastaj t’jua jepni pasurinë. Patjetër duhet t’i përgatisni ata, para pjekurisë, që të bëjnë një jetë të pavarur.

Përsa i përket thënies: Si mund të provohet jetimi? Mënyra për ta provuar atë është t’i japim një shumë të caktuar që të bëjë tregti, të blejë dhe të shesë me mbikëqyrjen e kujdestarit. Kjo të bëhet në atë formë që të mos i mohohet pavarësia jetimit. E nëse vërehet se jetimi është në gjendje të bëjë tregti dhe të bashkëpunojë ashtu siç duhet, pa asnjë gabim, është detyrë që atij t’i dorëzohet pasuria. Nëse ndodh e kundërta, është detyrë të vazhdojë edukimi dhe përgatitja e tij derisa të arrijë atë gradën e pavarësisë në punët dhe në administrimin e jetës së tij, me qëllim që frenat e së ardhmes të jenë në dorën e tij.

2- Me të vërtetë, përdorimi i frazës “...të bëhet për martesë...” tregon se pjekuria e kërkuar është ajo që arrin jetimi për të qenë i aftë për martesë. Është e vërtetë se, ai që është i aftë për martesë, duhet jetë i aftë të formojë familje. Nuk ka dyshim se njeriu, pa pasur një kapital financiar, nuk i arrin qëllimet e veta. Fillimi i jetës familjare njëkohësisht duhet të fillojë me fillimin e një jete ekonomike të pavarur.

3- Fjala “...nëse vëreni se janë pjekur...” tregon se është obligim që të siguroheni në pjekurinë e jetimëve, sepse fjala *ijnas*

do të thotë *vëreni* dhe *shihni*. Rrënja e kësaj fjale është prej fjalës *el-Insan*, e cila në kuptimin e saj do të thotë *shikim në sy*. All'llahu i Lartësuar pastaj thotë: **"...Mos nxitoni në shpenzimin e pasurisë së tyre në mënyrë të panevojshme dhe para se ata të rriten..."** Ky është një forcim që u kërkon kujdestarëve të jetimëve që të mos ia dorëzojnë pasurinë jetimëve para se ata të rriten dhe të bëhen të zotët e vetes që ta ruajnë atë pasuri dhe të mos e shpërdorojnë.

Pastaj, pas këtij përforcimi, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...kush është pasanik, le të përmbahet në marrjen e pasurisë së tyre e, në qoftë se është i varfër, le të harxhojë aq sa është e arsyeshme dhe e drejtë..."** Në këtë thënie, All'llahu i Lartësuar i ka lejuar kujdestarët e jetimëve që të marrin nga pasuria e tyre për veten e tyre në shkëmbim të ruajtjes së pasurisë së tyre, por të ruajnë anën e drejtësisë për atë që marrin nga pasuria e tyre si shpërblim, nëse kujdestari është i varfër. Nëse kujdestari është i pasur, nuk lejohet që të marrë asgjë nga pasuria e jetimit.

Janë transmetuar disa transmetime, të cilat qartësojnë thelbin e ajetit. Është transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja e Zotit qoftë mbi të*): "Me të vërtetë, ai është një burrë që e ka burgosur veten e tij nga jeta dhe nuk ka gjë. Nëse ushqehet aq sa atij i nevojitet, është e drejtë për të. Nëse zotëron pak pasuri (dhe kjo të mos vazhdojë për një kohë të gjatë) sigurisht të mos ushqehet në asnjë mënyrë nga ajo pasuri dhe të mos shpenzojë nga pasuria e jetimit."<sup>1</sup>

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Kur t'jua dorëzoni pasurinë e tyre, bëjeni këtë në prani të dëshmitarëve."** Kjo me qëllim që të mos mbesë asnjë akuzë apo keqkuptim. Ky është një

---

<sup>1</sup> "Usulul Kafijj", vëllimi 5, faqe 130. Tefsir "Ajashijj", vëllimi 1, faqe 221.

tjetër mësim në çështjen e kujdestarëve dhe të jetimëve, të cilën na e mëson ky ajet.

Dhe dijeni se Llogaritësi i vetëm është All'llahu i Lartësuar. E rëndësishme është se llogaria juaj është tek Ai. Atij nuk i fshihet asgjë dhe Atij nuk i kalon pa ditur as e vogla dhe as e madhja. Nëse ju i mashtroni jetimët, duke u fshehur njerëzve, dijeni, All'llahu i Lartësuar do ta shënojë atë dhe do t'u përlllogarisë dhe do t'u ndëshkojë për shkak të kësaj vepre. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...All'llahu është i mjaftueshëm si llogaritës."**

## Ajeti 7

لِّلرِّجَالِ نَصِيبٌ مِّمَّا تَرَكَ الْوَالِدَانِ وَالْأَقْرَبُونَ وَلِلنِّسَاءِ نَصِيبٌ مِّمَّا تَرَكَ  
الْوَالِدَانِ وَالْأَقْرَبُونَ مِمَّا قَلَّ مِنْهُ أَوْ كَثُرَ ۚ نَصِيبًا مَّفْرُوضًا ﴿٧﴾

**Meshkujve u takon pjesë nga ajo që ua kanë lënë prindërit dhe të afërmit, por, edhe femrave u takon pjesë nga ajo që ua kanë lënë prindërit dhe të afërmit qoftë ajo pak apo shumë, si pjesë e caktuar dhe e detyruar.**

### Shkaku i zbritjes

Në kohën e injorancës (para Islamit), arabët u jepnin trashëgimi meshkujve dhe jo femrave. Ata besonin se nuk trashëgon ai që nuk gjuan me shtizë, nuk është në gjendje të mbajë armën dhe nuk është në gjendje që të ruajë familjen, farefisin dhe pasurinë. Për këtë arsye, gratë dhe fëmijët ndalohehin që të trashëgojnë. U jepnin trashëgimi burrave të largët.

Kur ka vdekur një ensarij, që njëhej me emrin Eus ibn Thabit, la fëmijë të vegjël, djem e vajza. Pasurinë e tij e ndanë fëmijët e xhaxhait të tij Halidi dhe Arfexhet dhe nuk iu dha as bashkëshortes e as fëmijëve të tij. Bashkëshortja e tij u ankua te Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në atë kohë nuk kishte rregull, derisa zbriti ky ajet.

I dërguari i All'llahut i thirri këta dy persona dhe i urdhëroi që të mos vinin dorë mbi pasurinë e ensariut dhe atë pasuri t'ua lënë trashëgimtarëve të shtresës së parë të të vdekurit, që ishin gruaja dhe fëmijët e tij. Ai priste që të zbritnin ajetet të tjera, që të shpjegojnë më qartë mënyrën se si të ndahet trashëgimia ndërmjet trashëgimtarëve.<sup>1</sup>

## Komentimi

### Tjetër hap për të ruajtur të drejtat e grave

Ky ajet, në të vërtetë, është një hap tjetër për të luftuar zakonet dhe traditat e gabuara, të cilat çojnë në ndalimin e fëmijëve dhe të grave nga të drejtat e tyre të natyrshme e të pakundërshtueshme. Dhe mbi këtë bazë, ky ajet është plotësues i kërtimeve, të cilët i cekëm në ajetet e mëparshme. Arabët në kohën e injorancës (para Islamit), sipas traditave dhe zakoneve çnjerëzore e të padrejta, i ndalonin gratë dhe fëmijët nga e drejta e trashëgimisë.

Ky ajet e ndalon këtë zakon të gabuar e të padrejtë, duke thënë: **“Meshkujve u takon pjesë nga ajo që ua kanë lënë prindërit dhe të afërmit, por, edhe femrave u takon pjesë nga ajo që ua kanë lënë prindërit dhe të afërmit qoftë ajo pak apo shumë, si pjesë e caktuar dhe e detyruar.”**

Pastaj, All'llahu i Lartësuar, në mbyllje të këtij ajeti, për ta përforcuar më shumë këtë temë, urdhëron: **“...si pjesë e caktuar**

<sup>1</sup> Tefsiri “Durrul Menthur”, vëllimi 2, faqe 122. Tefsiri “Kurtubij”, vëllimi, 5 faqe 45.

**dhe e detyruar."**, për të prerë të gjitha rrugët e dyshimit e të lëkundshmërisë rreth kësaj çështjeje.

Ky ajet, sikurse shihet, përmend një rregull të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës. Për këtë, ata që thonë se pejgamberët nuk trashëgojnë, dhe nëse lënë ndonjë pasuri, nuk e trashëgojnë të afërmit e tyre, është në kundërshtim me ajetin në fjalë. (Sigurisht, qëllimi i pasurisë që lë pejgamberi (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është pasuria vetjake e tij. Kurse pasuria që ka lidhje me thesarmbajtësen (Bejtul Mal), që është e drejtë e të gjithë myslimanëve, rregulli i Islamit për atë pasuri është që të shpërndahet në vendet e duhura.

Gjithashtu, nga moskushtëzimi në këtë ajet dhe në ajetet e tjera që do të vijnë më pas dhe që flasin rreth trashëgimisë, sqarohet se thënia *ta'sib* (dhënia e pasurisë së lënë të afërmeve të të vdekurit nga ana e babit, sikurse thonë dijetarët e sunnetit), përsëri bie në kundërshtim me atë çfarë thotë Kur'anit i Shenjtë prej mësimave në fushën e trashëgimisë, pasi në disa raste, çon në mos trashëgiminë e gruas. E kjo është njësoj si dallimi në kohën para Islamit, të cilin Islami e kundërshton dhe nuk e nxjerr të pavlerë në këtë ajet dhe në ajete të tjera të ngjashme si këto.

## Ajeti 8

وَإِذَا حَضَرَ الْقِسْمَةَ أُولُو الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينُ فَأَرْزُقُوهُمْ مِنْهُ

وَقُولُوا لَهُمْ قَوْلًا مَّعْرُوفًا ﴿٨﴾

**“E kur në ndarjen e trashëgimisë të jenë të pranishëm farefisi i largët, jetimët dhe të varfrit, u dhuroni edhe atyre diçka dhe thuajuni fjalë të ëmbla.”**

### Komentimi

#### Rregull moralo-etik

Ky ajet kur'anor ka zbritur pas ligjit të ndarjes së trashëgimisë, sepse All'illahu i Lartësuar thotë: **“E kur në ndarjen e trashëgimisë të jenë të pranishëm farefisi i largët, jetimët dhe të varfrit, u dhuroni edhe atyre diçka ...”**

Për këtë, ky ajet kur'anor përmban një rregull moral të pëlqyeshëm (istihbabij) për shtresën e personave që nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e pasurisë, për arsye të pranisë së shtresës më të afërt që kanë lidhje me trashëgiminë. Ajeti thotë se, kur në ndarjen e trashëgimisë ndodhen edhe shtresa e dytë apo e tretë prej të afërmeve, po ashtu ndodhen edhe jetimë apo të varfër, jepuni edhe atyre diçka nga pasuria e lënë.

Me këtë veprim ju ndaloni lëvizjen e ndjenjës së hasedit (zilisë, smirës) dhe urrejtjes të dikush që mund të revoltohet për shkak të mosdhënies nga trashëgimia. S’ka dyshim se ky veprim është forcues i lidhjeve njerëzore e farefisnore ndërmjet jush.

Me të vërtetë, dy fjalët *jetama-jetimët* dhe *mesakijn-të vobektit*, edhe pse përmenden në formë të përgjithshme në këtë ajet, qëllimi është për jetimët dhe të vobektit nga të afërmit e të vdekurit. Sepse, në ligjin e trashëgimisë, ai që është më i afërt, e pengon nga trashëgimia atë që është më i largët. E nëse dikush prej shtresës së largët merr pjesë në ndarjen e trashëgimisë, është mirë t’u jepet atyre dhuratë diçka nga trashëgimia. (Sasia varet nga dëshira e trashëguesit dhe të jetë prej pjesës së të mëdhenjve dhe jo të të vegjëlve).

Një grup komentuesish supozojnë që fjalët *jetim* dhe *të varfër* në këtë ajet përfshijnë të gjithë jetimët dhe të varfrit që janë të afërm të të vdekurit apo jo. Por ky supozim duket pak si larg në logjikë, sepse të largëtit, në të shumtën e rasteve, nuk ulen në grumbullime familjare.

Gjithashtu, disa komentues besojnë se ajeti përmbledh rregull të detyrueshëm (vaxhib) dhe të pëlqyeshëm (istihbabij). Po të ishte i detyrueshëm, duhet të caktohej ajo që u takon këtyre dy grupeve (jetimëve dhe të varfërve), ndërkohë që çështja është lënë në dëshirë të trashëguesve.

Pastaj All’llahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet me një rregull morali: “**...dhe thuajuni fjalë të ëmbla**”, që do të thotë se në shtesë të ndihmesës materiale për ata, mbani një qëndrim të moralshëm dhe përfitoni nga burimi njerëzor e human për të fituar dashurinë e tyre, derisa të mos mbesë në zemrat e tyre asnjë

ndjenjë armiqësie drejt jush. Ky ligj është një argument dhe tregues tjetër se dhënia diçka prej trashëgimisë jetimëve dhe të varfërve nuk është obligim (vaxhib), por është e pëlqyeshme (nedb).

Nga të gjitha ato që përmendëm më lart, u qartësua se nuk ka kush të shfajësohet e të thotë se rregulli në këtë ajet është i shfuqizuar, i abroguar (mensukh) me ajetet që caktojnë pjesët e trashëgimisë, për shkak se nuk ka kundërshti mes këtij ajeti dhe ajeteve përcaktuese të pjesës së trashëgimisë.

## Ajeti 9

وَلْيَخْشَ الَّذِينَ لَوْ تَرَكَوْا مِنْ خَلْفِهِمْ ذُرِّيَّةً ضِعَفًا خَافُوا عَلَيْهِمْ فَلْيَتَّقُوا اللَّهَ  
وَلْيَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ﴿٩﴾

**“Le të druajnë nëse ata lënë pas vetes fëmijë të mitur, duke u brengosur për ta, le të kenë frikë Allahun dhe le të flasin drejt.”**

### Komentimi

#### Thirrje për mirësjellje ndaj jetimëve

Kur'ani i Shenjtë, me qëllim që të nxisë ndjenjën e dashurisë e të dhembshurisë ndaj jetimëve, tregon për një të vërtetë, ndaj së cilës njerëzit janë të pavëmendshëm. Dhe kjo e vërtetë është se njeriu duhet të sillet me jetimët e të tjerëve ashtu sikurse ka dëshirë që njerëzit të sillen me jetimët e tij.

Imagjinojini fëmijët që kanë humbur nënat e baballarët e tyre dhe jetojnë nën kujdesin e një zemërforti e tradhtari, që nuk i ruan ndjenjat e tyre dhe nuk bën drejtësi në të drejtat e tyre. Vërtet, imagjinojeni këtë fenomen të dhimbshëm dhe mendoni se sa do t'ju lëndojë. A do ta dëshironit një gjë të tillë për fëmijët tuaj të vegjël pas jush, sikur të ndërronit jetë? Sigurisht që jo. Ashtu sikurse i doni trashëgimtarët, po ashtu duajini edhe trashëgimtarët e të tjerëve dhe shqetësohuni për ta njësoj si shqetësoheni për trashëgimtarët tuaj.

Në këtë mënyrë, kuptimi i fjalës së All'llahut: **“Le të druajnë nëse ata lënë pas fëmijë të mitur, duke u brengosur për ta...”**, është se ata që i frikësohen të ardhmes së fëmijëve të tyre të vegjël, duhet të kenë frikë nga mashtrimi dhe keqbërja ndaj jetimëve.

Sigurisht, çështjet shoqërore shndërrohen në formë tradite nga viti në vit, nga e sotmja në të nesërmen dhe nga e nesërmja në të ardhmen e largët. Ata që përhapin tradita të padrejta, siç është ajo e keqtrajtimit të jetimëve, ky do të jetë shkak që kjo traditë të zbatohet edhe mbi fëmijët e atyre përhapësve. Në këtë mënyrë, ata përhapës, jo vetëm u bëjnë keq jetimëve të të tjerëve, por i kanë hapur portën padrejtësisë për fëmijët dhe jetimët e tyre.

Për këtë është detyrë që kujdestarët e jetimëve të zbatojnë rregullat dhe ligjet e All'llahut dhe ta kenë frikë All'llahun e Lartësuar për perkujdesjen ndaj tyre dhe t'u drejtohen atyre me fjalë të drejta, që janë në përputhje me legjislacionin islam. T'u flasin atyre fjalë të ndërthurura me ndjenjën humane, shpirtërore dhe vëllazërore, me qëllim që t'u shërohen plagët e zemrave të tyre dhe t'u kompensohet mangësia. All'llahu i Lartësuar, për këtë gjë urdhëron: **“...le të kenë frikë All'llahun dhe le të flasin drejt.”**

Këto mësimë të larta islame, të cilat i përmendëm në frazeologjitë e mësipërme, na paraqesin anën shpirtërore në fushën e edukimit të jetimëve. Duhet thënë se nevoja e jetimit nuk kufizohet në ushqim dhe veshmbathje, por më e rëndësishme është që të ruhen ndjenjat e tij shpirtërore.

Kjo ka një ndikim të madh në ndërtimin e të ardhmes së tyre, sepse jetimi është qenie njerëzore sikurse të tjerët dhe duhet t'i sigurohet ushqimi i nevojshëm shpirtëror.

Atij nuk duhet t'i mungojë përkushtimi, mirësjellja dhe dashuria, sikurse e gëzojnë edhe fëmijët e tjerë që rriten me praninë e prindërve. Ai nuk është qengj që del me kopenë për të kullotur në mëngjes dhe kthehet në perëndim.

Ai është njeri, i cili, në shtesë të përkujdesjes materiale, duhet të ketë edhe përkujdesjen shpirtërore. Përndryshe do të rritet i ashpër dhe mospërfillës, smirak dhe individ i rrezikshëm.

## Hulumtim

*Një qartësim i domosdoshëm:* Transmetohet nga Abdul A'la, Meula Al Sam se ka dëgjuar Ebu Abdullahun, Imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!): "Kush bën padrejtësi, All'llahu i Lartësuar do t'i dërgojë dikë që t'i bëjë atij padrejtësi, apo pasardhësve të tij, apo pasardhësve të pasardhësve të tij." Transmetuesi tha: "Këtë e përkujtova në veten time dhe thashë: "Të bësh padrejtësi e të të vijë dikush t'i bëjë padrejtësi të padrejtësit dhe pasardhësve e pasardhësve të tij?!" Përpara se unë të flas, Ebu Abdullahu më tha: "All'llahu i Lartësuar thotë: **"Le të druajnë, nëse ata lënë pas fëmijë të mitur, duke u brengosur për ta."**<sup>1</sup>

**Pyetje:** Me të vërtetë, pyetja që shqetësoi mendjen e transmetuesit, shqetëson edhe mendjen e shumë njerëzve, të cilët mund të pyesin: Si është e mundur që All'llahu i Lartësuar t'ua mbartë të tjerëve dënimin e një personi? Çfarë kanë bërë fëmijët e

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Burhan", vëllimi 1, faqe 346. "Mustedrekkul Uesail", vëllimi 12 faqe 98.

zullumqarit, derisa të sprovohen që edhe atyre t’u bëhet padrejtësi dhe të mbartin mbi shpatulla mëkatin e prindërit të tyre?”

**Përgjigje:** Sigurisht, përgjigjja e kësaj pyetjeje qartëson atë çfarë treguam në hadithin e mësipërm. Atë çfarë bëjnë njerëzit në shoqëri nga punët e tyre merr formën e një tradite, e cila me kalimin e kohës, kalon nëpër brezat e ardhshëm. Për këtë, ata që i bëjnë padrejtësi jetimëve në shoqëri dhe e mbrojnë këtë veprim të padrejtë, padyshim që zjarri i kësaj risie të keqe një ditë të caktuar do t’i godasë edhe pasardhësit e tyre.

Në të vërtetë, ky është prej ligjeve të vendosur nga njerëzit dhe askush të mos mundohet t’i japë ngjyra legjitime nga ana e All’llahut, sepse, All’llahu i Lartësuar nuk i bën padrejtësi askujt, por njeriu është ai, që me anë të këtyre veprave, i bën padrejtësi vetvetes dhe të tjerëve.

**Si përfundim:** Nëse padrejtësia përhapet në shoqëri, s’ka dyshim se ajo do të godasë të padrejtët dhe fëmijët e tyre (të po kësaj shoqërie).

## Ajeti 10

إِنَّ الَّذِينَ يَأْكُلُونَ أَمْوَالَ الْيَتَامَىٰ ظُلْمًا إِنَّمَا يَأْكُلُونَ فِي بُطُونِهِمْ نَارًا  
 وَسَيَصْلَوْنَ سَعِيرًا ﴿١٠﴾

**“Vërtet, ata që shpenzojnë pasurinë e jetimit pa të drejtë, vetëm mbushin barkun e tyre me zjarr dhe ata do të digjen në zjarrin flakëruar.”**

### Komentimi

#### Imazhi (pamja) i drejtë për veprat e njerëzve

Në fillimin e kësaj sureje përmendëm se ajetet e saj kanë zbritur për të ndërtuar një shoqëri të rregullt dhe të shëndoshë. Ajetet e kësaj sureje synojnë pastrimin e shoqërisë nga mbeturinat dhe prapambetjet e injorancës (para Islamit) dhe çfarë kanë mbetur nga zakonet e këqija në zemrat e disa myslimanëve të sapo hyrë në Islam, me qëllim që të bëhet e mundur ndërtimi i shoqërisë së pastër e të fortë.

Vallë a ka gjë më të keqe se sa marrja dhe shpenzimi me pa të drejtë e pasurisë së jetimit? Për këtë, kjo sure ka filluar me fraza të rrepta për ata që e shpenzojnë pasurinë e jetimit në një rrugë jo legjislative e të padrejtë.

Ajeti në fjalë është thënia më e qartë: **“Vërtet, ata që shpenzojnë pasurinë e jetimit pa të drejtë, vetëm mbushin barkun e tyre me zjarr dhe ata do të digjen në zjarrin flakërues.”**

Një ajet i ngjashëm me këtë ajet përmendet në Kur'an, në suren “El-Bekare”, ajeti 174, që ka lidhje me ata që fshehin të vërtetën dhe i devijojnë kuptimet nga e vërteta, që të arrijnë përfitime materiale dhe personale. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Padyshim ata që fshehin çfarë ka shpallur All'Ilahu në libër dhe e këmbëjnë atë me diçka tjetër të pavlerë, do të gëlltisnin në barkun e tyre vetëm zjarr.”**<sup>1</sup>

Më pas, All'Ilahu i Lartësuar sqaron rezultatin e përvetësimit e të shpenzimit me pa të drejtë të pasurisë së jetimëve: **“ata do të digjen në zjarrin flakërues.”**

Fjala *jesla* rrjedh nga fjala *es salije*, që do të thotë *hyrje në zjarr* dhe *përvoëlim me nxehtësinë* (flakën e tij). Ndërsa fjala *es-sajrë* do të thotë *zjarri i ndezur*.

Qëllimi i Kur'anit në këtë fjali është se ata që hanë me pa të drejtë pasurinë e jetimëve, jo vetëm që në këtë jetë ushqehen me zjarr, por ata do të hyjnë në zjarrin e ndezur përvëlues në Botën Tjetër.

Nga ky ajet përfitohet se veprat tona, në shtesë të pamjes së jashtme, kanë edhe pamje të vërtetë, e cila është e padukshme për ne në këtë jetë, por që do të shihet në Botën Tjetër. Kjo përbën çështjen e trupëzimit të punëve për të cilën flitet në besimin islam.

---

<sup>1</sup> Sure “El-Bekare”, ajeti 174.

Në këtë ajet, Kur'anit sqaron ata që e marrin dhe e shpenzojnë pasurinë e jetimëve me të padrejtë, edhe nëse veprimi i tyre në dukje është si ngrënia e ushqimeve të shijshme, e vërteta reale e këtij ushqimi është zjarri përvëlues, që do të qartësohet në Botën Tjetër.

Sigurisht, mes pamjes reale të veprës dhe mënyrës së dukshme të veprës ka gjithmonë ngjashmëri dhe përputhshmëri. Sikurse shpërdorimi i pasurisë së jetimit dhe uzurpimi i saj me të padrejtë e djeg zemrën e jetimit dhe e lëndon shpirtin e tij, edhe realiteti i këtij veprimi është zjarri përvëlues.

Vëmendja ndaj kësaj çështjeje (e vërteta reale e veprave) është mburoja më e mirë për ata që besojnë në këto të vërteta, me qëllim që të mos bëjnë gjynahe e mëkate. Vallë a ka ndonjë njeri që dëshiron të mbajë në dorën e tij prush zjarri, t'i futë në gojë e t'i përtypë? Sigurisht, është e pamundur.

Besimtarët kurrë nuk e shpenzojnë pasurinë e jetimëve me të padrejtë. Jo vetëm kjo, por ka edhe të tjerë që, jo vetëm nuk e bëjnë, por as nuk e mendojnë këtë gjë, siç janë eulijatë (të dashurit e Zotit). Kjo sepse ata në shtesë të mirësisë së dijes, besimit dhe moralit të përsosur që shfaqin, kanë arritur t'i shohin të vërtetat e veprave të njerëzve.

Sigurisht, fëmija i paditur mund të gënjëhet e ta tërheqë bukuria e flakës së zjarrit e të zgjasë dorën drejt tij, por njeriu me logjikë e i vetëdijshëm, i cili e ka provuar nxehtësinë e zjarrit dhe e ka shijuar dhembjen e tij, si mundet të mendojë një ditë për këtë?!

Për këtë tematikë janë transmetuar shumë hadithe, që e ndalojnë rreptësisht shpërdorimin e pasurisë së jetimëve dhe uzurpimin e të drejtave të tyre. Ato transmetime dëshmojnë dhe

vërtetojnë se është një mëkat i madh. Jo vetëm kaq, edhe veprat më të vogla të ngjashme me këtë, i përfshin ky ndëshkim i rreptë dhe i ashpër.

Në hadithin e transmetuar nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) apo nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) kur është pyetur për sasinë e shpenzimit të pasurisë së jetimit me pa të drejtë që të fut në zjarr, ka thënë dy derhem.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Tefsiri “Burhan”, vëllimi 2, faqe 31.

## Ajetet 11-12

يُوصِيكُمُ اللَّهُ فِي أَوْلَادِكُمْ لِلَّذِ كَرِ مِثْلُ حَظِّ الْأُنثَيَيْنِ ۚ فَإِنْ كُنَّ نِسَاءً فَوْقَ اثْنَتَيْنِ فَلَهُنَّ ثُلُثَا مَا تَرَكَ ۚ وَإِنْ كَانَتْ وَاحِدَةً فَلَهَا النِّصْفُ ۚ وَلِأَبَوَيْهِ لِكُلِّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا السُّدُسُ مِمَّا تَرَكَ إِنْ كَانَ لَهُ وَلَدٌ ۚ فَإِنْ لَّمْ يَكُنْ لَهُ وَلَدٌ وَوَرِثَهُ أَبُوَاهُ فَلِلْأُمِّهِ الثُّلُثُ ۚ فَإِنْ كَانَ لَهُ إِخْوَةٌ فَلِلْأُمِّهِ السُّدُسُ ۚ مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِي بِهَا أَوْ دَيْنٍ ۖ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ لَا تَدْرُونَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ لَكُمْ نَفْعًا ۚ فَرِيضَةٌ مِّنَ اللَّهِ ۚ إِنْ اللَّهُ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١١﴾ وَلَكُمْ نِصْفُ مَا تَرَكَ أَزْوَاجُكُمْ إِنْ لَّمْ يَكُنْ لَهُنَّ وَلَدٌ ۚ فَإِنْ كَانَ لَهُنَّ وَلَدٌ فَلَكُمْ الرُّبُعُ مِمَّا تَرَكَنَّ ۚ مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِي بِهَا أَوْ دَيْنٍ ۚ وَلَهُنَّ الرُّبُعُ مِمَّا تَرَكَتُمْ إِنْ لَّمْ يَكُنْ لَكُمْ وَلَدٌ ۚ فَإِنْ كَانَ لَكُمْ وَلَدٌ فَلَهُنَّ الثُّمُنُ مِمَّا تَرَكَتُمْ ۚ مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ تُوصُونَ بِهَا أَوْ دَيْنٍ ۚ وَإِنْ كَانَ رَجُلٌ يُورِثُ كَلَلَةً أَوْ امْرَأَةٌ وَلَهُ أَخٌ أَوْ أُخْتُ فَلِكُلِّ

وَاحِدٍ مِّنْهُمَا السُّدُسُ <sup>ج</sup> فَإِنْ كَانُوا أَكْثَرَ مِنْ ذَلِكَ فَهُمْ شُرَكَاءُ فِي

الثُّلُثِ <sup>ج</sup> مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصَىٰ بِهَا أَوْ دَيْنٍ غَيْرِ مُضَارٍّ <sup>ج</sup> وَصِيَّةٍ مِنَ اللَّهِ <sup>ق</sup>

وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَلِيمٌ ﴿١٢﴾

“All’lahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj: mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave; nëse trashëgimtarë janë dy e më tepër femra, atyre u takojnë dy të tretat nga trashëgimia; nëse është një femër - i takon gjysma e pasurisë; e për çdonjërin prind të të vdekurit - u përket një e gjashta nga pasuria e trashëguar, nëse i vdekuri ka lënë fëmijë; e nëse nuk ka fëmijë, e trashëgojnë prindërit dhe nënës i bie një e treta; nëse i vdekuri ka vëllezër, nënës së tij i bie një e gjashta, pas kryerjes së testamentit të lënë dhe larjes së borxhit. Ju nuk e dini se cili është më i afërt për ju nga dobia: prindërit tuaj apo fëmijët tuaj. Ky caktim është nga ana e All’lauhut. Pa dyshim All’lahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.

Juve ju takon gjysma e pasurisë nga ajo që kanë lënë bashkëshortet tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë. Por, nëse kanë fëmijë, ju takon një e katërta e asaj që kanë lënë ato, pasi të kryhet testamenti e të lahet borxhi. Në qoftë se nuk keni fëmijë, atyre (grave) u takon një e katërta e pasurisë që keni lënë e, nëse keni fëmijë, atyre u takon një e teta nga ajo që keni lënë, pasi të kryhet testamenti e të lahet borxhi. Nëse i vdekuri, qoftë burrë ose grua, është pa prindër dhe fëmijë, por ka vëlla ose motër (prej nënës), atëherë çdonjërit prej tyre u takon një e gjashta; e nëse ka më shumë nga ata, atëherë marrin pjesë bashkërisht në një të tretën e pasurisë, pasi të kryhet testamenti e të lahet

**borxhi, duke mos e dëmtuar askënd. Kjo është porosia e All'Ilahut! All'Ilahu është i Gjithëdijshtëm dhe shumë Durues."**

### **Shkaku i zbritjes**

Kur ka vdekur Abdurrahman ibn Thabit El Ensarij, vëllai i Hasan ibn Thabit, poet i njohur në fillim të Islamit, la pas gruan e tij dhe pesë vëllezër. Vëllezërit e tij e ndanë pasurinë që kishte lënë Abdurrahmani mes tyre dhe nuk i dhanë asgjë bashkëshortes së tij. Ajo iu ankua të Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për veprimin e tyre. Atëherë zbritën këto ajete, të cilët qartësojnë dhe përcaktojnë me përpikëri pjesën që u takon bashkëshorteve nga trashëgimia e burrave të tyre.<sup>1</sup>

Është transmetuar nga Xhabir ibn Abdullah El Ensarij: "U sëmura dhe më vizitoi i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Mua më ra të fikët dhe Profeti kërkoi ujë. Me një pjesë nga ai ujë mori abdes dhe pjesën tjetër ma hodhi mua dhe erdha në gjendje. Unë i thashë: "O i Dërguari i All'Ilahut, çfarë të bëj me pasurinë time? (Çfarë të bëj me pasurinë time, pasi unë të vdes)?"

I Dërguari i All'Ilahut heshti e nuk më foli. Atëherë zbritën ajetet e trashëgimisë, të cilat shpjegojnë rregullat dhe procedurat e trashëgimisë dhe të mënyrës së ndarjes së saj."<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup>Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", komentimi i ajetit në fjalë. Tefsiri "Durrul Menthur", vëllimi 2, faqe 443.

<sup>2</sup>Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", komentimi i ajetit në fjalë. Sahihu i Buhariut, vëllimi 7, faqe 4.

## Dy hulumtime

### 1- Trashëgimia e drejtë, e natyrshme

Përpara se të hyjmë në shpjegimin e këtyre ajeteve, patjetër duhet të cekim disa pika:

*E para:* Shumë njerëz mendojnë se është më mirë që pasuria e një personi pas vdekjes së tij të kalojë në pronë të përgjithshme dhe të shtohet në thesarmbajtësen e myslimanëve.

Por thellimi në këtë vepër na zbulon se kjo bie në kundërshtim me drejtësinë, sepse çështja e trashëgimisë dhe e ndarjes së saj është një çështje e natyrshme dhe shumë e logjikshme. Ashtu sikurse baballarët dhe nënat trashëgojnë tek fëmijët e tyre shumë veçori trupore dhe shpirtërore, sipas ligjit të natyrshëm të trashëgimisë, përse duhet të veçohet e të mos trashëgohet pasuria e tyre te fëmijët?

Në shtesë të kësaj, pasuria e lejuar është si rezultat i mundit dhe i përkushtimit të njeriut, është djersa dhe përpjekja e tij. Në të vërtetë, ajo përbën fuqinë e tij të trupëzuar në formën e pasurisë. Për këtë patjetër duhet pranuar se çdo njeri është pronar i natyrshëm i asaj që përfiton nga përpjekjet dhe munda të tij. Ky është ligji i natyrshëm.

Për këtë, kur njeriu ndalohet në përdorimin e pasurisë së tij për shkak të vdekjes, atëherë kjo pasuri është e drejtë e njerëzve më të afërt të tij, të cilët në realitet konsiderohen si vazhdimësia e gjenezës dhe e personalitetit të tij.

Bazuar në këtë parim, gjejmë shumë njerëz që nuk e lënë punën deri në momentin e fundit të jetës së tyre, edhe pse kanë

pasuri të madhe. Këtë e bëjnë me qëllim që t'u sigurojnë fëmijëve të tyre të ardhme të bollshme dhe jetë të lumtur. Kjo do të thotë që ligji i trashëgimisë është i aftë, që rrotën e ekonomisë ta shtyjë përpara, duke ia shtuar më shumë lëvizjet.

E kundërta ndodh kur një njeri e di që pasuria e tij, pas vdekjes, i kthehet në pronësi të përbashkët. Ai mund të goditet nga plogështia, përtacia dhe nuk do të jetë aktiv në çështjet ekonomike.

Këtë çështje e dëshmon më mirë ajo çfarë ka ndodhur në Francë para pak kohësh, ku Parlamenti Francez, siç thuhet, paraqiti amendamentin për të pezulluar ligjin e trashëgimisë dhe vendosi që trashëgimia e personit pas vdekjes të kalojë në bankën e shtetit dhe të bëhet pasuri e përgjithshme kombëtare dhe të merret nga instancat shtetërore dhe të menaxhohet në shpenzimet e përgjithshme, nga ku trashëgimtarët e të vdekurit nuk kanë të drejtë përdorimi prej asaj që ka lënë i vdekuri.

Ky amendament (ligj) ndikoi shumë keq në lëvizjen ekonomike. U pa një problem mjaft i madh në import dhe në eksport. Pati një rënie në zhvillimin ekonomik. Kjo gjë e shqetësoi shumë qeverinë. Shkaku i vetëm i kësaj gjendjeje ishte **"anulimi i ligjit të trashëgimisë."** Kjo gjendje e shtyu qeverinë, që të rishikojë edhe një herë vendimin e marrë rreth ligjit të trashëgimisë.

Sigurisht, nuk mund të mohohet se ligji i trashëgimisë dhe parimet trashëguese, në shtesë të të qenit ligj i natyrshëm dhe logjik, ka një ndikim të fortë dhe të thellë në ecurinë e zhvillimit ekonomik.

## 2- Trashëgimia në popujt e mëparshëm

Duke parë se ligji i trashëgimisë i ka rrënjët në natyrën e krijuar të njeriut, prania e trashëgimisë ka qenë në forma të ndryshme edhe në popujt e mëparshëm.

Te jahudinjtë, edhe pse disa thonë se parimi i trashëgimisë nuk gjendet te ta, po të lexohet Teurati (Toro), e gjejmë të përmendur në formë të qartë këtë ligj në “Seferul i’ dad”:

Izraeli tha: “Kur dikush vdes e nuk lë djalë, pasurinë e tij kalojani vajzës së tij. Nëse nuk ka vajzë, pasurinë e tij jepuani vëllezërve të vet. Po qe se nuk ka vëllezër, jepjani pasurinë e tij vëllezërve të babait të tij. Nëse nuk ka vëllezër të babait të tij, pasuria le t’i jepet atij që është më i afërt prej fisit të tij dhe ai le ta trashëgojë. Kjo le të jetë për bijtë e Izraelit një rregull ligjor siç ka urdhëruar Zoti i Musait (Moisiut).”<sup>1</sup>

Nga këto fraza përfitojmë se parimi i trashëgimisë rrotullohej rreth farefisit. Për këtë nuk përmendet pjesa që i takon gruas nga trashëgimia.

Ndërsa te feja e krishterë mjafton që parimi bazë i trashëgimisë të jetë përmendur në Teurat. Është transmetuar nga profeti Isa (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “Unë nuk kam ardhur për të ndryshuar ndonjë gjë nga rregullat e Teuratit.” Kështu që në librat për çështjet fetare të tyre, nuk gjejmë asnjë fjalë rreth trashëgimisë.

Në këto libra gjenden disa definicione. Por të gjitha ato kuptime tregojnë për trashëgiminë shpirtërore të jetës së përtejme.

<sup>1</sup> Teurati: “Seferul i’ dad”, is’hahu 27, faqe 253, fraza 8-11

Tek arabët në kohën e injorancës (para Islamit) trashëgimia shpërndahej sipas këtyre tri mënyrave:

1- Gjenezja: Këtu bënin pjesë vetëm fëmijët meshkuj dhe burrat. Nuk trashëgonin as femrat e as të vegjlit.

2- Birësimi: Këtu bëhej fjalë për atë që e përzinte familja dhe e birësonte një person tjetër ose familje tjetër, duke marrë përsipër kujdestarinë e tij. Në këtë formë realizohej trashëgimia mes të birësuarit dhe birësuesit.

3- Premtimi: Kjo kishte kuptimin që dy persona premtoun se do ta ruajnë njëri-tjetrit gjatë gjithë jetës së tyre dhe secili prej tyre të trashëgojë pasurinë e tjetrit pas vdekjes. Kështu që pas vdekjes realizohej trashëgimia mes atyre të dyve.

Islami e çliroi ligjin e trashëgimisë së natyrshme prej paganizmave të ngjitura. E pastroi prej dallimeve racore të padrejta, të cilat diferenconin mashkullin nga femra, të mëdhenjtë nga të vegjlit. Islami e bazoi trashëgiminë në tri çështje, të cilat nuk kanë qenë të njohura më parë në atë kohë.

1- Gjenezja me kuptim të gjerë. Në të përfshihet lidhja mes personave për shkak të lindjes në nivele të ndryshme, pa bërë dallim ndërmjet burrave dhe grave, të vegjëleve dhe të mëdhenjve.

2- Arsyeja ose shkak: Këtu përfshihen lidhjet mes personave për shkak të martesës.

3- El Uelaa: Këtu përfshihet lidhja që kanë personat jo për shkak të farefisit apo shkakut, por siç është *uelaul el itku*, që do të thotë: Nëse një njeri e liron robin (skllav) e tij, pastaj robi (skllavi)

vdes dhe ka lënë pas vdekjes pasuri dhe nuk ka askënd që ta trashëgojë pasurinë e tij nga ana e farefisit apo arsyes dhe shkakut, pasurinë e tij e trashëgon ai që e liroi.

*Uelaul imametu do të thotë nëse vdes dikush dhe nuk le dikë që ta trashëgojë nga arsyet që i cekëm më lart e trashëgon imami. Kjo ka kuptimin që pasuria e tij kalon në thesarmbajtësen islame dhe shpenzohet në çështjet e përgjithshme të myslimanëve.*

Për të gjitha këto shtresa ka rregulla dhe kushte të posaçme, që përmenden dhe janë shpjeguar në librat e Jurisprudencës islame.

## Komentimi

All'Ilahu i Lartësuar e fillon këtë ajet duke thënë: **"All'Ilahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj: Mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave..."** Në këtë ajet All'Ilahu tregon për rregullin e shtresës së parë prej trashëgimtarëve (dhe ata janë fëmijët, baballarët dhe nënat). Është e natyrshme se nuk ka lidhje më të fortë dhe më të afërt se lidhja prindër - fëmijë. Ky është shkaku i parapritjes së tyre ndaj shtresave të tjera të trashëgimtarëve.

Pastaj, vlen të përmendet caktimi i femrës faktor dhe bazë, sipas aspektit strukturor të fjalisë, në përcaktimin e pjesës së mashkullit. Kjo do të thotë se pjesa e saj nga trashëgimia është bazë dhe trashëgimia e mashkullit është degëzimi që njihet me analogji nga pjesa e femrës. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...Mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave..."**

Ky është një lloj përforcimi dhe vërtetimi për trashëgiminë e femrave dhe luftim i zakoneve të kohës para Islamit, që i ndalonte plotësisht femrat të trashëgonin pjesën e tyre që u takonte.

Ndërsa filozofinë e diferencës mes pjesës që i takon femrës dhe mashkullit, do ta shpjegojmë së afërmi, në dashtë All'Ilahu i Lartësuar.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...nëse trashëgimtarë janë dy e më tepër femra, atyre u takojnë dy të tretat nga trashëgimia"**, që do të thotë, nëse i vdekuri ka lënë më shumë se dy vajza, atyre u takon dy e treta, që ndahet mes tyre.

Pastaj All'llahu i Lartësuar urdhëron: **"...nëse është një femër, i takon gjysma e pasurisë..."**, që do të thotë se, nëse i vdekuri lë një vajzë të vetme, ajo trashëgon gjysmën e pasurisë së tij.

**Këtu lind pyetja:** Këtu Kur'ani thotë se **"më tepër se dy femra"**, që do të thotë se, nëse vajzat e të vdekurit janë më shumë se dy, u takon që të marrin dy të tretat dhe u ndahet mes tyre. Këtu Kur'ani ka treguar procedurën e trashëgimisë që i takon vajzës së vetme dhe më shumë se dy vajzave dhe ka heshtur për procedurën që u takon dy vajzave. Përse?

**Përgjigje:** Nëse e vërejmë pjesën e parë në fillim të këtij ajeti, qartësohet përgjigja. Dhe kemi për qëllim fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave."** Qoftë edhe përgjithësisht, sepse nëse trashëgimtarët e të vdekurit kufizohen me një djalë të vetëm dhe vajzë të vetme, djalin i takojnë dy të tretat dhe vajzës një e treta. Nëse janë dy vajza, sipas kësaj fjalie, atyre u takojnë dy të tretat.

Përkufizimi i thënies: Kur ka thënë mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave dhe numri i parë janë meshkuj dhe femra, mashkullit i takojnë dy të tretat dhe femrës i takon një e treta, nga kjo mësohet se dy vajzave u takojnë dy të tretat. Ndoshta, për shkak të qartësisë së kësaj çështjeje, ajeti nuk e ka cekur sqarimin e saj (pra, mashkullit i takon pjesa e dy motrave) dhe është mjaftuar me përmendjen e pjesës së vajzave që janë më shumë se sa dy, e cila është dy të tretat.

Gjithashtu, qartësohet, nëse i kthehemi ajetit të fundit të sures "En-Nisa", ajeti 176, ku motrës së vetme i takon gjysma e pasurisë (sikurse i takon vajzës së vetme). Pastaj All'llahu i

Lartësuar urdhëron: **“Në qoftë se një burrë pa fëmijë (dhe prindër) ka dy motra, atëherë ato do të trashëgojnë dy të tretat e pasurisë.”** Nga këtu qartësohet se pjesa e dy vajzave është dy të tretat.

Këtë çështje mund të gjejmë të trajtuar edhe në literaturën arabe: “më tepër se dy.” Këtu kuptohet dy edhe më shumë se dy femra.

Pa marrë parasysh ato që thuhet, rregulli i përmendur është prej rregullave të prera e të pranueshme në pikëpamjen e Jurisprudencës islame dhe të haditheve fisnike. Kthimi te sunneti i pastër (hadithet) është garanti për të larguar çdo paqartësi në fjalinë e përmendur, nëse ka paqartësi.

### **Përse mashkulli trashëgon dyfishin e femrës?**

Edhe pse ajo që trashëgon mashkulli është dy herë më shumë se ajo që trashëgon femra, nëse e vërejmë këtë çështje në një këndvështrim tjetër, duke arsyetuar dhe duke menduar thellë, sqarohet se femra trashëgon më tepër se ajo që trashëgon mashkulli. Kjo për shkak të interesimit të Islamit për mbrojtjen e të drejtave të femrës.

Qartësimi i kësaj: Mashkulli është i ngarkuar me disa detyra kundrejt femrës, nëpërmjet të cilave gjysmën e asaj që ai e trashëgon e shpenzon për femrën. Kurse femra nuk ka për detyrë asnjë lloj shpenzimi të tillë.

Sigurisht, obligimi i burrit është të shpenzojë për gruan e tij sipas nevojave të saj për vendbanim, veshmbathje, ushqim e të tjera nevoja që janë të domosdoshme për jetën. Po ashtu, ai duhet të shpenzojë edhe për fëmijët e tij të vegjël. Ndërkohë që gruaja

është e falur nga ky lloj shpenzimi deri edhe për veten e saj. Duke u bazuar mbi këtë, gruaja mundet që ta ruajë atë trashëgimi që ajo trashëgon. Nga këtu konkludohet se burri shpenzon dhe harxhon gjysmën e të ardhurave të tij për gruan dhe gjysmën tjetër për veten e tij. Ndërkohë, pjesa e gruas nga trashëgimia e saj mbetet e pandryshuar.

Për më shumë sqarim për lexuesin e nderuar sjellim këtë shembull: Të supozojmë se sasia e pasurisë që gjendet në botë, e cila ndahet gradualisht nëpërmjet trashëgimisë, ndërmjet grave dhe burrave, është 30 milionë dinarë. Dhe tani të llogarisim se sa u takon burrave dhe sa u takon grave nga ajo çfarë ata trashëgojnë. Të supozojmë se numri i burrave dhe i grave është i barabartë. Atëherë, në këtë rast, burrave u takon 20 milionë dinarë dhe grave u takon 10 milionë dinarë.

Kur gratë martohen, në të shumtën e rasteve, shpenzimi për to është obligim i burrave. Kjo do të thotë se gratë i ruajnë 10 milionë dinarët (që është pjesa e tyre nga trashëgimia) dhe u bashkohen burrave në 20 milionë dinarë, sepse është obligim i burrave që të shpenzojnë nga pjesa e vet për gratë dhe fëmijët e tyre.

Kështu që burrat shpenzojnë 10 milionë për gratë (dhe kjo është gjysma e pasurisë që ata kanë trashëguar) dhe shuma e pasurisë së grave arrin 20 milionë, që janë dy të tretat e pasurisë së botës. Ndërkohë që burrave nuk u takon më shumë se 10 milionë, pra, një e treta e pasurisë së botës. (Kjo është sasia të cilën burrat e shpenzojnë për veten e tyre).

Përfundimi është se pjesa që përfiton, zotëron dhe shpenzon gruaja, në të vërtetë, është dy herë më shumë se pjesa e

burrit. Kjo diferencë ndërmjet tyre bëhet se gruaja është më e dobët për të përfituar ose për të arritur pasuri (me punë dhe me mund). Kjo, në esencën e saj, është mbrojtje e arsyeshme dhe e drejtë, të cilën Islami i ka dhënë gruas. Kështu qartësohet se pjesa e saj e vërtetë është më e madhe, në ligjin islam, edhe pse në dukje është gjysmë.

Po t'i kthehemi trashëgimisë islame, do të shohim se e njëjta pyetje është shtruar që në fillimet e Islamit dhe i ka shqetësuar mendjet e disa njerëzve. Ata i pyesnin herë pas here dijetarët e fesë se cili është sekreti i kësaj difference. Në të shumtën e rasteve merrnin përgjigje të njëjta në përmbajtje, që All'llahu ka obliguar burrat që të shpenzojnë për gratë dhe për mehrin (prikën) e tyre dhe e caktoi pjesën e burrave më të shumtë se ajo e grave.<sup>1</sup>

Ebu Hasan Er Ridait (*Paqja qoftë mbi të!*) i janë dërguar shkrime për të sqaruar shkakun e dhënies së grave gjysmën e pasurisë nga ajo që i jepet burrit nga trashëgimia: sepse gruaja, kur martohet, merr, ndërsa burri jep. Për këtë, burrave u jepet më shumë. Shkak tjetër që i jepet burrit, po të njëjtën që i jepet gruas, sepse gruaja është prej familjes së burrit. Kur ajo ka nevojë, është obligim i tij që ta mbajë dhe të shpenzojë për të..."<sup>2</sup>

## Trashëgimia e babait dhe e nënës

Ndërsa trashëgimia e baballarëve dhe e nënave, të cilët janë prej shtresës së parë të trashëgimisë, edhe në përshkrimin e

<sup>1</sup> "Usulul Kafij", vëllimi 7 faqe 85, Kreu i shkakat se përse për mashkullin ka dy pjesë dhe për femrën një pjesë.

<sup>2</sup> "Usulul Kafij", vëllimi 7 faqe 85, Kreu i shkakat se përse për mashkullin ka dy pjesë dhe për femrën një pjesë.

fëmijëve, gjithashtu, sikurse përmend ky ajet kur'anor (ajeti i parë prej ajeteve në fjalë), ka tre alternativa.

**E para:** Personi që vdes, nëse ka lënë pas një fëmijë ose më shumë fëmijë, nëna dhe babai trashëgojnë secili një të gjashtë. All'llahu i Lartësuar për këtë gjë urdhëron: **"...e për çdonjërin prind të të vdekurit - u përket një e gjashta nga pasuria e trashëguar, nëse i vdekuri ka lënë fëmijë ..."**

**E dyta:** Nëse i vdekuri nuk ka lënë fëmijë dhe trashëgimia e tij kufizohet tek babai dhe nëna e tij, në këtë rast nëna trashëgon një të tretën e pasurisë, siç thotë All'llahu i Lartësuar: **"...e nëse nuk ka fëmijë, e trashëgojnë prindërit dhe nënës i bie një e treta..."** Nëse në këtë rast nuk gjejmë asnjë sqarim për pjesën e babit, sepse pjesa e tij është e qartë dhe ajo çfarë i takon atij është dy të tretat. Në shtesë të kësaj, kur i vdekuri lë bashkëshorte, në këtë rast pakësohet pjesa e babait dhe jo pjesa e nënës. Kështu, pjesa e babait është e ndryshme në alternativën e dytë.

**E treta:** Nëse i vdekuri ka lënë babanë, nënën, vëllezër nga të dy prindërit ose vetëm nga babai i tij dhe nuk ka lënë fëmijë, në këtë rast pjesa që i takon nënës bie në një të gjashtë, sepse vëllezërit e pengojnë nënën nga trashëgimia e sasisë shtesë e një të gjashtës, edhe pse ata nuk trashëgojnë.

Për këtë quhen vëllezërit e të vdekurit me pengesë. Kjo është ajo çfarë thotë fjala e All'llahut të Lartësuar: **"...nëse i vdekuri ka vëllezër, nënës së tij i bie një e gjashta, pas kryerjes së testamentit të lënë dhe larjes së borxhit."**

Filozofia e këtij rregulli është e qartë, sepse kur i vdekuri lë vëllezër, këta bëhen barrë për babain, sepse është detyrë e babait që të shpenzojë për vëllezërit e të vdekurit derisa ata të rriten. Për

këtë prania e vëllezërve të të vdekurit nga të dy prindërit ose vetëm nga babai, obligon uljen e pjesës që i takon nënës dhe nuk obligon uljen e pjesës së babait.

Nëse vëllezërit janë nga nëna, nuk e pengojnë atë (nënë) të trashëgojë atë që shtohet mbi një të gjashtë, sepse ata nuk kanë asnjë të drejtë shpenzimi ndaj babait të të vdekurit, sikurse është e qartë.

**Pyetje:** Këtu vjen pyetja: Me të vërtetë, Kur'ani e ka përdorur fjalën *vëllezër* në shumës: "**nëse i vdekuri ka vëllezër.**"

Ne e dimë se, shumësi më i pakët, është tre, ndërkohë që shumica e juristëve (fukahave) thonë që edhe dy vëllezër e pengojnë. Atëherë si është e mundur përputhja mes këtyre dy gjërave?

**Përgjigje:** Me të vërtetë, përgjigja qartësohet duke iu kthyer ajeteve të tjera të Kur'anit, ku nuk është obligim që të përdoret forma e shumësit tre apo më shumë. Por nga një herë përdoret edhe vetëm për dy persona, sikurse ka ardhur në ajetin 78 të sures "El-Enbija", ku All'llahu i Lartësuar thotë: "**Ne ishëm dëshmitarë të gjykimit të tyre.**"

Ky ajet ka të bëjë me gjykimin e Daudit e të Sulejmanit. Kur'ani e ka përdorur përemrin në numrin shumës në çështjen e atyre të dyve dhe ka thënë "**të gjykimit të tyre.**"

Nga këtu qartësohet se mund të përdoret shumësi i fjalive, gjithashtu në dy persona, por kjo ka nevojë për një argument dhe dëshmi. Dëshmia rreth kësaj është thënia e prijësve të fesë dhe mendimi i përbashkët i myslimanëve për këtë gjë. Për këtë çështje kanë rënë dakord të gjithë dijetarët islamë, sunni dhe shi'ia,

(përveç ibn Abasit), sepse rregulli i përmendur në këtë ajet përfshin gjithashtu edhe dy vëllezërit.

### **Trashëgimia pas testamentit (el uesijes) dhe borxhit**

Në vijim, All'llahu i Lartësuar urdhëron: **"...pas kryerjes së testamentit dhe pas larjes së borxhit..."** Është obligim që të zbatohet ajo çfarë i vdekuri ka lënë testament për trashëgiminë e vet, ose, së pari, të shlyhet borxhi që ai ka lënë, pastaj pjesa tjetër e mbetur të ndahet mes trashëgimtarëve. (Në Kreun e Testamentit thamë se çdokush duhet të lërë testament vetëm për një të tretën që i takon atij. Nuk lejohet të lërë testament për më shumë se sa i takon, vetëm me lejen e trashëgimtarëve).

Pastaj All'llahu i Lartësuar ka thënë: **"Ju nuk e dini se cili është më i afërt për ju nga dobia: Prindërit tuaj apo fëmijët tuaj."** Nga këto fraza përfitojmë se ligji i trashëgimisë, të cilën e cekëm më lart, është ndërtuar mbi themele të forta të interesave dhe dobive reale. Përcaktimi i këtyre dobive dhe interesave janë në dorën e All'llahut, sepse njeriu është i paaftë që t'i përcaktojë të gjitha dobitë dhe interesat e tij.

Disa mund të mendojnë se baballarët dhe nënat kanë më shumë dobi për ta, për këtë ata e meritojnë më shumë trashëgiminë se sa fëmijët. Ndërsa disa të tjerët mund të mendojnë të kundërtën.

Sikur çështja e trashëgimisë dhe e ndarjes së saj të lihej në dorën e njeriut, do të ndaheshin në njëmijë grupe (medhhebe) dhe çështja do të arrinte në një udhëkryq dhe pa zgjidhje, do të përfundonte në kundërshtime dhe përplasje. Por, All'llahu i Madhëruar, që është i Gjithëdijsëm për të vërtetat e çështjeve, e

ka vendosur ligjin e trashëgimisë mbi sistem të fortë, që i garanton dhe i siguron mirësi dhe dobi mbarë njerëzimit.

Me qëllim përforcimin e të gjitha çështjeve që u përmendën më sipër; me qëllim që rregulli i trashëgimisë, i cilësuar si ligj i pandryshueshëm dhe në mesin e njerëzve të mos ketë asnjë vend për polemikë, All'Ilahu i Lartësuar urdhëron: **"...Ky caktim është nga ana e Allahut. Pa dyshim All'Ilahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë."**

Dhe me këtë i pritet rruga çdo polemike në fushën e ligjeve, që kanë lidhje me pjesët në trashëgimi.

### **Pjesa që u takon bashkëshortëve nga njëri-tjetri**

Në ajetin e mësipërm u fol për pjesën që u takon fëmijëve, baballarëve dhe nënave. Në ajetin vijues All'Ilahu i Lartësuar urdhëron: **"Juve ju takon gjysma e pasurisë nga ajo që kanë lënë bashkëshortet tua, nëse ato nuk kanë fëmijë..."** Në këtë ajet All'Ilahu na tregon mënyrën se si trashëgojnë bashkëshortët nga njëri-tjetri. Bashkëshorti trashëgon gjysmën e pasurisë që i le bashkëshortja, nëse bashkëshortja nuk lë fëmijë.

Nëse ajo lë fëmijë (edhe sikur t'i ketë nga bashkëshort tjetër) bashkëshorti trashëgon nga pasuria e saj vetëm një të katërtën. Lidhur me këtë, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...Por, nëse kanë fëmijë, ju takon një e katërta e asaj që kanë lënë ato..."**

Kjo ndarje duhet të bëhet, pasi të jetë zbatuar testamenti i të vdekurit dhe pas shlyerjes së borxheve të tij nga pasuria, siç thotë All'Ilahu i Lartësuar: **"...pasi të kryhet testamenti e të lahet borxhi..."**

Ndërsa trashëgimia e bashkëshortes nga ajo që i ka lënë bashkëshorti është si vijon: Nëse bashkëshorti ka lënë fëmijë, (edhe nëse janë nga një bashkëshorte tjetër), bashkëshortja trashëgon nga pasuria e tij një të tetën, sipas thënies së All'llahut të Lartësuar: **"...nëse keni fëmijë, atyre u takon një e teta nga ajo që keni lënë..."**

Bashkëshortes i takon një e katërta, nëse bashkëshorti nuk ka lënë fëmijë, sipas thënies së All'llahut të Lartësuar: **"...Në qoftë se nuk keni fëmijë, atyre (grave) u takon një e katërta e pasurisë që keni lënë e, nëse keni fëmijë, atyre u takon një e teta nga ajo që keni lënë..."** Kjo ndarje duhet të bëhet pasi të jetë zbatuar testamenti i të vdekurit ose shlyerja e borxhit të tij, siç thotë All'llahu i Lartësuar: **"...pasi të kryhet testamenti e të lahet borxhi..."**

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë rast është ulja e pjesës që i takon bashkëshortëve në gjysmë, nëse i vdekuri le fëmijë. Kjo ndodh për të ruajtur gjendjen ekonomike të fëmijëve.

Kurse shkaku i pjesës së bashkëshortëve (burrave) sa dyfishi i pjesës së bashkëshorteve (grave) është ai që e përmendëm te hulumtimi i dallimit mes burrit dhe gruas.

Pastaj, këtu është një pikë shumë e rëndësishme, që do vëmendje, se pjesa që u takon grave (qoftë një e katërta apo një e teta) është në veçanti për atë që ka lënë vetëm një grua (ajo trashëgon një të katërtën ose një të tetën). Ndërsa, nëse i vdekuri lë shumë gra (më tepër se një) ajo pjesë ndahet (një të katërtën apo në një të tetën) në mënyrë të barabartë ndërmjet tyre.

## Trashëgimia e vëllezërve dhe e motrave të të vdekurit

All'Ilahu i Lartësuar, pasi përmendi pjesën që u takon bashkëshortëve, përmend pjesën që u takon vëllezërve dhe motrave të të vdekurit: **"Nëse i vdekuri, qoftë burrë ose grua, është pa prindër dhe fëmijë..."** Në këtë frazë përballemi me një term të ri, që është përdorur vetëm në dy vende në Kur'an, në këtë ajet dhe në ajetin e fundit të sures "En-Nisa" dhe ajo është fjala *kelaletu*.

Ajo që përfitohet nga librat e gjuhës arabe është se fjala *kelaletu* vjen nga fjala *kelaal*, që do të thotë *ikje e fuqisë*. Në fjalorët e gjuhës arabe thuhet se në origjinal fjala *kelaletu* vjen me kuptimin *kelaalun*, që do të thotë *ikje e fuqisë*. Më pas ajo fjalë është përdorur për vëllezërit dhe motrat e të vdekurit, të cilët e trashëgojnë atë.

Ndoshta, ngjasimi mes kuptimit të parë dhe të dytë është se vëllezërit dhe motrat konsiderohen nga shtresa e dytë në shtresat e trashëgimisë, të cilët nuk trashëgojnë vetëm në mosprezencën e babait, nënës dhe fëmijëve të të vdekurit, një që ka humbur babain, nënën, fëmijët patjetër që ndien dobësim të madh dhe rënie fuqie. Për këtë atij i thuhet *kelaletun*.

Kur është pyetur Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për kuptimin e fjalës *kelaletun* ka thënë: *"Kelaletu është ai që vdes dhe nuk ka as fëmijë dhe as prindër."*<sup>1</sup> Me këtë emër ka identifikuar të vdekurin. Të dyja këto thënie janë të sakta.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Kenzul "Ummal", vëllimi 11 faqe 78; Tefsirul "Mijzan", vëllimi 4, faqe 212.

<sup>2</sup> Tefsirul "Mijzan", vëllimi 4, faqe 212.

Kurse përshkrimi i Kur'anit për vëllezërit dhe motrat e të vdekurit me fjalën *kelaaletun* ndoshta është se këta njerëz, që humbën baballarët, nënat dhe fëmijët, ta dinë se pasuria e tyre (pas vdekjes së tyre) do të lihet në dorën e atyre që janë të dobët dhe kjo tregon dobësinë e tyre. Për këtë, është obligim i tyre që ta shpenzojnë pasurinë e tyre në vende të domosdoshme dhe ta shpenzojnë për ata që kanë nevojë, duke ruajtur interesat e përgjithshme.

### Kthim në komentimin e ajetit

All'llahu i Lartësuar thotë **"...Nëse i vdekuri është pa prind dhe fëmijë, por ka vëlla ose motër (prej nënës), atëherë çdo njërit prej tyre i takon një e gjashta..."**, që do të thotë: Nëse vdes një burrë dhe le vetëm një vëlla ose një motër, apo vdes një grua dhe le vetëm një vëlla ose një motër, secili prej tyre trashëgon një të gjashtën nga pasuria e lënë. Kjo, nëse trashëguesi është vëlla ose motër e vetëm.

Nëse janë më shumë se një, të gjithë trashëgojnë vetëm një të tretën, që do të thotë se një e treta ndahet mes tyre: **"...e nëse kanë shumë nga ato, atëherë marrin pjesë bashkërisht në një të tretën e pasurisë..."**

Pastaj Kur'ani vazhdon e thotë: **"...pasi të kryhet testament e të lahet borxhi..."** Pasuria e trashëgimisë ndahet pasi të jetë zbatuar testamenti që ka lënë i vdekuri ose i janë shlyer borxhet që ai mund të ketë lënë.

Më pas, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...duke mos e dëmtuar askënd..."**, që do të thotë se ajo që ka lënë testament i vdekuri, që të shpenzohet, po kështu edhe borxhi, të mos jenë dëmtues për trashëgimtarët.

Pra, të mos jetë më shumë se një e treta, sepse tejkalimi i testamentit apo i borxhit më shumë se një e treta është dëmtim për trashëgimtarët, sikurse shpenzimi i më shumë se i një të tretës ka nevojë për lejen dhe kënaqësinë e trashëgimtarëve.

Po ashtu, dëmtim është edhe nëse i vdekuri gënjen se ka borxhe, me qëllim që trashëgimtarët e tij të mos e trashëgojnë, sikurse ka ardhur në transmetimet e të dërguarit të All'llahut dhe Familjes së tij të pastër (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi ta!*).

Pastaj, All'llahu i Lartësuar, për ta përforcuar këtë rregull, thotë: **"...Kjo është porosia e All'llahut. All'llahu është i Gjithëdijshtëm dhe shumë i Butë"**, që do të thotë se kjo kërkesë është porosi prej All'llahut të Lartësuar dhe është obligim që ta respektoni atë, sepse Ai është i Gjithëditur për atë çfarë është më e mira dhe më e dobishmja për ju. Ai ju urdhëron me këtë, duke u bazuar në urtësi.

Gjithashtu, All'llahu është i Gjithëditur për qëllimet e porositësve (ata që lenë testament). All'llahu i Lartësuar është i Butë dhe nuk i ndëshkon e as nuk i dënon menjëherë mëkatarët për padrejtësitë e tyre.

## Hulumtime

Këtu duhen përmendur disa hulumtime:

**1-** Ajo çfarë u përmend në ajetin e lartpërmendur rreth trashëgimisë së vëllezërve dhe motrave, edhe nëse duket në pamje të parë i përgjithshëm, përfshin vëllezërit dhe motrat nga dy prindërit ose vetëm nga babai ose vetëm nga nëna.

Por po të shohim ajetin e fundit të sures “En-Nisa” (që së afërmi do të vijë komentimi i saj) do të qartësohet se qëllimi këtu është për vëllezërit dhe motrat vetëm nga ana e nënës. Ndërkohë qëllimi në ajetin e fundit të kësaj sureje është për vëllezërit dhe motrat nga ana e dy prindërve ose veçanërisht nga ana e babait. (Argumentet rreth kësaj çështjeje do t’i përmendim në komentimin e ajetit të fundit të kësaj sureje).

Duke u bazuar mbi këtë, këto dy ajete, edhe pse flasin rreth trashëgimisë së *kelaletu* (që janë vëllezërit dhe motrat e të vdekurit) në pamje të parë duken sikur janë të kundërt njëri me tjetrin. Por me një studim të thellë dhe vështirim në përmbajtjen e këtyre dy ajeteve, zbulohet se secili ajet ka për qëllim një grup të veçantë nga vëllezërit apo motrat e të vdekurit. Në të vërtetë nuk ka kundërshtim (mospërputhje) asnjëherë mes këtyre dy ajeteve.

**2-** Është mëse e qartë se kjo shtresë nuk trashëgon absolutisht vetëm se në mungesë të shtresës së parë, që janë baballarët, nënat dhe fëmijët. Për këtë tregon fjala e All’llahut të Lartësuar: “**ndonëse sipas librit të All’llahut, besimtarët që kanë**

**lidhje farefisnore, janë më të afërt për njëri-tjetrin (në ndarjen trashëgimisë)."**<sup>1</sup>

Sikurse edhe në shumë transmetime të ndryshme, që flasin për këtë temë, përcaktojnë shtresat e trashëgimtarëve dhe njëren palë nga tjetra.

**3-** Me të vërtetë, te fjala e All'llahut të Lartësuar: **"atëherë janë ortakë në një të tretën e pasurisë"**, përfitojmë se vëllezërit dhe motrat e të vdekurit (*kelaletu*) nëse janë më shumë se një motër e një vëlla, e ndajnë një të tretën mes tyre pa bërë dallim mes mashkullit dhe femrës, sepse kuptimi i sifjalisë **"janë ortakë në një të tretën e pasurisë"** është për barazinë e pjesëve.

**4-** Nga ky ajet përfitojmë se nuk është e drejtë që njeriu të pohojë borxhet e rrejshme që t'i dëmtojë trashëgimtarët e vet, t'i humbë të drejtat e tyre dhe t'i ndalojë ata nga e drejta e trashëgimisë.

Është obligim i tij që të tregojë, në momentet e fundit të jetës së tij, borxhet reale. Gjithashtu, ai duhet të lërë testament të drejtë, sikurse ka ardhur në transmetime që ky testament të mos jetë më shumë se një e treta e pasurisë së tij.

Në transmetimet e imamëve, për këtë temë, ka shprehje të rrepta dhe mohuese, për atë që lë testament dëmtues për trashëgimtarët. Prej atyre transmetimeve është thënia: *"Me të vërtetë, dëmtimi në testament (pasuri) është prej gjynaheve të mëdha."*<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Sure "El Enfal", ajeti 75.

<sup>2</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", komentimi i këtij ajeti. "Uesailu Shia", vëllimi 19, faqe 268.

Me të vërtetë, Islami i pastër, me vendosjen e këtij ligji ka ruajtur për të vdekurin diçka prej së drejtës në këtë çështje, duke i përgatitur atij mundësinë e përfuturit në sasinë e një të tretës.

Po ashtu, mbron edhe të drejtat e trashëgimtarëve, me qëllim që në zemrat e tyre të mos ketë asnjë pakënaqësi dhe të mos shkëputet lidhja farefisnore, të cilat duhet të vazhdojnë edhe pas vdekjes së trashëgimtarit.

## Ajetet 13-14

تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ يُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرَى مِنْ  
تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١٣﴾ وَمَنْ  
يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ  
مُهِينٌ ﴿١٤﴾

“Këta janë kufijtë e caktuar prej All’llahut. Atë që i bindet All’llahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Kjo është fitorja e madhe.

Ndërsa atë që nuk i bindet All’llahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, All’llahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.”

## Komentimi

Fjala *hudud* është shumësi i fjalës *had*, kuptimi i së cilës është *ndalim*. Më pas është përdorur për çdo pengesë që ndan në mes dy gjëra dhe që i dallon. Kufiri i shtëpisë, i kopshtit apo dhe i shtetit ka kuptimin e vendit që ndan një pikë nga pikat e tjera.

Ajeti i parë i këtyre dy ajeteve ka filluar me fjalinë dëftore, që tregon ligjet e trashëgimisë, të cilën e shpjegoam në ajetet e mësipërme, me fjalën *tilke*.

All’llahu i Lartësuar urdhëron: “Këta janë kufijtë e caktuar prej All’llahut...”, që do të thotë se këto janë kufijtë e caktuar prej

All'lahut, nga ku, askujt, që i ka njohur, nuk i lejohet t'i kalojë apo t'i nënvleftësojë ato. Sigurisht, ai që i kalon këto kufij është mëkatar dhe gjynahqar i madh.

Fjalja **“Këta janë kufijtë e caktuar prej All'lahut...”** është cekur në shumë vende në Kur'anin Famëlartë. Gjithmonë ka ardhur pas përmendjes së një zinxhiri ligjesh, rregullash dhe vendimesh shoqërore. Për shembull, në ajetin 187 të sures “El-Bekare” kjo frazë vjen pas informimit për ndalimin e marrëdhënieve intime ndërmjet bashkëshortëve gjatë kohës kur personi është mbyllur për adhurimin në xhami (*i'tikaf*) dhe pas përmendjes së rregullave që kanë lidhje me agjërimin.

Po ashtu, kjo frazë ndodhet edhe në ajetin 229 dhe 230 të sures “El-Bekare” dhe në ajetin 10 të sures “Et-Talak”, pas shpjegimit të një pjese rregullash të divorcit. Gjithashtu, ndodhet edhe në ajetin 4 të sures “Muxhadele”, pas shpjegimit të shlyerjes së shpagimit të *dhiharit*. Në të gjitha këto raste ka ligje dhe rregulla, të cilat nuk duhen shkelur e tejkaluar. Për këtë arsye janë cilësuar se janë **“kufijtë e All'lahut.”**<sup>1</sup>

Pas përmendjes së kësaj pjese prej kufijve të All'lahut, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Atë që i bindet All'lahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojë përherë.”** Me këtë Ai tregon rezultatin në Botën Tjetër, për shkak të zbatimit dhe të respektimit të kufijve të All'lahut. Më pas këtë rezultat në Ahiret e përshkruan me thënien: **“...Kjo është fitorja e madhe.”**

Në vijim, All'llahu i Lartësuar përmend të kundërtën e këtij përfundimi në formën e një mëkati, për shkak të shkeljes dhe të

<sup>1</sup> Në fund të komentimit të ajetit 229 të sures “El-Bekare” nga ky komentim, u fol me më shumë detaje rreth “kufijve të All'lahut”.

tejkalimit të kufijve të All'llahut: **"Ndërsa atë që nuk i bindet All'llahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, All'llahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues."**

Ne e dimë se mëkati dhe mosbindja ndaj All'llahut, sido që të jetë, nuk obligon përjetësinë dhe ndëshkimin e përhershëm në zjarr. Mbi këtë bazë, qëllimi i këtij ajeti është për ata që i kalojnë (kapërcejnë) kufijtë e All'llahut me kokëfortësi, padrejtësi, armiqësi dhe mohim. Në të vërtetë, janë ata që nuk besojnë All'llahun dhe as Botën Tjetër.

Vërejmë se fjala *hudud* - *kufij*, është shumë, atëherë ky kuptim do të sqarohet dhe se ai përfshin të gjithë kufijtë, ligjet dhe rregullat e All'llahut. Ai që i injoron të gjitha këto kufij hyjnorë, zakonisht nuk beson në All'llahun e Lartësuar, në të kundërt, ai do të respektonte të paktën disa prej tyre.

Ajo që tërheq vëmendjen në ajetin e mëparshëm është se All'llahu i Lartësuar flet për banorët e Xhenetit me numrin shumë: "*halidijne fijha*" - *do të qëndrojnë përherë*, ndërsa për banorët e zjarrit flet me numrin njëjës "*haliden fijha*" - *do të qëndrojë përherë*.

Ky ndryshim në përshkrim, në këto dy ajete, është krejt i qartë, se banorët e Xhenetit janë grupe-grupe. (Thënë ndryshe: Kjo do të jetë gjendja shoqërore mes banorëve të Xhenetit). Kjo në vetvete është mirësi prej mirësive të Xhenetit, me të cilën banorët dhe pjesëtarët e tij do të mirësohen.

Kurse gjendja e banorëve të Xhehennemit është ndryshe nga ajo e banorëve të Xhenetit, sepse gjithsecili prej banorëve të zjarrit është i zënë me veten e vet, për shkak të ndëshkimit, nuk vështron askënd dhe as që mendon për askënd.

Atij i intereson vetvetja. Kjo është gjendja aktuale e kokëfortëve dhe e të vetmuarve në mendime dhe qëndrime në

këtë dynja. Përballë tyre qëndrojnë grupet e bashkuara. Grupi i parë përfaqëson banorët e Xhehennemit dhe grupi i dytë përfaqëson banorët e Xhenetit.

## Dy hulumtime

### 1- Dallimet e ligjit islam të trashëgimisë

Në legjislacionin e trashëgimisë, në përgjithësi dhe në sistemin islam të trashëgimisë në veçanti, ka dallime. Më poshtë do të përmendim disa prej tyre:

1- Në sistemin e trashëgimisë islame dhe nën dritën e përcaktimit të shtresave që trashëgojnë, askush nga të afërmit e të vdekurit nuk ndalohet që të marrë nga trashëgimia e tij. Nuk ka në Islam ajo çfarë ka qenë zakoni i njohur (ose ndoshta akoma vazhdon) tek arabët e injorancës apo te disa shoqëri, të cilat i kanë privuar gratë dhe fëmijët të marrin pjesë në trashëgimi, për arsye se nuk janë në gjendje të mbartin armët dhe të marrin pjesë në luftë apo të tjera të ngjashme me këtë pretekst. Rregulli i trashëgimisë islame përfshin çdo pjesëtar të të vdekurit që ka lidhje afërsie me të.

2- Ky rregull i përgjigjet nevojave të natyrshmërisë njerëzore dhe legjislative, sepse çdo person është i obliguar që të shohë frytin e mundit dhe të përpjekjeve të veta në dorën e atij që konsiderohet vazhdimësi dhe ekzistencë e personalitetit të tij.

Për këtë arsye, pjesa e djemve, sipas këtij sistemi, është më e madhe nga pjesa e të tjerëve, ndërkohë që pjesët që u takojnë baballarëve, nënave dhe pjesëtarëve të tjerë të afërm, janë të respektueshme dhe ia vlen të konsiderohen e të vlerësohen.

3- Me të vërtetë, ky legjislacion i nxit njerëzit të përpiqen e të punojnë sa më shumë në rrugën e shtimit të pasurisë dhe të

zhvillimit ekonomik. Kjo për faktin se, nëse njeriu e di më së miri se rezultati, munda dhe frytet e punës së tij gjatë gjithë jetës së tij do t'i kalojnë tek ata që i do dhe i respekton, ai do të nxitet të punojë dhe të derdhë mund e djuersë, sado që të jetë mosha e tij dhe sido që të jetë arsyeja dhe shkaqet e tij. Dhe për këtë, absolutisht nuk mund të ndodhë asnjë amulli apo depresion në veprimtarinë dhe në aktivitetin e tij.

Më parë thamë se si anulimi i ligjit të trashëgimisë në disa shtete, ku pasuritë e të vdekurve bëhen pronë e shtetit, çoi në ndikime negative në fushën ekonomike, u shfaq rënia e frikshme e ekonomisë, e cila e shtyu edhe një herë shtetin që ta rishikonte pezullimin e ligjit të trashëgimisë dhe heqjen e tij.

**4-** Me të vërtetë, ligji i trashëgimisë islame e ndalon grumbullimin e pasurisë, sepse ky rregull obligon që pasuria të ndahet brez pas brezi ndërmjet pjesëtarëve në një formë të rregullt e të drejtë. Kjo ndihmon që pasuria të ndahet dhe të shpërndahet në mënyrë të drejtë.

Vlen të interesohet se kjo ndarje nuk has probleme ashtu siç has probleme ndarja e pasurisë në botën sotme, e cila në përgjithësi është e shoqëruar me një seri dobësish dhe dhimbjesh shoqërore të këqija. Rregulli islam është rregulli i vetëm në llojin e vet, i cili përfshin të gjithë me mëshirën e tij dhe nuk i shkakton shqetësim asnjë personi.

**5-** Pjesët në trashëgiminë islame nuk janë sistemuar mbi bazën e një lidhjeje të veçantë farefisnore me të vdekurin, por mbi bazat e nevojës aktuale tek trashëgimtarët.

Ne vërejmë se djemtë e të vdekurit trashëgojnë dyfishin e asaj që trashëgojnë vajzat apo babai, në disa raste, të trashëgojë më shumë se nëna, sepse, sipas rregullit islam, përgjegjësia më e madhe financiare është te burrat. Ata duhet të shpenzojnë për

gratë e tyre dhe të mbajnë familjen dhe për këtë është e domosdoshme që pjesa e tyre në trashëgimi të jetë më e madhe se pjesa e femrave.

## 2- Çfarë do të thotë fjala *aul* dhe fjala *ta'sijb*?

Në librat që flasin për trashëgiminë qëndrojmë përpara dy kërkime, njëri me titullin "*El aul*" dhe tjetri me titullin "*Ta'sijb*". Të dyja këto raste shfaqen te çështja e trashëgimisë, kur pjesët e përmendura në ajetet e cituara, nganjëherë, mund të jenë më pak se lënia (trashëgimia) (*et terike*) dhe njëherë tjetër mund të jetë më shumë.

Për shembull: Nëse i vdekuri lë dy motra nga ana e babait dhe e nënës dhe lë edhe bashkëshorten, dy motrat trashëgojnë dy të tretat e pasurisë dhe bashkëshortja trashëgon gjysmën. Totali gjithsej është  $7/6$ , ku  $1/6$  është shtesë nga e gjithë pasuria. Këtu shtrohet pyetja: A ta pakësojmë një të gjashtën e tepërt nga të gjithë trashëgimtarët, sipas pjesës së tyre në një formë të drejtë apo duhet ta pakësojmë nga pjesa e disa personave të caktuar e të veçantë?

Tek dijetarët e Ehli Sunnetit është njohur se ata e fusin pakësimin te të gjithë pjesëtarët që trashëgojnë. Këtë ndarje juristët (fukahatë) e kanë quajtur *aulen*, sepse në gjuhësi kjo fjalë ka kuptimin e *ngritjes* dhe të *shtesës*.

Në këtë shembull, dijetarët e Ehli Sunnetit thonë: Një e gjashta ( $1/6$ ), që është shtesë, duhet të ndahet tek të gjithë pjesëtarët dhe të pakësojmë nga të gjithë pjesëtarët që trashëgojnë sipas pjesës që u takon.<sup>1</sup> Po kështu veprohet edhe në çështjet e tjera. Në të vërtetë, trashëgimtarët, këtu zbresin në shkallën e debitorëve, për të cilët pasuria

<sup>1</sup> Mënyra e llogaritjes këtu është se ne duhet të pakësojmë  $1/6$  nga pjesa e dy motrave e cila është  $4/6$  dhe nga pjesa e bashkëshortit që është  $3/6$ . Pra  $1/6$  ta ndajmë në 7 pjesë dhe nga pjesa e dy motrave pakësojmë 4 dhe nga bashkëshorti 3. E kjo sipas ligjit "pjesët me përqindje" e përmesur në matematikë. Atëherë rezultati është: nga pjesa e dy motrave pakësohet sasia e  $4/42$  dhe nga pjesa e bashkëshortit pakësohet sasia e  $3/42$

e falimentuesit nuk mjafton për shlyerjen e plotë të borxheve të tij ndaj tyre.

Nga këtu futet pakësimi te të gjithë debitorët me përqindje të përshtatshme me sasinë e borxheve të tyre.

Kurse dijetarët shi'ia kanë mendim tjetër për këtë fushë. Për shembull: Në rastin e mëparshëm, pakësimin e fusin vetëm për dy motrat dhe thonë, sikurse ka ardhur në hadith: "Me të vërtetë, Ai që numëron (di) grumbullin e rërës, sigurisht që e di se pjesët as nuk shtohen e as anojnë kah pakësimi. Prandaj, patjetër All'Ilahu i Lartësuar për këtë gjendje ka vënë ligje që sqarojnë se mes trashëgimtarëve, të cilët i përmend Kur'ani, ka prej atyre që kanë pjesë të caktuar të palëvizshme, të paktë ose të shumtë, sikurse është burri, gruaja, babai, nëna. Por ka edhe nga ata, pjesa e të cilëve është e lëvizshme, sikurse janë dy motrat dhe dy vajzat.

Nga këtu kuptojmë se pakësimi duhet gjithmonë të futet tek ata që nuk kanë pjesë të caktuar (pra, nuk kanë kufi të caktuar te e pakta e as te e shumta) pra, ata që përballen me ndryshimin. Për këtë, pakësimi nuk hyn në pjesën e bashkëshortit. Ai trashëgon pjesën e tij nga trashëgimia që është gjysma pa asnjë mangësi për shkak të *aulit*. Pakësimi hyn vetëm te pjesa e dy motrave. (medito thellë)

Ka raste që totali i pjesëve të jetë më pak se totali i pasurisë dhe mbetet një sasi pasurie edhe pas marrjes së secilit prej individëve të shtresës së trashëgimtarëve pjesën që i takon.

Për shembull: Nëse vdes një burrë dhe ka lënë një vajzë dhe nënën. Pjesa që i takon nënës është  $1/6$  dhe pjesa që i takon vajzës është  $3/6$  dhe totali gjithsej është  $4/6$ , pra, tepron  $2/6$  e pasurisë. Në këtë rast, dijetarët e sunni dhe juristët (fukahatë) e tyre thonë

që këtë tepricë të pasurisë t'i shpërndahet *isbetit*<sup>1</sup> të të vdekurit, që janë burrat e shtresës së dytë të trashëgimisë (vëllezërit) dhe e quajnë këtë ndarje sipas farefisit (ta'sijb).

Ndërsa juristët (fukahatë) e shi'ia thonë që kjo tepricë duhet që të shpërndahet ndërmjet trashëgimtarëve të përmendur. Sepse me praninë e shtresës paraardhëse (babai, nëna, bashkëshortja dhe fëmijët) nuk arrin radha te shtresa pasardhëse (vëllezërit).

Në shtesë të kësaj, dhënia e tepricës nga pasuria e burrave shtresës pasardhëse, i ngjason asaj çfarë ishte e përhapur në kohën e injorancës (para Islamit), ku gratë privoheshin dhe ndaloheshin të trashëgonin.

Ky hulumtim është prej hulumtimeve shkencore të ndërlikuara. Këtu përmendëm përmbledhje të qartë sipas nevojës. Detajet e kësaj çështjeje gjenden në librat e Jurisprudencës.

---

<sup>1</sup> Isbeti i të vdekurit janë meshkujt që kanë lidhje me të vdekurin pa ndërmjetësim, siç janë vëllezërit.

## Ajetet 15-16

وَالَّتِي يَأْتِيَنَّ الْفَحِشَةَ مِنْ نِسَائِكُمْ فَاسْتَشْهِدُوا عَلَيْهِنَّ أَرْبَعَةً  
مِّنْكُمْ فَإِنْ شَهِدُوا فَأَمْسِكُوهُنَّ فِي الْبُيُوتِ حَتَّىٰ يَتَوَفَّيَهُنَّ الْمَوْتُ أَوْ  
يَجْعَلَ اللَّهُ لَهُنَّ سَبِيلًا ﴿١٥﴾ وَالَّذَانِ يَأْتِيَنِهَا مِنْكُمْ فَأَازِوهُمَا فَإِنْ تَابَا  
وَأَصْلَحَا فَأَعْرِضُوا عَنْهُمَا إِنَّ اللَّهَ كَانَ تَوَّابًا رَّحِيمًا ﴿١٦﴾

“Për ato gra tuaja që bëjnë kurvëri, kërkoni që të dëshmojnë për këtë gjë katër vetë prej jush; nëse dëshmojnë për këtë gjë, i mbani ato në shtëpi derisa t’u vijë vdekja ose derisa All’llahu t’u japë atyre rrugëdalje tjetër.

Dhe ata të dy prej jush që kanë bërë këtë punë të turpshme, i ndëshkoni që të dy; e nëse pendohen dhe përmirësohen, ua hiqni dënimin. Se All’llahu e pranon pendimin dhe është Mëshirues.”

## Komentimi

### Dëshmia përmbi veprat e këqija

Fjala *el fahishetu* do të thotë *punë ose fjalë shumë e keqe*, siç e kemi përmendur edhe më parë. Është përdorur për kurvërinë, sepse është vepër shumë e keqe dhe e shëmtuar. Kjo fjalë ka ardhur 13 herë në Kur'anin Famëlartë, ku nga njëherë është përdorur për kurvërinë, herë të tjera për homoseksualitetin dhe njëherë tjetër është përdorur për veprat e shëmtuara në përgjithësi.

Ajeti 15, sikurse e kanë kuptuar shumica e komentuesve të Kur'anit, bën fjalë për ndëshkimin e gruas së martuar, e cila bën kurvëri. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Për ato gra tuaja që bëjnë kurvëri, kërkoni që të dëshmojnë për këtë gjë katër vetë prej jush; nëse dëshmojnë për këtë gjë, i mbani ato në shtëpi derisa t'u vijë vdekja..."**

Ky ajet tregon dhe ka për qëllim dhënien e dënimit për imoralitetin e gruas së martuar, sepse fraza *"për ato gra tuaja"* kupton bashkëshortet tuaja. Kjo frazë është përsëritur në disa vende në Kur'anin Famëlartë. Atëherë, në këtë ajet, ndëshkimi i gruas së martuar, që bën kurvëri, është mbyllje e përjetshme (burgim).

Më pas, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...ose derisa All'llahu t'u japë atyre rrugëdalje tjetër."** Pra, patjetër duhet të vazhdojë mbyllja e përjetshme që u takon, derisa atyre t'u vijë vdekja ose atyre t'u caktohet një ligj i ri nga ana e All'llahut të Lartësuar.

Nga kjo frazë ne kuptojmë se ky ligj (burgimi i përjetshëm për gruan e martuar që bën kurvëri) është një ligj i përkohshëm.

Për këtë, në fillim të çështjes përmendet se Ai do të zbresë

për të drejtën e tyre një ligj të ri dhe rregull tjetër në të ardhmen. Atëherë, gratë që i përfshin ky gjykim me burgim, sigurisht nëse ato janë gjallë, do të shpëtojnë nga ai ligj dhe nuk i përfshin një gjykim tjetër ndëshkues. Shpëtimi nga burgimi është vetëm për shkak të anulimit të gjykimit të mëparshëm.

Ndërsa mospërfshirja e tyre në gjykimin e ri është se gjykimi i ndëshkimit nuk përfshin veprat që janë bërë më përpara. Ky ligj dhe gjykim që do të vijë më pas, si do që të jetë, është shkak i shpëtimit për këto të burgosura. Sigurisht, ligji i ri do t'i përfshijë të gjitha ato që e bëjnë këtë vepër të shëmtuar më pas.

Ka mendime nga disa dijetarë se All'llahu e ka pasur një qëllim kur e ka thënë këtë frazë: **"...ose derisa All'llahu t'u japë atyre rrugëdalje tjetër..."** Ata mendojnë se dënimi që do u japë All'llahu i Lartësuar këtyre grave është gjuajtja me gurë (rexhmun). Ky mendim i tyre është i gabuar, sepse fraza **"t'u japë atyre rrugëdalje"** asnjëherë nuk përshtatet me çështjen e ekzekutimit, sepse fjala *atyre*, ka kuptimin e asaj që është më e dobishme për to dhe nuk është ekzekutimi shpëtim për ato. Gjykimi që ka vendosur All'llahu i Lartësuar në Islam për gratë e martuara, që bëjnë kurvëri, është ekzekutimi me gurë (er-rexhmu). (Ky gjykim përmendet në sunnetin e Profetit të bekuar, që janë thënie të sakta, edhe pse ky gjykim nuk përmendet në Kur'an).<sup>1</sup>

Nga të gjitha ato çka u thanë më lart sqarohet se ajeti kurrë nuk është abroguar, sepse abrogimi ndodh në rregulla dhe në ligje që janë të përhershme e të pakufizuara që në fillim të çështjes dhe nuk ndodh në ato që janë të kufizuara dhe të përkohshme.

Gjykimi i treguar në këtë ajet (burgimi i përhershëm në shtëpi) është prej pjesës së dytë. Pra, është ligj i kufizuar dhe i

<sup>1</sup> Biharul Anuar, vwll. 9, f. 69. Nehxhul Belaga, fjalimi 127.

përkohshëm. Në disa transmetime gjejmë se ky ajet është abroguar me rregullat që kanë ardhur për ndëshkimin e bërësve të këtyre veprave të shëmtuara. Qëllimi i tyre nuk është abrogimi terminologjik, sepse abrogimi në gjuhën e transmetimeve dhe të lajmërimeve është për çdo limitim dhe veçantim. (*mendo thellë*)

Më pas duhet patjetër vëmendja rreth një pike të rëndësishme, që është se rregulli i burgosjes së këtyre lloj grave në shtëpi. Nga njëra anë është në dobi të tyre, sepse ky lloj burgimi është shumë më i mirë se mbyllja e tyre në burgjet e njohura e të përgjithshme. Përvoja tregon se burgjet e përgjithshme kanë një ndikim të keq në shkatërrimin e shoqërisë, sepse këto qendra, pak e nga pak, shndërrohen në institucione të mëdha për të mësuar ngjyrat dhe llojet e ndryshme të krimit dhe të shkatërrimit, pasi kriminelët shkëmbejnë në këto institucione, gjatë kohës që ata rrinë, përvojën e tyre në kriminalistikë.

Pastaj All'llahu i Lartësuar tregon ndëshkimin e gruas dhe të burrit të pamartuar që bëjnë kurvëri (zina). Ai thotë: **“Dhe ata të dy prej jush që kanë bërë këtë punë të turpshme, i ndëshkoni që të dy; e nëse pendohen dhe përmirësohen, ua hiqni dënimin. Se All'llahu e pranon pendimin dhe është Mëshirues.”**

Ky ajet, edhe pse nuk e përcakton qartë kushtin e “mosmartesës”, por përderisa ka ardhur menjëherë pas përmendjes së rregullit të të martuarës dhe përmendjes së ndëshkimit të saj, që ndryshon nga ky ndëshkim, i cili është më i lehtë se ai i përmendur në ajetin e mëparshëm, kuptohet se ky ajet flet për kurvërinë e të pamartuarve.

Pra, ajeti përfshin ndëshkimin e burrit të pamartuar dhe të gruas së pamartuar që bëjnë kurvëri, të cilët nuk bëjnë pjesë në ajetin e mësipërm. Kështu që ajeti i mësipërm është i veçuar, me

argumentin që u tregua, për kurvërinë e gruas së martuar, kurse ky ajet qartëson rregullin e kurvërisë së gruas së pamartuar.

Duhet të themi se rregulli i përmendur në këtë ajet është një ndëshkim i përgjithshëm dhe ajeti i dytë në suren "En-Nur" përmend se ndëshkimi i kurvërisë është 100 goditje për gjithsecilin, lavirit dhe lavires. Ky ajet mund të jetë sqarues dhe komentues për këtë ajet dhe përcaktues i rregullit të përmendur në këtë ajet. Për këtë, ky ajet nuk mund të jetë i abroguar.

Në tefsirin "El Ajjashij" transmetohet nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) në komentimin e këtij ajeti: *"Ka kuptimin e të pamartuarave (bikr), të cilët, nëse bëjnë vepra të turpshme, që i bëjnë të martuarat, ndëshkojini të dy."*<sup>1</sup>

Bazuar mbi këtë, fjala *el-ledhani* - që të dy, edhe pse tregon për dyzorin mashkullor, përfshin edhe mashkullin edhe femrën.

Një grup komentuesish kanë thënë që ky gjykim në këtë ajet mund të jetë për homoseksualët, pederastët, si dhe e kanë konsideruar ajetin e mësipërm që ka ardhur në gjykimin e lesbikeve.

Nga përdorimi i përemrit në thënien *që e kanë bërë këtë punë*, i përdorur në ajetin e mëparshëm, shkon për *veprat e turpshme*, atëherë nga kjo përfitohet se ky rregull i prerë në këtë ajet është i domosdoshëm të veprohet.

Thënia se ky ajet ka ardhur për çështjen e homoseksualitetit dhe ajeti i mëposhtëm ka ardhur për çështjen e lesbicizmit bie ndesh me të dukshmen (edhe pse këto dy veprime, homoseksualiteti dhe lesbicizmi përfshihen në të njëjtën temë, dëshirë për një intimitet të paanueshëm), këto dy ajete kanë ardhur për gjykimin dhe ndëshkimin e kurvërisë.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Ajjashij", vëllimi 1, faqe 227.

Nga ana tjetër, ne e dimë se ndëshkimi i homoseksualitetit në Islam është dënimi me vdekje dhe nuk është ndëshkim goditja. Nuk ka asnjë argument që tregon se ky ajet është i abroguar.

All'Ilahu i Lartësuar, pasi përmend këtë rregull, flet për çështjen e faljes dhe të pendimit për të tillë gjynahqarë: **“...e nëse pendohen dhe përmirësohen, ua hiqni dënimin. Se All'Ilahu e pranon pendimin dhe është Mëshirues.”**

Në të vërtetë ky mësim i hap rrugën e kthimit këtyre gjynahqarëve. Është detyrë e shoqërisë islame që t'i pranojë këta persona nëse pendohen dhe kthehen në pastërti dhe në rrugën e drejtë. Nuk duhet të dëbohen nga shoqëria pas kësaj, me argumentin e prishjes e të devijimit.

Nga ky gjykim, gjithashtu, përfitohet se nuk duhet që këtyre gjynahqarëve t'u përmendet e kaluara, pasi janë kthyer në rrugën e drejtë dhe janë penduar për veprat e tyre të shëmtuara.

Meqenëse, për shkak të pendimit dhe kthimit, nuk u zbatua as rregulli i sheriatit dhe as ndëshkimi hyjnor për këta persona, atëherë është e pranueshme dhe e kërkuar që njerëzit të mos flasin për të shkuarën e tyre. Kjo është edhe për atë ndaj të cilit është zbatuar ligji i sheriatit dhe më pas pendohet. Atëherë është detyrë që myslimanët ta falin.

## Hulumtim

### Ndëshkimet e Islamit janë të lehta dhe parandaluese

Nganjëherë, disa mund të pyesin: Përse Islami ka vendosur dënime të rrepta, ligje të rënda e të ashpra ndëshkuese? Për shembull: Përse në fillim gjykon me burgim të përherëshëm të lavires, që është e martuar dhe pastaj ka vendosur ligjin e ekzekutimit të tyre? A nuk do të ishte më mirë që Islami të mbante një qëndrim më tolerant dhe të butë në drejtim të këtyre veprave, me qëllim balancimin e krimit dhe të mos anonte njëra më shumë se tjetra?

Pavarësisht se ndëshkimet islame duken, në pamje të parë, të vështira, të rrepta e të rënda, në të vërtetë, vërtetimi i krimit në Islam nuk është i lehtë. Po ashtu, Islami ka vendosur kufi, kushte dhe rregulla në përgjithësi që verifikojnë se kryerjen e krimit.

Për shembull: Në rastin e kurvërisë numri i dëshmitarëve duhet të jetë katër, sikurse ka ardhur në ajet. Kjo është prej çështjeve shumë të vështira që nuk vërtetohet vetëm nëse kriminelin është shumë trim në këtë rast.

Nuk ka dyshim se të tillë persona duhet të ndëshkohen me një ndëshkim të rreptë, që të marrin mësim edhe të tjerët dhe të pastrohet mjedisi shoqëror nga papastërtitë e shkatërrimit, të devijimet dhe të krimit.

Po ashtu, cilësitë dhe kushtet e dëshmitarëve në shikimin e procesit seksual me sytë e tyre, përputhja e dëshmisë së dëshmitarëve e të tjera çështje, e bëjnë shumë të vështirë verifikimin e këtij krimi.

Në këtë formë, Islami për këto ndëshkime të rënda e të vështira, njëkohësisht edhe të rrepta, ka paraqitur argumentimin me fakte për këto lloje krimesh. Verifikimi me imtësi i këtij krimi

dhe këmbëngulja në zbatimin e ndëshkimit bëhet që të mos zgjerohet rrethi i kësaj vepre të shëmtuar.

Konkluzioni i kësaj çështjeje është se mënyra islame në përcaktimin e ndëshkimit dhe rruga e vërtetimit të krimit është mënyra më ndikuese dhe më e suksesshme për shpëtimin e shoqërisë nga përfshirja në gjynahe dhe mëkate, ndërkohë që shumë persona nuk përballen me këtë ndëshkim. Dhe për këtë mund ta emërtojmë këtë mënyrë “e lehtë dhe ndaluese”.

## Ajeti 17-18

إِنَّمَا التَّوْبَةُ عَلَى اللَّهِ لِلَّذِينَ يَعْمَلُونَ السُّوءَ بِجَهْلَةٍ ثُمَّ يَتُوبُونَ مِنْ  
قَرِيبٍ فَأُولَٰئِكَ يَتُوبُ اللَّهُ عَلَيْهِمْ ۖ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١٧﴾  
وَلَيْسَتِ التَّوْبَةُ لِلَّذِينَ يَعْمَلُونَ السَّيِّئَاتِ حَتَّىٰ إِذَا حَضَرَ أَحَدَهُمُ  
الْمَوْتُ قَالَ إِنِّي تُبْتُ إِلَيْنَ وَلَا الَّذِينَ يَمُوتُونَ وَهُمْ كُفَّارٌ ۖ أُولَٰئِكَ  
أَعْتَدْنَا لَهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿١٨﴾

“All’lillahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre All’lillahu ua pranon pendimin. All’lillahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.

Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: “Unë tani me të vërtetë po pendohem.” As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm.”

## Komentimi

### Kushtet e pranimit të pendimit

Në ajetin e mëparshëm All'Ilahu i Lartësuar sqaroi qartë çështjen e mosndëshkimit për ata që bëjnë vepra të turpshme dhe veprën e shëmtuar të kurvërisë, nëse pendohen dhe përmirësohen. Këtë e përmend në fund të ajetit 16: **"...Se All'Ilahu e pranon pendimin dhe është Mëshirues."**

Në ajetet 17-18, All'Ilahu i Lartësuar, tregon kushtet e pranimit të pendimi: **"All'Ilahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria ..."**

Për të kuptuar më mirë këto ajete, duhet të dimë se ç'vlerë dhe ç'peshë ka fjala *el xhehaletu - padituria* në këto ajete. A ka kuptimin e padituriisë dhe të mosnjohjes së gjynahut apo ka kuptimin e mosnjohjes së ndikimeve të këqija dhe të mosnjohjes së fundit të dhembshëm të gjynaheve dhe mëkateve?

Fjala *xhehl* dhe ato që rrjedhin nga e njëjta rrënjë, edhe pse kanë kuptime të ndryshme, por bazuar edhe te argumentet, qëllimi i i përdorimit të kësaj fjale në këtë ajet është për tiraninë e egos dhe mbizotërimin e epshit të shfrenuar mbi zërin e logjikës dhe të besimit. Në këtë mënyrë, edhe nëse personi nuk e ka humbur dijen ndaj gjynahut, por kur bie nën ndikimin e instinktit të pakontrolluar, humbet rolin e dijes dhe ndikimin e saj. Mosndikimi i dijes është i barabartë me paditurinë në veprim.

Nëse mëkati nuk është nga injoranca dhe nga pavetëdija, por është nga mohimi i ligjit të All'Ilahut të Lartësuar dhe kokëfortësia dhe kundërshtimi, atëherë kryerja e këtij gjynahu çon në mohim (kufr) dhe për këtë arsye atij nuk i pranohet pendimi, vetëm me kusht që të heqë dorë nga kokëfortësia, mosbindja dhe kundërshtimi i tij.

Ky ajet qartëson po të njëjtën të vërtetë që e ka thënë Imam Sexhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) në duanë e Ebu Hamzës: "...Zoti im! Kur mëkatoj, nuk mëkatoj pse e mohoj zotësinë Tëndë, as pse e shpërfill urdhrin Tënd. Nuk mëkatoj nga mendjemadhësia përballë dënimit që vjen prej Teje dhe as nga shpërfillja e kërcënimit Tënd. Ky ishte një gabim i imi që u bë e kaloi. Dëshirat e mia ma shfaqën të bukur gabimin, epshtet më nënshtruan dhe fatkeqësia ime vetëm sa i ndihmoi më shumë..."<sup>1</sup>

Pastaj All'llahu i Lartësuar tregon një kusht tjetër prej kushteve të pranimit të pendimit: "**..dhe pendohen shpejt...**" Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme rreth qëllimit të fjalës *karijb*. Shumica e komentuesve kanë mendimin se kuptimi i kësaj është për pendimin para se të paraqiten shenjat e vdekjes dhe *agonia e saj*.

Këtë mendim ata e argumentojnë me fjalën e All'llahut të Lartësuar: "**Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja...**", ku pendimi nuk pranohet, nëse shfaqen shenjat e vdekjes. Ka mundësi që përdorimi i fjalës *karijb* është për arsye se fundi i kësaj jete, sado që duket i largët, është afër.

Por disa komentues e kanë shpjeguar fjalën *min karijb* me kohën e afërt, nga koha kur është kryer gjynahu. Kështu që kuptimi i saj është se duhet të pendohen menjëherë, sa më shpejt për gjynahet e mëkatet e kryera.

Të pendohen tek All'llahu i Lartësuar, sepse pendimi i plotë është ai që i pastron shenjat e krimit dhe i largon mbeturinat e tij, si nga shpirti, ashtu edhe nga trupi, derisa të mos mbesë asnjë shenjë e tij në zemër. Kjo arrihet vetëm nëse njeriu pendohet përpara se mëkati t'i shtrijë rrënjët në qenien e tij dhe të thellohen

<sup>1</sup> "Biharul Anuar", vëllimi 95, faqe 88.

shenjat e këtij mëkati në ndërgjegjen e tij, duke i dhënë njeriut një natyrë tjetër.

Jashtë kësaj mënyre, shenjat e mëkatit do të mbesin në të gjitha skajet e shpirtit të njeriut, duke ngritur folenë e tyre në qelizat e zemrës së tij. Atëherë, pendimi i plotë është ai pendim që ndodh menjëherë pas momentit që bëhet mëkati. Dhe fjala *karijb*, që do të thotë *afër*, është më e përshtatshmja me këtë kuptim nga ana gjuhësore dhe tradicionale.

Është e vërtetë se pendimi, që bëhet edhe pas një kohe të gjatë, sigurisht që pranohet, por nuk është pendim i plotë. Ndoshta përshtkrimi i fjalës “*ala All’llahi*” që do të thotë: “*All’llahu është Ai që pranon pendimin*”, gjithashtu, tregon për këtë kuptim, sepse i tillë, si ky përshtkrim, nuk ka ardhur në Kur’an vetëm në këtë ajet. Kuptimi i saj është se pranimi i pendimit të afërt nga koha e kryerjes së gjynahut është prej të drejtave të robve. Kurse pranimi i pendimit të largët nga koha e kryerjes së gjynahut është mirësi prej All’llahut.

Pastaj, pasi tregon kushtet e pendimit, All’llahu i Lartësuar thotë: “**...Pra, këtyre All’llahu ua pranon pendimin, All’llahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë**”, duke treguar për rezultatin e pendimit që bëhet sipas kushteve të lartpërmendura.

Pastaj All’llahu i Lartësuar urdhëron: “**Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: “Unë tani me të vërtetë pendohe.” As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë...**” Ky ajet tregon për ata që nuk u pranohet pendimi.

Shkaku i mospranimit të këtij lloji pendimi është i qartë, sepse në momentin e vdekjes, njeriut i largohen perdet dhe shikon ato që nuk i shihte më parë. Pas largimit të perdes nga shikimi i tij, ai shikon disa të vërteta në lidhje me Botën Tjetër dhe shikon me

sytë e tij rezultatin e veprave që ka bërë në këtë botë. Dhe çështjet të cilat ai i ka dëgjuar bëhen të prekshme.

Në këtë gjendje është e natyrshme që çdo kriminel pendohet për veprat e këqija që ka vepruar dhe mundohet që të largohet prej tyre si ai që vrapon kur sheh se flakët e zjarrit po ia prekin trupin.

Por është e pranueshme se obligimet dhe sprovat hyjnore për njerëzimin nuk bazohen mbi këto lloje zbulimesh dhe shikimesh, por mbi bazat e besimit në *gajb* në të fshehtën dhe në shikimin e syrit të mendjes dhe të zemrës.

Për këtë, në Kur'anin Famëlartë lexojmë se dyert e pendimit ishin të mbyllura për disa popuj zullumqarë e gjynahqarë në momentin që i është paraqitur ndëshkimi në këtë botë. Si shembull po përmendim fjalën e All'Ilahut të Lartësuar për Faraonin: **"Ne i mbartëm izraelitët përtej detit dhe Faraoni me ushtrinë e tij i ndoqi ata nga ligësia dhe armiqësia. Por, kur po mbytej, (Faraoni) tha: "Besoj se s'ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit; dhe unë jam ndër myslimanët."** "Vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar...?!"<sup>1</sup>

Edhe në disa ajete të tjera kur'anore (për shembull në suren "Sexhde", ajeti 12), lexojmë se gjynahqarët pendohen kur shohin ndëshkimin hyjnor në Botën Tjetër. Por ky pendim nuk ka asnjë dobi për ta në këto momente. Ata persona i ngjajnë kriminelëve që, kur e shohin vendvarjen dhe e ndiejnë litarin në qafat e tyre, pendohen për krimet dhe veprat e tyre të shëmtuara.

Është e qartë se ky lloj pendimi nuk quhet as mirësi, as krenari e as përsosmëri. Kështu që ai pendim nuk ka asnjë ndikim. Ky ajet nuk bie në kundërshtim me transmetimet që tregojnë për mundësinë e pranimit të pendimit deri në momentin e fundit të

---

<sup>1</sup> Sure "Junus", ajetet 90-91.

kësaj jete,<sup>1</sup> sepse qëllimi i këtyre transmetimeve është për momentet e fundit në të cilat nuk janë shfaqur akoma shenjat e vdekjes. Thënë ndryshe: Personit nuk i paraqitet bota e berzahut, të cilat i shfaqin të vërtetën e Botës Tjetër.

Kjo është për grupin e parë, të cilëve nuk u pranohet pendimi kur pendohen në kohën kur u paraqiten përpara syve shenjat e vdekjes dhe duken ndikimet e saj.

Kurse grupi i dytë, të cilëve nuk u pranohet pendimi janë ata që vdesin jobesimtarë, siç thotë All'llahu i Lartësuar: **“As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë.”**

All'llahu i Lartësuar përmend këtë të vërtetë në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë.<sup>2</sup>

Këtu shtrohet pyetja: Kur nuk i pranohet pendimi atyre që vdesin jobesimtarë?

Disa kanë supozuar se pse nuk u pranohet pendimi në Botën Tjetër. Disa të tjerë kanë supozuar se qëllimi i pendimit në këtë pozicion nuk është për pendimin e robve, por për pendimin ndaj All'llahut, që do të thotë falja e mëshira e Tij për të.

Por në pamje të parë, ky ajet ka për qëllim një çështje tjetër, ku thotë se me të vërtetë ata që pendohen nga mëkatet e tyre në gjendjen e faljes dhe të besimit, por vdesin jobesimtarë, nuk u pranohet pendimi dhe ai pendim nuk ka asnjë dobi.

Qartësimi i kësaj: Ne e dimë se prej kushteve të pranimit të veprave është që njeriu të vdesë besimtar.

Ata që vdesin jobesimtarë nuk u pranohen punët, qofshin edhe të mira, sipas thënies së Kur'anit.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> “Uesailu Shijja”, vëllimi 16, faqe 86.

<sup>2</sup> Sure “Al-Imran”, ajeti 91; sure “El-Bekare”, ajeti 161; sure “El-Bekare”, ajeti 217; sure “Muhammed”, ajeti 34.

<sup>3</sup> Sure “El-Bekare”, ajeti 217.

Si përfundim, themi se pendimi pranohet me dy kushte:

**I pari:** Pendimi të bëhet përpara se njeriu të shohë shenjat e vdekjes.

**I dyti:** Të vdesë e të jetë besimtar.

Nga ky ajet, gjithashtu, përfitohet se njeriu nuk duhet ta vonojë pendimin e tij, sepse është e mundur që t'i vijë vdekja papritur dhe t'i mbyllet porta e pendimit dhe nuk arrin të pendohet. All'illahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet duke thënë: **"...për këta Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm."**

Nuk është nevoja që të përmendim se për pendimin, në shtesë të asaj që u tha, ka kushte të tjera që përmenden në ajete të tjera të ngjashme në Kur'an.

## Ajeti 19

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَحِلُّ لَكُمْ أَنْ تَرِثُوا النِّسَاءَ كَرْهًا وَلَا تَعْضُلُوهُنَّ  
لِتَذْهَبُوا بِبَعْضِ مَآءَاتِيْمُوهُنَّ إِلَّا أَنْ يَأْتِيَنَّ بِفَحِشَةٍ مُبَيِّنَةٍ وَعَاشِرُوهُنَّ  
بِالْمَعْرُوفِ فَإِنْ كَرِهْتُمُوهُنَّ فَعَسَى أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَجَعَلَ اللَّهُ فِيهِ خَيْرًا

كَثِيرًا ﴿١٩﴾

**“O besimtarë! - nuk ju lejohet të bëheni përdhunisht trashëgimtarë të grave dhe mos i pengoni ato me qëllim që t’ua merrni një pjesë nga dhuratat që ua keni dhënë, përveç nëse bëjnë gabime sheshazi. Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duronit!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që All’lillahu në atë do t’ju sjellë shumë të mira.”**

### Shkaku i zbritjes

Është transmetuar në tefsirin “Mexhmaul Bejjan”, nga Imam Muhammed Bakiri (Paqja qoftë mbi të!): “Ky ajet ka zbritur për burrin që e burgos (mbyll) gruan, dhe nuk e trajton si bashkëshorte, në shtëpinë e tij pa pasur nevojë për të derisa asaj t’i vijë vdekja për të trashëguar pasurinë e saj.”<sup>1</sup>

Transmetohet nga Ibn Abasi se ky ajet ka zbritur për ata që u japin grave dhuratë të madhe martese (mehrin), pastaj i mbyllin në shtëpi pa pasur nevojë për to.

<sup>1</sup> Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, komentimi i këtij ajeti. Tefsiri “Ruhul Meanijj”, vëllimi 4, faqe 241.

Ata nuk i divorcojnë ato për shkak se prika që u kanë dhënë është e madhe dhe e rëndë. I keqtrajtojnë ato derisa të pranojnë divorcin, pasi heqin dorë nga dhurata që u është dhënë.<sup>1</sup>

Një grup komentuesish kanë transmetuar një shkak tjetër të zbritjes së këtij ajeti, i cili nuk përshtatet me këtë ajet, por përshtatet me ajetin 22 të kësaj sureje. Në komentimin e këtij ajeti (22) do ta përmendim mendimin e tyre me lejen e All'llahut.

## Komentimi

### Mbrojtja e të drejtave të grave

Në fillim të komentimit të kësaj sureje thamë se ajetet e kësaj sureje kanë si qëllim luftimin e shumë veprave të padrejta e të pandershme, që kanë qenë të përhapura në kohën e injorancës (para Islamit). Edhe ajeti në fjalë tregon për disa zakone të errëta në kohën e injorancës dhe All'llahu i Lartësuar i paralajmëron myslimanët që të mos përzihen në to duke u thënë:

**1- Mos i mbyllni gratë për arsye që të trashëgoni pasurinë e tyre.** Ky ka qenë një prej zakoneve çnjerëzore në kohën e injorancës. Sikurse e shpjeguam edhe në shkakun e zbritjes së këtij ajeti, burrat martoheshin me gra të pasura dhe që kanë pozitë të lartë në shoqëri dhe ishin të fisshme, por nuk i ishin të bukura.

Pas martesës, burrat as nuk bashkëpunonin me to si bashkëshortë dhe as nuk i divorconin. Ata prisnin që të ato gra të vdisnin dhe të trashëgonin pasurinë e tyre. Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar thotë: **"O besimtarë! - nuk ju lejohet të bëheni përdhunisht trashëgimtarë të grave..."** Me këtë thënie të ajetit Islami e mohoi këtë zakon të keq.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mekhmaul Bejjan", komentimi i këtij ajeti.

**2- Mos u bëni presion grave tuaja, që t'ua japin juve dhuratën e tyre (mehrini).** Gjithashtu, prej zakoneve të errëta e barbare në kohën e injorancës ishte se ata u bënë presion grave me të gjitha mënyrat dhe mjetet që ato të hiqnin dorë nga dhurata e martesës (mehri) dhe të pranonin divorcin.

Ky zakon zbatohej kur dhuratat ishin të mëdha e të shtrenjta. Ky ajet e ka ndaluar këtë vepër: **“...dhe mos i pengoni ato me qëllim që t'ua merrni një pjesë nga dhuratat që ua keni dhënë ...”**, pra bëhet fjalë për dhuratën e martesës (mehrini).

Por në këtë ajet është një përjashtim për këtë rregull që përmendet: **“...përveç nëse bëjnë gabime sheshazi...”** Paturpësia (*el fahsha*) është kur gruaja bën kurvëri dhe tradhton bashkëshortin e vet. Në këtë rast burrit i lejohet të bëjë presion mbi gruan që ajo të heqë dorë nga dhurata e saj (*mehri*) dhe t'ia japë atij dhe ai ta divorcojë. Në të vërtetë, ky është një lloj ndëshkimi. Kjo është e ngjashme me gjobitjen si pasojë e asaj që kryejnë këto gra.

A është qëllimi i fjalës *el fahishetu*, në këtë ajet për *kurvërinë* apo për çdo lloj vepre e sjelljeje mosbindjeje ndaj bashkëshortit? Mes komentuesve të Kur'anit ka mendime rreth kësaj çështjeje. Në një hadith, të transmetuar nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), përcillet qartë se është për çdo mëkat të bashkëshortes.<sup>1</sup> (Sigurisht përjashton gjynahet e lehta për shkak të mosfutjes në konceptin e paturpësisë, që tregon për rrezikshmërinë e mëkatit, e cila vërtetohet me fjalën sheshazi *mubejjineh*).

**3- Jetoni me to (bashkëshortet) një jetë të drejtë.** Kjo është ajo që i porositi All'Ilahu i Lartësuar bashkëshortët në këtë ajet:

<sup>1</sup> Tefsiri “Nurul Thekalejn”, vëllimi 1, faqe 459. Tefsiri “Durrul Menthur”, vëllimi 2, faqe 132.

**"...jetoni e silluni mirë me to..."**, që do të thotë jetoni me to një jetë të njerëzishme, e cila i përshtatet femrës dhe bashkëshortes.

Pastaj ajeti vazhdon: **"Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duroni!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t'ju sjellë shumë të mira."** Edhe nëse nuk jeni plotësisht të kënaqur nga gratë dhe i urreni ato për disa arsye, mos nxitoni të ndaheni e të divorcoheni prej tyre. Por është detyra juaj që të silleni mirë me to, sepse ka mundësi që të keni gabuar ndaj tyre dhe, atë që e urryet, All'llahu t'ua bëjë mirësi të shumtë.

Për këtë duhet të silleni mirë me to, përderisa çështja nuk ka arritur deri në atë cak sa nuk përballet. Shumica e dyshimeve mes bashkëshortëve janë të pabaza dhe vendimet që marrin nuk bazohen në realitet. Ka raste kur ata të mirën e shohin të keqe dhe të keqen të mirë, deri në kohën që u zbulohet e vërteta e çështjes.

Është e nevojshme të përmendet se "mirësia e madhe" që thuhet në këtë ajet, e cila i përgëzon bashkëshortët që të sillen mirë me gratë e tyre ka kuptim të gjerë.

Prej vërtetësive të qarta të kësaj thënieje janë fëmijët punëmirë e të respektuar.

## Ajetet 20-21

وَإِنْ أَرَدْتُمْ اسْتِبْدَالَ زَوْجٍ مَّكَانَ زَوْجٍ وَآتَيْتُمْ إِحْدَاهُنَّ قِنْطَارًا فَلَا تَأْخُذُوا مِنْهُ شَيْئًا ۚ أَتَأْخُذُونَهُ بِهْتَانٍ وَإِثْمٍ مُّبِينٍ ﴿٢٠﴾ وَكَيْفَ تَأْخُذُونَهُ وَقَدْ أَفْضَىٰ بَعْضُكُم إِلَىٰ بَعْضٍ وَأَخَذَ مِنْكُمْ مِيثَاقًا غَلِيظًا ﴿٢١﴾

“Në qoftë se dëshironi të ndërroni grua, duke e lëshuar njërën për të marrë tjetrën, asaj që i keni dhënë pasuri, mos i merrni nga ajo (pasuri) asgjë. A do ta merrnit atë padrejtësisht, duke bërë gjynah të qartë?! Si do t’ia merrnit atë dhuratë, kur ju i jeni dhënë njëri-tjetrit dhe kur ato kanë marrë nga ju besë të fortë?”

### Shkaku i zbritjes

Përpara Islamit ka qenë zakoni se, nëse burri donte ta ndante gruan e tij dhe martohet me një grua tjetër, e akuzonte gruan e parë për kurvëri dhe tradhti bashkëshortore, me qëllim që të mos paguante dhuratën (mehri) e saj; ose qëllimisht sillej ashpër ndaj saj, që ajo t’ia kthente mehrin që kishte marrë më parë nga burri. Burri, këtë mehr ia jepte gruas së re që dëshironte të martohet me të.

Atëherë, zbriti ky ajet, që mohon këtë vepër të shëmtuar shtazarake dhe çnjerëzore dhe bën thirrje në drejtësi ndaj grave dhe të mos u bëhet padrejtësi në dhuratat e tyre.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Tefsiri “Safijj”, vëllimi 1, faqe 434. Tefsiri “Ruhul Meanijj”, vëllimi 4, faqe 243.

## Komentimi

Këto dy ajete kanë zbritur për të ruajtur pjesën tjetër të të drejtave të grave. Ajeti i parë thotë: **"Në qoftë se dëshironi të ndërroni grua, duke e lëshuar njërën për të marrë tjetrën, asaj që i keni dhënë pasuri, mos i merrni nga ajo (pasuri) asgjë..."**

Ky ajet i lajmëron myslimanët se, nëse vendosin që të ndajnë bashkëshorten e vet dhe të zgjedhin bashkëshorte tjetër, ata nuk kanë të drejtë që t'ua pakësojnë (ulin) mehrin gruas së parë dhe as të kërkojnë që t'u kthehet një pjesë e mehrit të dhënë bashkëshortes më parë, sado që të jetë sasia dhe vlera e tij, i cili në këtë ajet është shprehur me fjalën *kintar*. Fjala *kintar*, siç u cek edhe më parë, do të thotë pasuri e madhe.<sup>1</sup>

Këtu divorcimi i gruas së parë kryhet për interes të burrit dhe nuk bëhet për shkak të sjelljes së keqe të gruas nga rruga e nderit dhe e pastërtisë. Për këtë nuk ka kuptim neglizhimi i të drejtave të saj.

Në pjesën e fundit, ajeti tregon për një metodë të përhapur në kohën e injorancës, ku burri e akuzonte gruan e tij për tradhti bashkëshortore, për të bllokuar dhuratën e saj.

All'llahu i Lartësuar në formë pyetësi mohues thotë: **"...A do ta merrnit atë padrejtësisht, duke bërë gjynah të qartë?!"** Ky ajet përcjell pyetjen se a do t'ia merrni dhuratën atyre nëpërmjet akuzimit të tyre për kurvëri?

Por ky veprim është një mëkat i qartë dhe haptazi. Sigurisht parimi i bllokimit të dhuratës së gruas është një padrejtësi dhe gjynah i madh. Përdorimi i këtyre mënyrave mëkatore është një tjetër mëkat i qartë dhe padrejtësi e madhe.

---

<sup>1</sup> Për sqarime të mëtejshme shiko komentimin e ajetit 15 të sures "Al Imran".

Më pas, në ajetin tjetër, All'llahu i Lartësuar vazhdon në brendësi të kësaj pyetjeje mohuese, me qëllim që t'i lëvizti ndjenjat e brendshme njerëzore tek burrat, duke u thënë: Si keni të drejtë të veproni kështu, ndërkohë që jetuat një kohë të gjatë me bashkëshorten e parë dhe ka qenë partnerja juaj në jetë?! Keni gëzuar njëri-tjetrin duke qenë një shpirt i vetëm në dy trupa. Pas kësaj lidhjeje të fortë e të ngrohtë bashkëshortore që kishit mes jush a keni të drejtë ju, o bashkëshortë, t'ia pakësoni mehrin gruas së parë?! All'llahu i Lartësuar e ka përmbledhur në një ajet këtë gjë: **“Si do t’ia merrnit atë dhuratë, kur ju i jeni dhënë<sup>1</sup> njëri-tjetrit?”** A u lejohet ta bëni këtë vepër sikurse ju të dy të ishit të huaj?

Kjo është e ngjashme me dy shokë të dashur, që kanë jetuar një kohë të gjatë dhe më pas janë zënë. Dhe si po zihen ndërveti ndërkohë që ju keni qenë shokë të ngushtë e të dashur për shumë vite?

Në të vërtetë, bërja e kësaj vepre ndaj gruas suaj, partneres së jetës, nuk është gjë tjetër veçse një padrejtësi ndaj vetvetes.

Pastaj All'llahu i Lartësuar vazhdon: **“...dhe kur ato kanë marrë nga ju besë të fortë...”**. Pra, si është e mundur që t'ia pakësoni e t'ia merrni mehrin bashkëshortes, ndërkohë që në lidhjen e kurorës ato morën besën dhe premtimin prej jush se do t'ua jepnit atyre të drejtat e plota që u takojnë? Si mund ta mohoni këtë premtim të shenjtë, kur ky premtim është dhënë prej jush kur keni bërë marrëveshjen e kurorëzimit?

---

<sup>1</sup> Rrënja e fjalës *el ifda* është *el fadaa* që do të thotë hapësirë, zgjerim. Kështu që kuptimi i fjalës *el ifda* është gjetja e hapësirës, sepse njeriu për shkak të bashkimit dhe jetesës me një njeri-tjetër e zgjeron rrethin e tij. Për këtë, fjala *el ifda* është përdorur me kutimin e prekjes dhe të kontaktit.

Duhet të theksojmë se ky ajet edhe nëse ka ardhur për rastin e divorcimit të gruas së parë për t'u lejuar të martohet me gruan e dytë, ai nuk ka vetëm këtë qëllim, por përfshin çdo lloj tjetër divorci, që mund të parashtrohet nga bashkëshorti, ndërkohë që gruaja nuk ka aspak dëshirë për t'u divorcuar. Në këtë rast, burri duhet t'i japë gruas të gjithë dhuratën që i takon, nëse ai dëshiron që ta divorcojë atë dhe të mos kërkojë asgjë prej mehrit, nëse ia ka dhënë asaj, edhe nëse ka për qëllim që të martohet me një grua tjetër apo jo.

Për këtë, thënia: **"Në qoftë se dëshironi të ndërroni grua..."** tregon për zakonin e përhapur në kohën e injorancës. Po ashtu, duhet përmendur se fjala *istibdal* do të thotë *të kërkosësh zëvendësim*. Dhe për këtë ajo merr në të kushtin e dëshirës. Kur është e shoqëruar me fjalën *ered'tum* që do të thotë *dëshironi*, është vetëm për të tërhequr vëmendjen në këtë pikë, se, nëse përgatiteni të ndërroni gruan me një tjetër, është obligim që të mos e filloni këtë zëvendësim nga hapat e paligjshëm e të padrejtë, duke ua marrë mehrin bashkëshorteve tuaja.

## Ajeti 22

وَلَا تَنْكِحُوا مَا نَكَحَ آبَاؤُكُمْ مِنَ النِّسَاءِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ إِنَّهُ

كَانَ فَحِشَةً وَمَقْتًا وَسَاءَ سَبِيلًا ﴿٢٢﴾

**“Mos i merrni ato gra që kanë qenë gratë e baballarëve tuaj, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar vërtet. Kjo është paturpësi dhe rrugë e shëmtuar.”**

### Shkaku i zbritjes

Në kohën e injorancës ka qenë zakon se, nëse vdiste burri dhe lë pas grua dhe fëmijë dhe ka pasur fëmijë me grua tjetër, trashëgimtarët e tij trashëgonin gruan e babait të tyre sikurse trashëgonin pasurinë e tij. Ata kishin të drejtë të martoheshin me të ose ta martonin me dikë tjetër.

Po ashtu, kishin të drejtë të silleshin me të njësoj sikurse silleshin me pasurinë e tij. I tillë veprim ka ndodhur me njërin prej myslimanëve edhe pas shfaqjes së Islamit. Një mysliman prej ensarëve, Ebu Kajs, ndërroi jetë dhe la gruan dhe një djalë nga gruaja tjetër. Djali i propozoi asaj të martoheshin. Gruaja i është përgjigjur: “Unë të konsideroj si fëmijën tim dhe ti je prej të sinqertëve të popullit tënd.”

Ajo shkoi te i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për ta pyetur dhe për t’u sqaruar rreth këtij rregulli. I Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka thënë:

*"Kthehu në shtëpinë tënde."* Atëherë All'llahu i Lartësuar zbriti këtë ajet, i cili e ndalon rreptësisht këtë lloj martese.<sup>1</sup>

## Komentimi

Ky ajet, sikurse përmendëm në shkakun e zbritjes, ka zbritur për të ndaluar një zakon të keq prej zakoneve të injorancës. Ai thotë: **"Mos i merrni ato gra që kanë qenë gratë e baballarëve tuaj..."**, që do të thotë, mos u martoni me gratë e baballarëve tuaj. Por meqenëse ligji nuk i përfshin rastet e kaluara, përpara se të zbriste ligji i ndalimit, All'llahu i Lartësuar më pas thotë: **"...përveç rasteve që tashmë kanë kaluar..."**

Në vijim, All'llahu i Lartësuar, për ta vërtetuar dhe për ta përforcuar këtë ndalim, përdor tri fraza të rrepta rreth kësaj lloj martese: **"...vërtetë kjo është paturpësi..."** Pastaj shton e thotë: **"e ndyrë"**, një vepër që nuk e pranon logjika e shëndoshë dhe natyra e pastër njerëzore, por e urren dhe e përbuz atë. Dhe e mbyll këtë ajet me thënien: **"...dhe rrugë e shëmtuar"**, pra, ky është një zakon i ndyrë, sjellje e egër dhe diskriminuese.

Në historinë e kohës së injorancës lexojmë se ka pasur njerëz që e urrenin këtë lloj martese dhe e kanë cilësuar neveritëse dhe fëmijët, që lindnin prej kësaj martese, i kanë quajtur si fëmijë të përbuzur e neveritës.

Është e qartë se ky ligj ka dobi të shumta dhe urtësi të ndryshme. Martesa me gruan e babait, nga njëra anë, është e ngjashme me martesën me nënën, sepse gruaja e babait është në vendin e nënës së dytë. Dhe nga ana tjetër, është përdhosje dhe injorim ndaj babait dhe mosrespektim i nderit të tij.

---

<sup>1</sup> Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", komentimi i këtij ajeti.

Përveç kësaj, kjo vepër mbjell te fëmijët e babit të vdekur farën e hipokrizisë, për shkak të mosmarrëveshjes rreth martesës së gruas së tij, se cili prej tyre do të martohet me të.

Nuk është e largët që këto tri fjali të përmendura në këtë ajet, të cilat përbuzin këtë lloj martese, të tregojnë për këto urtësi të ndalimit të martesës së gruas së babait.

## Ajeti 23

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمْ أُمَّهَاتُكُمْ وَبَنَاتُكُمْ وَأَخَوَاتُكُمْ وَعَمَّاتُكُمْ وَخَالَاتُكُمْ  
وَبَنَاتُ الْأَخِ وَبَنَاتُ الْأُخْتِ وَأُمَّهَاتُكُمُ اللَّاتِي أَرْضَعْنَكُمْ وَأَخَوَاتُكُمُ  
مِّنَ الرَّضَاعَةِ وَأُمَّهَاتُ نِسَائِكُمْ وَرَبِّبُكُمُ اللَّاتِي فِي حُجُورِكُم مِّن  
نِّسَائِكُمُ اللَّاتِي دَخَلْتُم بِهِنَّ فَإِن لَّمْ تَكُونُوا دَخَلْتُم بِهِنَّ فَلَا جُنَاحَ  
عَلَيْكُمْ وَحَلَائِلُ أَبْنَائِكُمُ الَّذِينَ مِّنْ أَصْلَابِكُمْ وَأَن تَجْمَعُوا بَيْنَ  
الْأُخْتَيْنِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿٢٣﴾

**“Ju ndalohet martesë me nënat tuaja, me bijat tuaja, me motrat tuaja, me hallat tuaja, me tezet tuaja, me bijat e vëllezërve dhe bijat e motrave, me nënat (gratë) që ju kanë dhënë gjë, me motrat tuaja, që kanë thithur prej një gjë, me nënat e grave tuaja, me vajzën e gruas suaj që gjendet nën kujdestarinë tuaj, nëse me atë grua keni pasur marrëdhënie bashkëshortore; e, nëse nuk keni pasur marrëdhënie bashkëshortore, atëherë nuk ka pengesa. Ju ndalohet martesë me gratë e bijve tuaj dhe t’i bashkoni dy motra, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar. Pa dyshim, All’lillahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**

## Komentimi

### Ndalimi i martesës me meharim<sup>1</sup>

Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar ka treguar gratë me të cilat është e ndaluar martesë. Kjo ndalesë mund të jetë për tre arsye:

- 1- Lindja, e cila konsiderohet lidhja gjenetike.
- 2- Martesa, e cila konsiderohet lidhja me arsye.
- 3- Gjdhënia, e cila konsiderohet lidhja me anë të thithjes së gjirit.

Në fillim ajeti tregon për gratë ku ndalohet martesë me to, për shkak të lidhjes gjenetike. Ato gra janë shtatë grupe. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ju ndalohet martesë me nënat tuaja, me bijat tuaja, me motrat tuaja, me hallat tuaja, me tezet tuaja, me bijat e vëllezërve dhe bijat e motrave...”**

Duhet pasur parasysh se me fjalën *el ummu - nënë* nuk kuptohet vetëm ajo që lind njeriun. Kjo fjalë përfshin gjyshet dhe stërgjyshet nga ana e babait dhe nga ana e nënës. Po ashtu, fjala *el bintu - vajza* nuk ka qëllim vetëm vajzën e drejtpërsëdrejti, por përfshin edhe vajzën e vajzës, vajzën e djalit, vajzën e vajzës së djalit apo të vajzës... Kështu vazhdon edhe për pesë grupet e tjera.

Është e qartë se njeriu e urren martesën me këtë grup femrash. Kjo është arsyeja që e ndalojnë të gjithë popujt dhe shoqëritë (shumë rrallë mund të gjendet dhe mund të ndodhë kjo lloj martesë).

Deri edhe adhuresit e zjarrit, të cilët e kanë pasur të lejuar këtë lloj martesë, sot ata e urrejnë dhe e ndalojnë. Për më tepër,

<sup>1</sup> Meharam janë ato femrave që përmendet në ajetin në fjalë me të cilat është e ndaluar rreptësisht martesë me to. (shënim i përkthyesit)

edhe sot është vërtetuar se martesë ndërmjet personave që kanë gjak të njëjtë shkakton rreziqe të mëdha dhe çon në përhapjen e sëmundjeve të fshehta, trashëguese e ripërtëritëse, deri në atë masë sa disa nuk e pëlqejnë martesën me të afërmit, siç është martesë mes fëmijëve të xhaxhallarëve,<sup>1</sup> sepse mendojnë se edhe kjo martesë çon në përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme të trashëguara. Por kjo lloj martesë, nëse nuk shkakton asnjë problem tek të afërmit e largët, siç ndodh zakonisht, s'ka dyshim se shkakton rrezik të madh të të afërmit e afërt, të cilët kanë gjak të njëjtë.

Përveç kësaj, në disa raste, martesë me meharim shkakton dobësim të dëshirës seksuale, sepse meharim, në përgjithësi, rriten bashkë e rinohe me njëri-tjetrin. Për këtë, martesë mes tyre nuk është diçka e papritur dhe nuk mund të cilësohet lidhje e re, sepse ata kanë qenë mësuar me njëri-tjetrin. Kështu që askush prej atyre nuk është i ri për tjetrin. Marrëdhëniet e tyre janë të zakonshme. Por disa raste të rralla nuk mund të jenë shkak i heqjes së ligjeve të përgjithshme, kundërshtimi a kritikimi i tyre.

Ne e dimë se tërheqja seksuale është kusht kryesor për vazhdimësinë e marrëdhënieve bashkëshortore dhe i lidhjes familjare. Për këtë, nëse kryhet martesë ndërmjet meharimit, atëherë lidhja bashkëshortore e lindur nga kjo martesë do të jetë e dobët, e lëkundshme dhe jetëshkurtër.

Pastaj All'illahu i Lartësuar thotë: **"...me nënat (gratë) që ju kanë dhënë gjë, me motrat tuaja që kanë thithur prej një gjiri..."**

---

<sup>1</sup> Sigurisht, Islami nuk e ndalon martesën mes fëmijëve të xhaxhallarëve, sepse kjo lloj martesë nuk është si martesë me lidhje gjenetike, përse i përket rrezikshmërisë dhe se shfaqja e fenomeneve të rrezikshme në këtë lloj martesë është më e pakët. Ne i kemi vënë re vetë shembujt e kësaj lloj martesë dhe rezultatet e saj, ku fëmijët e kësaj martesë janë më të shëndetshëm dhe më të mirë mendërisht, kanë dhunti.

Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar tregon të ndaluarat me anë të gjidhënies.

Kur'ani ka treguar dy llojet e kësaj ndalese prej gjirit, që janë nëna prej gjirit dhe motra prej gjirit, por ndalesa e martesës për shkak të gjidhënies, sikurse përfitohet nga transmetimet e shumta, nuk kufizohet në atë çfarë përmendet në këtë ajet. Por, për shkak të gjidhënies ndalohet edhe ato që ndalohen për shkak të lidhjes gjenetike. Këtë e tregon edhe hadithi i njohur, që transmetohet nga i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Ndalohet nga gjidhënia ajo që ndalohet nga gjenetika.”<sup>1</sup>

Sasia e gjidhënies që shkakton ndalimin, kushtet e gjidhënies së konsiderueshme e të tjera rregulla të posaçme rreth kësaj çështjeje janë të sqaruar në librat e jurisprudencës. Filozofia e ndalimit të martesës me të afërm për shkak të gjidhënies është se rritja dhe zhvillimi i trupit dhe i kockave të thithësit të gjirit nga qumështi i një gruaje të caktuar e bën që ky pirës nga gjiri i saj të jetë si fëmija e vet i vërtetë. Kjo grua i jep për të pirë një fëmijë nga gjiri i saj një sasi të caktuar qumështi dhe nga ky qumësht rritet e forcohet trupi dhe kocka e fëmijës. Kjo lloj gjidhënieje e bën këtë fëmijë të ngjashëm me fëmijët e saj, ku të gjithë pinë nga trupi i saj, ku të gjithë si ata prej gjiri dhe ata prej nënës e babës janë vëllezër e motra.

Pastaj, në pjesën e fundit, All'llahu i Lartësuar tregon për grupin e tretë të grave, me të cilat është e ndaluar martesa. Ato i përmend në brendinë e disa titujve:

1- **“Me nënat e grave tuaja”**, që do të thotë se, kur një grua martohet me një bsurrë dhe vendos lidhjen e martesës, atij burri i ndalohet martesa me nënën e saj dhe me nënën e nënës së saj...

<sup>1</sup> “Usulul Kafijj”, vëllimi 5, faqe 437, 442.

2- **"Me vajzën e gruas tuaj që gjendet nën kujdestarinë tuaj, nëse me atë grua keni pasur marrëdhënie bashkëshortore (intime)"**, që do të thotë se, në momentin që ju keni bërë lidhjen martesore (kurorëzimin) me gruan, nuk e obligon ndalimin e martesës së tij me vajzat e saj nga burri tjetër, por është kusht që, përveç kontratës së martesës, të kenë gjithashtu edhe marrëdhënie intime.

Prania e këtij kushti në këtë thënie **"...keni pasur marrëdhënie bashkëshortore (intime)..."** pohon se rregulli i nënës së gruas (vjehrrës), i cili u përmend në fjalinë e mëparshme, **"me nënat e grave tuaja"** nuk e ka këtë kusht. Thënë ndryshe: Ky kusht këtu (në këtë pjesë të ajetit) përforcon dhe pohon moskufizimin e rregullit në thënien e mësipërme. Atëherë rezultati është se, sapo të lidhet kurora, burrit i ndalohet martesa me nënën e gruas, edhe nëse nuk ka marrëdhënie intime me vajzën e saj.

Pastaj, kushti **"...nën kujdestarinë tuaj..."** edhe pse kuptohet se vajza e gruas nga burri tjetër nuk është rritur në shtëpinë e burrit të dytë, atij nuk i ndalohet martesa me të, por ky kusht, sipas argumentit të transmetimeve dhe gjykimit të prerë të këtij rregulli, nuk është parandalues, por tregon pikën e ndalimit, sepse shembulli i këtyre vajzave, nënat e të cilave martohen me një burrë tjetër, në përgjithësi, janë në moshë të vogël dhe si rrjedhim, formohen e rriten në shtëpinë e burrit të ri njëjloj si vajzat e tij. Ajeti thotë se vajzat e grave tuaja, që nuk janë tuajat, janë sikurse vajzat tuaja. A mundet që ndokush të martohet me vajzën e vet?

Dhe përzgjedhja e të përshkruarit **"thjeshtira"** (rebaibun), që është shumësi i fjalën (rebijbetun) është për shkak të kujdesjes së burrit të dytë ndaj saj.

Pastaj All'llahu i Lartësuar, për ta përforcuar këtë kërkesë, thotë: **"...e nëse nuk keni pasur marrëdhënie bashkëshortore, atëherë nuk ka pengesa..."**, që do të thotë se, nëse nuk keni pasur kontakt seksual me nënën e saj, është e lejuar të martoheni me vajzat e tyre.

3- **"...ju ndalohet martesë me gratë e bijve tuaj..."** Fjala *halail* do të thotë *gratë e djemve tuaj*. Faza *min eslabikum* ka kuptimin *bijtë tuaj prej shtyllës kurrizore*. Ky ajet ka ndaluar (prishur) një zakon prej zakoneve të këqija të injorancës. Në atë kohë një person birësonte një fëmijë dhe i jepte të gjitha të drejtat njësoj si fëmijës së tij të vërtetë. Për këtë arsye nuk martoheshin me gratë e këtij fëmije, sikurse nuk martoheshin me gruan e fëmijës së vet të vërtetë. Birësimi dhe procedurat e saj nuk kanë bazë në Islam.

4- **"...dhe t'i bashkoni dy motra..."**, që do të thotë se nuk lejohet të bashkohen dy motra në një kurorëzim. Lejohet martesë me dy motrat në kohë të ndryshme, pas ndarjes nga motra e parë. Martesë me dy motra në të njëjtën kohë ka qenë traditë e shëmtuar në kohën e injorancës. Ka pasur njerëz që e kanë vepruar kështu, prandaj ajeti thotë: **"përveç rasteve që tashmë kanë kaluar"**, që do të thotë se edhe ky rregull është si rregullat e tjera, që nuk i përfshijn gjendjet e mëparshme. All'llahu nuk ua merr për mëkat këtë vepër, edhe pse kanë qenë të obliguar që të për zgjedhin njërin prej dy motrave dhe të divorcojnë tjetrën, pasi ka zbritur ky rregull.

Na mbetet të dimë se sekreti i ndalimit të kësaj martese (martesë me dy motra në të njëjtën kohë) në Islam është lidhja gjenetike që kanë këto dy motra me njëra-tjetrën dhe dashuria e fortë që kanë me njëra-tjetrën. Nëse këto të dyja bëhen

konkurruese nën hijen e një burri të vetëm, nuk do të ishte e mundur të ruhej harmonia dhe dashuria ndërmjet tyre.

Në këtë formë mund të ndodhin kundërshtime psikike, të cilat sjellin dëme ndërmjet dy motrave dhe u shkatërron jetën të dyjave.

Secila motër do të vuante vazhdimisht instinktin e garimit dhe konfliktin e brendshëm shkatërrues, fundi i të cilave nuk do të pëlqej.

Disa komentues kanë supozuar se sifjalia **“përveç rasteve që kanë kaluar”** kthehet tek çdo grua që u përmend në fillim të ajetit. Atëherë kuptimi është se, nëse ndokush është martuar me ndonjëren prej këtyre grave, që martesë me to është e ndaluar, atë nuk e përfshin ky rregull i ndalimit të martesës, edhe pse është obligim që, pas zbritjes së këtij ajeti, të hiqnin dorë nga këto gra dhe t'i divorconin.

Fundi i këtij ajeti: **“Pa dyshim All'Ilahu është Falës e Mëshirues”** i përshtatet këtij kuptimi.

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

*Tema*

*Faqja*

|                                                                                |    |
|--------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Ajeti 92</b> .....                                                          | 5  |
| Komentimi .....                                                                | 5  |
| Shenjat e besimit .....                                                        | 5  |
| Çfarë do të thotë fjala el birr’rru në këtë ajet? .....                        | 6  |
| Ndikimi i Kur’anit në zemrat e myslimanëve. ....                               | 7  |
| <b>Ajetet 93- 95</b> .....                                                     | 10 |
| Shkaku i zbritjes.....                                                         | 11 |
| Komentimi. ....                                                                | 12 |
| Teurati në qarkullim dhe ndalimi i mos ngrënies së disa lloje<br>kafshësh..... | 14 |
| <b>Ajetet 96 – 97</b> .....                                                    | 16 |
| Komentimi .....                                                                | 16 |
| Shtëpia e parë e ngritur për njerëzimin.....                                   | 16 |
| Hulumtime .....                                                                | 20 |
| Cili është kuptimi dhe qëllimi i fjalës Bekkeh? .....                          | 20 |

|                                                            |    |
|------------------------------------------------------------|----|
| Zgjerimi i Mesxhidi Haramit (Qabes) .....                  | 21 |
| Veçoritë e Qabes dhe dobisë e saj.....                     | 23 |
| 1. E bekuar - mubarek.....                                 | 23 |
| 2. Udhërrëfyese për popujt.....                            | 24 |
| 3. Në të ka shenja të qarta: Vendi i Ibrahimit .....       | 25 |
| 4. kush hyn në të është i sigurt.....                      | 26 |
| Rëndësia e Haxhit. ....                                    | 28 |
| <b>Ajetet 98 – 101</b> .....                               | 30 |
| Shkaku i zbritjes.....                                     | 31 |
| Komentimi. ....                                            | 33 |
| Përçarësit e rreshtave dhe përhapësit e mospajtimeve. .... | 33 |
| <b>Ajetet 102-103</b> .....                                | 37 |
| Shkaku i zbritjes.....                                     | 38 |
| Komentimi.. ....                                           | 40 |
| Thirrje për devotshmëri.....                               | 40 |
| Thirrje për në unitet.....                                 | 41 |
| Përse përdoret fraza “litarin e All’llahut”?.....          | 42 |
| Armiqtë e djeshëm dhe vëllezër të sotëm. ....              | 43 |
| Pranimi i dijetarëve dhe i historianëve. ....              | 44 |
| Roli i bashkimit në ekzistencën e popujve.. ....           | 47 |
| <b>Ajetet 104-105.</b> .....                               | 48 |

|                                                                                             |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Komentimi .....                                                                             | 49 |
| Thirrja në të vërtetën e lufta ndaj së keqes. ....                                          | 49 |
| Hulumtim .....                                                                              | 52 |
| 1. Çfarë është “e mira” dhe çfarë është “e keqja”? .....                                    | 52 |
| 2. Urdhërimi në të mirë, a është detyrë logjike<br>apo zbatim i porosisë së Profetit?. .... | 52 |
| 3. Rëndësia e urdhërimit në të mirë<br>dhe e ndalimit nga e keqja .....                     | 53 |
| 4. A e mohon lirinë urdhërimi me të mirë?.....                                              | 55 |
| 5. A nuk krijon urdhërimi me të mirë çrregullim në shoqëri?...                              | 55 |
| 6. Urdhërimi në të mirë nuk është ashpërsi .....                                            | 56 |
| 7. Përçarja pas bashkimit është veçori e jehudinëve<br>dhe e të krishterëve.....            | 58 |
| <b>Ajetet 106-107</b> .....                                                                 | 61 |
| Komentimi. ....                                                                             | 61 |
| Fytyra të zbardhura dhe fytyra të nxira.....                                                | 61 |
| <b>Ajetet 108-109</b> .....                                                                 | 64 |
| Komentimi. ....                                                                             | 64 |
| <b>Ajeti 110</b> .....                                                                      | 66 |
| Komentimi .....                                                                             | 66 |
| Luftimi i së keqes dhe thirrja për tek e vërteta dhe tek e drejta.....                      | 66 |

|                                                  |    |
|--------------------------------------------------|----|
| Dy qëndrime në këtë ajet .....                   | 67 |
| <b>Ajetet 111-112.</b> .....                     | 70 |
| Shkaku i zbritjes.....                           | 71 |
| Komentimi. ....                                  | 71 |
| Jehudinjtë dhe qëndrimi i tyre i përhershëm..... | 74 |
| E ardhmja e zyrtë e jehudinje.....               | 76 |
| <b>Ajeti 113 -115.</b> .....                     | 78 |
| Shkaku i zbritjes.....                           | 79 |
| Komentimi .....                                  | 79 |
| <b>Ajetet 116-117.</b> .....                     | 82 |
| Komentimi. ....                                  | 83 |
| Hulumtim .....                                   | 85 |
| Shpenzimi i jobesimtarëve.....                   | 85 |
| <b>Ajeti 118- 120</b> .....                      | 88 |
| Shkaku i zbritjes.....                           | 89 |
| Komentimi. ....                                  | 90 |
| Mos i bëni armiq të miq.....                     | 90 |
| Urrejtja përballë dashurisë.....                 | 91 |
| Hulumtim.....                                    | 93 |
| Paralajmërim për myslimanët .....                | 93 |
| <b>Ajeti 121 – 122.</b> .....                    | 95 |

|                                                                                                                   |     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Komentimi..                                                                                                       | 96  |
| Hulumtim.                                                                                                         | 99  |
| Shkaku i Betejës së Uhudit                                                                                        | 99  |
| Abasi i dërgon mesazh Profetit.....                                                                               | 99  |
| Profeti konsultohet me myslimanët....                                                                             | 100 |
| Myslimanët përgatiten për t'u mbrojtur.....                                                                       | 101 |
| Fillimi i betejës.                                                                                                | 103 |
| Kush thirri se Muhammedi (Paqja dhe bekimet e All'llahut<br>qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u vra?! ..... | 105 |
| <b>Ajeti 123- 127.</b>                                                                                            | 107 |
| Komentimi..                                                                                                       | 108 |
| Periudha e rrezikshme e luftës.. .....                                                                            | 108 |
| <b>Ajeti 128.....</b>                                                                                             | 112 |
| Komentimi .....                                                                                                   | 112 |
| Ndreqja e gabimit.....                                                                                            | 114 |
| <b>Ajeti 129..</b>                                                                                                | 117 |
| Komentimi. ....                                                                                                   | 117 |
| <b>Ajeti 130-132.....</b>                                                                                         | 119 |
| Komentimi.. .....                                                                                                 | 120 |
| Rreth lidhjes ndërmjet ajeteve të Kur'anit.....                                                                   | 120 |
| Ndalimi i kamatës në disa periudha.....                                                                           | 121 |

|                                                               |     |
|---------------------------------------------------------------|-----|
| Ndalimi i kamatës në këtë ajet. ....                          | 123 |
| <b>Ajetet 133 -136.</b> .....                                 | 125 |
| Komentimi.....                                                | 126 |
| Garimi në fushën e lumturisë.....                             | 126 |
| Dy pyetje: .....                                              | 128 |
| Ku ndodhet Xhenneti dhe Xhehennemi? .....                     | 129 |
| Veçoritë e të devotshmëve. ....                               | 132 |
| <b>Ajetet 137 – 138.</b> .....                                | 140 |
| Komentimi... ..                                               | 140 |
| Shikim në historinë e të shkuarve dhe në gjurmët e tyre. .... | 140 |
| Udhëtimi në tokë.....                                         | 142 |
| <b>Ajetet 139-143</b> .....                                   | 146 |
| Shkaku i zbritjes .....                                       | 147 |
| Komentimi .....                                               | 148 |
| Studimi i rezultateve të Luftës së Uhudit .....               | 148 |
| Ngjarjet e hidhura edukojnë .....                             | 152 |
| Hamendësime të kota .....                                     | 154 |
| Studim i shpejtë për shkaqet e humbjes në Uhud.....           | 155 |
| <b>Ajetet 144- 145</b> .....                                  | 157 |
| Shkaku i zbritjes .....                                       | 158 |
| Komentimi .....                                               | 160 |

|                                                   |     |
|---------------------------------------------------|-----|
| Nuk ka adhurim dhe mbivlerësim të individit ..... | 160 |
| <b>Ajetet 146 – 148</b> .....                     | 166 |
| Komentimi .....                                   | 167 |
| Muhaxhidinët e parë .....                         | 167 |
| Çështje të tjera që trajtohen në këto ajete ..... | 168 |
| <b>Ajeti 149-151</b> .....                        | 170 |
| Komentimi .....                                   | 171 |
| Vërejtjet e njëpasnjëshme .....                   | 171 |
| Fitorja me faktorin e frikës .....                | 174 |
| <b>Ajetet 152– 154</b> .....                      | 176 |
| Komentimi .....                                   | 178 |
| Humbja pas fitores.....                           | 178 |
| Cytjet e injorancës.....                          | 182 |
| <b>Ajeti 155</b> .....                            | 186 |
| Komentimi .....                                   | 186 |
| Mëkati pason një mëkat tjetër .....               | 186 |
| <b>Ajeti 156 – 158</b> .....                      | 188 |
| Komentimi .....                                   | 189 |
| Veprimi i hipokritëve .....                       | 189 |
| <b>Ajetet 159 – 160</b> .....                     | 193 |
| Komentimi .....                                   | 194 |

|                                                  |     |
|--------------------------------------------------|-----|
| Urdhri për falje të përgjithshme.....            | 194 |
| Urdhri për konsultim.....                        | 196 |
| Hulumtime .....                                  | 199 |
| 1. Rëndësia e konsultimit në Islam .....         | 199 |
| 2, Me kë duhet të këshillohesh? .....            | 201 |
| 3, Detyra e konsultuesit.....                    | 201 |
| 4, Konsultimi i Umer ibn Hatabit.....            | 202 |
| 5, Faza e vendimit përfundimtar.....             | 204 |
| 6, Rezultati i mbështetjes dhe frytet e tij..... | 206 |
| <b>Ajeti 161</b> .....                           | 208 |
| Komentimi .....                                  | 208 |
| Tradhtia është e ndaluar rreptësisht .....       | 208 |
| <b>Ajeti 162–163</b> .....                       | 212 |
| Komentimi .....                                  | 212 |
| Kundërshtarët e xhihadit (luftës) .....          | 212 |
| Metoda ndikuese dhe edukuese kur'anore .....     | 214 |
| <b>Ajeti 164</b> .....                           | 216 |
| Komentimi .....                                  | 216 |
| Mirësia e madhe e All'llahut .....               | 216 |
| Kur njihet vlera e dërgimit të Profetit? .....   | 220 |
| <b>Ajeti 165</b> .....                           | 221 |

|                                                   |     |
|---------------------------------------------------|-----|
| Komentimi .....                                   | 221 |
| Studime të tjera rreth Betejës së Uhudit.....     | 221 |
| <b>Ajetet 166-167</b> .....                       | 223 |
| Komentimi .....                                   | 224 |
| Rreshtat duhet të dallohen.....                   | 224 |
| <b>Ajeti 168</b> .....                            | 228 |
| Komentimi .....                                   | 228 |
| Pretendimet e kota të hipokritëve.....            | 228 |
| <b>Ajetet 169-171</b> .....                       | 230 |
| Komentimi .....                                   | 231 |
| Jeta e përjetshme .....                           | 231 |
| Dëshmia e qëndrimit të shpirtit.....              | 234 |
| Shpërblimi i Dëshmorëve .....                     | 235 |
| <b>Ajetet 172-174</b> .....                       | 237 |
| Komentimi .....                                   | 238 |
| Beteja Hamraul Esed .....                         | 238 |
| Edukimi hyjnor dhe shpërblimi i menjëhershëm..... | 242 |
| <b>Ajeti 175</b> .....                            | 243 |
| Komentimi .....                                   | 243 |
| <b>Ajetet 176 – 177</b> .....                     | 245 |
| Komentimi .....                                   | 246 |

|                                                         |     |
|---------------------------------------------------------|-----|
| Mbështetja shpirtërore e Kur'anit për Profetin .....    | 246 |
| <b>Ajeti 178</b> .....                                  | 248 |
| Komentimi .....                                         | 248 |
| Të rënduarit me mëkate .....                            | 248 |
| Përgjigjja e pyetjes .....                              | 251 |
| Çështje gjuhësore dhe letrare .....                     | 252 |
| <b>Ajeti 179</b> .....                                  | 254 |
| Komentimi .....                                         | 255 |
| Myslimanët në fushën e provimit dhe të ndarjes .....    | 255 |
| <b>Ajeti 180</b> .....                                  | 258 |
| Komentimi .....                                         | 258 |
| Qaforja e rëndë e robërisë .....                        | 258 |
| <b>Ajetet 181-182</b> .....                             | 261 |
| Shkaku i zbritjes .....                                 | 262 |
| Komentimi .....                                         | 263 |
| <b>Ajetet 183-184</b> .....                             | 267 |
| Shkaku i zbritjes .....                                 | 268 |
| Komentimi .....                                         | 268 |
| Idetë e gabuara të jahudive dhe shpjegimet e tyre ..... | 268 |
| <b>Ajeti 185</b> .....                                  | 272 |
| Komentimi .....                                         | 272 |

|                                                            |     |
|------------------------------------------------------------|-----|
| Vdekja dhe ligji i saj i përgjithshëm .....                | 272 |
| <b>Ajeti 186</b> .....                                     | 276 |
| Shkaku i zbritjes .....                                    | 276 |
| Komentimi .....                                            | 277 |
| Mos t'ju lodhë juve rezistenca .....                       | 277 |
| <b>Ajeti 187</b> .....                                     | 279 |
| Komentimi .....                                            | 279 |
| Dijetarët dhe detyrat e tyre madhore .....                 | 281 |
| <b>Ajetet 188 – 189</b> .....                              | 283 |
| Shkaku i zbritjes .....                                    | 284 |
| Komentimi .....                                            | 285 |
| Të mahnitur me veten e tyre .....                          | 285 |
| <b>Ajetet 190-194</b> .....                                | 287 |
| Rëndësia e këtyre ajeteve .....                            | 288 |
| Komentimi .....                                            | 290 |
| Rrugët më të qarta për të njohur All'llahun .....          | 290 |
| <b>Ajeti 195</b> .....                                     | 297 |
| Shkaku i zbritjes .....                                    | 298 |
| Komentimi .....                                            | 299 |
| Rezultat i mirë për qëndrimin e të zotëve të mendjes ..... | 299 |
| Vlera shpirtërore e mashkullit dhe e femrës .....          | 300 |

|                                                  |     |
|--------------------------------------------------|-----|
| <b>Ajetet 196-198</b> .....                      | 303 |
| Shkaku i zbritjes .....                          | 304 |
| Komentimi .....                                  | 305 |
| Pyetje shqetësuese.....                          | 305 |
| Njohja e pikave të dobëta dhe të forta.....      | 307 |
| <b>Ajeti 199</b> .....                           | 311 |
| Shkaku i zbritjes .....                          | 311 |
| Komentimi .....                                  | 312 |
| Ithtarët e Librit nuk janë të barabartë.....     | 312 |
| <b>Ajeti 200</b> .....                           | 315 |
| Komentimi .....                                  | 315 |
| <b>SURE “EN-NISÂ”</b> .....                      | 321 |
| 1. Tematika e zbritjes së kësaj sureje .....     | 322 |
| 2. Përmbajtja e kësaj sureje.....                | 323 |
| 3. Mirësitë e leximit të kësaj sureje .....      | 325 |
| <b>Ajeti 1</b> .....                             | 326 |
| Komentim .....                                   | 327 |
| Luftimi i dallimeve dhe i përvetësimeve.....     | 327 |
| Si ka qenë martesë e bijve të Ademit? .....      | 329 |
| Thirrja për ruajtjen e lidhjeve farefisnore..... | 331 |
| <b>Ajeti 2</b> .....                             | 333 |

|                                                                         |     |
|-------------------------------------------------------------------------|-----|
| Shkaku i zbritjes .....                                                 | 333 |
| Komentimi .....                                                         | 334 |
| Jo tradhti e mashtrim në pasurinë e jetimit .....                       | 334 |
| <b>Ajeti 3</b> .....                                                    | 337 |
| Shkaku i zbritjes .....                                                 | 337 |
| Kometimi.....                                                           | 338 |
| Dy hulumtime.....                                                       | 341 |
| 1. Cili është qëllimi te drejtësia mes grave .....                      | 341 |
| 2. Poligamia domosdoshmëri shoqërore .....                              | 344 |
| <b>Ajeti 4</b> .....                                                    | 352 |
| Komentimi .....                                                         | 352 |
| Hulumtim .....                                                          | 354 |
| Mehri, mbështetje shoqërore për gruan .....                             | 354 |
| <b>Ajetet 5-6</b> .....                                                 | 358 |
| Komentimi .....                                                         | 359 |
| Kush është (sefijhu) i paafte mendërisht .....                          | 359 |
| Pasuria juaj mjet jetese për ju .....                                   | 362 |
| Dy mësim në çështjen e jetimëve.....                                    | 363 |
| Një tjetër mësim në çështjen e jetimëve<br>dhe të pasurisë së tyre..... | 364 |
| <b>Ajeti 7</b> .....                                                    | 368 |

|                                                    |     |
|----------------------------------------------------|-----|
| Shkaku i zbritjes .....                            | 368 |
| Komentimi .....                                    | 369 |
| Tjetër hap për të ruajtur të drejtat e grave.....  | 369 |
| <b>Ajeti 8</b> .....                               | 371 |
| Komentimi .....                                    | 371 |
| Rregull moralo-etik .....                          | 371 |
| <b>Ajeti 9</b> .....                               | 374 |
| Komentimi .....                                    | 374 |
| Thirrje për mirësjellje ndaj jetimëve.....         | 374 |
| Hulumtim .....                                     | 376 |
| <b>Ajeti 10</b> .....                              | 378 |
| Komentimi .....                                    | 378 |
| Imazhi (pamja) i drejtë për veprat e njerëzve..... | 378 |
| <b>Ajetet 11-12</b> .....                          | 382 |
| Shkaku i zbritjes .....                            | 384 |
| Dy hulumtime.....                                  | 385 |
| 1. Trashëgimia e drejtë, e natyrshme .....         | 385 |
| 2. Trashëgimia në popujt e mëparshëm.....          | 387 |
| Komentimi .....                                    | 390 |
| Përse mashkulli trashëgon dyfishin e femrës .....  | 392 |
| Trashëgimia e babait dhe e nënës .....             | 394 |

|                                                            |     |
|------------------------------------------------------------|-----|
| Trashëgimia pas testamentit (el uesijes) dhe borxhit ..... | 397 |
| Pjesa që u takon bashkëshortëve nga njëri-tjetri .....     | 398 |
| Trashëgimia e vëllezërve dhe e motrave të të vdekurit..... | 400 |
| Kthim në komentimin e ajetit .....                         | 401 |
| Hulumtime .....                                            | 403 |
| <b>Ajetet 13-14</b> .....                                  | 406 |
| Komentimi .....                                            | 406 |
| Dy hulumtime.....                                          | 409 |
| 1. Dallimet e ligjit islam të trashëgimisë.....            | 409 |
| 2. Çfarë do të thotë fjala aul dhe fjala ta'sijib?. .....  | 411 |
| <b>Ajetet 15-16</b> .....                                  | 414 |
| Komentimi .....                                            | 415 |
| Dëshmia përmbi veprat e këqija.....                        | 415 |
| Hulumtim .....                                             | 420 |
| Ndëshkimet e Islamit janë të lehta dhe parandaluese.....   | 420 |
| <b>Ajeti 17-18</b> .....                                   | 422 |
| Komentimi .....                                            | 423 |
| Kushtet e pranimi të pendimit.....                         | 423 |
| <b>Ajeti 19</b> .....                                      | 429 |
| Shkaku i zbritjes .....                                    | 429 |
| Komentimi .....                                            | 430 |

|                                      |     |
|--------------------------------------|-----|
| Mbrojtja e të drejtave të grave..... | 430 |
| <b>Ajetet 20-21</b> .....            | 433 |
| Shkaku i zbritjes .....              | 433 |
| Komentimi .....                      | 434 |
| <b>Ajeti 22</b> .....                | 437 |
| Shkaku i zbritjes .....              | 437 |
| Komentimi .....                      | 438 |
| <b>Ajeti 23</b> .....                | 440 |
| Komentimi .....                      | 441 |
| Ndalimi i martesës me meharim .....  | 441 |

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء چهارم)

نویسنده: فقیہ مفسر حضرت آية الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلہ)

مترجم به زبان آلبانی: آگیم رچای و وُلْنَتْ مِرْیَا

ویرایش: مییدا کولا

مقابلہ: سونیلا کاظمی

صحافی: کوزتا لاپری

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیراژ: 1000 نسخه

تیرانا: 2013

# الأمثل فی تفسیر کتاب الله المنزل

مؤلف: علامہ مفسر ناصر مکارم شیرازی

جزء چہارم

مترجم: آگیم رچای و وُلَّتْ مَرِيَا

تیرانا: 2013